Xhevahir Cirongu
Bedri Neziri

KOSMOGONIA E NJË POETI KOSOVAR

Xhevahir Cirongu
Bedri Neziri

KOSMOGONIA E NJË POETI KOSOVAR

Durrës, 2015

Redaktor:
Xhevahir Cirongu
Bedri Neziri

Recensent:
Mazllum Baraliu

Lektor:
Veli Veliu

Dizajni i ballines:
Mentor Lutolli

Botues:
''Medaur''Durrës
ISBN 9789946-36-2

PARATHËNIE

Bedri Neziri (1)
Xhevahir Cirongu (2)

Ky libër është një përmbledhje kritikash letrare të autorëve të njohur të vendit dhe të huaj që me një vështrim mjeshtëror dhe të mprehtë shkruajnë për krijimtarinë letrare të poetit kosovar Adem Zaplluzha, i cili inkorporohet në gjirin e margaritarëve të poetëve të rrallë të letrave tona që krijon një lirikë me motive të veçantë kosmogonike. Ndërkaq , ky libër mëton të hedhë dritë mbi krijimtarinë letrare të poetit kosovar duke e pasqyruar dhe argumentuar vlerat e veçanta ku përshkruhet fryma e modernitetit të ideve filozofike, kurse në qendër të shqetësimeve të tij është revolta, kundruall një realiteti të hidhur, me kuptim, që qenia njerëzore t'i ikë karakterit negativ, dhe të prezantojë ato vlera që shquhen për vizionin e tij të një bote të dëlirë. Kurse vepra e poetit kosovar Adem Zaplluzha, do të lënë gjurmë në fushën e letërsisë me një varg kritikash të studiueseve të njohur vendas e të huaj që janë marrë mbi krijimtarinë letrare. Ndërkaq ta njohësh veprat e këtij poeti kosovar nuk është vetëm një lexim i thjeshtë, sepse para nesh kemi një krijues i cili ka 123-të vepra të botuar, dhe po ta analizojmë krijimtarinë e poetit kosovar Adem Zaplluzha, do ta shohim origjinalitetin dhe

sinqeritetin që komunikon, ëndërron, shkruan dhe është ndër poetët e rrallë të letrave tona që i afrohet viteve të 72-ta të jetës së tij . Ai meriton të hyjë në librin e GINISIT për numrin e madh të veprave të botuar brenda vitit përkatësisht brenda një viti del t'i këtë shkruar me se 30-të vepra. I tëre opusi letrar i poetit kosovar shquhet për kah botimin e veprave letrare që janë gurë të veçantë të një mozaiku xhevahiresh dhe që pasqyrojnë hapësirën mbarë shqiptare me të gjitha ngjyrat e saj. Cilido lexues që do ta marrë në duar veprat e këtij poetit Kosovar, do të shohë se ka vlera të veçanta në poezitë e tij. Veprimtaria letrare është shumë produktive dhe joshëse për çdo lexues. Vepra e tij është e veçantë dhe emblematike që i ofron lexuesit një spektakël të botës metafizike, duke i nxjerrë në pah shumë mendime refleksive, mbi nektarin e fjalës së bukur artistike dhe melankolinë e shpirtit tij që udhëton krenar duke i skalitur e thurur tinguj muzikal të poezisë lirike, që me afshin e shpirtit dhe gurgullimat e zemrës së tij të zhuritur për dashuri dhe atdhedashuri. Poeti kosovar nuk ndalet se thururi vargje por ai, vazhdon rrugën drejtë së ardhmes me mesazhin se e nesërmja do jetë më e bukur për shoqërinë tonë ku depërton thellë në memorien e çdo lexuesi duke qenë i pavarur nga ndikimet e të tjerëve, Ndërkaq poeti kosovar nuk dështon kurrë në fushën e artit, sepse ai, di të hapë rrugët e ndjenjave të tija, i cili është si një gurrë e pashtershme të frymëzimeve të tija lirike, duke i trasuar

në shtigje të reja përmes këngës së një kombi martirësh që nuk u gjunjëzua kurrë. Hapësira e atyre që kanë bërë vlerësime dhe kritikat letrare nëpër korpusin e botimeve të poetit Adem Zaplluzha, janë nga gjithë trojet shqipfolëse, madje edhe nga kritikë shqiptarë që jetojnë e shkruajnë në vendet e tjera, si në Ballkan ashtu edhe në Evropë. Lexuesi do t'i gjejë me lehtësi emrat e tyre në këtë përmbledhje vlerësuese që botohet me rastin e 72 vjetorit të lindjes së poetit tashmë të afirmuar në shkallë kombëtare e më gjerë. Më shumë se vlerësimet tona, flet puna e vepra e vetë poetit Kosovar, Adem Zaplluzha.

Kastriot, 4 janar 2015

(2)

Poezia e Adem Zaplluzhës ka universin e dashurisë për atdheun

Shfleton librat e poetit Kosovar Adem Zaplluzha, dhe vetja të duket sikur udhëton së bashku me vargun poetik nëpër atdheun tonë të dashur Shqipëri! Në çdo varg të poezisë gjen arteret e e venat e poetit të mbushura me gjak shqiptari, të cilat gurgullojnë udhëve të atdheut tonë nga veriu në jug, nga lindja në perëndim të vendit tonë . Vetë poeti është i shkrirë si një trup i vetëm së bashku me vargun e poezisë në çdo thërrmijë dheu, e prej andej ai si një llavë të zjarrtë mbjell dashuri në zemrat e njerëzve. E veçanta e këtij poeti është se, në oazën e botimeve që ato janë të shumta, spikatin për një stil sa të thjesht, po aq edhe filozofik që përcjellin tek lexuesi. Ai është i kuptueshëm në vargun që shkruan, saqë ky varg i lexuar nga gjithë shtresat shoqërore, duke filluar nga punëtori, nxënësi, bujku, historiani, intelektuali, etj, përcjell tek ata mesazhe të qarta e që të mbeten në memorie. Me të drejtë, për këtë autor prodhimtar si një ‘’ frut shege’’, kanë shkruar mendimet e tyre duke e cilësuar si një poet vizionar e që meriton një vlerësim të veçantë . Hapësira e atyre që kanë bërë vlerësime dhe kritikat letrare nëpër korpusin e botimeve të poetit Adem Zaplluzha, janë nga gjithë trojet shqipfolëse, madje edhe nga kritikë shqiptarë që jetojnë e shkruajnë në vendet e tjera, si në Ballkan ashtu edhe në Evropë.

Lexuesi do t'i gjejë me lehtësi emrat e tyre në këtë përmbledhje vlerësuese që botohet me rastin e 72 vjetorit të lindjes së poetit tashmë të afirmuar në shkallë kombëtare e më gjerë.

Më shumë se vlerësimet tona, flet puna e vepra e vetë poetit Kosovar, Adem Zaplluzha. Sigurisht , ky libër për poetin do të jetë si një gur meteori, cili do t'i japi forcë shqiponje, do e rigjallërojë në shpirt për t'i thënë vargut poetik: Do jetoj me ty gjithmonë.

Durrës, 18 Dhjetor 2014.

JETA DHE VEPRA E POETI TË KOSOVËS ADEM ZAPLLUZHA

Adem (Haki)Zaplluzha i lindur me 1 shkurt 1943 në Prizren në një familje bujare fshatare me tradita kombëtare. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës dhe Hoça e Qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në në gazetën e punëtorëve"Kosova" të KEK-ut (ish KXEM "Kosova") deri sa edhe u pensionua . Si i punësuar në KXEM "Kosova" përveç punës si përkthyes ai së bashku me disa shokë të punës dhe të penës, formuan grupin letrar "Lulëkuqet Kosovës" ku veprimtarinë letrare e ka zhvilluar në Shtëpinë e Kulturës së Punëtorëve, të KXEK "Kosova" në Obiliq. Në numrat e kësaj gazete të punëtorëve u botuan disa shkrime të tij por edhe të anëtarëve të grupit letrar''Lulëkuqet e Kosovës'' *dhe gjatë kohës së veprimtarisë së këtij grupi letrar që botuar dy përmbledhje"Ngjyra e kohës",(1975) dhe "Dashuria e madhe",(1981) në të cilën u botuan një numër i poezive të tij. Me shkrime filloi të merret kryesisht me poezi që nga* mosha e fëmijërisë .Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë, të cilën e botoi në revistën "Pionieri", më 1957. Si i punësuar ne Korporatën Energjetike të Kosovës, bashkë publikuara

në revistat për fëmijë, botoi edhe një sërë krijimesh letrare nëpër gazeta dhe revista, që dilnin në Prishtinë,Shkup dhe Zagreb. Në vitin 2010 i përkthehet një libër ne gjuhën Rumune, nga përkthyesi i mirënjohur Baki Ymeri,"Pema e Bekuar", libër, i cili u mirëprit nga lexuesi Rumun. Po atë vit, në një nga numrat e revistës "Shqiptari",në Rumani, në bashkëpunim me redaksinë revistës "Dituria",në Boras të Suedisë, botohet një antologji, "Jehona e Shekujve", autor Sokol Demaku, ndërsa në gjuhën angleze Antologji me poezi shqipe të botuar në Londër nga autorët Fatmir Terziu dhe Agim Mato me titull:" Lotët e Virgjër" Virgin Tears , ku përfshihen edhe disa punime të Adem Zaplluzhës. Është prezantuar në LEKSIKONIN I SHKRIMTARËVE SHQIPTAR 15O1-1990, nga Hasan Hasani, si dhe në LEKSIKONIN SHKRIMTARËT SHQIPTAR PËR FËMIJË,1872- 1995 nga Odhise K. Grillo, dhe në librin Portrete Shkrimtarësh nga Demir Behlul, Prishtinë,2002. Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe si dhe është përfaqësuar në Rumuni në një antologji të Shkrimtarëve të Kosovës nga Monica Marushan KOSOVA LITERARA, (Kosova letrare, përkthyer nga Baki Ymeri,alias Alban Voka. 20 11) Prej vitit 1976 është anëtarë i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Ndërkaq aktivitetin letrar e zhvillon në Kastriot pranë Shoqatës së Shkrimtarëve"Fahri Fazliu" i cili është ndër themeluesit e kësaj Shoqatë. Në krijimtarinë letrare u dallua kryesisht në vitet pasluftës ka shkruar poezi për të rritur kryesisht ,por nuk kanë mbetur

jashtë vëmendjes së tij edhe lexuesit e vegjël i cili u shpall krijuesi me i suksesshëm i viteve 2011,2012,2013,2014 dhe është nderuar me “Çmimin për vepër jetësore” nga Shoqata e Shkrimtarëve”Fahri Fazliu”në Kastriot. Jeton dhe vepron në Prishtinë .

Refleksione...

KËNGËTIMI POETIK I ADEM ZAPLLUZHES, PASQYRIM I BOTËS REALE

Kur flasim për vargun poetik të poetit A. Zaplluzha, kemi parasysh se kemi të bëjmë me një krijues të mirëfilltë, i cili në letërsinë shqiptare bashkëkohore është krijuesi më frytdhënës, ku kultivohet fjala e bukur poetike. Poeti Zaplluzha me zell të madh, përkushtim, pasion, dashuri dhe energji të pashtershme i dedikohet poezisë. Ai deri më tani ka botuar 122 vepra me poezi të zhanreve të ndryshme, për të rritur dhe fëmijë. Veprat e tij janë përmbledhje me motive, frymëzime dhe me tematika nga më të ndryshmet që janë në dobi të lexuesit tonë, nga se ato nxjerrin në pah aktin e lindjes, atdheun, ëndrrat fëmijërore dhe fëmijërinë, mallin për vendlindje, dashurinë, sakrificën për lirinë e vendit, ku me mjeshtri ka poetizuar: “Nuk dua vdekje më të bukur, sesa kjo kënaqësi, që shtrihet në krahun e djathtë, të fluturës së atdheut tim”. Me punë të palodhshme dhe kontribut të jashtëzakonshëm për avancimin e Adem Zaplluzha me bashkëshorten në ekspozitën e librave të botuar kauzës kombëtare dhe shoqërore poeti kërkon nga të gjithë shumë punë, mirëkuptim, dashuri, harmoni dhe përkushtim në ndërtimin e vendit dhe të shtetit të ri, ne konsolidimin dhe përparimin e atdheut sepse sipas poetit përgjumja askujt nuk i bënë mire. Pra, krijuesi Zaplluzha

me këmbëngulje kërkon që të mos ketë ngecje, por të ecet përpara deri në ngadhënjim, siç e dëshmojnë edhe vargjet: **“Ne duhet tëecim bijtë e mi, domosdo duhet të ecim, përtej ngadhënjimit të fjalës” ...** “ etj. Shihet qartë në krijimtarinë e tij se zëri protestues i poetit shfaqet me nota dhembshurie dhe të ashpra i cili tenton që përmes vargut të ndikojë në mendjet e atyre te cilët me vetëdije hapin plagë të pashlyeshme në jetën njerëzore. Se vërtet A. Zaplluzha është zë kryengritës dhe është vetë shpirti i popullit flasin edhe këto vargje: “Vargu im kryeneç, sa shumë i përngjan shpirtit të popullit saqë pa te kurrë nuk do të mund të qëndroj aq fort në këmbët e veta”. Si shumë poetë tjerë edhe A. Zaplluzha ka bërë emër me vepra cilësore si nga ana artistike aq më shumë edhe me mesazhe që ato përcjellin te lexuesi. Poezitë e këtij poeti janë shkruar me gjuhë artistike që lexuesin e bëjnë për vete dhe veprat i ngre në nivel të lartë ideoartistik. Këtë nivel dhe vlerë poetike e vërtetojnë edhe recensionet e shumë studiuesve për poezitë e A. Zaplluzhës, shkruar e botuar në revista e gazeta të periudhave të ndryshme kohore, nga të cilët po citojmë: “Produksioni i tij letrar i gjertanishëm është i denjë edhe për shoqata , asociacione dhe madje për akademi të tëra, të arteve e të shkencave të ndryshme, gjë që gjerë me tani nuk na ka ra të dëgjojmë, se në të vërtetë ka ndodhur”, nga Dr. Mazllum Baraliu.

“Vargu që shkruan në haik Ademi, pulson fuqishëm me vendlindjen e tij Prizrenin. Rrënjët e vargut poetik janë ngulur nga veriu, deri në skajin më jugor të Shqipërisë, atje deri te deti Jon”, nga Xhevahir Cirongu, poet.“Ka ardhur koha që një poet si Adem Zaplluzha të renditet në fronin e bukur të poetëve cilësorë të shqipes”, nga Përparim Hysi, poet dhe “Lirikat e poetit Adem Zaplluzha lexuesin e bëjnë për vete”,

Shahbaze Vishaj, shkrimtare.

Deri me tani ka të botuara këta vepra letrare:

1"Puthje"1974, **2.**"Ecjet e viteve të mëdha"1995, **3**."Çamarrokët e Thepores"1996. **4**."Muret"1997, **5**."Morfologjia e dhembjes" 2000, **6**."Ai vjen nesër"2oo7, **7.**"Letër nga mërgimi" 2007,**8.**"Letër nga mërgimi 2 2007, **9.**"Udhëndarja"2007, **1o.**"Thirrje e gjakut" 2008, **11.**"Asgjë sikur molla"20008, **12**."Vesa në lotin tim" 2009, **13.**"Puthja e gozhduar" 2009, **14**."Kashelasha në vargje",2oo9, **15.**"Pema e bekuar" E përkthyer, Rumani, 2o1o, **16.**"Bajraktarët e vatanit" 2010, **17.**"Hijet e ndryshkura" 2010, **18.**"Stuhi në Kutulishte" 2010, **19.** "Posa ikte nata"2010. **2o.** "Loja e myshqeve", 2010., **21**. "Lumëbardhi dhe gjëma",2o1o **22.** "Metafora e heshtjes", 2o1o, **23**. "Hyji në Prekaz" 2010**. 24.** "Sinorët e hinores", 2010, **25**. "Don Kishoti dhe Rosinanti"2010, **26**."Zjarri i dashurisë" 2010, **27**. "Kur likenet vallëzojnë" 2010, **28.** "Ditari në vargje" 201O , ,**29.** "Tingujt që nuk përfundojnë" 2o1o**, 3o.** "Shtegu i mallit" 2010, **31**."Korniza e thyer"'2010, **32.** "Zgjimi i gjëmës" 2010, **33.** "Vallja mistike",2010, **34.** "Merre kodin" 2011, **35.** " Letër atdheut" 2011, **36.** " Tejdukshmëria e shiut"2o11, **37.** " Përtej teje"2011, **38.** "Sa afër e sa larg" 2011, **39**. "Vallja e zanoreve",2011, **40**. "Ikja e eshtrave" 2o11, **41.**"Kalorësit e mjegullave" 2012**, 42**. "Hingëllimat e shiut" 2012, **43.** "Kur pemët i ndërrojnë këmishët" 2o12**, 44.** "Mirëmëngjes Imzot" 2o12, **45.** "Kafshimi i mikut" 2012, **46.** "Atje tej maleve"2012, **47**. "Heshtja që del në shesh" 2o12, **48.** "Portat e shpresës" 2012, **49.** "Në dhomën time gjysmë

të errët” 2o12, **5o.** “Kinse Lojë Shahu” 2o12, **51.** “ Për çdo dekadë nga një baladë “ 2o12, **52**. “Fusha e mëllenjave” 2o12**, 53**. “E kujt është kjo vetmi” 2o12, **54**. “Mos pyet për adresën e lumit 2012, **55.** “ Stoli në parkun vjetër” 2012, **56.** “Urori i stralltë”,2o12, **57.** “Po të mos ishte fjala” 2o12, **58.** “Thyerja e urave”, 2o12, **59.** “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”, 2o12, **60.** “ Në flokët e dëborës” 2012, **61.**“Një grusht nostalgji” 2o12**, 62.** “ Kur filluan të flasin njerëzit” 2012, **63.** “Kur stinët kapërcejnë fshehurazi” 2012, **64**. “ Lisi në rrënjët e veta” 2o12, **65**. “Eca ecëm dhe do ecim”2o12, **66.** “Fëmijët e erës” 2012, **67.** “ Çast në fund të stinës” 2012**, 68.** “Si të flas me drurët”2012, **69,** “ Më pëlqejnë mendimet e tua” 2012, **70.** ”Andej dhe këndej kohës” 2012**, 71.** “Zëri i heshtjes”, 2o12, **72.** “Kush i lexoi letrat prej erës” 2012, **73.** “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë” 2012, **74.** “Koha e ime dhe koha e jote” 2012, **75**.” Diku te një baladë” 2012, **76.** “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve” 2012, **77 “** Ky def pre hëne” 2012, **78.“**Pyesni zogjtë në ikje ” 2013, **79** “ Fërfërimë gjethesh” 2013, **80.** “Refrene yjesh” 2013, **81.** “Te delta e mjellmave”2013, **82**.“Rinjohja” 2013**, 83**.“Diku në fund të një fillimi” 2013, **84**.“Makthi i hijes” 2013, **85.**“Një zog prej uji”2013, **86**.”Asnjë fjalë nuk frymon” 2014, **87.**”Daullet e një nate” 2014, **88**.”Sytë e gurtë të erës” 2014, **89.**”Kur dehen perënditë” 2014, **90.** “Fjetëm njëqind shekuj” Prozë poetike, 2014, **91**.”Krakëllimat e natës” 2014, **92.** “Ndjekësit e enigmave” 2014, **93.** “Atdheu i paçmuar” 2014**, 94, ”**Psalm i harruar ”,2014**, 95,”**Për kë po bie moj kambanë” 2014, **96.** “Mbi flokët e ullukëve” 2014, **97.** “Menatë vijnë lejlekë” 2014, **98**. “Loti i gotës së dehur” 2014**, 99.** “Stina asnjanëse” 2014, **100.** “Dëneste bashkë

me erën” 2014, **101**. “Druri i pikëlluar” 2014, **102.** “ Një grusht dashuri” 2014, **103.** “Lëreni zërin tim” 2014, **104.** “Shi në qytetin tim” 2014 **105.** “Si trenat e verbër ” 2014, **106.** “Zjarri i malli tim ” 2014, **107** . “Kur teshtinë era ” , 2014, **108.** “Mbi shpirtin e erës pagane ” 2014, **109.** “Nëpër gjymtyrët e mjegullave” 2014, **110**”Ajo nuk erdhi sonte” 2015, **111**.“Një hënë e zhveshur”2015, **112.** “Nëpër plasaritjet e mureve”2015, **113.**“Mes telave *gjembor* ”, 2015, **114.** “Të vizatosh një zog në mur”2015, **115.”** Nuk flenë as kuajt e dehur”2015, **116** ”Fluturojnë zogjtë e verbër” 2015, **117.** “Një shi prej bryme” 2015, **118.** “Në prehrin e pemëve” 2015**, 119**. “Zëri i largët i shiut ” 2015 ,**120** “Yjet e ngrira të kujtesës” 2015, **121**. “ Thirrmat e hijeve ” 2015, **122.** “Dritaret e verbëta ” 2015,

KONTRIBUTI I DHËNË NË FUSHËN E LETËRSISË POETI YNË ADEM ZAPLLUZHA

Për kontributin e dhënë në fushën e letërsisë shqiptare vepra e poetit tonë Adem Zaplluzha duhet ta zë vendin e veçantë në historinë e letërsisë, sepse i takon brezit të shkrimtareve më prodhimtarë dhe krijueseve më të suksesshëm që rrugën letrare e filloj prej vitit 1957 dhe që nga ajo kohë vazhdon me sukses të plotë së vepruari aktivisht si krijues *i shquar. A*rsyeja që kemi vendosur të shkruajmë për jetën dhe veprën *në nderim të* 72-vjetorit lindjes apo në 68-të vjetorit të veprimtarisë letrare të begatshme të poetit tonë ADEM ZAPLLUZHA, i cili meriton të hyjë në librin e GINISIT për numrin e madh të librave të botuar brenda vitit përkatësisht brenda një viti del t'i ketë shkruar me se 30 vepra. *N*ë mesin e atyre krijuesve të qytetit të Kastriotit të këtij nënqielli të kësaj toke shqiptare i dha dritë duke skalitur vargjet poetike që rrezatojnë dhe na mbajnë gjallë duke i përjetësuar buzëqeshjen e çdo vepre të cilat lexuesi ynë i përjetëson me një dashuri të zjarrtë . *P*oeti i Kosovësshquhet sidomos në fushën e letërsisë dhe që krijon kryesisht poezi e me pak prozë dhe që ka një stil të veçantë të komunikimit . Si krijues i mirëfilltë që shkruan në një distancë kohore në fushën e letërsisë,rrezja e dritave tona që shkëlqeu në të gjitha periudhat e historisë së letërsisë ka të botuar 122 përmbledhje poetike ose i ka shkruar gjithsej 168,363

vargje. Personaliteti i poetit tonë është i tillë sepse është ngjizur më natyrën shqiptare, dhe kërkon amësimin aty nëpër rrjedhën e Lumëbardhit. Duke vlerësuar veprimtarinë e tij artistike atëherë na del në pah se të gjitha poezitë e shkruar gjatë këtyre viteve (1957 – 2015) janë të realizuara mirë artistikisht dhe që kanë strukturë me gjuhë e stil të përsosur. Tematika e vjershave lirike, satirike dhe filozofike kanë mesazh që reflektojnë për ngjarjet e se djeshmes dhe të sotmes me elemente të poezisë shumëdimensionale e moderne. Ndërkaq veprimtaria letrare e poetit Adem Zaplluzha fillon në tri fazat e zhvillimit të saj duke filluar prej vitit 1957 dhe që nga ajo kohë vazhdon me sukses të plotë së vepruari aktivisht si krijues i shquar në fushën e letërsisë. Në fazën e parë si përkthyes që ishte i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës që së bashku me shokët e punës dhe të penës themeloi grupin letrar"Lulëkuqet e Kosovës" dhe vazhdon të veprojë edhe në ditët e sotme kur ai është në pension. Në kuadër të punës së këtij grupi qe botuar dy përmbledhje:" Ngjyra e kohës"dhe "Dashuria e madhe" në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij,të cilat dëshmojnë se është një krijues i shquar. Dhe se dyti krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë,botoj një sërë krijimesh letrare që dëshmojnë për kulturën që ka poeti i cili gjatë gjithë jetës së tij ia kushton veprimtarisë letrare duke i botuar poezitë edhe nëpër shumë gazeta dhe revista letrare që dilnin në atë kohë në Prishtinë,Shkup e Zagreb. Së treti në vitin 2010 përherë të parë i përkthehet vepra e tij në gjuhë të huaja si në gjuhën

rumune në një antologji të Shkrimtarëve të Kosovës nga Monica Marushan dhe nga përkthyesi i mirënjohur Baki Ymeri,me titull: “ Pema e Bekuar “ libër që pati jehonë në Rumani. Ndërkaq në bashkëpunim me redaksinë “ Dituria “ po ashtu në Boras të Suedisë ,botohet një antologji me titull:“ Jehona e Shekujve “ autor Sokol Demaku ku autori në fjalë paraqitet me disa punime ndërsa në gjuhën angleze Antologji me poezi shqipe të botuar në Londër nga autorët Fatmir Terziu dhe Agim Mato me titull:” Lotët e Virgjër” Virgin Tears.Marrë në tërësi,me të drejtë mund të konstatohet se veprat e poetit Adem Zaplluzhës ka vlerë,me përmbajtje dhe mesazh të thellë artistik dhe të realizuara mirë. Për veprat e tij kanë shkruar kritikë të njohur të vendit dhe të huaj. Ndërkaq në të gjitha veprat e Adem Zaplluzhës përshkon fryma e modernitetit të ideve filozofike, kurse në qendër të shqetësimeve të tij është revolta, kundruall një realiteti të hidhur, me kuptim, që qenia njerëzore t’i ikë karakterit negativ, të prezantojë ato vlera që shquhen për vizionin e një bote të freskët dhe të dëlirë, shënjuese për kohën dhe hapësirën. Lexuesit e admirojnë poezitë e tij, sepse kanë mesazhin poetik dhe si e tillë,bazuar në kriterin cilësor, terë opusi i tij letrar do t’i përballojë edhe kritereve të kohëve të tjera.

Kastriot,16 dhjetor 2014

FJALËT QË DALIN NGA LËVOZHGA SI DO ZOGJ TË SHENJTË

Baki Ymeri

Adem Zaplluzha është një shijues idesh të koncentruar deri në maksimum. Poemat e tij janë lapidare, alegoriko-metaforike, të koncentruar, të thella apo pitoreske, medikamente të mira për përkëdheljen e shpirtit.

Tema qendrore janë ëndrrat, dashuria ndaj atdheut, e transmetuar në mënyrë plenare përmes të gjitha ndjenjave. Këto tekste të koncentruar gërshetojnë një karakter sentencash lirike kushtuar rrugëve e stinëve nëpër të cilat kalojnë ëndrrat e qytetit dhe vetmisë me të cilën "jetojmë sonte në duet". Poeti përshkruan fshehtësinë e erës që dremit mbi çati, kur vjeshta me lotët e mjegullave i shkund gjethet nga buzëkuqet e nuseve, duke e futur në kornizë ditën kur asnjë pëllumb nuk fluturoi nga "muranat e rrënuara të qytetit". Para nesh kemi librin e 55-të të këtij autori që lexon,

komunikon, ëndërron, shkruan dhe boton. I këtillë ishte edhe Abdylazis Islami në pleqërinë e tij, njëri nga krijuesit më të zellshëm të Iliridës. Shumë libra dhe pak fjalë, sepse fjalët e poetit janë thesar të fshehur që të joshin t'i zbulosh, lexosh e deshifrosh. Derisa faktet e shëmtuara të lëndojnë, madje edhe të vrasin, fjalët e poetit janë margaritarë dhe perla të levarashta ilaçesh që ta shtojnë shijen për jetë. Poetët dhe të dashuruarit, sipas autorit të këtij libri, dalin nga lëvozhga "si do zogj të shenjtë". Çuditërisht dhe befasisht , përmes lojës së metaforës dhe ekspresionit, hijerëndë dhe i thellë deri në esencializimin e mesazhit, Adem Zaplluzha na fton në një shëtitje të shtruar mbi pasqyrën e ekzistencës së pashmangshme bashkëkohore.

Poemat e tij s'e përfillin plisin e shqyer por ato kanë koncizion dhe frymë të freskët me theks postmoderne, një vetëdije të çiltër që reflekton metastazat e heshtjes së dritareve ku pamë eklipsin e lindjes dhe "vdekjen e mynxyrës" që "mori ngjyrën e dheut". Toka, sipas tij, e përpiu gjuhën e ditës, kurse "nata nuk bëzani asnjë fjalë". Nuk mund të bëhet fjalë për degdisje fjalësh, mendimesh apo ndjenjash, por përkundrazi, për pasurimin e letrave tona me vlera të reja. Sipas Adem Zaplluzhës, kurrë më nuk duhet të heshtim, derisa lindin fjalët, "në hidhërimin e tmerrit/ nata luan me thika". Kur e gatuam dashurinë, sipas tij, "i besuam formës së gurit/ djajtë ikën përtej urave/ dhe kurrë më/ nuk u kthyen në atdhe".

Filozofi më i madh në botë të josh me imagjinatën e tij të fuqishme. Kjo vlen edhe për poetin. Autori nuk vuan nga mosnjohja e stilistikës letrare, por na ofron
ndjenja, kolorit, formë, mrekulli metaforash të befasueshme, ngrohtësinë e një drite të veçantë.
Asgjë nuk refuzon poeti nga thesari i regjistrit shpirtëror, “kur na mori malli/ për degët e shelgjeve/ deshëm ta harrojmë historinë/ por na zgjoi ëndrra e lisit/ dhe kurrë më/ nuk na zuri gjumi”. Ide fantastike dhe frymëzime të mrekullueshme.
A ka nevojë ta bezdisim më tej lexuesin me vlerësime të reja, prezent në gjirin e kësaj vepre me të cilën Adem Zaplluzha e përfiton betejën me ekonominë e vlerave dhe bukurive që kanë mbetur mbi dhe!

NË VEND TË PARATHËNIES

Baki Ymeri

Adem Zaplluzha ia shton opusit të tij letrar edhe një vepër të re, duke joshur vëmendjen e lexuesit me një poezi emblematike, nostalgjike dhe paradigmatike. Autori reliefon mundësinë e komunikimit përmes simbolit dhe refuzimit të vargut klasik. Tek/tuk, shkëlqen me përfytyrime alegorike, duke përjetuar në intimitetin e njeriut modern, dramën e njeriut dhe qenien kozmike: "Nga kujtesa e mjegullave/ Binte një shi i rreptë/ Te kroi i zanave/.../ Kur i dëgjuam jehonat e daulleve/ Na dogji një mall i përflakur/ Mbi shpatullat e plagosura të atdheut/ Njëqind vjet s'e pamë diellin"

E denjë për syrin kritik është edhe thjeshtësia, nganjëherë e rëndë, e konfesionit metaforik, poeti duke e njohur "dehjen" romantike të ndjenjave, zjarrin përvëlimtar të përgjërimit, duke kërkuar në shkrimet e tij një zotërim të vetvetes, që të shkruajë sa më shumë e të vuajë sa më pak

Poetit në stinën e tretë të moshës së tij, i lejohet kjo e drejtë, pa u bërë viktimë e skribomansisë, dhe sidomos

autorit të këtij libri vlerash të veçanta lirike, që dëshmon një gamë të pashtershme frymëzimesh e “shkarkimesh” shpirtërore të denja për lexim. Autori
na ofron një spektakël metafizik të botës, duke nxjerrë në pah një mendim refleksiv, me forcën e fjalës së “ngarkuar” me etikën dhe melankolinë e shpirtit shqiptar.
Fanar i vetmuar është shpirti i poetit, “Deri sa nën këto kristale yjesh dëgjohen/ Tingujt e natës/ Që kurrë nuk përfundojnë”. Në çdo vëllim të ri, ai e ruan po atë ton dhe interes të gjallë për një horizont temash e motivesh të zgjedhura, meditative e subjektive, sociale, erotike dhe patriotike. Në spektrin e tyre defilon llojllojshmëria sintaktike dhe surprizat e një diskursi lirik me shprehje të pashfrytëzuara nga homologët e tij. Mjafton të citosh apo analizosh vetëm poemën e parë, për të konstatuar se edhe të tjerat janë të të njëjtit nivel vlerash të veçanta letrare: “Përjetojnë shqetësimin/ Fanari i vetmuar shikon në largësi/ Derdhjen e shtambave të qiellit/ Me yje prej kristali”.
Kjo atmosferë lirike përpëlitet në valët e përjetshme të ndjenjës dhe mendimit, të njerëzores që e karakterizon traditën më të pëlleshme të poezisë sonë që nga zanafilla e saj. Përndryshe, poemat e Adem Zaplluzhës
kultivojnë format e modernitetit, të sintetizuara mu nga këto virtyte, duke ruajtur në përfytyrimin e tyre, një notë të theksuar të sinqeritetit, inspirimit dhe autenticitetit.

VALLJA E VARGJEVE TË LIRA NË TRUALLIN DARDAN

Vladimir Muça



Poeti Adem Zaplluzha paraqitet në këtë libër të 44-të si krijues me formim të gjerë letrar, me konceptime të qarta, vizione e stil modern ku bie në sy mëkimi i muzës së poetit me poetikën migjeniane.Adem Zaplluzha vjen në truallin dardan me pasaportën e vet biometrike e ligjësuar që të kalojë pa frikë çdo doganë në Shengenin poetik EvropianCilido lexues që do e marrë në duar librin e ri poetik "Kur pemët ndërrojnë këmishët" të Adem Zaplluzhës, do ta identifikojë atë me brigjet e Lumëbardhit, Fushë Kosovën veshur kurorë nga malet e pyjet, me dhimbjen, brengën, baballarët, gjyshërit si dhe zambakët e Prizrenit tek shpërthejnë në lulërinë e tyre në freskun e Lumëbardhit. Jam i sigurt se lexuesi do të ndjejë një rishtjellim të përhershëm emocionesh që shkaktojnë këto tema universale, të veshura me një rrobë të re, çka i ngre në një nivel më të lartë, u jep një vlerë

më të madhe përjetimi duke kaluar vetëm thjeshtë argëtuese. Poeti Adem Zaplluzha paraqitet në këtë libër të 44-të si krijues me formim të gjerë letrar, me konceptime të qarta, vizione e stil modern ku bie në sy mëkimi i muzës së poetit me poetikën migjeniane.

Poeti nuk e parafytyron lirizmin gjithnjë rozë, romantik e idilik, por nëpër vargjet e lirikave të tij, herë ,herë kryengritës, nxjerrin kryet konflikte e nocione dramatike që shndërrohen dhe në urrejtje. Më të thekura këto vihen re tek poezitë "Kur pemët ndërrojnë këmishët", "Kudo mure të ngjyrosura", "Me afshin e lëkurës së zeshkët", "Ti eja", "as kujtim për ty", "Vetëm ti", Nën gjethet e rëna". Në të tre ciklet që përbëjnë produktin poetik qartazi dallojmë portretin poetik të Ademit të penelatuar. Këto tre cikle përbëjnë njëkohësisht dhe anatominë poetike të librit.

Ciklet dhe tërë poezitë në tërësi ndërthuren, ushqejnë me ekstrakte poetike, ideore e mendore njëri-tjetrin si enët e gjakut e të limfës në trupin e njeriut, duke i dhënë jetë patosit poetik qe çel si zambakët e Prizrenit, aty buzë rrjedhës së Lumëbardhit, bukuria, paqja, urtësia, lufta për përsosjen e mëtejshme të botës, si veti fondamentale të poezisë në tërësi. Po të lexosh poezitë "Baladë për qytetin tim", "Kishim mall", "Në qytetin tim", "Në ecejaket e çmendura", "Tavolinat e vjetra të qytetit" na përvijohet poeti atdhetar, patriot, dashuria pa kufi për vendlindjen, dëshira për progres shoqëror. Ndaj dhe koha për poetin identifikohet si përjetim dhe kapja e çastit si burimore e çasteve të fëmijërisë me ato imazhet e pra që të mbeten të pashlyera në kujtesë. Ndaj dhe natyralizimi i moernitetit poetik të Adem Zaplluzhës na vjen i ndjerë, i ëmbël e plot ndjenjë.

Adem Zaplluzha vjen në truallin dardan me pasaportën e vet biometrike e ligjësuar që kalojë pa frikë çdo doganë në Shengenin poetik Evropian. Poeti ynë na prezantohet me një soj disi të ri, me shumë rezonancë në kumtet e tija patriotike, social-etnike, pa ju larguar thelbit dhe në poezitë lirike, ku ndonëse me nota migjeniane, manifestimi i së bukurës e jep rezonancën që në titull e vargjet e para me kuintencën e një ideje se mosha nuk ndikon në shpirtin lirik të autorit. Ajo çel vrullshëm "si një tulipan" apo si "zambak i bardhë", fluturon në "Qiellin blu" si mjellma e Lumëbardhit. E këto lirika nuk janë, siç ndodh rëndom në shumë poetë, shpërthyese, të pakontrolluara, të shthurura, pa programim
esencial. Në këto që kemi kënaqësinë t
lexojmë mbizotëron raporti i arsyes dhe shpirtit që bën vetërregullimin poetik, vesh profilin mjeshtëror të poezisë me rrobën
figuracioneve artistike duke përflakur momentet më të çiltra të poetit dhe duke hijezuar njëkohësisht dëshirat e pavullnetshme, duke perceptuar matamorfozat palimpseste të jetës, duke nxjerrë nga mendja e shpirti poetik atë shkëlqim të pasur diamantik, i cili jep zananfillën e një bing-bengu.

Ndaj dhe hera herës, duke qenë poezi post moderne, të natyralizuara në vendin ku u lind dhe u rrit poeti ynë, duke qenë në startin e një poezie inteligjente, brenda këtyre poeti na paraqitet dhe me një lloj impresionizmi ku hera herës realiteti merret si i dyzuar. Ky lloj impresionizmi baritor, qytetar, më kujton Montalen Zhak Preverin, Rilken, ku brenda stilit flak mërzitjen dhe dhimbjen për jetën si në të kaluarën, të tashmen e në të ardhmen. Poezia "Kishim një mall" mund të merret si

etalon i një moderniteti të natyralizuar në tokën amë me nuance konceptuale të një poezie inteligjente. Ajo ka një prirje drejt një personalizimi. Ajo vjen në këtë vëllim tjetër lloj nga ajo e bashkëshkrimtarëve kosovarë. Ka në të më shumë filozofi, është në startin e nisjes të një rrugënaje të re, ku ngërthehen ngushtas nocionet filozofike me ato artistike , stilistike e jetësore, të shkrira në një unitet letrar të ri në prurjet e sotme poetike.
Thjeshtë kemi të bëjmë me një nismë të re post moderniste, një poezi inteligjente me parametra tokësor, të kapur fort në tabanin ku jeton e militon poeti ynë i nderuar Adem Zaplluzha. Ky personalitet poetik është i tillë sepse është ngjizur në natyrën prizrenase , është lindur dhe kërkon amshimin aty në rrjedhën kreshtëshkumë të Lumëbardhit. Poeti nuk mund të bëjë asnjë poezi për të dashurën, gruan, nënën, babanë, gjyshin, nipin pa e futur mes gjelbërimit të brigjeve ujëshkumë, të mollëve, kallinjve, zogut të dashur, mëllenjave skepisha, çafkave, bilbilave e laureshave, mes këtij gjelbërimi të dendur.Në këtë densitet natyror autori prodhon peizazhe vangogiane aq shumë të preferuara nga poetët. Në këtë stilizim natyror, ai me një rëndesë mendimi, godet me penelata të ashpra hipokrizinë, demagogët, shpifarakët që vegjetojnë gjirizeve të qytetit. Duke bërë një shëtitje nëpër gjurmët e metaforave të poezisë të A. Zaplluzhës ku purpurantja nuk i ikën fjalës për ta lënë atë të zhveshur, unë si redaktor kam besim se lexuesi do të flatrojë mbi këtë pyll poetik me këtë purpurantë duke thithur aromat e përjetimeve të bukura njerëzore me bukurinë e shpirtit poetik të poetit.

(Vjeshtë e parë, 2011)

Xhevahir Cirongu

(VËSHTRIM I SHKURTËR RRETH KATËR LIBRAVE ME POEZI)

Poetët shquhen nga të tjerët që shkruajnë e krijojnë, sepse ata dinë të zgjedhin midis atyre magjinë e fjalës së shkurtër, me ngjyrim të ylberta, me ngrohtësi si rreze dielli; me një vargëzim të kristaltë si ujë burimi, që në fund të fundit depërton fuqishëm me mesazhet e tij tek lexuesi duke u bërë profet i shpirtit të tyre. Ai udhëton në kalvarin e viteve krijuese si një meteor që s'di të ndalet, por ecën me hapin e një luani duke rrokur pas vetes poezinë. Si i tillë, ky autor ka ditur t'u dalë hapur kohëve tinzare që në shumë mënyra kanë dashur t'i ndalojnë fjalën e shpirtit, poezinë. Poeti nuk thyhet aq lehtë para intrigave të pushteteve, të ligësisë që bën kushdo pushtet apo sundues ndaj një pjese të shoqërisë tjetër me gjuhë e zakone ndryshe nga pushteti sundues. Aty në kullën e shpirtit të vet, poeti Adem Zaplluzha rrit filiza pemësh e lule të shumta që me aromën e tyre e me vlagun e plisit të tokës së vendlindjes, shkruan vargun e poezisë. Tek bisedon me poetin, vetja të duket sikur takohesh me dy botë: njëra botë është e pa shpirt që ka mbjellë errësirë me dekada deri aty që edhe fjalën e ndalonte për ta shprehur, dhe tjetra botë të shfaqet si një dritë neoni që përcjell paqe, liri e zhvillim shoqëror demokratik të mbarë shoqërisë njerëzore. Në copëza letre i shkruante

poezitë Ademi dhe i ruante diku në raftet e librave , besonte se në një të ardhme do t'i botonte ato, sepse ato ishin pjesë e botës shpirtërore të tij, por edhe brenga që një ditë do u tregonin brezave se sa e vështirë ishte ajo kohë e zymtë me tokë të thatë shpirtërore edhe për krijuesit Kosovarë

Adem Zaplluzha ka lindur në Prizren më 1943. Arsimin fillor e të mesëm e kreu në vendlindje. Kurse Akademinë Pedagogjike e mbaroi në Prishtinë. Për një kohë punoi mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës dhe Hoça të Qytetit afër Prizrenit. Më vonë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Kjo ndikoi që të njihej me shumë probleme që kishte Kosova në atë kohë e më vonë, liria e vërtet tek kosovarët mungonte e padrejtësisht ajo kishte hapur plagë të shumta që duhej medikamenti për t'u shëruar. Një e tillë, por që kishte forcë të madhe për të qenë e lirë Kosova, duhej edhe fjala e poetit. Kështu,poeti Adem Zaplluzha filloi qysh në moshën e rinisë rrugën e vështirë, por plot krenari me vargun e poezisë duke e shkruar atë në fletore. Për herë të parë ai boton në revistën ''Pionieri'' një poezi në vitin 1957. Kjo i dha krahë Ademit si të shqiponjës, por edhe këngën e bilbilit të derdhur me delikates në varg poetik. Më vonë me një grup shokësh të punës e të penës, themelon grupin letrar ''Lulëkuqet e Kosovës'', e më vonë si shkas i kësaj rrethane të krijuar u botua përmbledhja me titull : ''Ngjyra e Kohës'', ku aty u përfshinë një numër i konsiderueshëm nga ky autor. Kjo bëri emër në rrethet letrare e krijuese të asaj kohe, pavarësisht nga rrethanat që jetonte edhe vetë autori. Ai ka botuar jo vetëm në revista për fëmijë, por dhe në faqet letrare të gazetave që

dilnin e dalin në Prishtinë, Shkup e Zagreb. Ja përse duhet thënë se ky njeri ka merita të veçanta si autor, sepse ai ka skalitur modelin e atdhetarit, të luftëtarit të dijes për edukimin e brezave si edukator e përçues i diturisë, të njeriut që ndriçon e jep dritë komunitetit e gjithë shoqërisë. Vetë poeti është munduar të japë portretin e vetvetes duke e lidhur atë me problematikën e shqetësimet e mbarë shoqërisë , e në veçanti atje ku edhe ai është pjesë e jetës. Në të gjitha veprat e këtij autori mbretëron fjala e hapur me rrënjë dashurie e mirësi, por edhe paqëtim. Objekti filozofik si krijues, gërmon nëpër skutat e shpirtit njerëzor, lartëson virtytin, triumfon të mirën ndaj së keqes që shoqëria njerëzore të jetë sa më e pastër në zhvillimin e përparimin e saj. Kështu, autori kapërcen caqet krijuese deri në kufirin e përkthimit të veprës së tij edhe në gjuhën Rumune,nga përkthyesi Baki Ymeri me librin me titullin ‘’Pema e Bekuar’’, që lexuesi Rumun e mirëpriti me dashamirësi. Në lumin e krijimtarisë të autorit Adem Zaplluzha të cilat nuk janë pak, ne zgjodhëm vetëm katër vëllime prej tyre, për të sjellë para lexuesit copëza poezie të shkëputura prej tyre. Nga prurjet e kohëve të fundit të këtyre lumenjve me botimet e botuara, autori ka krijuar liqenin e vet shpirtëror ku kanë mbirë vepra të ndryshme si zambakë të bardhë që japin mesazhe jete. Dhe ja më konkretisht si thotë poeti në poezinë me titull ‘’Kërraba’

‘’ Një hije flokëbardhë
Mbanë në dorën e djathtë,
Kërrabën e thinjur të shekujve
i mban të gjitha mëkatet njerëzore’’

Poeti bën dialog me veten, por edhe me të tjerët. Njeriu plaket, por s'duhet të bëjë mëkate. Është një thirrje e brendshme e autori që e mbart fuqishëm nëpërmjet vargut edhe për të tjerët, pra mbarë shoqërisë njerëzore që të mos biem në mëkatarë. Dhe vazhdon më tej me poezinë me titull '' Asnjë peshk i kaltër '' :

…….
''Sa qenkan të thepisura
Brigjet e ikjes….!
Po ashtu edhe ato të ardhjes.
Mbi supet e ditës
Rëndohen mjegullat
Asnjë lehtësim
Pas zbrazjes së shirave''.

Meraku i poetit shkon deri aty, se mos me anën e fjalës ka bërë mëkat ndaj Lokes së tij që e lindi, i dha nga gjiri i saj sisë, e rriti dhe e edukoi me fjalën e ngrohtë të dashurisë prindërore; sa edhe vetë e kujton me mall kur vetë është prind e me thinja të bardha flokësh mbi kokë. Në poezinë '' Jam i bindur'' poeti e thotë qartë me vargjet :

……
''vetëm fjala
Ka mundur ta plagosë loken time,
Marrëzisht të pakrehur ''
''Ajo në varfërinë e saj
Asgjë nuk ka pasur,
Përpos fjalës
Dhe flokëve të thinjura të dëborës ''.
Apo

‘’Ky gur i murit të vajit
Askush nuk di,
Se sa vite vajton këtu
E muret qeshin e i përqeshin

(Marrë nga vëllimi **‘’Si të flasë me drurët’’, poezi)**



Edhe në librin me titull ‘’Kalorësit e mjegullave’’, poezitë rrjedhin natyrshëm me sentenca origjinale duke përshkruar frymën patriotike e atdhetare të shkrira në vargun letrar, ku estetika, metafora, krahasimi , virtyti , burojnë nga shpirti i autorit të gdhendura në fjalën poetike. Kur lexuesi prek vargun poetik të këtij autori, ndjen vlugun e tokës së vendlindjes, por brengat që shuhen dal ngadalë gjatë leximit të poezive që kthehen në forcë e burim jete. Këtu qëndron magjia e vargut të këtij poeti, sa poet e atdhetar. Në një poezi thotë konkretisht

‘’ Ne dinim të pinim ujë guri
I shtrydhë edhe lisat kur kishim uri,
Dhe vrapuam pas kaprojve
Deri sa takoheshim me etjen ‘’

Ose në poezinë:

” Zëri im’’

Dashuri e lashtë e lisave,
Aq shumë i doje këngët
Sa që ende i kërkon tingujt
Nëpër xhepat e shqyer të luginave ‘’

Ndërsa lexon poezitë diellore me pika shiu në vëllimin e titulluar ‘’Hingëllimat e shiut’’, ndjen klithma patkonjsh për ditën e nesërme, por shpalosen hapur hartat e atdheut me dhurimin e testamentin nipërve duke e nxjerrë nga ashti i lashtë dardan. Ai përmend kodet tona që nga lashtësia me zjarrin e tingullin e këngës të shkrirë në një trup të vetëm: Dashurinë për Atdheun, për tokën tonë antike.

Në njërën poezi , na e përcjell bukur me zë bilbili autori duke derdhur vargje me mesazhe të qarta. Më konkretisht në poezinë’’ Toka ime antike’’.

‘’Në brendësi të këngëve
Do ta mbështjellim me guaskën e diellit,
Tërë dashurinë për ty
O toka ime antike ‘’.

Por, autori Kosovar Adem Zaplluzha në poezitë e veta, udhëton krenar duke i dhënë tinguj muzikale poezisë të cilat nuk ndalen kurrë, ecin drejt së ardhmes me mesazhin se e nesërmja do jetë më e bukur për shoqërinë tonë shqiptare e më tej. Dhe këtë poeti e kërkon tek fuqia që përcjell fjala, e sidomos fjala e gdhendur poetike. Aty

, Ademi ka gjetur vetveten, por ngre edhe progresivitetin e mendimit që duhet të ndërgjegjësohet e gjithë shoqëria njerëzore., sepse në fund të fundit mendimi i kualifikuar në çdo fushë të shkencës sjell përparim e zhvillim. Ja edhe mesazhi që na jep autori:

’Mos është vallë kjo
Dhuratë e Zotit!?
Që rriten sot zambakët
Në majë të shtagës ‘’

Kur lexon vargun tek poezia me titull’’Koha e gjymtuar’’, të zgjon shumë kujtime dhe i thua vetes pse na ndodh kaq shumë tragjikja?!

“Ai shkëmb
U bënë hije maleve
Zanat këndojnë balada
Gjetheve
Gurët ecin vertikalisht
Deri te qiejt
Ku zgjohen ninullat’’.
Ose
‘’Si të flas me drurët
Nuk kam më kohë për pendesë
Çfarë kuptimi ka bukuria
Ne edhe kur flemë’’

Vlerat artistike që kanë vëllimet e autorit Adem Zaplluzha, janë në radhë të parë pjesë e shpirtit të tij,por të gatuar me baltën magjike të vendlindjes, ku pasqyrohet virtyti njerëzor së bashku me dashurinë, me

pemët e gurët që lagen me vesën e shpirtit krijues, me portretizimin e figurave të personazheve nëpërmjet vargut poetik, me fjalën e shkruar që derdhet si mjalti në hojet e botimeve në librat e këtij autori, e që mbeten në memorien e lexuesit tonë. Duke qenë një krijues me prodhimtari e cilësi të lartë në këtë dekadë të shekullit të XXI- të,Adem Zaplluzha zë një vend të rëndësishëm në letrat shqipe. Në foto, nga e majta në të djathtë:

ADEM ZAPLLUZHA, "KAMPION" I BOTIMEVE PËR VITIN 2012…

Prof. MURAT GECAJ, publicist e studjues - Tiranë

1.
Tani, kur po i shkruaj këto radhë, për poetin e njohur Adem Zaplluzha, më kujtohet se prej tij kam lexuar disa krijime, në faqe të ndryshme Interneti. Ndërsa me atë vetë jam takuar, në pragun e përvjetorit të 100-të të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Kjo ndodhi në mjediset e shkollës 9-vjeçare "Demokracia" të Durrësit, ku kishin ardhur miq nga Suedia, ndër ta bashkatdhetarë shqiptarë, por edhe suedezë. Kështu, aty ishin veprimtarët e dalluar për çështjen shqiptare dhe krijuesit, Sadulla Zendeli-Daja e Sokol Demaku, por dhe drejtori i një shkolle të qytetit Boras, Për Kettisen, mësuesja Sonja Person e të tjerë. Por ishin të ftuar edhe miq nga Kosova, si poeti Adem Zaplluzha dhe drejtoresha e një shkolle, Dije Meniqi e të tjerë.
Pasi dëgjuam bisedat e zhvilluara dhe pamë një koncert të bukur tematik, "Lumja ti, moj Shqipëri, 100 vjet Pavarësi", Ademi më premtoi se, në takimin më të parë, do të m'i dhuronte disa libra të tij. Aty për aty, nuk e pyeta për sasinë, por as për vitin e botimit të tyre. Po rasti e solli që unë shkova, në muajin nëntor, po më 2012, në një përurim libri në Prishtinë, bashkë me Akademikun Alfred Uçi. Pas qytetit të Shkupit, aty dërguam e dhuruam 200 copë libra, kushtuar martirit të shkollës shqipe, Petro Nini Luarasi-"Mësues i Popullit", shkruar nga prof. Uçi. Ndër pjesëmarrësit, ishin kryetari i

Komunës së Prishtinës, Isa Mustafa e drejtoresha e kulturës aty, Vlora Dumoshi; Akademiku Pajazit Nushi, pedagogia dhe studiuesja e gjuhës shqipe, Shefkije Islamaj; publicisti Vezir Ukaj e të tjerë. Por nuk mungonte as kolegu e miku im, Adem Zaplluzha. Se atë e takon gjithnjë në veprimtari të tilla. Poeti Adem Zaplluzha (i pari, majtas), duke ndjekur një veprimtari, në shkollën"Demokracia"-Durrës (nëntor, 2012)

Kur mbaroi ajo veprimtari mbresëlënëse dhe ne po nënshkruanin disa nga librat tanë, që dhuruam, mu afrua Ademi me një pako plot me libra, për të cilët e falënderova nga zemra. Të them të vërtetën, nuk e kisha të saktë se sa ishin ata, çfarë tematike trajtonin dhe në cilët vite ishin botuar. Ndërsa, kur u ktheva në Tiranë, i pashë e i shfletova me vëmendje të veçantë. Për kërshërinë e lexuesve, po tregoj se ata nuk ishin pak, por plot 37(tridhjetë e shtatë) copë. Sigurisht, kjo gjë më befasoi, por më tepër fakti se të gjithë ishin botuar gjatë vitit 2012. Ndoshta, është ky një rekord ndër autorët shqiptarë, brenda e jashtë vendit, po edhe për shtete të tjerë. Kështu, besoj kam edhe mendimin e shumë lexuesve, që poetin Adem Zaplluzha, pa ndonjë komision ose juri, ta shpallim "kampion" në fushën e botimit të librave, për vitin 2012!

2.

Ka kaluar disa kohë nga dita, kur Adem Zaplluzha m'i dhuroi gjithë ata libra. Sigurisht, gjatë kësaj periudhe e kam pasur "peng" ose më "rëndonte", që të shkruaja diçka, si lajm të rrallë për këtë autor, por dhe për gjestin e tij bujar. Se, përsa i përket përmbajtjes së tyre, është e

kuptueshme që ka shumë vështirësi për t'i përmbledhur mendimet, në një shkrim të veçantë. Gjëja e parë, që më ra në sy në këta libra, është tematika e larmishme e tyre. Te të gjithë sundojnë fryma atdhetare e liridashëse, dashuria për vendlindjen e traditat tona, malli i pashuar i emigrantëve etj.

Sa për ta përligjur sadopak mendimin e mësipërm, po riprodhoj këtu ndonjë varg, nga librat e tij. Në librin "Letër nga mërgimi"-2 është edhe poezia kuptimplote, "Ah, Kosovë", ku shkruan: "Na u tretën djemtë/ nëpër Evropë,/ mbeti Kosova/në pleq e plaka,/ nga kjo, dhimbja shpëtim nuk paska!" Po me këtë shqetësim janë edhe vargjet e poezive tjera të këtij vëllimi, si: "Nga malli", "Kosovë ilire", "Ecja udhës", "Kthimi", "Gjysma e Kombit", "Ëndrra e mërgimtarit","Në dhe të huaj", "Letër gjyshit", "Në Prishtinë", "Të fala Kosovës". Kopertinat e disa librave, nga poeti Adem Zaplluzha Në librin tjetër, "Eca, ecëm dhe do ecim", duke akuzuar me gisht pushtuesit gjakatarë serbë, u drejtohet atyre plot urrejtje, duke thirrur më zë të lartë: "Zotërinj,/ ju akuzoj,/ në emër të lirisë së robëruar,/ që sot/ e kush e di sa vjet,/ jeni duke mbajtur në burg/ një popull të tërë!"(Poezia "Duke pritur shfajësimin"). Ndërsa në vëllimin me titullin "Lisi, në rrënjët e veta", më tërhoqi poezia e bukur, "Në se i bashkojmë forcat", ku janë edhe këto radhë: "Në udhët tona/ asnjëherë nuk i pranuam pengesat, /me qindra vjet ecëm,/ deri te ky qytet i mermertë…". Ose më tej: "Lëre, të lutem,/ le të rrinë në atë qoshe,/ mos ua prek mallin plagëve,/ që kullojnë me qindra vite!…". Domethënës janë dhe vargjet: "Më thanë/ se do të më akuzojnë për bigami…/ O, kurrë më shumë, se atë ditë/ nuk kam qeshur!/ Troç, u thashë,/ e

keni gabim,/ unë e dua vetëm Atdheun tim!”(Prishtinë, 11 janar 2012).

3.

Natyrshëm, një lexues i zakonshëm dhe që nuk e njeh nga afër poetin Adem Zaplluzha, këtë “kampion” të fjalës letrare shqipe, sidomos me botimet e shumta dhe cilësore të vitit 1912, dëshiron të dijë diçka më shumë për të. Këto të dhëna të shkurta janë në disa nga librat e tij, por dhe në faqe të ndryshme Interneti. Lindi në Prizren, në vitin 1943. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike, në Prishtinë.
Me dashurinë për profesionin e nderuar të mësimdhënësit, shërbeu në fshatrat Studençan i Therandës (ish-Suharekë) dhe Hoçë, afër qytetit të Prizrenit. Pastaj u punësua përkthyes në Korporatën Eneregjetike të Kosovës. Dëshira për të shkruar poezi i lindi që në fëmijëri dhe rininë e hershme. Vjershën e parë për fëmijë e botoi në revistën e kohës, “Pionieri”, në vitin 1957.
Kur ishte në at5ë Korporatë, së bashku me shokët e punës dhe të krijimtarisë, formoi grupin letrar, me emrin aq domethënës, “Lulëkuqet e Kosovës”. Anëtarët e tij i tubuan krijimet e tyre në përmbledhjen “Ngjyra e kohës”, ku kishte edhe disa poezi të vetat. Veç krijimeve, që i botoi në revistat për fëmijë, shkroi edhe nëpër gazetat e asaj periudhe, të cilat dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Ka vite që Adem Zaplluzha është anëtar aktiv i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Jeton në Prishtinë, ndërsa veprimtarinë letrare e zhvillon në Klubinletrar “Fahri Fazliu”, të Kastriotit. Përherë është i pranishëm

në përurime e diskutime librash të kolegëve e miqve, në veprimtari kulturore e artistike, duke e dëshmuar atë një intelektual me vlera dhe interesa të shumanshme.

AFSHI I SHPIRTIT TË ZHURRITUR PËR DASHURI DHE ATDHEDASHURI

Baki Ymeri

Që nga bari i djegur i ciklit të parë e deri te malli i lotit tim dhe qentë e lagjes sonë, Adem Zaplluzha depërton në memorien e lexuesit me afshin e shpirtit dhe gurgullimat e zemrës së tij të zhuritur për dashuri dhe atdhedashuri. Duke qenë i pavarur nga ndikimet e të tjerëve, poeti nuk dështon në fushë të artit, sepse di të hapë rrugët e ndjenjave, duke trasuar shtigje të reja dhe duke e kundruar njeriun dhe natyrën si një horizont ku, edhe pse pulson bari i djegur, moti i lig dhe mjerimi social, poeti tenton pavdekshmërinë përmes këngës së një kombi martirësh që nuk u gjunjëzua kurrë. Poezia e Adem Zaplluzhës shquhet përmes një origjinaliteti dhe sinqeriteti që i ka hije. Në frymëzimet e tij defilon atdheu, natyra dhe dashuria. Libri i tij më i ri strukturohet në tre cikle ku koha ec paralelisht me aspiratat e njeriut që e preferon shfajësimin që në hapin e parë, ku zërat e çiftelisë jehojnë si në një kor hyjnor, ku hyji shikon nga lart, njeriu pret stinën e buzëqeshjes, duke i rektifikuar gabimet me punë, me vetëmohim e sakrificë.

Në ciklin e dytë që mban titullin e librit, Eca ecëm dhe do të ecim, mençuria ndërlidhet me optimizmin dhe etjen për jetë, shpirti kompletohet me zërin e ndërgjegjes, sepse, edhe pse gishtërinjtë ende s'e prekin erën, "Ne të gjithë sonte jemi dikush tjetër." Në memorien e autorit mbretërojnë Adem Zaplluzha

Eca, ecëm dhe do ecim**,** kujtimet për një mori dashurish, për një princ dhe një mbret tekanjoz, për shpirtin e fshehur në të gjitha qeniet, madje edhe në varg, për nuset tona dhe "kalin tim tekanjoz", për flakjen e frikës dhe dashurinë që manifestohet edhe atëherë kur ik dita e vjen nata, dhe anasjelltas. Duke i analizuar përmes syrit kureshtar dhe mendjes së prehtë, kupton se njeriu i çliruar nga dëshirat dhe trishtimet, e kundron botën duke e hyjnizuar Krijuesin si një madhështi e shpirtit. Na është bërë shprehi që të shkruajmë pak e për merak, se sa shumë e për lumë. Poeti i mirë në moshë të pjekurisë nuk ngutet të botojë më shumë se një libër në çdo 3-4 vjet, por kur i afrohet pleqërisë, është e drejtë e tij të botojë disa libra brenda një viti, për të përkujtuar kohën e shkuar kur ishte e pamundur të lansosh mendimin e lirë, dhe për të konsoliduar veprën në momentin e duhur. Poeti mediton për një miqësi të sinqertë me pak dritë e pak ujë, për çastet që e anashkalojnë pesimizmin, për kallinjtë e arave tona që kapen dorë për dore, për fillimin që kupton se shpirti është një urë e shëndetshme që e flak trishtimin në fushat e

përmallimit, sepse të pritja kur "ishte dita e parë e majit", kur pafajësia me mallin e lotit tim, degdiset si një
qen i lagjes në shtëllungat e mjegullave. Në këtë kontekst kemi të bëjmë me një univers të plotë mendimesh që reflektohen në varg e në vargje, në çdo tekst e kontekst të kësaj vepre që përmes filozofisë së vlerës, mbetet si një kujtim i bukur në memorien tonë.

Revoltë dhe meditim mbi poetikën e Adem Zaplluzhës

Veprat e shkrimtarëve tanë janë një kontribut permanent dhe vendimtar për realizimin e profilit shpirtëror të Evropës dhe të mbarë botës krishtere. Themi krishtere sepse Ademi para se të bëhet Adem ishte Adam, njësoj siç ishte Ibrahimi Abraham, Demiri Dhimitër etj. Këto ditë, në 101 vjetorin e Pavarësisë dhe 70 vjetorin e lindjes së poetit, Fatmir Minguli nga Durrësi vjen para opinionit shqiptar me një vepër të re: "Revoltë dhe meditim mbi poetikën e Adem Zaplluzhës" (Shoqata e shkrimtarëve "Fahri Fazliu", Kastriot, 2013). Sipas tij, të shkruash për krijimtarinë poetike të një poeti prishtinas, do të ishte e barabartë sikur të shkruash një sagë të vërtetë jetësore. Në këtë sagë librat poetikë të këtij poeti janë kapituj që jeta e tij i ka për subjekt, e ku lexohen këndshëm ndodhi, epika, legjenda, dashuritë, natyra e Kosovës, heronjtë e kohës, jeta e shkuar dhe e ardhshme, qiejt e hapur dhe mjegullat e jetës, kozmosi dhe zogjtë.
Nga vështrimet kritike, prezentë në këtë libër, kuptojmë se Adem Zaplluzha shkruan me ndjenjën e dinjitetit personal dhe me një moralitet të veçantë të gjërave të

thjeshta. Të njohësh poezinë e Adem Zaplluzhës, thekson autori në kuadrin e parathënies, “duhet të lexosh të 77 librat e tij, por edhe një poezi e vetme do të mjaftonte për këtë njohje. Ky nuk është thjeshtë një konstatim ndoshta grotesk por një forcë e talentit të poetit që po i afrohet vitit të 70-të të jetës së tij. Kopertinat e 77 librave janë tashmë si gurë të veçantë të një mozaiku që pasqyron hapësirat kosovare me të gjitha ngjyrat e saj.” Dhe më tej: “Një punë vigane e poetit për të ndërtuar një obelisk të poezisë moderne kosovare e për tu folur njerëzve se jeta është e bukur dhe e patjetërsueshme, se kosovarët si ilirë dardanë vinë në ditët tona krenarë e të përparuar në lirinë e tyre të fituar me sakrifica e humbje njerëzore. Por në obeliskun poetik të Adem Zaplluzhës, nuk janë vetëm këto. Janë ato elemente në magmën e krijimit të poetikës ku bien në sy talenti i veçantë i tij, një talent i lindur midis shpirtit të zambakëve të Prizrenit dhe vrullit të ujërave të Lumbardhës.”

Para nesh kemi një libër që i jep rëndësi poetikës moderne shqiptare duke pasur Adem Zaplluzhën si personazh qendror. U desh ky libër për të njohur dhe hapësirat e botës së lexuesve dhe të kritikës së specializuar, se si janë konfrontuar me veprën e këtij krijuesi të njohur. Që nga faqet e para konstatojmë se mendimet e dhëna në këtë libër nuk janë thjeshtë një konfirmim, por edhe një vlerësim real dhe dashamirës. Autorë të ndryshëm janë prezentë me shkrimet e tyre, duke u bërë jo vetëm kritikë veprës poetike, por duke qenë edhe zëdhënës të një vepre që ia vlen të lexohet. Shumë kritikë, publicistë, poetë e shkrimtarë të ndryshëm që paraqiten në këtë botim të veçantë, vijnë jo

vetëm nga Kosova, por dhe nga Shqipëria, Rumania, Amerika, Suedia, Gjermania etj. Fatmir Minguli konkludon se kjo vepër voluminoze është një gjeografi që do ta kishte zili kushdo nga krijuesit e ndryshëm.

Në kuadrin e parafjalës, Vladimir Muça thekson: Tek lexoja një parathënie të librit "Letër atdheut" të Eshref Ymerit, më përfshiu fiksioni në përcaktuershmërinë e thjeshtë, por bindëse të tij: "Shpreh bindjen se krijimtaria artistike e Adem Zaplluzhës ka tërhequr e do të vijojë të tërheqë vëmendjen e studiuesve të letërsisë, të kritikës dhe gjuhëtarëve të cilët me metoda shkencore do të mundohen të zbulojnë të fshehtat e shpirtit të poetit dhe t'i përgjigjen pyetjes se ku fshihet magjia e ndikimit të tij mbi shpirtin e njeriut? Eseisti Fatmir Minguli mori nismën për të përmbledhur gjithë shkrimet e botuara në gazeta e revista për Adem Zaplluzhën. Në kontekstin letrar ndoshta, sipas V. Muçës, kjo krijimtari e bollshme, por edhe shumë cilësore, vjen në letrat shqipe si ato ngulimet e "Trojës letrare" në truallin dardan dhe baca Adem na vjen si një Priam poetik.

Duke plasuar ide personale në lirikën e tij, Adem Zaplluzha plason vlerat letrare dhe morale të botës shqiptare. Nga parafjala kuptojmë se vlerat që përcjellin veprat e trajtuara në kritikologji, e justifikojnë plotësisht evidentimin e studimeve, eseve, refleksineve të përmbledhura në këtë libër. Ky libër përmbledh një varg shkrimesh analitikë të shkruara me zërin e zemrës, në konceptimin filo-analitik, me një dashuri të përbashkët, por edhe me një shqetësim për ardhmërinë e poetikës së sotme në suazat e një recesioni që ka mbërthyer krijimtarinë mbarëkombëtare. Ndoshta ky libër mund të marrë vlerat e një doracaku në evidentimin e vlerave të

vërteta të poezisë së sotme kosovare dhe më gjerë, thekson Vladimiri në kuadrin e vlerësimit të tij, duke shtuar: Kolegët që janë marrë në këtë hapësirë kohore me studimin e veprës poetike të Adem Zaplluzhës e dinë fort mirë tashmë dhe e kanë parasysh se çfarë vështirësish komplementare përbën hartimi dhe përmbledhja e tipareve, përbashkësive, ku të treten tiparet individuale të secilit studjues. Por ata kanë pasur parasysh dhe atë djaloshin Adem që në vitin 1968 fitoi çmim të parë në konkursin poetik në Beogradin e ish Jugosllavisë. E kur ju kërkua nga kryetarja serbe e jurisë që ta recitonte në serbisht poezinë fituese, Ademi nuk pranoi. Por poeti i madh kroat Miroslav Kërlezha iu drejtua dhe i tha: “Mirë biri im, lexoje në gjuhën e nënës!”, dhe Ademi e lexoi shqip.

Një poet i tillë kaq atdhetar, u mbajt në mjegullat e Andromedave ziliqare, futur diku në vrimat e dheut si ato ngulimet trojane, me xeherore brilantine që prisnin sortirimin në karierat letrare të kohëve që do vinin. Pas çlirimit nga zinxhirët e pushtimit 100 vjeçar serbo/sllav, autori i librave poetikë dhe studjuesit e tij kanë bërë një punë të madhe drejt përfitimit të përqasjes koherente nga shumë lexues. Gjeografia shkrimore ka qenë e gjerë duke përfshirë jo vetëm Shqipërinë dhe Kosovën por dhe Rumaninë, Suedinë, Amerikën, Kanadanë etj. Shkrimet evidentojnë vlerat e një arti të ri (deri tani të pamediatuar) me një përqasje drejt një moderniteti të natyralizuar. Por universialiteti poetik i Adem Zaplluzhës, i tejkalon kufijtë e racionales dhe lëvron në troje të iracionalitetit, në kondicion subkoshience të një ëndrre të kahmotshme.

Cila është ajo të rrëmben me larminë e saj befasuese e interpretuese të ndjenjave? – pyet Vladimir Muça dhe përgjigjet: Studiuesie lexuesi e ndjejnë veten si në një Akropol ku janë ekspozuar të gjitha gjetjet e ndjesive shpirtërore. Nga përbashkësia e shkrimeve në këtë libër evidentohet qartazi se vepra poetike e Zaplluzhës nuk është thjeshtë një epizëm apo një atdhetarizëm trashendent. Ajo synon për më thellë, duke spikatur drejt një filozofie sociale të kohës e mbarsur me brengat dhe handikapet e saj.

Ndaj dhe autori i kësaj përmbledhjeje studimore e mirëpërcaktuese shkruan: "Poetika e Adem Zaplluzhës në të gjithë
tërësinë e saj bazohet në revoltën legjitime të një poeti atdhetar dhe që pasohet shpesh nga një meditim i thellë për hallet e shoqërisë së sotme."

Ky është dhe boshti rreth të cilit prevalojnë artikujt e përmbledhur në këtë libër të veçantë në llojin e vet, si një detyrim jo vetëm shoqëror por dhe atdhetar e shkencor në nxjerrjen në pah të vlerave të patrajtura në nivelet që ajo kërkon. Fatmir Minguli na ofron një lekturë magjike që të ndrit dhe pasuron, për një poet që s'e përsërit vetveten, dhe që të mundëson të hedhë një shikim të saktë në thellësinë e veprës së tij

FATMIR MINGULI

(MBI POETIKËN E ADEM ZAPLLUZHËS)

Introduktë

Të shkruash për krijimtarinë poetike të poetit prishtinas Adem Zaplluzha do të ishte e barabartë sikur të shkruash një sagë të vërtetë jetësore. Në këtë sagë librat poetikë të këtij poeti janë kapituj që jeta e tij i ka për subjekt e ku lexohen këndshëm ndodhi, epika, legjenda,dashuritë,natyra e Kosovës,heronjtë e kohës, jeta e shkuar dhe e ardhshme, qiejt e hapur dhemjegullat ejetës,kozmosi dhe zogjtë...

Të njohësh poezinë e Adem Zaplluzhës duhet të lexosh të 77 librat e tij, por edhe një poezi e vetme do të mjaftonte për këtë njohje. Ky nuk është thjeshtë një konstatim ndoshta grotesk por një forcë e talentit të poetit që po i afrohet vitit të 70-të të jetës së tij. Kopertinat e 77 librave janë tashmë si gurë të veçantë të një mozaiku që pasqyron hapësirat kosovare me të gjitha ngjyrat e saj.

Një punë vigane e poetit për të ndërtuar një obelisk të poezisë moderne kosovare e për tu folur njerëzve se jeta është e bukur dhe e patjetërsueshme, se kosovarët si ilirë dardanë vinë në ditët tona krenarë e të përparuar në lirinë e tyre të fituar me sakrifica e humbje njerëzore. Por në obeliskun poetik të Adem Zaplluzhës nuk janë vetëm këto , janë ato elemente në magmën e krijimit të poetikës ku bën sy talenti i veçantë i tij, një talent i lindur midis shpirtit të zambakëve të Prizrenit dhe vrullit të ujërave të Lumbardhës.

U desh një libër si ky që kemi në duar , të paraqiste atë që poetikës moderne të Adem Zaplluzhës i takon.

U desh ky libër për të njohur dhe hapësirat e botës së lexuesve dhe të kritikës së specializuar se si janë konfrontuar me veprën e Adem Zaplluzhës .

Mendimet e dhëna në këtë libër janë thjeshtë një konfirmim ,por dhe një vlerësim jo vetëm dashamirës. Autorë të ndryshëm janë prezent me shkrimet e tyre duke u bërë jo vetëm kritikë të veprës poetike të poetit kosovar por dhe zëdhënës të një vepre që ja vlen të lexohet.

Shumë kritikë, publicistë, poetë e shkrimtarë të ndryshëm që paraqiten në këtë botim të veçantë vinë jo vetëm nga Kosova, por dhe nga Shqipëria, Rumania, Amerika, Suedia, Gjermania etj.

Është kjo një gjeografi që do ta kishte zili kushdo nga krijuesit e ndryshëm.

dh në letër çdo ditë ashtu pa ndrojtje, por me refleksione ndaj fenomeneve që jeton vetë e të tjerët; dhe ashtu me ndjenjën e shpirtit të pastër si kristalet e dëborës,ndërton vargje që marrin kuptime jetësore në poezi. Nuk ishte rastësi që unë shfletova disa libra të këtij poeti energjik e

kurajë , ku sharmi poetik ishte derdhur aq bukur sa poezia të dukej sikur të fliste e të thoshte më lexo!

Kur mbarova së lexuari katër vëllimet e këtij poeti të titulluara **: ‘’Hingëllimet e shiut’’,’’Kalorësit e mjegullave’’, ‘’Si të flas me drurët’’,’’Tinguj që nuk përfundojnë’’,** apo edhe poezitë e lexuara në shtypin letrar e atë elektronik; thash me vete se poeti nga Kosova Adem Zaplluzha ka në vetvete disa të veçanta nga poetët e tjerë. E them këtë, sepse ky poet ka rrënjë krijuese që janë ngulur thellë së bashku me poezinë brenda shpirtit në tokën që e lindi dhe e rriti, pra vendlindja e qytetit të Prizrenit, ky qytet i atdhedashurisë të bashkimit të mendimit Kombëtar. Janë faktet historike e atdhetare të qytetit të lindjes të këtij poeti, që kanë nxitur të mendojë e të shkruajë poezinë.Si rrjedhim edhe të faktorëve të tjerë historik e shoqëror,arsimor e kulturor por edhe letrar, tek Ademi ‘’mbinë’’ filiza poezish brenda shpirtit të tij, por u deshën mjaftë kohë që një ditë ‘’Pema e shpirtërore’’ të çelte lule e më pas të bënte fruta. Kjo ëndërr e thyer e të së kaluarës i trazonte shpirtin edhe poeti tonë nga Kosova.



Duke përballuar sfidat e kohës,edhe Ademi krijimet e tija letrare filloi ti botojë të përmbledhura në shumë vëllime mbas pavarësisë së Kosovës. Me marrjen lirshëm të oksigjenit krijues ai derdh vargun në letër si gurë diamantesh që i shton ison e këngëve të zogjve që fluturojnë lirshëm në qiellin e kaltër të Kosovës. Kjo këngë për poetin e gjithë shqiptarët do këndohet nëpër shekuj. Për këtë këngë të gëzueshme që s'do ndalet kurrë, poeti ka titulluar edhe librin e fundit me një titull që të befason e të bën që të pyesësh edhe zogjtë për ku fluturojë, kënga e tyre çfarë mesazhesh na përcjell neve si komb.

Në këtë vëllim poetik janë përfshirë 66 poezi. Se cila nga këto poezi ka të veçantën e saj. Aty jepen të qarta mesazhet e jetës. Edhe në poezinë nga ku ka marrë titullin ky vëllim, lexuesi do gjejë shpresëjete; të jetojë e këndojë me ritmin e kohës e të zhvillimit të mbarë së jetës shoqërore njerëzore. Më konkretisht poeti e thotë kështu:

‘’ Nga kujtimet i shkundim degët
Që thahen në eter,
Dhe më pastaj e thërrasim fëmijërinë
Në fronin e vetëdijes,
Ulemi me të si me të kaluarën.’’

I pyesim zogjtë në ikje:
Ku veni kështu në heshtje?
A thua ky itinerar i shtjellës
I përngjan,
Shakullinës së mendimeve!’’

Siç e kemi thënë edhe më lart, ndjesia e poetit është shumë e ndjeshme edhe për vetë faktin, sepse brumi i poezive është shpirtëror e nuk shkëputen dot nga plisi i dheut të vendlindjes, nga ujët e burimeve, nga pemët e lisat shekullorë aty ku qëndrojë zogjtë e këndojë apo bëjnë gjumin e natës; deri te lulet në kodra e livadhe, apo dashuritë që zgjohen e çelin si ''Nerënxa'' që duam ti prekim ato nëpër udhëkryqe e pastaj aty të puthim lulet e jetës. Poeti me metaforën e krahasimet e tija, arrin deri aty sa e thotë fuqishëm dashurinë e zemrës për të shtrenjtin atdhe, nga ku e shprehë qartazi e me delikates se mbi të gjitha dashuria për atdheun është dashuria për të jetuar i lirë e sovran, por me dëlirësinë e shpirtit e të mendimit. Kështu, poeti Adem Zaplluzha na e sjell tek poezia me titull ''Në dhembjen e gurit'',sepse vërtet guri është i ftohtë nga natyra, por kur atë gur të vendlindjes e do me të vërtet, te ai gur gjen ngrohtësi shpirti e të dhimbset. Por duhet thënë, se në tërë filtrin e poezive të këtij poeti gjerdanizohen qartë shpirti i pastër poetik, fjala e ngrohtë, dashuria për vendlindjen, respekti njerëzor, e mbi të gjitha aromën e fjalës së pavdekshme të nënës që e lindi e që e mëkoi me qumështin e saj.Kjo e lidhur me fjalën e gjuhën shqipe, me Shqipërinë tonë të dashur, me gurin e vendlindjes,sepse siç thotë populli ynë''Guri i rëndë në vendin e vetë''. Dhe ja si na e përcjell poeti të vargëzuar që të jep forcë kur e lexon atë e të vë në mend

‘’ Po deshe,
Preke me gishtat e tua
Dashurinë në udhëkryqin e memories.
Ose kur i çelë sytë pranvera
Puthe egërsisht nerenxën!...
E cila mbinë’’
Dhe vazhdon në poezinë’’ Kosovë, djepi im i pathyeshëm’’

‘’Kosovë !
Djepi im i pathyeshëm.
Dhe varri i armikut tim
Sa herë që të robëruan po aq herë,
Linde nga zjarri
Feniksi.
Kosovë
Emri dhe mbiemri,
I rrënjëve të tokës
Asnjëherë nuk të trishtuan.’’

Adem Zaplluzha në udhëkryqet e kohës historike e të jetës na paraqitet herë si një njeri i mbyllur që vërtitet rreth qenies së tij , dhe hera- herës ai është në kërkim të një diçkaje, por të pa dukshme. Kjo e ka munduar për gjithë jetën këtë njeri. Dhe me të vërtet të padukshmen e gjeti vetëm atëherë kur erdhi dita e lirisë së mendimit e fjalës në Kosovë, ku nga aty lindën filizat e drurëve të rinj në shpirt, çelën lulet e Marsit me bardhësinë e borës që kishin aromë pranvere me çlirimin e vendlindjes; që nga aty dëgjoi në djepin e përkundur nga nëna fjalën

magjike e të dashur ‘’Nënë ‘’ e ‘’Atdhe’’. Në poezinë ‘’Në se ecim’’ na vjen me një mesazh të fortë e dinamik që kurrë të mos humbasim shpresat tona, por të ecim në rrugën tonë për të thënë të vërtetën, sepse kjo e vërtet di vetëm të eci përpara. Ajo është e pavdekshme



‘’Nëse ecim
Pa vënë gishtin në kokë,
Kush e di
Se ku do të jemi nesër’’.

Kjo thirrje e fuqishme e poetit tonë Adem Zaplluzha, na jep forcë e kurajë për të ecur të sigurt në rrugëtimin e gjatë të jetës, sepse vetëm me kurajë e guxim mund të sfidosh të keqen. E nesërmja është më e bukur kur di të jetosh të sotmen. Këtë na e thotë edhe poeti në vëllimin me poezi të titulluar: ‘’Pyesni zogjtë në ikje’’. Edhe ne i urojmë suksese e shëndet këtij poeti me cicërimën e këngës së zogjve që të mos ndalet së shkruari poezinë ku zemrat e njerëzve merr in oksigjenin e jetës.

Xhevahir Cirongu
Durrës,Mars 2013

Baki Ymeri: Lirika kosmogonike e një shqiptari
E Diel, 04.11.2012, 03:20 PM .

LIRIKA KOSMOGONIKE E NJË SHQIPTARI ETSHËM PËR DITURI

(Adem Zaplluzha, Ky def prej hëne, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012)
Zërin e patëm shkreptimë vetëtime, thekson autori në njërin nga titujt e poezive të tij, dhe po qe se e deshifrojmë peshën stilistike të vargjeve respektive, konstatojmë se "hëna rri ulur në fronin e saj", se "ballëhapur qëndron tundimi", kur një buf i zi nate, tenton të ngulfatet "në qerpikët e ndezura të atdheut", duke parashtruar pyetjen "e kujt është kjo kërrabë", apo: "kush i la të hapura erërat", kur "vraponim mbrëmjeve të vona".

Baki Ymeri:

Titulli i librit ndërlidhet me një subjekt inspirimesh magjike të botës kozmike. Kosova përfaqëson një univers të veçantë ku poeti bëhet mbret, dhe mbreti poet, edhepse kjo zonë e prekur nga dallgët e përgjakura të invazionit osman dhe terrorizmit serb, ende nuk e ka një mbret që mund ta bëjë Kosovën Shqipëri dhe Shqipërinë Zvicër ballkanike ku shqiptari nuk e vret vetveten si pasojë e varfërisë.

Koha në lirikën e Adem Zaplluzhës i përngjan mjegullave që bredhin mbi shtegtimet e gjumit ku "peshqit vdesin për një gllënjkë të buzëqeshjes". Autori shkruan për kukullat e drunjta që i afrohen bregut me dehje tingujsh, atje ku bie shi mbi "gjethet e manit të bardhë", ku qan një nënë me një fëmijë "në gjumin tim", ku një def i hënës ta përkujton hartën e vjetër kur pas rrëmujës së madhe "mbeti heshtja".

Sa shumë krakëllima paska kjo natë, mahnitet poeti që pret orën për adaptim në këto lëndina ku "çuditërisht guri e ndryshoi formën e ngurtë", ku gurët pluskojnë lot të kristaltë, ku "do bëhemi erë prej pluhuri". Gjendja shpirtërore e tij fluturon në botën stelare (të yjeve), ku "mbrëmë ujqërit e shqyen hënën", derisa "të reshurat i ndezin qirinjtë e kujtimeve", kur "nga brendia e qiellit" kënga e koha dhe qengji im "nuk po mejnë". Baci Adem inkorporohet në spektrin e poetëve të rrallë të letrave tona që krijon një lirikë motivesh kosmogonike, e denjë për lexim dhe rilexim. Ai krijon vlera të veçanta lirike mbi kohën me një maturi dhe thjeshtësi të veçantë, mbi gjëra të dukshme e të padukshme, ku "trenat kalojnë këndejpari", e "hëna rri ulur në fronin e saj".

Zërin e patëm shkreptimë vetëtime, thekson autori në njërin nga titujt e poezive të tij, dhe po qe se deshifrojmë

peshën stilistike të vargjeve respektive, konstatojmë se "hëna rri ulur në fronin e saj", se "ballëhapur qëndron tundimi", kur një buf i zi nate, tenton të ngulfatet "në qerpikët e ndezura të atdheut", duke parashtruar pyetjen "e kujt është kjo kërrabë", apo: "kush i la të hapura erërat", kur "vraponim mbrëmjeve të vona". Në krahasim me nja 2-3 kuaj që na janë bërë anëtarë të Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, pa pasur kurrfarë vlerash morale apo letrare, Adem Zaplluzha është një nga krijuesit tanë më të zellshëm, pa marrë parasysh moshën e tij të tretë që ndërlidhet me një pleqëri të bardhë e të mbarë, Vëllimi i
tij më i ri (Ky def prej hëne), strukturohet në tre cikle vlerash lirike të një ekuilibri të veçantë, ku fërshëllen era dardane mbi "dheun tim të bardhë", ku "mund të më gjesh në ndonjë baladë", ku "në maja të luleve përtëritet mëngjesi", ku "një prush i verdhë i ndezi malet", dhe "vetëm lehja e qiellit mbeti pezull". Kemi para nesh një botë paralele, një hapësirë të njohur, ku "hukama dëgjohej përtej shtatë bjeshkëve", ku i dëgjojmë thirrjet e erës, dhe të gjitha daljet nga balada.

Adem Zaplluzha shkruan poezi të përpunuara, nuk e hedh fjalën si lopa baglën, siç veprojnë disa skribomanë që e poshtërojnë gjuhën shqipe me krahinarizma banale, por na jep një botë interesante ku shpërthejnë idetë, mendimet, ndjenjat, imagjinata, pa përsëritje vargjesh nga 77
vëllimet e tij, pa metafora të sëmura dhe periferike. Vlera semantike e vargut të tij, meriton të respektohet, përfundimisht duke i dëshiruar një pleqëri të bardhë e të mbarë.

(Adem Zaplluzha, “**Diku te një baladë**,” “Fahri Fazliu”, Kastriot 2012)

Baki Ymeri



Diku te një baladë, thekson autori, ne deshëm ose nuk deshëm, sonte do t’i durojmë krakëllimat e korbave. “Kjo frymë e egër malesh/ Po ua shtrëngon shpirtin lisave.” Adem Zaplluzha nuk merret me çështje antipoetike duke përmendur emra korbash që vijnë nga lashtësia për t’i vrarë bijtë e shqipes. Autori depërton në botën universale, duke na dhuruar librin e tij më të ri, ku “Sa të trishtueshme qenkan/ Këto britma prej rrënjëve/ Kush e vrau Hamletin/ Kur netët vinin mbi krahë korbash.”. “Diku te një baladë” është një nga veprat që na e përforcon bindjen se poezia nuk degdiset nën agresionin e hiperteknologjive që na riorientojnë ekzistencën, duke na e përkujtuar mërgimin, dhe mikpritjen e famshme shqiptare: “I ftoj të njohurit e mi në ndejë/ Dhe ua tregoj/ Se si priten miqtë e vjetër? Një aromë e vjeshtës del në dritare/ Dhe i përshëndet/ Fluturimet e zogjve shtegtarë”. (Nëna ime).

Adem Zaplluzha nuk është një dritë e vetmuar, sepse në moshën e pjekurisë së tij artistike, din me mjeshtëri të rrallë të na i sjellë në varg fushat, malet, bjeshkët, qytetet dhe fshatrat e Dardanisë që i kanë dhënë këtij vendi një numër impresionues heronjsh, dijetarësh e shkrimtarësh që digjen për komb e atdhe. “Kuptova se qante një dru i vjetër/ Qanin edhe lisat e tjerë/ Nga lotët shqyhej mali/ Prej dhembjeve mbuloheshin gurët” (Dita kishte mbetur diku në vetmi). Imagjinata është prezent gjithandej, madje edhe “Dikur vonë/ Kur kishin filluar të largohen hijet/ I vara edhe duart e shelgjeve/ Po në ato vende që i përngjanin fëmijërisë” (Po aty). Mund të thuash se nuk ka inspirim dhe sens poetik në këto vargje brilante?

Sipas autorit, dita kishte mbetur në vetmi, askush nuk rrinte me të, asnjë zog nuk këndonte, madje, edhe drurët u përngjanin qyqeve. Pluhuri i yjeve dhe pluhuri i harresës nuk më kujtohet tani, thekson në një poezi tjetër: “Se si ka qenë ky pluhur/ I bardhë ose i hirtë// Një diell i portokalltë/ Fle mbi tjegulla/ Kjo gjuhë e gjelbër gjarpri/ Si flaka po i lëpin çatitë”. Adem Zaplluzha është një misionar i vargut kosmogonik ku dita e shembur nga koka, shikon në një pikë të çuditshme, dhe i numëron këputjet e meteorëve. Dhe më tej: “Ajri në metastazë/ Ka filluar të çmendet nga dhembjet/ E pashërueshme”.

Ka edhe shumë për të thënë për këtë poet, i lindur para 69 pranverave, dhe i dekoruar me 77 vëllime poetike, 37 sosh duke i botuar brenda një viti, siç kemi thënë dikur, aq sa pat jetuar Ati Ynë (Jezu Krishti), 33 vjet. Pse? Sepse “Vrapuan nëpër erë/ Etja/ Hiri e zjarri”, dhe më tej: “Vrapuan nëpër kujtesën e galopit kuajt/ Kur u ndalën të pinë ujë/ I dëgjuam zërat e nëntokës”

(Kalorësi). Kritikët e mirëfilltë shqiptarë dhe ata të Perëndimit, qëndisin ese pa citime vargjesh, duke analizuar tekstin poetik konform teorisë së letërsisë dhe stilistikës letrare, duke evidentuar trope, metafora dhe vlera tjera që ndërlidhen me analizën e tekstit, kurse kritikët rumunë dhe ne, pa dashtë e anashkalojmë këtë "kod" profesional, duke i ofruar lexuesit edhe mendimet e autorit, duke cituar perla poetike të seleksionuara nga vëllimi respektiv. Pse? Sepse, siç thekson baci Adem, dolën në dritën inkandeshente, me flamuj eshtrash, kalorësit e mi të bardhë.

Libri më i ri i Adem Zaplluzhës, proklamon të drejtën e vargut harmonik në ekzistencën e saj të lirë, në konditat e destrukturimit të ligjërimit lirik, gjë të cilën kritika letrare e ka përqafuar kaherë. Me gjithë këtë, një diskurs i këtillë, i pjekur dhe i frymëzuar, mbetet një çështje e virtuizitetit emocional përmes përshkrimit të dashurisë në formën klasike dhe bashkëkohore të vjershës, autori pa u bërë rob i lirikës klasike me rimë, duke shkruar me një dorë delikate, për një trëndafil të gurtë, që "Për herë të parë/ Mbiu në prehrin e mëngjesit".

POET I SIMBOLEVE DHE MENDIMIT TË THELLË

Fatmir Minguli - Durrës



Poeti kosovar Adem Zaplluzha vjen rishtas me një vëllim të ri poetik të titulluar "Te delta e mjellmave". Është libri poetik i 79-të i këtij poeti kaq prodhimtar, e megjithatë lexohet sikur të ishte libri i parë i jetës së tij si poet. Adem Zaplluzha është sot një nga poetët më kurajozë dhe më i përkushtuar ndaj poezisë, dhe jo vetëm asaj. Përkushtimi ndaj artit të poezisë e ka bërë poetin Zaplluzha që të ndërtojë stilin e tij të poetikës , të mjeshtërisë së dhënies së mendimeve duke i skanuar filozofikisht nëpërmjet simboleve të shumta e tejet të gjetura. Prandaj ,kam theksuar dhe vazhdoj të konstatoj se në krijimtarinë e bollshme të këtij poeti kemi të bëjmë me filozofinë e jetës. Nuk është aspak normale që të mendohet se ekziston rreziku i përsëritjes. Po,ky rrezik, mund të ekzistojë thjeshtë për një lexues që shfleton përciptazi, por e kundërta ndodh me njeriun e ditur, atdhetar, të thjeshtë që është larg euforive dhe sloganeve e që e thith mendimin e poezisë.

Kështu lexohet poezia e Adem Zaplluzhës që e sheh botën e kosovarëve në Kosovën e lirë, ashtu siç është,me andrallat e ndërtimit të një jete të re, në përpjekje për të tejkaluar ato të këqija që aty këtu mbeten. Këto konstatime përfitojmë nga ky libër i fundit i Adem Zaplluzhës, konstatime që shqetësojnë jo vetëm nënat por dhe lumenjtë, lisat e zogjtë e hapësirave kosovare**"Diku në Ballkanin e trazuar'':**

''Prej kryqeve
Dhe gjysmë hënave,
Një nënë vajton mbi një hartëFatin e grisur të atdheut."

Në këtë libër të ri që mbështetet nga Shoqata e Shkrimtarëve " Fahri Fazliu" të Kastriotit dhe nën kujdesin e recensentit Mazllum Baraliu e lektorit Veli Veliu , lexuesi do të gjejë konceptualitet e lirisë të stigmatizuara në simbolet e mjellmës. Mjellma, kjo " zonjë e rëndë " jo vetëm e liqeneve shqiptare e ka frymëzuar poetin tej mase duke e bërë që të krijojë kaleidoskope me pamje nga më të ndryshme të këtij shpendi fisnik.

Mjellma për Ademin është si një nuse e bukur, një vajzë e trishtuar, një konkuruese me zogjtë e tjerë, një mjellmë e murosur, një krijuese deltash (të lumenjve) . Janë pikërisht këto struktura të ndërtimit të simboleve që e bëjnë poetikën e Ademit modern, jashtë skemave skeletore të rëndomta e të shumë përsëritura të poezive që botohen nëpër faqet e gazetave politike të ditës.

" Libri i mjellmave " , do ta quaja këtë vëllim të ri poetik. Ky libër sjell akuarele të veçanta me fluturime

mjellmash jo në qiej të zakonshëm por për midis mjegullnajave të kohës “ që shi nuk lëshojnë” apo “erës, kjo që than pendët e mjellmave”.

Nuk mungojnë në këto akuarele edhe simbolet e reja që poeti Adem Zaplluzha na ofron rishtas, atë të dunave. Koncepti i futjes së këtij simboli shkon paralel me atë të deltës së lumenjve, që në rastin tonë është delta e mjellmave. Dunat janë grumbullimi i mendimeve, ngjarjeve, njerëzve, zogjve, antitezave dhe kontradiktave të mendimeve

E mbi këto duna fluturojnë trishtimet e mjellmave , e vetë mjellmat intersektohen me fjalë njerëzish e me pamje qytetesh ku dridhjet e xhamave të vitrinave rezonojnë me dridhjet e mendimeve dhe me rrahjen e krahëve të mjellmave.

Janë këto përsiatje që ilustrojnë poezitë moderne të librit “Te delta e mjellmave”, përsiatje që japin pak a shumë dhe melodiozitetin e vargjeve të poezive të ndryshme. Ja një varg i Adem Zaplluzhës ‘’ shirat kishin ndërruar pamjen” që na kujton De Radën me vargjet lapidare “ jeta lisa kish ndërruar”.Muzikaliteti në poezinë e Zaplluzhës është i tipit “muzikalitet mendim”. Ai , poeti vuan dhe trishtimin, revoltën, ndjenjat e bukura për njeriun e dashur apo për qytetin e tij i tregon me forma të ndryshme e tek i shpreh me forcë, qetësohet.

“Ato mote të prera
Te shkallët e liqenit
Ikën mbi kujtime mjellmash
Ikën nëpër pluhurin e harresës
Me një sini të artë!”

Duke ndërtuar laboratorin e metaforave, simboleve e metonomive , poeti arrin të kapë majën e mendimit filozofik ,duke hyrë thellë në shpirtin e njeriut, jo nëpërmjet predikimit sloganesk, por me magjinë e gjykimit të dekoruar me figurat që natyra na dhuron. Kjo është një vuajtje e poetëve të mëdhenj, vuajtje jo për të gjetur figurat komerciale por një vuajtje shpirtërore që kërkon mënyra të shërimit të shpirtit të vetë poetit. Në një pasazh prej interneti, kam gjetur një shkrim të një poeteje dhe studiuese për poetin e madh lirik Lasgush Poradeci , e cila thotë: "…ai kish një muaj që përgjonte ardhjen e mjellmave nga Ohri. Ato ende s'kishin fluturuar mbi liqen, sepse nuk kishte ardhur nata e shenjtë e qirinjve që lundrojnë mbi ujë!"
Si gjithmonë ,edhe në këtë libër të ri, nuk mungojnë poezitë për atdheun, për muajin e ngjarjeve, marsin, për Prekazin e për lumin e ëndrrave të Adem Zaplluzhës, Lumëbardhin.
E poeti udhëton rrugëve të çuditshme:

''Ky udhëtim i tejdukshëm
Me dizgjinët prej ere
Si kaprojtë e egër
Kalëron qiejve''.

Ashtu është, udhëtimi i poetit me këtë libër është si pamjet e poezive të tij e ai kalëron i
sigurt me artin e tij poetik, i bindur se po i jep gjithçka popullit të tij.
I qoftë kalërim i mbarë!

KUR I LËMË GJURMËT TONA

Ismet Hasani
Stockholm – Suedi, mars



"Në secilin hap të mendimit, Ne i lëmë gjurmët tona, pa e kontrolluar frymëmarrjen, ecëm udhëve deri në theqafje" Me këto thënie, autori - poeti Adem Zaplluzha, e fillon librin me titull "Fërfërimë gjethesh" në të cilin janë 63 poezi të përfshira në tre cikle.

Në ciklin e parë janë 20 poezi me tituj të ndryshëm si: Ato xhelozojnë, Të thashë, Shitësja e luleve, Acari, Njeriu me kapelë të vjetër, Toka e premtuar, etj. ndërkaq vet cikli titullohet "Njeriu me kapelë të vjetër"

Në ciklin e dytë janë 25 poezi të ndryshme të cilat mbajnë tituj: Shpirti i natës, Nga bedenat e Atdheut, Në vetëdijen njerëzore, Fërfërimë gjethesh, Kthimi, Atdheu etj, ndërkaq vet cikli titullohet "Fërfërimë gjethesh".

Në ciklin e tretë me titullin "Këto rrënjë të kujtesës" janë 18 poezi, disa nga të cilat mbajnë këto tituj : Ishin ato

kohëra, Të jesh poet ose profet, Këto rrënjë të kujtesës, Nuk është koha, Nëpër xhepat e fushave, Elegji për mikun, etj. Që të gjitha (63) poezitë, ashtu siç kanë tituj të ndryshëm, të ndryshme e kanë edhe përmbajtjen, edhe synimin apo qëllimin e poetit. E veprat vlerësohen në bazë të qëllimit, ndërsa gjykohen e sanksionohen në bazë të pasojave që lënë.

Thuaja së në të gjitha poezitë, poeti, në mënyra dhe me shprehje tëndryshme flet për njeriun, për kohën, përambientin, për mendimet e njeriut për jetën e tij, për krejt atë që e rrethon, për krejt atë që ia mundëson të jetoi më lehtë apo më vështirë. Dhe, jo vetëm për njeriun si individ, por edhe për njerëzit në përgjithësi: për mendimet e tyre, vetëdijen e tyre, për kujtesën dhe rrënjët e kujtesës, për momentet se a ishte koha apo nuk ishte koha?

Duke u thelluar në secilin varg dhe në secilën fjalë, poeti na mëson se në jetën e njeriut qëndrojnë vetëm dy rrugë: e para, të shpie kah synimi, kah qëllimi kah jeta, e dyta, të shpie kah shkatërrimi, kah humbja, kah vdekja. Tjetër rrugë nuk ka.

E veçanta e kësaj është se kjo e vërtetë jetësore, që na prezanton poeti ynë Adem Zaplluzha, thuaja së nga asnjë, apo te rrallë ndonjë poet tjetër, mund të mësohet.

Hartuesi i kësaj parathënie, duke qenë mirënjohës për caktimin e tij në cilësinë e redaktorit, e duke e kuptuar përgjegjësinë e punës, pikë së pari i ka studiuar mirë e mirë dhe analizuar secilën nga 63 poezitë, duke “hyrë” në brendinë e çështjes, bile, bile, siç shprehen studiuesit e së drejtës me thënien latine “in medias res”që nënkupton të hyjsh në brendinë e thellë, si të themi, të hyjsh në thelbin e bërthamës.

Mirëpo, këtu, për shkak të hapësirës dhe kohës, hartuesi nuk e ka atë mundësi që, përmes kësaj parathënie, në mënyrë përshkruese të shpreh krejt atë që përmbajnë në bërthamë/farë dhe në thelb që të gjitha (63) poezitë, apo secila veç e veç, por duke theksuar disa nga poezitë e përzgjedhura, do mundohet ta jep kuptimin dhe qëllimin e kësaj vepre. Mu për këtë, kërkon nga autori i librit dhe nga lexuesi që ta mirëkuptojnë se me këtë parathënie janë të përzgjedhura vetëm disa nga këto poezi, ani pse të krijuara nga i njëjti brumë, por të cilat "për diçka pak" veçohen nga të tjerat.

*

Të "ecim" pak udhëve të poetit, nëpër të cilat, në secilin hap të mendimit, i lëmë gjurmët tona, pa e kontrolluar frymëmarrjen, deri në théqafje dhe, nëse mbërrijmë te qëllimi jonë, jemi shumë më të lehtë sesa që ishim para së të niseshim. Po që së "arrijmë" në freskinë e ylberit në eter* (mbi retë), pas shiut dalin larvat* (kafshë, apo insekte), e po që së ulemi në degët e pemëve, të çezma/kroi nuk dalin më plakat, të cilat xhelozojnë vashat, xhelozojnë frymëmarrjen e lisave, ku mund, rastësisht, të zgjohet një Evë* (Eva e Adami) e fjetur. Kështu i kuptojmë hapat e mendimit të poetit, të shprehura në poezinë me titull "Ato xhelozojnë".

*

Shitësja e luleve i kishte humbur kordhat e zërit dhe vetëm nga sytë e saj
njerëzit ia lexonin qëllimet; në njërën dorë mbante një shportë prej mjegulle,
kurse dorën tjetrën e kishte të mbushur me trishtime; që të dy qëndronim të pasigurt mbi këmbët tona të kalbura, me gjasa, na mbante për dore një qëllim i njëjtë.

Sa me domethënie është shprehja e poetit: **“...qëndronim të pasigurt mbi këmbët tona të kalbura, me gjasa, na mbante për dore një qëllim i njëjtë”, të cilën e gjemë te poezia me titull “Shitësja e luleve”.**

*

Njeriu me kapelë të vjetër kalonte trotuareve këmbëzbathur dhe bisedonte me kambanat e qytetit, e ndonjëherë, kur ishte i vetmuar, bisedonte me qentë endacakë; disa pohojnë se ky është i shenjtë, kurse të tjerët iknin prej tij si djalli prej temjanit* (tym kur digjet rrëshira); njeriu me kapelë të vjetër shkelte nëpër rrugicat e qytetit me aq lehtësi, sa që na dukej se ecte nëpër shpirtin e paskajshëm të ujit. Ç’ti themi kësaj urtie, pos ta lidhim me urtinë tjetër: “... uji i thellë rrjedh qetë, qetë, njeriu i mençur flet ngadalë, ngadalë!” Të gjitha këto poeti i shpreh në poezinë më titull “Njeriu me kapelë të vjetër”.

*

Nata vjen si shtojzovalle dhe hyn si gjumi nëpër kolonadat e ëndrrave. Në çastin kur ndizen kandilat e yjeve, dalin edhe zanat e maleve, ulen në sofrën e atdheut dhe u këndojnë rrapeve. Deri sa yjet pikojnë në një mënyrë madhështore mbi flokët e thinjura të zonjës Hënë burrat ulen këmbëkryq nën rrap, te shkëmbi i kuq ndizen kandilat - Shpirti i natës zbret te plepat dhe bisedon me arkivolet e kujtesës. Kështu ndjehet shpirti i poetit, i cili këtë e shprehë në poezinë e tij me titull “Shpirti i natës”.

*Kur një zog qanë, qajnë edhe lisat me lot fëmijësh. Tej rrapeve Një kërrabë në ethe dënesë, çapitet me legjendat. Në vrimat e kavallit zgjohet e nesërmja. Ecin

lisat drejtë të panjohurës. Hapat e erës s'ndalen dot. Fërfërimë* gjethesh (*zhurma e gjetheve kur i lëviz era). Në zërin e honit ia vunë mëgojëzat rapsodive që vajtonin. * ("Fërfërimë gjethesh")

Ah moj këmisha ime e shqyer! Sa shumë po i përngjanë Hartës së atdheut. Sado që po të arnon nëna Shqipëri, nga të katër anët po fryjnë erërat e liga me zili. Në Veri po të kafshojnë ujqërit, tërbimet nuk ndalen as në Jug.Nëno! Kush mund t'i shëroj plagët nga këto kafshime shtrigash? T'i ndanë malet në disa pjesë, i prenë lisat. Për dru zjarri detit i hynë mes për mes. Me ty nënë, askurrë nuk përfundoi "pazari". Duan të të fusin në një thes, të përfundosh si një mace e shkretë. Burrat e tu nënë, me disa të huaj me gjasa nuk donë të të shohin as si princeshë, e as si mbretëreshë.

("Atdheu")

Në qytetin e përrallave pemët kanë mbetur pa gjethe. Ca degë të lëbyra* (*t'i vranë sytë) në oazë - i thithin rrënjët e veta. Po që se sonte nuk vjen pranvera
e do dalim te kisha dhe do i thërrasim të reshurat - si në kohërat pagane. Pastaj do kërkojmë prej Hënës pak dritë, po aq sa merr prej Diellit. Këto rrënjë të kujtesës nuk lulëzojnë në shkretëtirë për t'i ujitur kujtimet. Do i thërrasim nuset, që aq shumë kanë lot në sy sa që po përmbyten Kolonadat e mermerta të historisë.

* **("Këto rrënjë të kujtesës")**

Thonë se të jesh poet, duhet të kesh një mallkim në shpirt dhe një gur të zi në mendje. Ose pa mallkim e të jesh profet, me qenë edhe i padukshëm, të gjithë të dashurojnë. Të jesh profet është sikurse të jesh i lindur për herë të tretë. Për herë të parë ne të gjithë lindim

lakuriq, kurse të dytën herë, mbase na i veshin ca pantallona që u përngjajnë erërave. Njëlloj është të jesh poet ose profet, kryesore në morfologjinë e etjes duhet kërkuar se si dhe pse stërkalat e shiut shndërrohen në dallga detesh?

* ***("TË JESH POET OSE PROFET")***

Janë këto disa nga poezitë e këtij libri, të cilat, për hir të lexuesit, u përpjeka t'i shpjegoj krejt ashtu siç edhe vet i kuptova, duke hyrë në thellësinë e brendisë së tyre – në thelbin e bërthamës. Mirëpo, lexuesin e porosis që mos të ndalet vetëm në këto, por të lexoj të gjitha poezitë e këtij libri dhe tek atëherë do të bindet se: sa më thellë që hyn, aq më shumë ka me hasë në thesarin e paçmuar të kësaj pasurie poetike, të cilën na ka dhuruar poeti, tashmë i mirënjohur, Adem Zaplluzha.

RINGJALLJA E ROMANTIZMIT DHE OPTIMIZMIT TË POETIT

Fatmir Minguli
Durrës, 27 mars 2013



Tek shfleton dhe pastaj lexon me vëmendje librin e ri poetik të poetit prishtinas Adem Zaplluzha ,ndjen një aromë ndryshe poetike, ndryshe nga librat e mëparshëm të shkruar dy vitet e fundit.

Adem Zaplluzha sot njihet si poet i revoltës kosovare dhe njëkohësisht i mendimit ngulmues për gjithçka është kosovare dhe më tej gjithë shqiptare. Por me sa duket, afrimi i pranverës së sivjetshme e detyron poetin të rrotullojë shigjetën e busullës e të hapë disa perde në skena disi të harruara në "teatrin poetik" të tij.

Nën një kujdes delikat të autorit Adem Zaplluzha , libri i 80 –të me titull " Refrene yjesh" merr pamje sa të bukura aq dhe rinore, ku optimizmi është refren i tij e i shoqëruar nga ndriçimi i yjeve.

Një ambiguitet refrenesh që transmetohen në linja kozmike.

Në librin e ri ndjehet pranvera e gjithanshme, pranvera e fijeve të barit dhe pranvera e Bacës Adem me këto poezi krejt ndryshe, jo vetëm në formë por dhe në mendimin poetik.

Po të shohësh dhe titujt e tre cikleve të këtij libri do ndeshesh me "Refrene yjesh", "Asnjë flutur e dylltë", "Jo të gjitha udhët", që kapërthejnë gjithçka brendore që vjen mbas tyre. Optimizmi, kjo kategori e mendimit njerëzor, e ka tronditur tashmë poetin dhe ai e kthen në filozofinë poetike, ku me pak fjalë u thotë njerëzve se **"udhët janë të hapura":**

Asnjëherë,
Nuk ngushtohen rrugët
Në fund të një udhe
Fillon një nismë e re
E cila kurrë nuk përfundon."

Poezi të tilla të stilit të Zaplluzhës i gjejmë shpesh në librin **"Refrene yjesh "**

Epoezi e shkurtër ku simfonia e stinës hynë në harmoni me dy kërcimtarët e ata harrohen…Por dhe hëna ka një pjesë të madhe në shumë poezi .Hëna për Adem Zaplluzhën është burimi i ngjyrave me argjendin e të cilave vesh tisat e mjegullnajave, lumenjtë bel hollë, rrapin mendimtar, kalatë e moçme dhe atë qe poeti ka më shumë për zemër: baladat.

Me hënën romantike krijohen imazhe të vërteta të baladave, se vetë ato janë mishërimi i një epike romantike , një fenomen poetik i mjeshtërisë së Adem Zaplluzhës, mjeshtri e tillë që nuk gjendet në krijimtarinë

e poetëve të tjerë. Baladën ,ky poet e ka himnizuar duke e përcjellë kudo në botën shqiptare, duke luftuar format propagandistike të epizmit gazetaresk. Balada për Ademin shoqëron deri në imtësira aspektet e jetës.

Në libër gjejmë figura të tilla të guximshme si shirat metalikë të meteorëve që aludojnë sulmet e dikurshme të armiqve me problemet ekologjike të sotme Në këtë mënyrë Zaplluzha tejkalon simbolin drejt koncepteve shkencore të kozmosit e këto tejkalime janë tepër të dashura për të.

“Rri kacule një hënë
Rri dhe shikon
Diku tej përtejmes
Mallin e përgjumur të atdheut.”

Po Zaplluzha mëton të “ecë nëpër balada “ sepse ai e ka “qëmtuar me kohë sekretin e legjendave të vjetra e të reja.”Janë këto fshehtësi që “ një ditë do e çojnë poetin dhe gjithë popullin deri te drita”!

Gjatë këtij udhëtimi ,përveç se romantizmit optimist poeti ndeshet me arkivolet, një tjetër simbol i dëshiruar, i pëlqyer nga poeti. E nuk ka si të ndodhë ndryshe ,ai ,poeti kurrë nuk e harron të keqen , e konsideron pjesë të jetës , pjesë që e sheh me syrin e realitetit edhe kjo si pjesë e baladave. Këto përcaktime dalin nga poezia e bukur “Kalaja si nëpër baladë”.

Për sa i përket motiveve poetike, edhe në këtë libër nuk mungojnë motivet e trenave, shtegtimit të zogjve si rasti i poezisë me objekt laraskën, mjegullat, lumenjtë me shtratin që u ngushtohet si beli i vajzave, shirat e pafund, qeset e najlonit që vërtiten si të çmendura

bulevardeve, deti me varkat e përmbysura të peshkatarëve, këpucët e poetit e shumë motive të tjera.

Poeti Zaplluzha është munduar ,ndoshta me pak vështirësi të mos bjerë në përsëritje me librat e mëparshëm, një rrezik evident por që ai i ruhet rreptësishtë. Motivet, natyrisht janë " të personalizuara " dhe dallojnë jo vetëm nga poetë të tjerë po dhe me vetë poezitë e Zaplluzhës.

Për mendimin tim, me këtë libër Ademi ka eksperimentuar duke ringjallur një romantizëm të brishtë të fillimeve të veta poetike e duke ardhur deri këtu me një romantizëm epiko optimist si një risi në poezinë panshqiptare.

Një risi tjetër që poeti e kultivon prej kohësh por e pavënë re nga kritika është dhe ndërtimi i cikleve brenda numrit të preferuar "3", risi që e aplikon në shumicën e librave të tij poetikë. Kjo risi e ndihmon autorin dhe bashkë me të dhe lexuesin që të ketë një përqëndrim teknikisht më të lehtë, ku lexuesi e merr aromën e poezive si nga lule të panjohura më parë.

Struktura e librit më të ri "Refrene yjesh" është më ndryshe nga librat e mëparshëm, është më i kapshëm, më rinor, ndoshta nga dozat e larta të një romantizmi disi të "harruar".Por njerëzit e duan romantizmin, prandaj poeti në një varg thotë: "po lind një diell i ri".Shkurt, qartë dhe me optimizëm!

E ai nuk e harron rrapin, pemën simbol e për të cilin thur vargje komplekse duke përfshirë problemet që preka më lart në këtë shikim:

“Rrapet kush e di se për të satën herë
Çelën do zogj prej fjalëve
Dhe asnjëherë më
Nuk u gjunjëzuan
Në bejlegun e lirisë.”

Jo vetëm që një diell i ri po lind për shqiptarët por dhe fjalët e poetëve çelin zogjtë e lirisë anë e mbanë trojeve Shqiptare. Nuk është fjala për nacionalizëm politik por për një ringjallje të shqiptarizmës së Rilindasëve të 100 viteve më parë që para së gjithash ishin iluministë e vetvetiu dhe romantikë.

Libri i ri i Adem Zaplluzhës na shpjegon shumë gjëra të tilla.

ADEM ZAPLLUZHA MBI FLATRAT E IMAGJINATËS

(Sonte çdo gjë i përngjan lotëve,
Fahri Fazliu, Kastriot, 2012)
Baki Ymeri

Poezia sipas Kantit është arti për të prezantuar një lojë të lirë të imagjinatës si një aktivitet të intelektit. Duke shfletuar 77 veprat e Adem Zaplluzhës, nuk mund ta anashkalojmë këtë konstatim, sepse imagjinata e tejkalon përvojën dhe parimet e njohjes, ndërsa aplikimi i saj në praktikë, krijon vlera që e pasurojnë thesarin e kulturës kombëtare. Vrapi i ditëve, koha e kuajve dhe zogjtë e mjegullave. Sonte çdo gjë dënes, sipas autorit, vetëm një qen i vetmuar dëgjohet, ndërsa ne jemi "fëmijë të ëndrrave", duke parashtruar pyetjen "Mbas cilit yll vrapuan ditët?"

Askush nuk shkruan pas shpresën për të qenë i lexuar, as baci Adem, madje. Libri i tij më i ristrukturohet në dy cikle: Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve, dhe, Si një

hukamë prej mjegullave. Ajo që i mungon autorit, janë mjegullat e mendimeve, sepse ai nuk ka mjegulla, por ka imagjinatë, vitalitet dhe energji për t'i ofruar lexuesit surpriza pas surprizash. E nesërmja, sipas tij, apo sipas Migjenit të dikurshëm, "ndoshta do të gdhijë", e ne "do të bëhemi zogj prej mjegullave/ ku t'i gjejmë honet e përgjumura", sepse "po na ikën kjo kohë". Poeti respekton etikën poetike të gjeneratës së tij, madje edhe të gjeneratave më të reja. Kjo mund të vërehet edhe në bazë të disa titujve të poezive të tij, si: "**Dhe ndodhi ashtu siç mendonte** poeti", **"Flenë edhe trarët e tymosura", "Sa pak jetuam me duart që vetmojnë", "Dhe prej atyre që janë fëmijë zvarranikësh", "Nën qepallat e mjegullave", "Shikimet na mbetën tej urës", kur "Ju të gjithë jeni pas meje".**

Edhe pse i përket një gjenerate krijuesish të vjetër, pa u bërë viktimë e kompromiseve, autori i përmbys principet e lirikës shabloniste të realizmit socialist, duke respektuar parimet e një gjenerate që kalon nga komunizmi në kapitalizëm. Mbi supet e kësaj gjenerate mbështetet ana aktive e letërsisë së sotme shqipe. Nga etika dhe poetika e saj, varet ardhmëria letërsisë kombëtare, jo vetëm te shqiptarët. Kosova në këtë aspekt, shkëlqen përmes lirikës nacionale me vlera universale të Sali Bashotës dhe gjeneratës së tij. Për të mos anashkaluar subjektin, po kalojmë te baci Adem me lirikat e engjëjve të tij, "pranë murishtave te plepat", kur "atë natë qante edhe mali me vaje gjethesh", kur "do t'i pyesim edhe zogjtë", në "çaheshin kokrrat e pluhurit ndër çati", "nëpër rrugicat e ngushta të mendjes", kur "nga befasia u dehën të gjitha gjethet". Mund të thotë

kush se nuk ka frymëzim në kontekstin e këtyre vargjeve?
Ndërmjet poezisë së parë (Sonte çdo gjë dënes) dhe asaj të fundit (Nëpër plasat e mureve fshiheshin merimangat), defilon etika poetike e një lënde të mbrujtur me ironi (kur në pasqyrën e mendjes binte një shi i zi), ndjeshmëri (kur në zemrën time strukej një grusht me re), tekstualizëm dhe postmodernizëm. Adem Zaplluzha nuk është një poet vlerash të mëdha universale, siç është Sali Bashota, apo vlerash të mëdha nacionale, siç është Ali Podrimja, por ai
noton mes universales e nacionales me vargje qëmbeten në kujtesë, sepse ai shëmbëllen me një fëmijë që dëneste, kur "qante edhe loti i gurit", kur "qanin rrapet" dhe "lot gjethesh derdhej udhëve". Dhe "Kështu kjo ditë/ Zbriti nga kapela e ime", duke cijatur "me zogjtë e fëmijërisë".Çdo gjë buzëqesh dhe qan në lirikën e tij, madje edhe lisat që dënesin për duart e thyera të degëve, kur "Shirat bëhen lot nusesh/ Kur dalin nga gjerdeku/ Ëndrrat e merimangave", në këtë natë të trishtë, madje edhe era "që mërmërit pa pushuar", kur "Nëpër të çarat e kujtesës/ Përbirohen shqetësimet". Derisa në vargjet e Bashotës dhe Podrimjes shndërrisin fushat dhe bjeshkët e letërsisë shqipe me një dritë të mençur, në platformën poetike të Adem Zaplluzhës defilon Kosova me një melankoli të veçantë, ku nostalgjia "Tinëzisht i shkund pemët", kur "Diku në një bahçe/ Si kujtimet bien mollët" dhe " Era si një hije e pa ngjyrë/ Depërton tej portretit të pasteleve/ Dhe s'lë asnjë shenjë në horizont/ Vetëm lehjet e kontrolluara të qenve/ Ngjiten mureve si gozhda fjalësh". Nuk ka hije ta teprojmë me vargje të cituara, sepse kritika e mirëfilltë kërkon analizë të tekstit poetik,

por na ka hije ta përfundojmë këtëshkrim me këto vargje, ku ne ipresim me padurim:“Pritjet e shkundura/ Te portat e fundme të qytetit” kur “Dalin nuset me pajën e fshehur/ E dhëndurët/ Kurrsesi nuk kthehen nga luftërat .

KOHA SHQIPTARE E NJË KRIJUESI KOSOVAR

(Adem Zaplluzha, **“Koha ime dhe koha ejote”**, Shoqata e Shkrimtarëve Kastriot, 2012)

Baki Ymeri-Bukuresht



Mbushe një gjym me shpirtin e erës dhe erërat e qytetit tim, dhe zgjate dorën moj hije madhështore, dhe pyet: “Kush është ai atje” dhe “Kush banon përtej teje!”. Me vargje të këtilla brilante defilon Adem Zaplluzha në librin e tij më të ri, përmes të cilit dëshmon se librat e kanë shpëtuar botën nga terri i skëterrës, nga heshtja mortore e asaj që s’flet, nga një gjeth i vyshkur që bie mbi tokë, kur vjeshta “Hyri në fazën përfundimtare”.

Autori është një plakush i mençur që pas një muaji i mbush 70 pranvera, pa e bezdisur lexuesin me vargje apo sintagma që përsëriten në 77 veprat paraprake, apo, ku ta dimë ne se sa ka botuar deri tani, gjithmonë duke i dhënë prioritet artit poetik. Dimri vjen ngadalë, sipas tij, apo: “Si kërraba e gjyshit tim/ Çapitet kalldrëmeve shqiptare/

Dhe futet diku të pushojë/ Nën ullukët e çative të rrënuara". Edhepse nuk ka një situatë financiare më të mirë se në kohën e Titos, siç e kishin shqiptarët e kësaj zone të persekutuar nga zullumi osman dhe ekspansionizmi serb, Ademi nuk shkëputet nga libri dhe bën mirë, sepse bota pa libra është si një kotar delesh pa dele, apo si një hergjele kuajsh pa kuaj.

Nuk janë të befasishme erërat/ Ato përditë kalojnë këndej/ Vrapojnë si kuajt e drunjtë/ Deri te rropullitë/ E arkivoleve/ Vrapojnë e s'ndalen askund/ Shkojnë të flenë/ Mes eshtrave dinozaurësh/ Erërat e qytetit tim/ Fryma e mirë e maleve krenare. Edhepse i moshuar, por ende i paplakur, Adem Zaplluzha ka një ambicie dhe një vullnet pune për admirim. Autori e përkujton fëmijërinë pa fëmijëri, kur askush si ne, nuk e kuptonte fërshëllimën e erës, kur "Herë këndonim/ E herë prej lotëve të kristaltë/ Krijonim shiun/ Për t'i mbytur skamjet". Për t'i kuptuar mirë vargjet që e sajojnë këtë vëllim, është e domosdoshme t'ia njohim edhe jetën, dhe pse jo, edhe moshën e njomë, kur "Shikonim nëpër rrugë/ Këpucët e zonjave me taka", kur "Shoqeve tona/ Shkruanim letra prej ere/ Dhe kur i shihnim ato/ Ne bëheshim erë prej dëshpërimi". E këtillë ka qenë e shkuara e shqiptarit, me halle të vogla apo të mëdha, jo vetëm në Kosovë, kur "Mbushnim mataranë me dhallë/ Dhe përtypnim misërniken bajate".

Dhe papritmas, pas një jete të bujshme, vjen pleqëria kur grindemi me bastunin dhe kalojmë rrugëve, dhe na mundojnë disa mendime, dhe nuk dimë, a kemi qenë ndonjëherë fëmijë, apo kemi lindur të rritur! Mendimet respektive i përkasin autorit që e strukturon librin e tij në tre cikle me tituj të zgjedhur si, Mbushe një gjym me

shpirtin e jetës, Ishin zhveshur të gjitha yjet, dhe Ky shi i zi i përzier me pluhur. Lirikë e pastër ku reflektohet jeta e shqiptarit të ndarë e përçarë në dy shtete të "mëdha" (Shqipëri e Kosovë) dhe katër vilajete pa mbret e mbretëri (Çamëria, Ilirida, Lugina e Preshevës dhe një trung i Shqipërisë Etnike që ka mbetur nën ombrellën e Malit të Zi). Vaj halli për ne që ende nuk dimë të lozim si duhet, që "Pranë çdo kafeje/ Jemi në gjendje t'i nxjerrim sytë/ Njëri tjetrit// Kur nuk mendojmë/ Se për çfarë na duhen grindjet tona/ Mos vallë / Me këto mosmarrëveshje banale/ Jemi duke i plotësuar mungesat e fëmijërisë!".

Autori t'i kujton vargjet e njërit nga titanët e lirikës sonë (Pas çdo gazi e hidhërimi/ mbetet pas vetëm kujtimi/ ah dhe i shkreti mallëngjimi), duke e ripërkujtuar kohën dhe moshën e saj, "Kur u kthyem në shtëpi/ Na prite një pjatë me fjalë/ Sa pak patëm lozur atë ditë/ Kur tek shtatë krojet/ Na zuri mbrëmja/.../ Sa pak qeshëm atë ditë/ Me fluturat e fushës", kur çdo gjë e kishim të ndaluar, madje, edhe qeshjet tona fëmijërore. Para nesh kemi një lirikë interesante subjektesh sociale dhe meditative, ku defilon jeta me të gjitha të papriturat e saj. Jemi zogj apo njerëz që u përngjajmë zogjve, pyet në kontekstin e një poezie dhe përgjigjet: "Zogjtë i mbajmë në kafaz/ Si dekor të përditshmërisë". Por ne, vazhdon më tej poeti, për dashurinë tonë në, mburremi te miqtë, se sa pendla të bukura kanë zogjtë tanë.

Tejet impresionuese janë vargjet kushtuar aktualitetit shqiptare me konotacione universale, kur murgjit dhe hoxhallarët s'mbarojnë me lutjet e tyre: "Për një lek/ Edhe kriminelin e drejtojnë në Parajsë/ Kështu e

ka kjo jetë/ Por çfarë të bëjnë të varfrit/ Kur s'kanë asnjë lek". Po qe se japim vetëm titujt e poezive të shkëputura nga përmbajtja në fund të librit, lexuesi nuk mund të na e zë për të madhe pse i japim kaq rëndësi këtij autori, ndaj po e përfundojmë me kaq, siç përfundon një ditë edhe jeta jonë: "Në çastin kur vdesim/ Na i mbathin nga një palë këpucë të reja/ Dhe dalim nga lëkura e
jonë/ Mu ashtu/ Siç e zhvesh këmishën/ Gjarpëri me zile// Të dashurit tanë/ Na drejtojnë kah portat e Parajsës/ Kurse ne që sapo dolëm nga Ferri/ Sërish hymë në Ferr/ E vetmja rrugë/ Të cilën e mësuam përmendësh që në fëmijëri".

PARATHËNIE

Dilaver Goxhai

Poezitë e shkruara nga Adem Zaplluzha nuk mund të ishin shkruar kurrsesi pa atë perspektivën që vetë historia i dha jetës së tij dhe gjithë popullit tonë pas fitores së lirisë së Kosovës, ndaj dhe poezitë e tij kanë gjithë ndjesinë dhe peshën njerëzore të kësaj ngjarjeje të madhe. Dhe ajo ishte një ngjarje që e mbart veten në lartësinë e historisë e të poezisë. Kjo perspektivë i dha jetë edhe krijimtarisë së Adem Zaplluzhës, i cili ka arritur me nxjerrë nga botimi vëllimin e 80-të poetik të tij. Dhe kjo është shumë e shpjegueshme. Kjo prodhimtari e Adem Zaplluzhës tregon se ai poezinë nuk mund ta lidhë pas asaj që po mbaron e po vdes. “Duhet të dish se si t’i shkulësh bukuritë letrare gjer edhe nga vet gjiri i vdekjes – na thotë Lotrëmoni – por veçse këto bukuri s’do t’i përkasin vdekjes”. Tek poezitë e Zaplluzhës vdekja s’është veçse shkak rastësor.

Duke cituar Lotrëmonin, nuk di pse më shkoi mendimi tek dyshimi se mos vallë Adem Zaplluzha e ka pa parasysh këtë thënie të tij që edhe në këtë vëllim poetik vdekjen e ka tepër rastësore, madje edhe kur është i detyruar ta përmendi i kundërvë asaj gëzimin e jetës. Këto dy antiteza i shohim dukshëm edhe tek poezia, e cila i ka dhënë titullin edhe vet këtij vëllimi poetik: "Mëkati i Hijes", i cili thotë:

''Secili prej nesh,
Ecën deri te fundi i rrugës
Mos vallë na pëlqejnë ecjet funerale
Dhe muzika mortore''.

Dhe menjëherë i drejtohet erës, sinonimit të jetës, duke thënë:

''Kur na bekon era
Mendojmë se jemi të pavdekshëm,
I shkundim të gjitha gjethet
Nga rrethi i unazës''.

Por po të lexojmë edhe poezinë tjetër "Dënesim dhe qeshim", shohim se tek poeti nuk humbasin as kujtesa dhe as vetëdija. Prandaj mund të themi me plot gojën se poeti ynë nuk është nga ata poetë që bëjnë poezi me porosi por është poet që përjetëson rrethanat dhe momentet jo vetëm ato historike, por edhe një rrethanë sado të vogël. Këtu qëndron edhe sensi poetit i tij. E them këtë pasi poezia e Adem Zaplluzhës buron nga vet ndjenjat e tij me saktësinë e pasqyrimit, duke qenë

besnik i ngjarjes, duke e transmetuar atë ndjenjë artistikisht tek lexuesi, duke e bërë poezi me vlerë.
Kur poeti thotë:

‘’Nga këtu
Filluan ikjet e zogjve..!
Nuk di
Nëse ju kujtohet kënga e qyqes
Ishin të gjata rrugët e pikëllimeve’’.

Ai na tregon ngjarje e kohës së tij, kur nënat me ‘zogjtë e tyre në duar (fëmijët) u detyruan të ikni na Kosova si rrjedhojë e gjenocidit serb në Marsin e vitit 1999, duke e konkretizuar me qyqen, zogun e vetmisë.

‘’Më kujtohet
Kur i lamë te pragu gëzimet!?
Dhe dolëm pa itinerar
Për të marrë botën në sy
Nuk na u desh shumë kohë’’.

Dhe ashtu ndodhi, fillimisht populli ynë iku për të gjetur një strehë, për të futur kokën dhe për të shpëtuar fëmijët, ndaj dhe u duk sikur ishte vetëm duke mbetur në pikëllim, por poeti e konkretizon përsëri kur na thotë:

‘’Ishte Marsi me shi lotësh
Data 27 viti 1999,
U gëzoheshim si fëmijë
Zogjve të metaltë
Dhe ecnim binarëve pakufi’’.

Ishin "zogjtë metalikë", avionët luftarakë të NATO-s, të cilëve populli shqiptar në Kosovë u gëzohej njësoj si fëmijëve të tyre:

''Shikonim se si fluturonin
Mbi krahët e duraluminit
Dënesnim e qeshnim
Me gëzimin
Në pikëllimin tonë''.

Vetëm sikur me këto dy poezi të kufizohemi në këtë analizë, mund të themi me plot bindjen se Adem Zaplluzha e ka kaluar me kohë periudhën e sprovës. Dhe këtë e shohim te horizonti i poezisë së tij, i cili është zgjeruar mjaft, gjë që tregon se poeti ynë nuk mund të largohet kurrë nga fatkeqësitë e popullit të tij. Ky zë i tij mbizotëron në krijimtarinë e tij poetike, sepse ai përkon me dëshirën e përjetshme të popullit të tij për të jetuar, në kundërshtim me shkatërrimin dhe rrënimin.
Poeti ynë e di se paqja është e vetmia parullë, i vetmi mesazh që ai e përjeton, e vetmia e ardhme e mundshme, prandaj na thotë:

''Zjarre këngësh të kënduara
E të pa kënduara
Hipin cikloneve
Dhe zbresin me mjeshtëri
Tej mjegullave
Vijnë
Si shpirtra zgalemash
Dhe udhëtojnë deri në përjetësi''. (Poetët)

Tamam për këtë realitet luftoi ai popull. Nuk mund të ketë për Ademin rrethana që nuk janë të lidhura mes tij dhe popullit të tij. Përmes poezive të këtij vëllimi poeti kërkon të na thotë: as zogjtë, as zemrat tona s'kanë për të reshtur ndonjëherë së kënduari për ata që na solli lirinë.

Top of Form
Bottom of Form
Pak si hyrje, pak si parathënie

Ismat Hasani

Është kënaqësi e veçantë kur lexon vepra të një njeriu, i cili ka dalë prej gjirit të një populli të vogël, e me kohëështë bërë i madh e i njohur dhe popullin e vendin e vet i ka bërë të mëdhenj e të njohur!

Ka raste të rralla njerëzish, të cilët sukseset më të mëdha i kanë arritur pas moshës 65 vjeçare, atëherë kur shumë të tjerë kanë menduar për ta se kanë filluar të plaken, se nuk i kanë më lëvizjet e shpejtuara të gjymtyrëve, nuk kanë forcë të të menduarit dhe se nuk janë më të dobishëm për mesin ku jetojnë, për shkak se ju mungon energjia e mendimit dhe e krijimit. Autori i këtij libri, poeti i respektuar Adem Zaplluzha e dokumentoi atë të parën: është ndër të rrallët poetë, shkrimtarë e publicistë që më shumë ka tituj të botuar sesa vite jete, raporti deri me sot është 70:82 në të mirë të botimeve. E kush e di edhe sa e sa tituj do të botojë,

ende pa i bërë 71 vjet?! I dëshirojmë suksese të mëdha drejt ngjitjes në majat më të larta të artit, shkencës dhe përparimit të mendimit njerëzor.
Pata rastin dhe privilegjin të jam redaktor i librit të tij me titull "Një zog prej uji " – mbi çka ndihem krenar, por edhe përgjegjës ndaj obligimit të besuar, për përmbushjen e të cilit do të përdor të gjitha aftësitë e mia...
Poeti Adem Zaplluzha përmes këtij libri paraqitet me 50 poezi të përfshira në 3 cikle:
(1) cikli i parë me titull "Palaçot e të gjitha ngjyrave" përmbledh 10 poezi, si ajo me titull: "Jemi të pangopshëm", "Një kornizë pa titull", "Në duart e kripura të barkave", "Nuk ishim të gatshëm", "Palaçot e të gjitha ngjyrave", "Fillimi i një përfundimi",etj.
(2) cikli i dytë me titull "Një zog prej uji " përmbledh 21 poezi, si ajo me titull: "Nuk është hera e parë", "Mes psalmeve të lashta", "Çelin zogjtë e shenjtë", "Tingujt e një muzike", "Nëse mbërrimë", "Lutje me frymën e butësisë", etj.
(3) cikli i tretë me titull: "Atje te pemët" përmbledh 19 poezi, si ajo me titull: "Kollitet si kali plak", "I përngjan të verbëtit", "Këndonin vashat e vetmuara", "Teorema", "Atje te pemët", "Askush nëpër rrugët e qytetit", etj.
*

"Shoh njerëz të braktisur
Nënat me nga disa lloje
Shiringash në shpirt
Duke bredhur rrugëve

Pandërprerë ecin nëpër skëterrën
E trishtuar të jetës

Lypsarë
Dhe perëndi pa fron

Shoh prostituta të moshuara
Që s'kanë çka të shesin
Përveç brekëve të palara
Dhe trishtimin e jetës"
... ("Palaçot e të gjitha ngjyrave")
Me këto vargje e fillon poeti ciklin e parë të poezive te tij.
Për të vazhduar ciklin e dytë:

"Këndej
Mund të kalojnë vetëm ata
Që kanë mësuar të ecin mbi litar
Dhe ata që e njohin
Më mirë lojën e vdekjes
Kjo fije kashte
Shumë lehtë mund të digjet
Nëse flenë me zjarrin

Sa për pak ujë ka nevojë
Loti im
sa për pak qeshje po ashtu
Kanë nevojë
buzët e ndryshkura prej erës

Kurse njerëzit që qeshin
U përngjajnë të marrëve
Kur përtypin fjalët e mjegullave
Si kafshatë të hidhur të jetës"
... ("NUK ËSHTË HERA E PARË")

Ndërkaq ciklin e tretë – të fundit me titull ”Atje te pemët” e fillon me vargjet:

“Jeta ime
I përngjan jetës së harabelit
Më mjaftojnë nëpër stinë
Disa kokrra mel
Dhe i them dimrit eja bablok
S’ke se çfarë më bën”
... (“Jeta ime”)

Dhe e përfundon ciklin e tretë me vargjet:

“Pranvera ishte për mua
Vetëm një dëshirë e largët
Në njëmijë dyer trokita

Dhe asnjëherë më
Nuk u ndalën
Trokëllimat e stinëve të egra”
... (poezia “Thonë se”)

Me sa unë kam mundur ta kuptoj, poeti na mëson se tri gjëra janë të vështira në jetë:

‘’Të dëgjosh,
Të shohësh, dhe
Të heshtësh.
Mirëpo, na udhëzon që ta kemi
parasysh se:
E VËRTETA,
LIRIA, dhe
VIRTYTI, janë tri gjëra për të cilat duhet ta duam jetën’’.

SHENJA TË NDRITSHME SHQIPTARE

Baki Ymeri



Poezia dhe gruaja na duken si dy përralla të përjetshme. Është apo s'është poezia një "instrument" për çlirimin e shpirtit dhe shkarkimin e ndjenjave? Përgjigjen mund të na e japë vetëm kritika letrare e rangut të lartë. Adem Zaplluzha krijon "përralla" poetike me engjëj të vërtetë. Kjo vërehet që nga cikli i parë (Në lotin e nisur të një nëne), të vëllimit Rinjohje që gjendet në shtyp: "Nëno fisi i jonë/ Përjetoi një tronditje të madhe/ Ishte dyndja e mjegullave" që "Depërtoi nëpër shpirtin e erës/ Kur kohërat e liga/ Brenin hekurin". Vargjet e tij janë margaritarë të ndritshëm që fundamentojnë kërkimin permanent të së Vërtetës. "Sikur të ishim me shtatë shpirtra/ Ne sërish/ Nuk kishim gjasa/ Për një ngadhënjim mbi vetveten/ U deshtë të ecim përtej çdo mundësie". Në këtë kontekst gjendemi në rrugën që ka si finalizim shkrirjen me qenien kur ne depërtuam në një rrugëtim të përjetshëm.

Dikush na i zuri këmbët, thekson autori, “Me një kërrabë prej bore/ Por ne nuk kishim/ Se çfarë të bënim/ Me kokëfortësinë tonë/ E lëmë eshtrat/ Te një dru i shenjtë/ Dhe ikëm tejpërtejmes”. Adem Zaplluzha e ndjen veten si një njeri të lumtur, përmes vullnetit të Zotit, mënjanë, dhe përmes përpjekjeve të tij, në anën tjetër. Ai din t’i përshkruajë misteret e jetës, kur thonë se nuk kishim nevojë për asnjë lloj lutjeje në ato çaste vendimtare, sepse “Neve na mjaftonin/ Vetëm lutjet tona pagane/ Dhe shpirti i erës/ Që hynë dhe del/ Nga çdo portë/ E këtyre murishtave”. Mendimet e autorit përbëjnë librin e shenjtë të jetës dhe të natyrës: “Mbase pritnim lindjen tënde/ Ashtu siç pritën/ Edhe popujt e tjerë”. Dhe më tej: “Ne filluam/ Ta harrojmë gjakun tonë/ Kur erdhe ti/ Ishin lëshuar në gjysmë shtize/ Perdet nëpër sokakët e shpirtit/ Dhe dënesnin si kalamaj/ Flamujt e atdheut .Këtu, shenjtëria nuk mban shenjat e një misterium tremendum, por ajo fanitet konform rregullave transparent sipas të cilave, pas duartrokitjeve tona filluan të shkunden gjethet e pemëve që i përngjanin mishit të njeriut. “Dhe me të vërtet ngjau ajo/ Që pritëm me shekuj/ Ngjau shkundja e çdo gjëje” kur nga murishtat e rrënuara, filluan të lëshojnë myk, vegimet e trishtuara të baladave. Poezia e parë e vëllimit respektiv, ndahet në 16 njësi të shkruara më 31 mars 2013. Numri nuk është simbolik, ngase nuk ka të bëjë as me 8-të apo 88-të, por janë simbolike meditimet dhe parafytyrimet kur nën degët lakuriqe të hënës, i zhveshëm shpirtrat zogjve, “Dhe sot bredhim sokakëve të fëmijërisë/ Bredhim pa kurrfarë qëllimi/ Dhe nuk dimë/ Se ku e kemi këmbët/ Dhe ku kokën”. Madje, edhe nostalgjia ka rolin e saj konstruktiv, kur “Një shpirt pagan/ Zgjohen në

ashtin tonë/ Dhe merr me vete/ Fëmijërinë/ Dhe vajtimet e mjegullave/ Ku akoma flenë shirat”.
Shkrimtari peruan Mario Vargas Llosa, i nderuar me Çmimin e Nobelit më 2010, thekson se “Letërsia më ka dhënë çastet më të bukura”. Çastet më të bukura, jo vetëm për mua, janë gruaja dhe dashuria si përrallë e përjetshme. Apo, pse jo, lufta e dikurshme për çrobërimin e Shqipërisë nga zullumi osman, apo betejat e lavdishme për çlirimin e Kosovës nga terrorizmi serb (1999). Adem Zaplluzha është poeti i stinëve dhe meditimit filozofik kushtuar jetës shqiptare në Kosovë: “Dje u pamë/ Me një stinë të vonuar/ Kurse lisat e prera dënesnin/ Tok me arkivolet e lagjes/ Që asnjëherë nuk i zuri gjumi// Siç po duket/ Këtu në këtë lagje/ Akoma nuk paskan pushuar/ As daullet e shqyera të luftës”. Janë vargje brilante që posedojnë vlera universale për njohjen e një kombi kreshnik që ka përjetuar më shumë trauma se sa lumturi, kur çdo të dytën apo të tretën ditë, në mëhallën tonë, ndërrohen kufomat e balsamosura, me flamujt e trishtimeve

Para bacës Adem e ndjejmë veten të çarmatosur. Është për shtatë vjet më i vjetër

se unë dhe ka botuar 81 vëllime poetike, pa kaluar në kategorinë e skribomanëve: “Kur dëgjoj ndonjë këngë lakuriqe/ Në emër të ndërgjegjes/ Protestoj deri në mëngjes/ Kurse në anën tjetër” konstatoj se kënga/ Duhet të jetë fillimi i gëzimit/ I veshur me krenari/

Dhe dinjitet/ E jo fillimi i mjerimit/ Të një shpirti mbushur me blasfemi”. Vargjet e

propozuara nga Adem Zaplluzha, reflektojnë vlera të larta fetare dhe ekzistenciale, konform të cilave feja jonë është shqiptarizmi: “Sa herë që kaluan këndej pari/ Priftërinjtë e dehur/ Dhe hoxhallarët e ekzaltuar/ Një instinkt i lashtë/ Na thoshte të shkojmë pas tyre// Dhe kurrë nuk u ndalëm/ Ecëm/ Përtej të pamundurës/ Deri sa mbërrimë/ Ta gjejmë Ferrin/ Te buzët e ndryshkura të atdheut”. As që ka nevojë ta çojmë më tej këtë mendim kritik mbi lirikën e tij, duke u bazuar vetëm në 2-3 poezi të tij, duke ua lënë kritikëve të mirëfilltë analizën kritike të krejt librit, për ta dekoruar autorin me një medalje të artë, siç e meriton.

KRIJUESI QË NUK VJETROHET

Begzad Baliu



Në historinë e letërsisë shqipe, nuk janë të paktë shkrimtarët të cilët krijimtarinë letrare e përcaktojnë brenda një periudhe të tyre jetësore, duke i arritur majat krijuese në një moshë të hershme apo të thyer. Pa dashur të përmend shkrimtarë dhe periudha letrare që ata u takojnë, do të doja të kujtoj se kjo është një përvojë që nuk ka ndodhur vetëm brenda letërsisë shqipe, por edhe në letërsinë evropiane. Letërsia shqipe, përkatësisht krijuesit tanë identifikohen në këtë kontekst edhe më veçantë, për faktin se shumë shkrimtarëve mundësitë e tyre krijuese u janë caktuar edhe brenda zhvillimeve politike të kohës, pasi shumë herë për periudha të caktuara u është ndaluar mundësia e botimit.

Autori, krijimtarinë e të cilit e kemi bërë objekt studimi, identifikon një përvojë krijuese, do të thoshim noliane, një skaj i kundërt i asaj që jemi mësuar ta shquajmë: lasgushiane. Ndonëse krijues që ka filluar të shkruajë e të botojë në një moshë shumë të hershme, majat e larta të

saj i ka shënuar për të mos thënë vazhdon t'i shënojë në një moshë të shtyrë.
Temat e shumta, motivet, ana shpirtërore e materiale e një brezi të cilit i ka takuar, të përvijuara dhe të reflektuara brenda poezisë së tij, tashmë të bartura në një kohë pothuajse tjetër, kanë marrë kahe dhe zhvillime, të cilat i diktojnë jo vetëm ndikimet e jashtme po edhe angazhimet intelektuale, referencat konceptuale, modelet krijuese, anë këto me të cilat janë të prirë të komunikojnë krijuesit që kalojnë nga modeli skolastik dhe deklarativ i poezisë së tyre, në modelin alegorik e ironik, që konceptualizon dhe motivon tash rrëfimin dhe komunikimin me recepientin.
Krijimtaria e tij, fillimisht tekstet poetike për fëmijë, aspak përjashtuese do të thoshim edhe për të rriturit, tash së fundi është zgjeruar si për temat dhe motivet ashtu edhe për modelin e artikulimit të tyre si opsesione kërkimi në fushë të poezisë. Fjala është për temën e madhe të lirisë, të mërgimit, të dashurisë, të mallit, të vuajtjes etj.
Po t'i bënim një prerje sado përgjithësuese dhe kronologjike, vetëm temave të mëdha të veprave të tij, nuk do të ishte vështirë të krijonim strukturën konceptuale të prirjeve të tij edhe në poetikën e tekstit. Ajo reflekton një botë të pasur ndjenjash sociopolitike e kulturore të kohës dhe pse jo edhe të prirjeve letrare të asaj kohe në fushë të poezisë, nga titulli i veprës së parë "Puthje" deri te titulli "Muret" apo nga "Morfologjia e dhembjes" deri te vëllimi "Ai vjen nesër", një prirje kjo mjaft simbolike në letrat shqipe të këtij brezi. Dhe për më tej nga titulli tjetër deklarativ "Udhëndarja"(2007) apo deskriptiv "Letër nga mërgimi" (2007) e "Thirrje

gjaku”(2008) te “Vesa e lotit tim”, të cilat shprehin gjithë botën shpirtërore të popullit të tij në vitet e dhimbjeve të mëdha, të besimit të madh, të lëvizjes së madhe kombëtare dhe çlirimit kombëtar. Të kësaj natyre janë edhe veprat me karakter përkujtues, për të mos thënë historik dhe përjetues: “Hyji në Prekaz”, “Shtegu i mallit”, “Zgjimi i gjëmës” etj., apo poezitë e veprave me temë humoristike dhe satirike “Don Kishoti dhe Rosinati”, “Kafshimi i mikut”, “Bajraktarët e vatanit”, sado poezia gjithashtu me prirje ironike apo thjesht ironia në poezinë e tij përgjithësisht nuk mungon as në veprat e tjera.

E bëra këtë prerja letrare të poetikës së veprës së tij nga aspekti kronologjik, historik dhe tematik për të ardhur e konstatuar korpusin letrar të poetikës së veprës së shkrimtarit Adem Zaplluzha, e cila tashmë nuk paraqet as prirjen hermeneutike të veprave të para të viteve ’70; as prirjen emocionale dhe deklarative e folklorizante të periudhës së dytë të viteve ’90; as prirjen ironike të temave të përditshmërisë sonë dhe atyre sociopolitike të shekullit XXI; por prirjen simbolike të krijuesit, i cili tashmë ka krijuar shenjat e tij letrare, përkatësisht simbolet e tij të kujtesës historike, të të menduarit dhe të poetikës së tij estetike, të pranishme dendur në vëllimet poetike: “Tejdukshmëria e shiut”, “Përtej teje”, “Ikja e eshtrave”, “Kalorësit e mjegullave”, “Hingëllima e shiut”, “Mirëmëngjes Imzot” etj.

Edhe vepra e tij më e re “**Thyerja e urave”,** gjithashtu është një përpjekje për të ruajtur linjën dhe sistemin narrativ, artikulimin simbolik të përditshmërisë apo kujtesës sonë. Në këtë frymë janë shkruar edhe poezitë e këtij vëllimi duke ruajtur gjithnjë shenjat përimtuese të

veprave të para apo duke i ridimensionuar përmasat e tyre.
Vëllimin e fundit e përbëjnë kapitujt: Kalorësit e shpirtrave, Urat e thyera dhe Nuse e paprekur moj erë.Fjalësi dhe togfjalëshat e poezisë së tij, në të vërtetë simbolet dhe metaforat e strukturës së poezisë së tij: shiu, mjegulla, shpirtrat, yll i vetmuar, kalorësit e shpirtrave, flokët e shprishura, vesa në vjeshtë, korniza në mur, arkivoli i ngjyrosur, vetvetja, urat e thyera, freskia e luleve, pëllumb i bardhë, kuja, isoja, shkëlqimi i rrejshëm, era, kambanat, ofshama e mbrëmjes, sirenë e vetmuar, dasmat e lashta, shpirti i etur i vendlindjes, shiu i vjeshtës, stoli i kujtimeve, mjegulla, Kosova ime Biblike, nënë e moshuar, plagët e shëruara të Gjergjit, loja e hingëllimës, brenda të cilave janë kaq shumë të pranishme vjeshta dhe përbërësit e saj, sikur të kujtojnë moshën e shtyrë të poetit, moshën e vjeshtës, frytet e së cilës mjeshtri ynë po i vjel si pak nga krijuesit tanë. Le të jetë kjo arsyeja që për figuracionin dhe përbërësit e tjerë të poetikës së poezisë së tij, do të preferoja të shkruaj në një rast tjetër.
Krijimtaria letrare e Adem Zaplluzhës tashmë ka formësuar profilin e tij krijues, e me gjasë ajo tashmë i ka kaluar lexuesit e proviniencës sonë dhe është bërë pjesë e hapësirës shqiptare e ndërkombëtare, si vlerë dhe si vëllim. Ajo sjell një pasuri të madhe vlerash të kujtesës historike e mbijetesës së
sotme. Disa nga poezitë e vëllimeve të tij mund të shërbejnë edhe model pune në formësimin e fjalësit dhe sidomos togfjalëshave dhe kuptimeve të tyre në letërsi.
Vite më parë, duke folur në shënimin e 65-vjetorit të lindjes, konstatoja: Le të jetë kjo arsyeja pse sot në

përvjetorin e lindjes së tij, në një përvjetor më të veçantë nga ato që ne i shënojmë në moshën tonë, të nderojmë krijimtarinë e tij letrare, krijimtarinë e krijuesit që vazhdon të shkruajë si në asnjë moshë tjetër, veprën e krijuesit që nuk vjetrohet. Le të thuhet këtu edhe njëherë se mendimin për te dhe për proceset krijuese të tij, as sot as këtu nuk i kam ridimensionuar, prandaj ndjehem mirë për këtë.

ORIGJINALITETI I NJË POETI MODERN

Bedri Tahiri

Se muza Kaliopë duhet të këtë qenë më e shkathëta dhe më e lirshmja, dëshmon edhe poezia e modernistit tonë, poetit që për më shumë së gjysmëshekulli nuk e lë t'i topitet maja e mprehtë e penës së tij, i palodhuri Adem Zaplluzha. Poezia e tij është specifike dhe shquhet për një origjinalitet të veçantë, që i shkon për shtati këtij individualiteti krijues me një botë emotive shpërthyese, përplot spontanitet e zjarr përvëlues vullkanik. Vargu i tij është i lire, i natyrshëm, i liruar nga të gjitha klishetë ngufatëse e ngurtësitë metrike. Mirëpo, në fakt, ai është i brumosur me ndjenjën e fuqishme të dashurisë për jetën, për njeriun, për atdheun.

Edhe njohja fizike (poezinë e tij e kisha lexuar dhe pëlqyer prej motesh) me poetin Adem Zaplluzha është disi e veçantë. U takuam në Durrës. Jo në plazh, duke u rrezitur, por në takim letrar, në Pallatin e Kulturës "Aleksandër Moisiu" të Dyrrahut plak. Ishte 18 maji

2013, në Festivalin “Pranvera poetike durrsake”. Unë referova për librin “Triumfi i kombit” të Skënder Kapitit, ndërkaq ai lexoi poezinë “Thyerja e hijeve” dhe fitoi një çmim të merituar, çmimin e karrierës.

Adem Zaplluzha është poet që ka zënë të botojë qysh në vitin 1957. Dhe, që atëherë më nuk ka pushuar për asnjë çast. Interesant, as diskursin e vet krijues nuk e ka ndërruar, i qëndroi besnik vokacionit poetik. Sot është në rrumbullaksimin e njëqind titujve të publikuar. Një ditë kishte ndarë mendje që dorëshkrimin “Diku në fund të një fillimi” të ma besoj mua për redaktim e lekturim. E pranova me gjithë qejf dhe u ndjeva i nderuar.

Libri “Diku në fund të një fillimi” është shkruar me një frymë, madje vetëm brenda një jave (23 mars- 29 mars 2013). Ashtu e ka frymëzimi. I bekuari, të vjen kur ia do zemra e jo kur ti e thërret. Nisur nga kjo rilindasit tanë dhe në përgjithësi krijuesit madhorë, frymëzimin e konsideronin si akt hyjnor, si komunikim të drejtpërdrejt me Perëndinë.

Libri më i ri i këtij poeti është ndarë në tre cikle të titulluar:

‘’Jepu një shans duarve tuaja,
E pamë një hartë të grisur dhe
Diku në fund të fillimit’’.

Duhet cekur se poezitë e kësaj përmbledhjeje, edhe pse në të parë duket të thjeshta, të lehta, me një rime të brendshme, në vete ngërthejnë porosi të qarta. Ato janë meditative e shumë të thella, me refleksione shumëdimensionale, me ngjyrime e kolorit autokton shqiptar. Heroi lirik është njeriu ynë, I djeshmi dhe i

sotmi, që me stoicizmin e vet sfidoi padrejtësitë e historisë njerkë.

Kështu, duke e skalitur portretin e babait tek poezia me titullin Babai im, pos tjerash ai shkruan:

‘’Babai im
Si dasmat
I adhuronte luftërat.

Ai burrë sy gështenjë dinte
Si askush tjetër ta përbuzte frikën,
Dhe të tallej me vdekjen
deri në pafundësi
babai im
Ndjesë pastë
sa shumë e donte lirinë’’.

Një tablo e bukur realiste, ku malësori, i lidhur si ashti me kockën për truallin e vet, i donte njësoj si dasmat si luftërat. Ai e përbuzte frikën dhe tallej me vdekjen, ngase shumë e donte lirinë.

Poeti, pas njëqind vjetësh (sigurisht e mendon 100-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë) sheh një dritë, dhe, ashtu si Migjeni që dikur kërkonte një Mbinjeri, sikur parapëlqen një ndryshim, një risi, një metamorfozë, sepse në poezinë “Preke lotin deri në fund” thotë:

‘’Po deshe
Preke shpirtin tënd deri në lot
Nga loti do mbijë molla
Kurse nga molla
Një njeri
Krejtësisht i ri’’.

Siç e thashë edhe në fillim, vargjet e kësaj përmbledhjeje, si kur flasin për fëmijërinë e pa fëmijëri të poetit, si kur flasin për dashurinë, që rrënjët i ka më thellë se sa rrënjët e urrejtjes, madje edhe kur i kthehet ledhnajave të historisë e tregon për kalanë e vendlindjes që ishte edhe para Rozafës, janë stolisur me fjalë të zgjedhura poetike e përplot simbolikë e figurshmëri, duke ia siguruar vetes vendin në faqet e antologjive më të përzgjedhura.

Vargu i lirë i Adem Zaplluzhës nuk është vetëm formal e struktural. Jo, ai është edhe funksional dhe nënkupton edhe liri mendimi e liri veprimi. E kjo, sipas poetit, arrihet vetëm atëherë kur njeriu lirohet nga vetvetja:

‘’Nëse nuk çlirohesh nga vetvetja
Ti kurrë nuk do të jesh i lirë
Miku im...’’

Këtë e thotë edhe në fillim, në poezinë “Jepu një shans duarve tua”, duke porositur:
‘’Të thash
Jepu një shans duarve tua
Të brishta
Dhe fluturo ku të duash
Nëpër botën e miniaturave...’’

Pa dashur të lëshohemi më thellë në hullinë e këtyre qilizmave të punuara me përkushtim, ku secila strofë e secila varg përshkohen nga një polisemi nëntekstuale dhe japin porosi, marrë guximin të them se përmbledhja më e re e poetit Adem Zaplluzha “Diku në fund të një fillimi”

parqet një nga perlat e poezisë së sotme shqiptare, andaj edhe shpresoj shumë se do të pritet mirë nga lexuesit dhe do të këtë jetëgjatësi në bibliotekat tona.

DAULLET E NETËVE KOSOVARE
(Adem Zaplluzha," Daullet e një nate", Kastriot 2013)

Baki Ymeri

Adem Zaplluzha duket si një gurrë e pashtershme e frymëzimeve lirike të veshura në tesha të mëndafshta. Në vargjet e tij dremisin lulet e saksisë si një magjepsje e gërshetuar me pëshpëritje zogjsh që depërtojnë tejmatanë perdeve, duke të ftuar për një dremitje të ëmbël, ngase gjumi e ka kapluar lulishten e shtëpisë.

Zogjtë,gështenjat, lulëkuqet, varret e dëshmorëve dhe Kosova dremit. Në kuadrin e ciklit të parë, Sonte nuk dua të vdes, autori provon të luajë sonte fatin e zogjve. Ajo që ngjan me ajrin, duket si një ishull mes mjegullave. Ishulli i uritur dhe i etur si zogjtë e shkretëtirës. Dhe më tej:

"Rëra fluturon përtej mendimit/ Një kaktus i etur/ Pi ujë në shpirtin e rërës/ Dielli si në copë gacë e përskuqur/ I pjek zogjtë në fluturim e sipër. Netët kosovare zalisen në zërin e mullinjve, kur kjo dunë prej vezëve të breshkës, me gjasë paska mbetur,

si një varr i vetmuar: "Një arkivol i hirtë/ Te një varr i panjohur/ I kreh flokët e thinjura të zjarrit", tejmatanë kufirit të kujtesës. Kur përmes pëlhurës së grisur të një anijeje, shpërthen kureshtja dhe guri i mullirit të duket si një blanë mbretërore, kur stina si syri i verbër i hënës, shiko tejpërtej galaktikave, rritjen e një shelgu të pikëlluar. Autori zgjohet "Përtej kujtesës/ Si nga një ëndërr e trishtë". Prej vezëve të thyera dalin çafkat, kurse qielli i mbuluar me pupla njerëzish, hingëllon si kali i sëmurë. Universi, imagjinata, tropet dhe figurat tjera stilistike nuk mungojnë, as atëherë kur baci Adem, përtej parmakëve të dritares, sheh djersitjen e ajrit: "Te dhoma e pritjes / Një shpend krah madh/ Është ulur pranë kujtesës/ Dhe i ëndërron/ Ikjet e kota të stinëve".

Shqiptarët, sipas tij, ishin me gjasa të parët, që e gjetën zjarrin, "Por mishin e pjekur e hëngri nata". Dhe më tej: "Kur dëgjuam kushtrimin/ Tupanët veç ishin shurdhuar/ Nëpër mëhallë/ Bredhin ardhacakët e dehur/ Dhe i recitojnë do psalme të vjetra/ Në një gjuhë të huaj/ Që s'na përket neve". Ne dënesëm një kohë të gjatë, thekson autori, dhe shton se me një ngashërim të padëgjuar deri atëherë, dëneste edhe kori i bretkosave: "Por vaji i jonë/ Më duket edhe sot/ Se i përngjante lutjeve të erës". Vargjet e bacës Adem duken si do këngë djepi në bibliotekën e sentimenteve letrare. Nën gurin e mullirit vërtiten shpresat dhe aspiratat, kur ti e përkujton zërin që e bluan romancën e ditëve të nesërme. Në vargjet e tij dremisin, madje, edhe shikimet ndaj yjeve, madje edhe ti, përmes kandilit që e përkund dritën e gjumit, kurse gjumi yt duket më i qartë se pa skajshmëria, në kohën kur: "Lëkura ime e grisur/ Shtatë

herë u shit sot në treg/ Dhe herën e tetë/ U konvertua në hartën e Atdheut".

Shqiptari i Kosovës nuk din të ndalet, sepse fjalët e tij kanë filluar t'i përngjajnë kristaleve të borës. Janë të ftohta si njerëzit, herë u përngjajnë eshtrave të elefantëve, e herë arkivoleve të kalbura: "Do dalim si gjarpri nga lëkura/ Do e grisim ëndrrën e posa nisur/ Te ky gur që nuk i përngjan as murit/ Do i mbjellim krahët e zogjve". Nuk kemi kohë për fluturime të reja, thekson autori: "Me mija vjet fluturuam/ Dhe asnjëherë nuk e mbërrimë cakun/ Sonte do të mendojmë pak më ndryshe/ Për itinerarin e kësaj udhe// Do ecim tejpërtej arsyes". Pse? Sepse nuk ka ndalje në këtë rrugë, dhe po qe se ndalemi, kurrë më, nuk do të mund ta prekim, ëndrrën tonë të posa nisur. Problemet e stilistikës letrare e angazhojnë kritikun të trajtojë krejt lëndën poetike, kurse ne e anashkalojmë këtë "porosi", duke analizuar vetëm poezitë e para, për të nxjerrë në pah të vërtetën, se kemi të bëjmë me një veteran të mirëfilltë të poezisë së sotme në Kosovë.

Më 30 korrik të këtij viti (2013), autori thekson me fjalë identike, se sonte është koha, të cilën e kemi pritur me mija vjet, dhe do të nisemi, atje poshtë te ledhnajat e historisë, ku na presin do punë posa të nisura. Dhe papritmas fanitet një re e dendur: "Më lëshoni", se "Sonte dua të dal/ Nga klishetë e së kaluarës/ Do hyj në labirintet e kësaj kohe/ Dhe si nëpër tregimet fantastike", do të kaloj në anën tjetër të lumit, në secilën degë të kësaj peme, do mbjellim nga një domethënie, kurse më pastaj do të ecim, deri te sinorët e luadheve: "Koha është/ Për kositjen e barit të njomë// Nëse vonohemi/ Për udhëtimin deri te baladat/ Nëpër rrugët e

metropoleve do i kërkojmë/ Pendlat e ndukura të zogjve/ Që mbetën peng i një tjetër kohe". Vargje brilante që shëmbëllejnë me perëndimin e Ballkanit të çmendur, dhe një stinë të re, kur, herë shqepen e herë ngjiten hartat, kur një re e dendur, asnjëherë nuk i ndryshon itineraret. Bacën Adem e ngazëllen fillimi i mirësisë dhe mbarimi i ligësisë. Ai ëndërron për zogjtë e erës dhe pa skajshmërinë e lumturisë. Sipas tij: "Këto gjëra që po i preki sot/ Më duket se i kam prekur/ Para disa shekujve/ kur vdisnin meteorët".

Zëri i mullinjve të ujit dhe zëri i mullinjve të erës. Zëri i viktimave të luftës dhe zëri i ditës së nesërme. Dita e djeshme kur tundej edhe mali, kur si fije bari tundeshin rrapet, kur "Nga vegimet e një trishtimi/ Fluturoi një shpend gjigand ", kur deshën të qajnë nënat, kur nga një hënë e gjymtuar, si peri doli para lotëve, dhe u shndërrua në disa dallgë të papara. Përfytyrimi fanitet kur "Atë çast filloi të fryjë një furtunë/ Nëpër flokët e mjegullave/ Veç kishte rënë një borë e kuqe/ Mbase dimri/ Mund të prekej me dorë si hija", kur më zë kotësia. Dhe papritmas, shqetësimin e zëvendëson optimizmi, kur filloj të mbjelli një farë të re, nga shpirti i erës, që i shtrydhi të gjitha trishtimet, dhe qeshi me gjelbërimin, deri sa pushojnë të reshurat:

"Nuk kam më kohë për shitje/ As për të blerë s'kam lekë/ Tundem udhëve/ Si një varkë e humbur/ Dhe në shpirtin pathyeshëm të detit/ U bie daulleve të kushtrimit".

Në ciklin e dytë, "daullet e një nate", defilojnë tituj poemash tjera brilante, si: Sonte do ecim, Te flokët e erës, Përtej çdo mundësie, Në tregtarë ëndrrash, Nëpër

rrugët e qytetit të ngrirë, Si disa gjallesa parahistorike, Rri varur skeleti i erës, Ata që u flijuan për ty, Dhe hija e një druri etj. Jashtë mureve të është cikli i tretë. Si zgalemat e rrufeve, Një dhembje si kjo, Në kokën time rebele, Pastaj vjen heshtja, As atje e as këtu,, Më shkruaj një letër, ne bëhemi zogj të egër, janë disa nga poezitë e këtij autori që shëmbëllejnë me një album historik të lirikës sonë kontemporane. Sipas
filozofit rumun, Tudor Vianu, feja, filozofia dhe arti janë pjesë e specialiteteve. Bota moderne del në pah me dridhjen e parë të mendimit. Adem Zaplluzha meriton respektin tonë për idetë dhe mendimet e tij në fushë të kulturës

ATY KU FJALËT PËRHERË FRYMOJNË

Adnan Abrashi



"Poezia shfaqet si njohje e drejtpërdrejtë për fshehtësinë e tmerrshme, të cilën jeta e jonë, e rrëmbyer nga fshehtësia kozmike, ia parashtron vetvetes

(Roland dë Penvil)

"Ma jepni një fjalë të bukur dhe unë nga ajo do ta krijoj poezinë ", kështu, në mes tjerash, kishte deklaruar në një emision televiziv poeti ynë i madh dhe miku im i dashur, Adem Zaplluzha. Nga ai emision i vlefshëm dhe i pasur prezantues, jo rastësisht i shkëputa mu këto fjalë për ta shprehur kështu në metaforë botëkuptimin tim që kam për të, sikur një "krijues përherë i kapluar nga transi poetik".Vërtet, si ta vlerësosh ndryshe këtë poet tonë të shquar cilësor, e mbi të gjitha të begatshëm sasior, sikurseështë Adem Zaplluzha, i cili, së bashku me këtë vepër konkrete në botim, edhe më tepër e pasuron visarin tonë të krijimtarisë së gjithmbarshme poetike kombëtare, duke marrë pjesë aty me gjithsej 86 vepra të veta të botuara në poezi. Po ta kesh parasysh gjithë këtë opus përmbledhjesh poetike të botuara nga një autor i

vetëm krijues, fiton përshtypjen se ke të bësh me një njeri i cili nuk njeh kotësinë. Si duket, çdo hap për të në jetë është përsiatje, trans i veçantë i përqendrimit shpirtëror, gjendje kjo e duhur transcendentale, nga e cila si vetëdije gufon vargu poetik i thurur në poezi.
Gjithnjë kam menduar se kritika letrare për një vepër të shkruar artistike, e veçanërisht për një vepër të zhanrit poetik, bëhet nga profesionist e fushës së caktuar adekuate. Andaj, në momentin kur, poeti dhe miku im i dashur, Adem Zaplluzha, kërkoi nga unë që të jem redaktor i veprës së tij të 86-të me rend në poezi, titulluar: ”Asnjë fjalë nuk frymon”, t’ju them të drejtën, në fillim u befasova shumë. Edhe pse, që më parë i kisha të lexuar shumicën e veprave të tij, dhe, sado-kudo, në vete veç kisha të formuar një koncept të përgjithshëm si bindje për frymën e tij krijuese, tashti këtë ofertë e përjetova, jo më si dikur, një ftesë për një debat të ndërsjellë miqësor, por si një sfidë serioze për një vlerësim më autoritaiv që pas vete ka një përgjegjësi më të madhe publike. Natyrisht, përveçse si obligim, njëkohësisht ky besim për mua ishte edhe një privilegje e madhe, të cilën assesi nuk mundja ta refuzoja.
Duke lexuar me vëmendje veprën në dorëshkrim, gjëja e parë që menjëherë më ra në sy ishte metafora e paradoksit të titullit të përzgjedhur nga vetë autori: ”Asnjë fjalë nuk frymon”?! Si redaktor, t’ju them të drejtën, këtu pak hamendësova , por shpejtë u binda se pikërisht ky emërtim metaforik i kësaj vepre, shprehë realitetin tjetër paradoksal të asaj që duhet të thuhet për poezinë e Adem Zaplluzhës: se çdo fjalë frymon fuqishëm në vargun të tij poetik. Aq fuqishëm saqë emocionalisht nuk e lë indiferent edhe dashamirin e

zakonshëm dhe jo aq të pasionuar të poezisë. Ai, mbase, këtë joshje fascinante të përfitimit të lexuesit e bënë në mënyrë automatike... dhe, pikërisht këtu fshihet mrekullia krijuese e një autori të begatë që ne zakonisht e vlerësojmë si "talent". Talent të radhë, pa dyshim.

Pra, përmbledhja me poezi "Asnjë fjalë nuk frymon" qysh nga titulli na jep retorikën e heshtur, pasivitetin që ngritët në nivelin e emocionit e të asociacionit të metaforës klinike. Shenjëzon metaforën e vdekur por të ringjallur brenda diskursivitetit tekstor. Asnjë fjalë nuk frymon jashtë fjalës e fjalisë, jashtë mendimit e ndjenjës, përfundimisht jashtë poezisë. Gjithçka çka është poezi, çka është figurë ka trajtimin e lirshëm të frymës e të frymëzimit. Poezitë e autorit kthehen gati përherë në retrospektivë duke dashur të prekin në të shkuarën e të gjitha kohërave, duke gjetur kujtimet, jetën dhembjen dhe dashurinë. Figurat e kujtimit, stacionet, mjegullat përherë nostalgjizojnë;

Këto valë të kripura herë hynë
E herë dalin si lugetër
Nga përgjumja e fanarit të një nostalgjie
Zgjohen përmbytjet e peshkatarëve

Poezia e dashurisë është ekspresive duke dashur të sjellë origjinalitetin krijues të autorit. Atdheu shprehet si etje, e etja si epistem dhe si gnosis të hedh detyrimisht në krajatat e dhembshme, të durimit të njeriut tonë dhe mbi të gjitha të dhembjes nëpër kohë e histori. Poezia okazionale është poezi e meditimit ekstrapersonal. Autori dyndet në botën e tij personale duke dhënë edhe super fuqinë e tij krijuese, na hedh në retrospektivë dhe në nostalgji me kujtimet te cilat janë aq të freskëta dhe i japin simbolikë tekstit poetik. Qyteti i Lidhjes nuk

determinon veç historinë dhe të kaluarën por ngjeshët edhe me autorin, jetën e tij dhe në veçanti me dashurinë dhe bukurinë dualiste të qytetit dhe të vajzës shqiptare;

‘’Lozte edhe era
Me fustanin e gocës ,
Kurse Lumëbardhi
Si çdo herë krenar
Depërtonte nëpër damarët
E lashtësisë së qytetit të Lidhjes’.

Gjatë tërë kohën, si në këtë vepër, ashtu edhe në gjithë krijimtarinë e poetit e bukura është kudo prezentë, por ajo nuk ka te bëjë kryekëput me te mirën dhe as decidivisht me moralin, por konceptohet si një absolute ne vetvete. Nga vargu në varg , lexuesi i joshur, gradualisht vëren se ajo e ndryshon trajtën, është e papërcaktueshme, e lëvizshme, të duket se nuk i nënshtrohet rregullave e doktrinave... Është e tillë, sepse ajo gjithmonë shpik vetveten. Po ashtu, duhet të thuhet gjithsesi këtu se e bukura, sikur në këtë përmbledhje, përgjithësisht sikur në gjitha poezia e Adem Zaplluzhës, është tërësisht subjektive sepse gjithkush e përjeton atë nga këndvështrimi i vetë! Kjo pra është universaliteti i kumtesë specifike në poezitë e Adem Zaplluzhës

Meqë nga natyra nuk jam ithtar i fjalamanisë dhe fjalë gjatësisë së tepruar për të shprehur dhe përshkuar diçka që gjithsesi duhet edhe drejtpërdrejtë të përjetohet, këtë parathënie modeste bërë kësaj vepre, do ta përfundoja me një urtësi të shkruar nga një autor gjenial emri i të cilit, në këto momente , nuk po më kujtohet:

“Në detin e pakufishëm të poezisë vetëm poeti është krijues absolut; bota zhvillohet sipas dëshirës së tij. Në

qoftë se është i ndjeshëm, bota në poezinë e tij do të jetë i ngjyruar me emocione; në qoftë se nuk është i ndjeshëm, bota në poezinë e tij do të jetë shterpe. Poeti i mirë, për nga vullneti i vet absolutisht lirisht mund t'i ngjall sendet
pa shpirt si dhe t'ua marr shpirtin atyre që kanë."
Të gjitha këto karakteristika të mirëfillta, janë prezentë në poezitë Adem Zaplluzhës, duke dëshmuar kështu se poezia është vërtet fryt i prekjes së shpirtit me realitetin.

PAK SI PARATHËNIE, PAK SI HYRJE

Ismet Hasani

Njeriu, gjatë jetës së tij, shpesh herë ka fat, shpesh herë është i shpërblyer. Por shumë varet nga ajo se çka e merr si fat e çka e merr si shpërblim. Pa marrë parasysh këtë, si fati si shpërblimi janë të mirëseardhur për njeriun. Mendoj se edhe *fatit* edhe *shpërblimit* duhet vet njeriu t'i paraprijë, pra, të është në rrugën e fatit dhe në rrugën e shpërblimit.

Pasi e përmenda fatin, atëherë po them diçka më shumë për të.

Mendoj se fati nuk të ndihmon, po që se ti nuk i ndihmon vetvetes. Fati qeshet, por ai bën edhe gjëra jo të mrekullueshme: ta zëmë, ta dhuron trëndafilin, por bashkë me te, edhe gjembat; fati ta dhuron shiun, por ti duhet ta kesh ombrellën; fati na udhëzon: në qoftë se dikujt ia dhuron fatin, duhet ta mësosh se si ta shfrytëzoi atë. Fatet vijnë nga vetë ne, ashtu si rétë e qiellit që vijnë nga toka.

Fati dhe xhami thyhen shpejt.

Pasi, përveç se fatit, përmenda edhe shpërblimin, apo dhuratën, e tash po përpiqem të provoj se a bën këto të dyja të lidhën? Mendoj se po. Për shkak se *Dhurata më e vlefshme dhe Fati më i pasur në botë është miqësia e mirë me njëri-tjetrin*

Sa e befasishme, por e këndshme! Tani, fati e shpërblimi u lidhen edhe me miqësinë. Dhe, kjo befasi e këndshme kësaj here më takoi mua, ngase u lidhen që të tria: fati,

dhurata dhe miqësia. Ja se pse! Me poetin, shkrimtarin, publicistin, autorin e afër 100 titujve të botuar gjer me tani, z. Adem Zaplluzha, ka kohë që kemi krijuar miqësi të sinqertë dhe është shumë interesant se kjo miqësi është forcuar çdo herë e më shumë, edhe pse gjendemi në një distancë prej më se 3 mijë kilometrash. Prandaj, lirshëm mund të shprehem se: *disa shihen, disa dihen, miqtë e mirë në distancë njihen.*

Të kthehem aty ku ia nisa, pra të fati e dhurata. Fati më ka shërbyer dhe jemi njohur me mikun Adem Zaplluzha, e ky më ka shpërblyer shumë: më ka dhuruar tituj e tituj të botuar, më ka dërguar përmes postës elektronike dorëshkrime e materiale të shtypura, por më ka shpërblyer edhe me diçka me shumë vlerë: së bashku me shumë recensentë, redaktorë e lektorë të mirënjohur, më kanë caktuar në cilësinë herë të recensentit, herë të redaktorit dhe herë-herë të lektorit në shumë nga titujt e përgatitur për botim.

Edhe në këtë libër të përgatitur për botim që mban titullin *„Fjetëm 100 shekuj”* më kanë caktuar në cilësinë e redaktorit dhe lektorit, mbi çka ju jam mirënjohës tërë jetën.

Të them që tash se, për të kryer punën e redaktorit dhe të lektorit në dorëshkrimet e autorit Adem Zaplluzha, të cilat do që t’i botojë, nuk

edhe aq punë e vështirë, për shkak se vet autori është tejet i kujdesshëm dhe gjatë shtypjes se materialit, nuk lejon gabime dhe se është aq i pagabueshëm edhe në pikëpamje të lekturimit, ngase përvoja e tij e gjatë ka bërë që, përveçse anës autoriale, e ka përvetësuar fort mirë edhe korrekturën, redaktimin, recensimin dhe lekturën , që është veçori tek një numër i rrallë i krijuesve të tillë.

Mirëpo, për hir të asaj që më kanë besuar punë kaq me vlerë, ndjej obligim që, duke aplikuar terë njohuritë dhe aftësitë e mia, duke u shërbyer edhe me përvojën e deritashme, atë që më është besuar, të kryej me nder dhe me respekt të veçantë, në mënyrë që, jo vetëm autori, por edhe lexuesit të vërejnë se puna është kryer me korrektësi dhe se këtë shembull duhet ndjekur edhe të tjerët.

Kjo, aq më tepër kur ta kemi parasysh se kemi të bëjmë me njërin ndër autorët e rrallë e të veçantë, kur vëmë në pah moshën e tij në raport me titujt e botuar deri me tash, del një proporcion 70:97, apo thënë qartë: 70 vite jetë e 97 tituj të botuar, që konsiderohet rast *sui generis* në letërsinë shqiptare dhe atë jashtë shqiptare dhe, sikur vetëm një pjesë e titujve të këtij autori të ishin për*krthyer në gjuhë të huaja, ta zëmë, në gjuhën angleze, në gjuhën gjermane, në gjuhën frengjishte, në gjuhën rumanishte,...,* emri dhe veprat e Adem Zaplluzhës, do vlerësoheshin edhe nga krijues e publicistë me renomé ndërkombëtare, dhe më pastaj, mendoj se do ta propozonin për ndonjë *Çmim Ndërkombëtar* në letërsi. Kur kësaj i shtohet edhe fakti se ky autor lënë përshtypjen e një „uzine të letërsisë”, nga se në vazhdimësi „prodhon”, respektivisht krijon e krijon dhe

se brenda vitit nga ky mendimtar dalin me dhjetëra tituj – secili më i mirë se tjetri.

Sa i përket numrit të titujve të botuar deri me tash, lexuesi do të vërtetohet nga evidentimi i secilit titull veç e veç në fund të këtij libri, me ç'rast do të shihej se autori Adem Zaplluzha lënë pas vetes numër të konsiderueshëm krijuesish, bile edhe me renomé në letërsinë shqipe dhe duket si prijetar ndaj atyre që, gjatë tërë jetës se vet kanë arritur ta kenë vetëm nga një apo vetëm nga 5-6 vepra, e hiç më.

Përveç kësaj, autori Adem Zaplluzha është ndër të veçantët, për mënyrën e të shprehurit të ndjenjave të tija: fjalori me të cilin shkruan është krejt i veçantë nga fjalorët e krijuesve të tjerë, ngase është edhe *„leksikograf i llojit të vet", sepse shprehet e tija dhe terminologjia e tij, nuk haset në asnjë rast, apo te veprat e cilitdo krijues tjetër.* Me këtë autori Adem Zaplluzha argumenton të vërtetën e pamohueshme se gjatë frymëzimit me ndjenjat krijuese, thua se transformohet *„në botën e vet" dhe se mbamendja e tij qëndron aq e fuqishme dhe aq e freskët edhe për të akumuluar me energji „mbinjerëzore", respektivisht*
me energji„jashtënjerëzore".

E veçanta tjetër e këtij autori është se pas *„prodhimit të një vepre"*, nuk harxhon kohën rreth *„cikërrimave"* apo imtësirave, por ato ua lë të tjerëve, ndërkaq vet ia nisë *„prodhimit të ri"*, thua se nga vepra paraprake vetëm sa ka akumuluar energji, pasi *„materien për lëndën e ré"* e ka në mbamendje dhe nxiton e nxiton që sa më shpejt ta hedh në letër.

Të gjitha këto që i theksova në pjesën e paraprake të parathënies, do të paraqitën se fakte, argumente apo prova, nëse e lexojmë pjesën vijuese.

"Rrezet e përskuqura të diellit, nuk premtonin asgjë në ditarin e saj të grisur nga koha, donte të largohej, por s'mund të ndahej nga vetvetja, ku të shkonte në këtë kohë, ku në çdo hap e kafshonin gjarpinjtë, por ec e ndale shakullinën kur çmenden erërat".

Kështu shprehet autori në njërin nga nëntitujt e shumtë "Iku nga vetvetja", për të vazhduar:

"Ec e ndale tërbimin e shpirtit kur të kafshon gjaku yt, ishte dita e parë e vjeshtës kur i humbi sandalet e kuqe, dita kur nuset mbesin veja kurse vashat bëhen nuse me dhunë.

Ajo ikte diku me tërë të kaluarën e saj të dyshimtë, ikte nga lëkura e saj e zeshktë, ikte por çdo gjë i shkonte pas me të dhe kokën e saj topolake si një sferë pa kurrfarë rregulli gjeometrik.

Në dorën e saj të mëngjër mbante një qeskë najloni thua se në të fshihte të gjitha trishtimet e përjetuara, tërë ato çaste që i kishin mbetur kujtim i fustanit të grisur".("Iku nga vetvetja")

Apo në nëntitullin tjetër "Malli", ku autori shprehet:

Ç'më mbyt një mall i pashuar, o ç'ma ndezi shpirtin po ai zjarr që rrinte në kujtesë si një shtëllungë trishtimi. Askund ajo mes gishtave të harresës

Askurrkund hija e ime e thyer në pasqyrën e akullt të ujit. Ishte dita e shtatë e pritjes së mjegullave, dita e cila në vete ngërthente tregimin për poemën eharruar. ("*Malli*")

*

Për çdo ditë të lume më del parasysh plaku im mjekër bardhë duke i kafshuar ose duke i përpirë kokrrat e farës të arave tona.

Përpinte sepse me javë nuk kishte përtypur asnjë kafshatë buke, sa herë që ulej në sofër unë e dija se do të thoshte , ju hani fëmijët e mi se unë para pak kohe sapo i lava duart, nuk jam i uritur, kurse unë vëreja se si i përpinte me sy kafshatat tona të mjerimit.

Nuk mund të ju them asgjë më shumë, nuk di, athua këputeshin yjet nga sfondi i qiellit ose vraponin pas mjegullave, megjithatë, toka ishte e mbuluar me një grusht gjethesh të fishkura, ose të kristalta, nuk isha më në gjendje të dalloj se me çfarë mbulohej në mjerimin i ditëve të varfërisë në mendjet njerëzor(*"Plaku im mjekërbardhë"*)

Fragment nga *"Fjetëm 100 shekuj"*

"Sa herë që provuam të hymë në gjumin e heshtjes,mbetëm një pjesë e saj e pandashme, po ju them, nëse sërish hymë në gjumin e heshtjes kurrë më nuk do të zgjohemi. Sepse

një njeri që fle ai nuk di se kur lind dita dhe kur vdes nata.

Nuk di më për të satën herë deshëm të zgjohemi nga gjumi i maktheve, fjetëm njëqind shekuj, nuk pat kush të na zgjojë. Më duket se akoma jemi duke fjetur.

Ky gjumë i përdalë me gjasa po i përngjanë dashurisë, thonë se dashuria i ka

sytë e zeza, i përngjajnë natës dhe vetëm natës i përket, kështu thonë, kurse unë vetëm po ju tregoj se çfarë thonë për dashurinë, ju nëse doni besoni e nëse nuk done nuk

keni asnjë arsye tu besoni fjalëve të mia!" *("Fjetëm 100 shekuj") Ismet Hasani*

Hyrje

Libri është një shok i mirë, i cili t'i zbulon fshehtësitë, është një dritë në errësirë dhe kënaqësi në vetmi. Libri, po ashtu ta shton diturinë, ta pasuron dhe ta pastron fjalorin, të largon nga shprehitë e këqija. Leximi nuk është i mjaftueshëm, pa e përshkruar mirë atë që e ke lexuar.

Pasi lexova me shumë kujdes dhe vëmendje të përqendruar librin e autorit Adem Zaplluzha me titull „Fjetëm 100 shekuj", iu riktheva leximit, sepse për të kuptuar më mirë qëllimin e veprës, mendoj se duhet të përjetosh ndjenjat e autorit, dhe se ato nuk janë aq me ndikim nëse nuk prekin në shpirt lexuesin.
Për të kuptuar drejtë veprën, më është dashtë të hy në brendinë e çështjes, e në disa raste edhe më thellë: një urti e vjetër latine e shkruar me pak fjalë „*in medias res*" na obligon që, në ato raste kur dëshirojmë të hyjmë thellë në brendinë e problemit, duhet të mendojmë edhe në atë se do të hyjmë *„në thelbin e bërthamës"* Pra, thënë më qartë të hyjsh në embrionin. Për të hyrë aq thellë, kërkohet njohuri, vullnet dhe ambicie.
Për të hyrë në thelbin e bërthamës më është nevojitur njohje e drejtë e shprehjeve dhe termave të autorit të përdorura në këtë libër. E, në këtë drejtim pata pak vështirësi, ngase autori ka një „leksikon fjalësh të veçanta", të cilat i gjen vetëm tek ky autor.

Kam të lexuar se: *„Gjëja më me vlerë që të dhurohet nga miku është libri!”* dhe se *„Libri është një gjë e mirë, por ta lexosh atë, bëhet edhe më i mirë dhe më me vlerë”*. Dhe këto dy urti për librin, për momentin thua se ishin të dedikuara për mua dhe më takuam, ngase: fitova si dhuratë për ta redaktuar dorëshkrimin e materialit për librin e ri të autorit Adem Zaplluzha me titull: *„Fjetëm 100 shekuj”*

Mikun e madh Adem Zaplluzha e falënderova, ndërkaq materialin në dorëshkrim nga ai, me kujdes të veçantë dhe me vëmendje të përqendruar e lexova, dhe vërtetë m’u bë edhe më i mirë. Kur them *edhe më i mirë*, mendoj në atë se, pikësëpari mësova shumëçka dhe pasurova, si fjalorin ashtu edhe diturinë.

Më ka mbetur shprehi që, gjatë leximit të shikoi edhe faqen e fundit ku gjendet „Përmbajtja”. Edhe këtu veprova kështu dhe, duke shikuar edhe „përmbajtjen” e kuptova se në këtë libër nuk bëhet fjalë vetëm për një çështje apo qëllim, por me duar2duarshmërinë e temave të „rrahura”, autori kalon prej njërës në tjetrën, ashtu lehtazi dhe të lënë përshtypjen se secila temë, apo çështje është e punuar më mirë sesa tjetra, me çfarë autori edhe e bën secilën e më të kapshme e më të se tjetrën.

Përveç këtyre, autori Adem Zaplluzha, në mënyrë të veçantë, jep mendimin e tij tejet përmbajtjesor, shumë interesant dhe mjaft domethënës.

Duke lexuar veprën e autorit Adem Zaplluzha me titull *„Fjetëm 100 shekuj”* mësova se autori ka bërë, jo vetëm një përzgjedhje tejet interesante nga pikëpamja hapësinore, por edhe një përshkrim të mahnitshëm të temave nëpër nëntitujt e veprës. Dhe, me këtë të lënë

përshtypjen se secila temë, sado e shkurtër, përmban në vete aq shumë fjalë, shprehje e fjalor, sa të ishte një roman i vërtetë. Ndjenjat e autorit janë të shprehura e të thurura aq mirë, sa që është e pamundur të mos prekin në shpirtin dhe të menduarit e çdo lexuesi. Të miat po se po.

Jeta jonë është e mbushur me befasi, është një histori në vete, është një sprovë, por ne duhet të jemi të përgatitur që asnjë e papritur mos të na befasojë në jetë sepse atëherë edhe jeta humbë qëllimin.

Njerëzit mund të pyesin përse i duhet filozofia njeriut, poetit, shkrimtarit, gazetarit?

Nuk mjafton vetëm të dish të shkruash apo lexosh sipas rregullave të thata. Shumë më e rëndësishme është se çfarë veprimi ka shkrimi, çfarë porosie ka shkrimi dhe si e sa mund t'u ndihmojë njerëzve ai shkrim në jetën e përditshme, në realizimin e pozitives në jetë. Është me rëndësi thelbësore që shkrimet ta bëjnë të gëzueshme jetën e njeriut. Përmes shkrimeve tregohet natyra e vërtetë e njeriut, tregohen momentet më kritike dhe më të vështira në jetë, por në anën tjetër na vjen në shprehje edhe ana e durueshme, ana karizmatike, e dëgjueshme, dhe ajo çka sot ka vlerë ana e drejtë. Duhet ta çmojmë kulturën e të gjithëve dhe respektojmë historinë e secilit. Në larminë globale duhet të ekzistoj mirëkuptimin midis shoqërive në përpjekje pozitive midis tyre.

Por për fat te keq, ne nuk lexojmë! Është koha të pranojmë para vetës këtë fakt, dhe shoh se ne na kanë mbuluar te gjitha llojet e varfërisë, dhe mendoj se ilaçi i gjithë kësaj është libri!

Prandaj, mos të qesim në harresë e kohës, se:
Libri mpreh mendjen dhe zbutë shpirtin!

Pra, autori , i ka theksuar që të gjitha, andaj nuk më mbetet tjetër, pos, *duke e falënderuar dhe duke i shprehur urimet më të përzemërta për këtë titull të ri, t'i dëshiroj shëndet të plotë, harmoni e lumturi në familje, mbi te të mbizotëroi Qetësia Absolute, të arrijë* suksese *të mëdha e të ngjitet drejt majave më të larta të artit, shkencës, kulturës dhe përparimit të mendimit njerëzor.*

Dhe, po përmbylli këtë *hyrje* me fjalët:

Nuk dihet...! Ky libër dokumentar mund t'u hyjë në punë hulumtuesve të qenies sonë edhe pas 100 viteve të ardhshme!"

Add/PS: Më lejoni, vetëm edhe këtë porosi!

Pasi vet e lexova këtë libër me shumë kujdes dhe vëmendje të përqendruar dhe mësova shumëçka të panjohur, i preferoj lexuesve dhe dashamirëve të librit e të autorit Adem Zaplluzha, që gjithsesi ta lexojnë këtë libër dhe do të bindën se do të përjetojnë kënaqësitë që përjetova unë.

NJË JETË E TËRË DHËNË PAS POEZISË DHE ME POEZINË .

Sokol Demaku

Një jetë e tërë dhënë pas poezisë dhe me poezinë, e ky është poeti dhe shkrimtari Adem Zaplluzha, i cili na vjen pas prozës poetike "Fjetëm njëqind shekuj" me buqetën e tij poetike më të freskët "Krakëllimat e natës", e cila buqetë poetike shpalos me mall dhe ndjenja shpirtin e poetit nëpër kohë dhe vuajtje e mundime shpirtërore.

Përmbledhja poetike "Krakëllimat e natës", është ndarë në tre cikle, të cilët sejcili në vete ngërthejnë dhe mbajnë gjallë vrullin e poetit për një të ardhme më të mirë. Ciklin e parë autori e ka titulluar "Ishte koha e një kohe", cikli i dytë "Krakëllimat e natës" dhe i treti " Një zog i trishtuar".

Autori bënë një shëtitje nëpër kohë, bënë një lëvizje, e cila lexuesit i jep mundësin që të njihet dhe përjetoj kohën dhe përjetimet e kohës, duke u nisur nga koha antike, duke përdorur filozofinë tij prej poeti,

filozofinë e fjalës, në paraqitjen e realitetit të kohës dhe jetës.

E një fjalë e urtë filozofike Shqiptare na thotë: *"Njeriu nuk është i përjetshëm, le të përpiqet të jetë e pavdekshme ajo që do të thotë dhe ajo që do të bëjë"*,e këtë lexuesi do e gjejë në punën dhe veprën e autorit të buqetës poetike "Krakëllimat e natës.

Poeti Adem Zaplluzha në shpirt ka një gurrë të pashtershme frymëzimi të veshur në stilin dhe modelin e lirikës sonë popullore. Në vargjet e tij do hasim kohët e shkuara me të gjitha të ligat të cilat më shekuj renduan mbi supet tona dhe se lan rrënjët, të cilat edhe sot e kësaj dite na dalin dhe na *"zgërdheshen si macet e zgjebosura"*dhe se në mënyrë alegorike poeti ve në pah të bëmat të cilat kanë edhe sot e kësaj dite rrënjët nga lashtësia sepse autori thotë: *Dallgët e liqenit/Nuk fjetën atë natë/S'i zuri gjumi as zogjtë e ujit/Te shkallët e një gjëme/Po përgatitej preja e një mali/Që nuk shembej me asgjë.*

Por është shumë magjepse ndjenja e poetit për kohën e kaluar, për fëmijërinë e tij që ai atë e gërsheton më ëndrrat të cilat e kthejnë në kohën e ninullave të tija, pro të cilat ninulla kanë humbur diku e autori thotë: *Kur më ngatërrohen ninullat/Dhe më humbin rrugët e gjumit/Te unë zgjohet fëmijëria.*

Por kjo fëmijëri është e zymtë ka humbur rrugën sikur anija që do të fundoset e nuk gjen dot shpëtim: *Dielli në horizontin e përskuqur/Noton si anijet e fundosura/Mbi shpirtrat e pafajshme të mjegullave.*

Nga këtu e fillon poeti ciklin e dytë të buqetës në fjalë, i cili cikël ve në pah ndjenjën e fëmijërisë se autorit por edhe filozofinë dashurisë së kohës, e këtë përmes

poezisë “Krakëllimat e erës” nga e cila poezi edhe vëllim i mori titullin.

Të kujtohet/Valsi jonë i parë/Ne ishim pak kokëfortë/E pak më shumë konfuzë/Stinës i vinte një erë borziloku/Kurse flokët e tua kaçurrela /I përngjanin aromës së tërfilit/I cili depërtonte nëpër shqisa/
Pa trokitur /Në asnjë portë të mendjes.

Dhe se koha bashkëkohore ka pasur ndikimet e saja në rrjedhat e jetës dhe se ndikimi i saj ndihet në të gjitha poret e jetës:

Kur u rritëm/Nuk i përngjanim më vetvetes/Nga rropullitë tona /Filluan të fryjnë disa lloje erërash/Krejtësisht ishte më ndryshe/Kur ishim të vegjël/Jetonim pa i njohur dredhitë e njerëzve/
U besonin pafajësisë së fluturave/Tërë ditën loznim /Me të gjitha speciet e zogjve.

Autorin e brenë në shpirt dhe ai këtë e ndjenë me keqardhje se tani ne nuk jemi ata të cilët duhet të jemi, kemi humbur atë që na lanë trashëgim të parët dhe se kjo:

Asnjëherë në jetë/Nuk kuptuam se kush jemi ne/Të gjallët e rrjepin /Kurse të vdekurve me një elegancë/Ta paparë/Ua veshim pantallonat/Këpucët dhe këmishët e reja/Nuk e harrojmë as kravatën.

Vuajtja shekullore që ka rendua mbi supet tona ka lënë vragë të thellë në ndjenjat e poetit dhe ato vragë janë prezent edhe sot ndër gjenerata:NJERËZIT MË NUK DINË

Mos të lutem/Mos i hap portet e dhembjes /Të kësaj nate të gjymtë/Hijet kaherë /I vranë merimangat e zeza/Një kambanë që disa shekuj/Po vajton golgotën e fateve të

fluturave/Kryqet u dehidruan në shi/Vetëm një zë si mallkim i lashtë/Dëgjohet nëpër eterin e pluhurosur.

Por autori është optimist dhe se ndjen se rruga e trasuar do jetë ajo e cila do ndritë dhe të gjithë së bashku do ecim përpara:

HARABELAT

Çdo njeri e ka historinë e vet/Një palë këpucë vrapojnë rrugëve/Vrapojnë /Deri sa
të shqyhen shollat/Si një hartë e grisur prej letre/Po duket atdheu im.

Në ciklin e tretë," Një zog i trishtuar", defilojnë tituj poezish idilike, poezi të cilat japin jetë dhe shpresë për një të ardhme më të lumtur si:

NËSE NGJAN E KUNDËRTA/ULEMI TE PRAGU I DERËS/NGA LËVORJA E DRURIT/NJË ZOG I TRISHTUAR/JONI NOSTALGJIK/NJË ZOT I HARRUAR/NGA SYTË E TUA/FRYJ SA TË DUASH/KUR MË ZURI PLEQËRIA/

dhe shumë poezi tjera të cilat janë një realitet i jetës në të cilën poeti jeton.

Më ka rënë të dëgjoj, por edhe në jetë e kam provuar edhe vetë se botimet e librave janë tubime të këndshme ose festa të përbashkëta të atyre që krijojnë dhe atyre që adhurojnë gjuhën dhe letërsinë, si lexues të çdo moshe dhe gjinie. Se libri është ai që bashkon njerëzit, se libri është pishtar i madh i cili rrezaton dritë e dituri te njerëzit.

(VËSHTRIM RRETH LIBRIT***‘’KUR DEHEN PERËNDITË’’***POEZI TË AUTORIT A. ZAPLLUZHA)

Xhevahir Cirongu



Të lexosh poezitë e poetit Kosovar *Adem Zaplluzha*, s’ke se si të mos ndjesh që në fillim aromën e plisit të tokës së vendlindjes . Ajo shpaloset me gjithë fuqinë e saj magjike, dhe të rrok pas vetes si një lum që ka ujë të kulluar për gjatë rrugëtimit të leximit. Në këtë rrugëtim , kur ke lexuar 86 vëllimet e këtij poeti, të cilat janë tashmë në duart e dashamirëve të librit, e sidomos adhuruesit e poezisë,ndjen një krenari të ligjshme , sepse vargu të ngroh si dielli. Në këtë vëllim të ri, që poeti Adem Zaplluzha e ka ndarë në tre pjesë, me titull *‘’Kur dehen perënditë’’*, vargu poetik përshkruhet nga fillimi gjer në fund me ndjenjën e thellë të dashurisë njerëzore. Poezitë e autorit Adem Zaplluzha, janë me rrënjë te plisi i tokës sonë Shqipëri. Atdheu , natyra e njeriu, janë të shkrira në një plan të vetëm në këtë vëllim poetik.

Ato flasin me gjuhën filozofike të thjesht e japin mesazhe të qarta për te lexuesi, sepse poezia që në

lashtësi e deri sot, ka qenë pjesë e shprehjes shpirtëror të njerëzimit.
Poezia ka qenë dhe është oaza që ka mbushur shpirtin e njerëzve, si në gëzime e në hidhërime, për të lartësuar ndjenjat njerëzore duke u dhënë forcën e gurit dhe ëmbëlsinë e mjalti të fjalës. Të tilla janë edhe poezitë e poetit Adem Zaplluzha, sa të thjeshta, aq edhe kuptimplota me ‘’farën e grurit’’shpirtëror që kanë në vetvete ato, e përcjellin fuqishëm për te lexuesi ynë. Laramania e poezive që sjell poeti në këtë vëllim të ri me titullin *’’Kur dehen perënditë’’*, është një shprehje e gjallë e jetëdhënse, sepse vargu poetik ka rrënjët e tija me degët e frutat krijuese të dhuruar nga vetë perëndia, që më së fundi për poetin vargu është një frut ‘’Shege’’ me rruaza të kuqe gjaku në dehje që s’ka vdekje kurrë. Në poezinë me titull ‘’Ku njeri prej stralli’’ tregon lindjen e njeriut nga pluhuri kozmik e që ka forcën si guri i zjarrtë të strallit e lëshon zjarr e xixa fjale e tinguj me ngjyra ylberi në gjithësinë , ku vetë njeriu e poeti është pjesë e këtij realiteti jetësor. Ndërthurja e faktorit historik dhe me miteve historike njerëzore, si dhe të heronjve, janë përshkruar me ndjenjë e patos poetik në poezitë e shkruara të autorit Adem Zaplluzha. Ato kanë vargun e qiellit kaltërosh e të detit të kaltër të mendimeve. Në poezinë *‘’Po të ishte ndryshe’’* (Prolog) ai thotë se: *‘’Sytë tuaja të kaltër/ i përngjanin lotit të Adriatikut..’’*. Kurse në poezinë me titull *‘’Ky njeri prej stralli’’* na jep dritën e flakës që del nga gur i strallit të vargut poetik e qenien njerëzore, që s’shuhet kurrë sepse shpirti nuk vdes , por diku ai jeton në qiellin e kaltër atje te Zoti!
. ..Dhe poeti na e sjell shprehimisht kështu:

‘’I shkulte lisat e sinonimeve,
për të mbjellë dashurinë
në kraharorin e atdheut të dërmuar.’’

Vështrimi poetikë letrar të poezive të këtij autori ngjasojnë si fibra optike në gjithë brendinë e tyre. Aty gjen dashurinë njerëzore e të qenurit njeri, hipokrizinë, historitë, tokën e lumin, pemët me gjethet,gurin dhe zogjtë, hënën me yjet, hapësirën qiellore e kozmosin, heroin e njeriun e thjeshtë, të gjitha këto të përfshira në korpusin e vargut poetik. Te nëna natyrë poeti nuk ndahet për asnjë çast, dhe nga shpirti i tij del llava poetike e vargu me ngjyra ylberi. Ato janë spërkatur me vesën e avujt e frymës njerëzore, të shkrira në një të vetme që quhet *‘’Dashuri njerëzore!’’*. Dhe kjo duket qartë në lexueshmërinë e vargjeve në gjithësinë e poezive e më konkretisht te poezia që ia kushton poetit lirik Frederik Reshpes.

Te poezia me titull: ‘’Më duket se atë natë’’, ai shkruan këto vargje: ***‘’Mbi parmakët e qelqta të mendimeve/ binte nga pak shi’’.(për natyrën e mendimin).***

..Ose te poezia që ia kushton poetit Frederik Reshpes, midis vargjeve të tjera thotë me dhimbje e kujtim malli për njeriun e letrave shqipe, e sidomos që poetin, për dhimbjen e vargut të këtij poeti. Vargu del si gurrë nga thellësia e shpirtit të poetit për poetin. Ja si thotë Adem Zaplluzha:

‘’Jo ,or miku im i mirë
Nuk vdiq Frederiku!’’

Por , edhe për mjegullat që ngrihen e lartësohen lartë në qiell, së bashku me mendimet e poetit pikojnë si vesa e mëngjesit në shpirtin e tij e derdhen në lumin e vargut

poetik. Pra, te vëllimi më i ri të titulluar : *''Kur dehen perënditë''*,lexuesi gjen xhevahire shpirtërore aty.

''Mjegullat me do riga të vetmuara
Vajtojnë fatin e reve''.

Apo te poezia me titull *'' Të mos qajë edhe ai copë druri''* i cili na jep kështu këto vargje:

''Të mos qajë edhe ai copë druri
Të mos dënesi si guri i lagjes,
Ku kanë pritur pleqtë e fshatit
Kthimin e djemve nga kurbeti''.

Edhe shprehet metaforike i përdor disi të kursyera, me gjetje gjithmonë në ngjitje për nga domethënia e tyre kur derdh në vargun poetik. Brenda kullës së shpirtit, furtunat e jetës janë në shpërthim e sipër te autori. Ai këtë e tregon me vargun që shkruan çdo ditë, mbi fletën e bardhë, që mendimi i cili buron nga kulla e shpirtit të tij të përjetësohet në varg poetik, si një mënyrë rebelimi ndaj fenomeneve që ka kaluar gjatë jetës, por edhe faktorit jetik ku jetojmë në jetën tonë të përditshme si atë shoqërore e sociale ekonomike. Kuptimplotë ky fakt shprehet te poezia *''Nga syri i një peme të egër''* , më konkretisht:

''I kujt ishte ai sarkofag
Nga i cili fluturuan
Disa zogj të çmendur!?

Por, autori i librit jep me detaje edhe tragjiken e jetës, vdekjen, truallin e gurin e përmotshëm që s'ka ''vdekje'', pra , varret me epitafet e tyre që flasin me heshtjen te të gjallët. Dhe ai e përshkruan qartazi me këto vargje :

''Më lër të pi trishtimin e këtij helmi,
…doli edhe nata''….

Të gjitha metaforat që përdor autori Adem Zaplluzha në poezitë e këtij vëllimi, janë shprehje e pjekurisë së vargut që i jep jetë e domethënie gjithçka që e rrethon njeriun në këtë botë me plotë mistere. Në fund të fundit , jeta duhet jetuar ashtu si është, por mesazhet e autorit na tregojnë se duhet edhe guxim e qëndresë ndaj fenomeneve e pengesave gjatë rrugëtimit të jetës sonë. Të mos thyhemi para vështirësive, dhe kur njeriu ka shpirtin e madh, lartësohet deri në pavdekësi. Rrënjët e shpirtit metaforik të shprehura në poezitë e autorit, na jepen me detaje të arrirë nëpërmjet artit e fjalës së shkruar.

Edhe ky vëllim i ri poetik *'' Kur dehen perënditë''* është një gur themeli që i vendoset '' kështjellës'' krijuese poetike të autorit kosovar Adem Zaplluzha.

NËN UTURIMËN E MJEGULLAVE – POET ME VIZION MEDITATIV

Nezir Prokshi

Adem Zaplluzha, autori i mbi 95 veprave letrare, kryesisht në poezi, por edhe në prozën poetike – artistike si edhe me disa vëllime me satira të mrekullueshme, tashmë e ka formuar individualitetin e vet letrar, duke hyrë në letërsi si poet i vlerave të mirëfillta artistike e letrare, ndër më të angazhuarit në këtë fund e fillim shekulli në gjithë gjeografinë shqiptare. Në vëllimin poetik "Për kë po bie moj kambanë" të ndarë në tre cikle që fillon me poezinë "Zogjtë e zier" e për të përfunduar me poezinë e ciklit të tretë " Kanë filluar të lehin netët"autori si çdo brez që vjen në poezi më ndjeshmërinë, vetëdijen, psikologjinë, botëkuptimet në raport me bashkëkohësinë e vet do të sjell edhe traditën dhe historinë. Të gjitha këto veçori do të mishërohen tek gjuha e poezisë dhe fuqia e ritmit që krijojnë, pastaj veçorit e konstruktit origjinal të poetit. Adem Zaplluzha edhe në librin me poezi që e kemi në

dorë " Për kë po bie moj kambanë" vazhdon të mbetet një poet me vizion meditativ i lidhur ngushtë më përmasën sociale, bashkëkohore me të cilën
projekton nervin e tij të shqetësuar qytetar përmes një rebelimi metaforik. Në vargun e tij nuk vërehen mite të zbrazëta etnike dhe etike, marrëdhënie të klasifikuara në role midis temave tabu morale e shoqërore që shpie në orientim të mënjanimit të dinjitetit janë të qëndrueshme ku edhe përthyhet përjetimi dhe përvoja poetike e tij. Një nder armët me të forta të poezisë së Adem Zaplluzhës është dhe mbetet vargu i drejtpërdrejtë i hapur me një intonacion që anon nga neutraliteti me një prirje tashmë të dëshmuar aforistike – sentenciale që vjen prej një përvoje të trajtuar kujdesshëm me karakteristika të poezisë meditative.
Vargu i Ademit nuk është i rënduar me figuracione dhe piruet, por është një varg plot ritëm dhe ligjërim i shëndetshëm intim që ndërtohet nëpërmjet një narracioni poetik i mbështetur në frymën e një post moderne të theksuar. Në këtë rast harmonia e vargut përcillet më një ritëm funksional dhe te drejtpërdrejt: / Miqtë e mi/ Unë jam pranë jush/ Sa herë që doni mund të më prekni/ nga poezia "Zogjtë e zier" Sepse nuk jam i tejdukshëm, por as i përhumbur, i tretur si një flluskë sapuni, thotë poeti.
Po të kundrohet në aspektin tematike poezia e Zaplluzhës shoqërohet me motive e refleksione filozofike për të na shpien deri tek një ekzistencializëm që nuk dëmton gjuhën estetike të poezisë. Libri "Për kë po bie moj kambanë" prodhon edhe një frymë të oponencës kombëtare shumë të nevojshme për refleksionet poetike këtu e kudo në mjedisin tonë dhe gjithsesi të konkurueshëm me vlerat me të mira në

letërsinë tonë. Mjafton të shkëpusim vetëm disa vargje nga poezia "Një nënë dhe një përmendore". Se atdheu ende është plotë

Me gabimin tim redaktor në këtë libër është shënuar Bedri Neziri, por në të vërtet redaktor është Nezir Prokshi
dhembje e dëshpërim poeti do të dëshmoj edhe në këto vargje:

''Nuk mund të marr frymë
Kam dhembje shpirti,
Shikimet e topitura
Po shkasin nëpër njomësinë
E tejdukshme të bronzit.

Një nënë me një tufë lule mështekne
Qëndron e mpirë
S'i lëvizin as qerpikët e erës
Vetëm shpirti i saj i madh
Ka një gjëmë të brendshme''.

Dhe për ta përfunduar mund të konstatojmë
Se poezitë e këtij vëllimi janë shkruar në një gjendje ankthi për t'u kapur fortë pas dhe përditshmërisë së saj. Kjo u jep poezive karakter universal sepse siç do të vërehet nga leximi i poezive në përmbajtjen e tyre ka gjendje psikologjike të ghithëanëshme që lidhet me përjetime të fateve të një bashkësie e jo të një fati individual. Kjo më së miri pasqyrohet në poezinë "E mjegullave të brymta" ku "Njeriu me paterica" qenësisht i kafshon konservat të cilat hedhen në kontejner dhe

“Dhëmbët artificial” mbesin nëpër qoshet e kutive... Kjo i jep poezisë se A. Zaplluzhës një përmasë tjetër, jo të karakterit të një përballje në sfidën e madhe të luftës për liri, por për një luftë për një bashkim në solidaritet për një barabarësi për jetë më të mirë.

Dhe krejt në fund mendoj se kjo poezi po i largohet suksesshëm hermetizmit “maniak” të një pjese të poezisë që po botohet në Kosovë e pse jo edhe në gjithë gjeografinë shqiptare. Ky vëllim me poezi do të jetë i mirëpritur në aulat e fjalës artistike shqipe në Kosovë e kudo.

PLAKU ME PENDËN PLOT MARGARITAR

Të mençurit shkruajnë

(popullore)
*Recesion për librin "**Sytë e gurtë të erës"** të autorit, Adem Zaplluzha*

"Ademi poezinë nuk e ka vetëm ëndërr, ai poezinë e ka jetë" MUHAMET HOXHAJ

Me "Sytë e gurtë të erës", poeti Adem Zaplluzha tregon qartë nivelin e tij të stilit bashkëkohor evropian, ku çdo varg dhe rresht përmban një metaforë që prek thellë në shpirtin e të gjithë artdashësve.

Poeti sikur na tregon rrugëtimin e tij nga një poezi të shkurtër që mund të zbërthehet në një libër të gjatë, sepse brenda poezive, mund të lexohet akoma më shumë, si në poezinë *"Dhe kush jeni sot"*:

.....
''Kaluan disa dimra të rënd
Më të rënd se vet trishtimi
Erdhën edhe ardhacakët e egër
I shlyen nga faqja e dheut
Të gjitha faltoret e qytetit
E shlyen nga faqja e dheut
Edhe vet historinë''
.....
Poeti në këtë mënyrë shfaqë ndjenjat e tija për dhimbjen shpirtërore që mban me vete, të kaluar ndër vite të errëta, në të cilën po kalojmë edhe sot.
Vargjet e Adem Zaplluzhës në këtë libër të bëjnë të mendosh gjatë dhe të kuptosh se rreshtat që burojnë sipas stilit të tij artistik, janë dëshmi të rralla, kryesisht me konotacione metaforike.

Paralelisht me vargjet e Adem Zaplluzhës, ne rrugëtojmë nëpër struktura të ndryshme kohore, nëpër të cilën mendimet shprehen përmes vargut të poetit me pendën plot margaritarë.
Poezia e tij, përmban përjetime shpirtërore, me shumë apo pak komplekse dhe është e shkruar me një pasion të kohës sonë moderne, ku ndjenjat shprehen me shije të hollë letrare.
Ademi poezinë nuk e ka vetëm ëndërr, ai poezinë e ka jetë.
Ja edhe një strofë e shkëputur nga poezia, "VETËM NJËHERË NË JETË":

.....
‘’Shirat nuk erdhën mbrëmë
Te majat e plepave
Zgjohen trishtimet
Si mund t’i ndali këto pak fjalë
Të mos i vrasin arkivolet’’.
.....
Ai në vargjet e tij, dëshmon se e donë, e çmon dhe e adhuron fjalën e shkruar në ritin metaforik, ruan si rrallëkush poezinë bashkëkohore dhe e përjetëson atë me rreshta të artë.
Bota e brendshme në poezinë e Ademit, paraqet reflektimin e mendimeve të thella që autori i përdorë në mënyrën më të dashur lirike. Dëshira e tij për të pasqyruar ngjyrat e jetës, në buqetën e vargjeve plot metaforë, në ditët që jetojmë sot dhe të kaluarës, është përdorimi i kohërave natyrore në vargjet dhe stilin e tij modern/lirik.
Autori me sukses reflekton rreshtat e renditura, duke mos e kufizuar hapësirën poetike të artit në vijat letrare.
Ngjyra e vargjeve që përdorë Ademi në poezinë e tij, janë melodi e zemrës që zbut dhimbjet, nxit dëshirat dhe ëndrrat për të ecur me pendën e artë në poezi moderne.
.....
‘’Asnjëherë nuk më kanë bezdisur
Fjalët e të tjerëve
I doja kukullat
Po aq shumë sa e doja
Edhe pushkën e babait
Kisha një ndjenjë
Se edhe loja është luftë’’.
.....

Autori tregon qartë natyrën ku ai ka lindur dhe është rritur me modernistet , me atë vatër të pangopur për liri dhe barazi, në të cilën të gjithë kemi kaluar.
Janë këto vargjet që e bëjnë Ademin të pavdekshëm, i cili me një formë shumë prekëse, qëllon majat e larta të ndjenjave të secilit nga ato që kanë shije për artin e shkruar në poezi.

.....

''Eci nëpër rrugicat e ngushta
Të qytetit tim
Mbase paskam humbur
Mes lashtësisë së kalldrëmeve''.

.....

Duke lexuar këto poezi të spikatura me realitetin që përjetojmë, të krijuesit dhe vetë autorit, më erdhi në mendje edhe njëherë fjala: *"Ademi poezinë nuk e ka vetëm ëndërr, ai poezinë e ka jetë"*.

.....

''Ecën miku im
Parakalon ledheve të jetës
Po me atë bastun si gjyshi i tij dikur
Ka mbërri në atë kohë
Ku më nuk di se kah të ja mbaj''.

.....

Siç duket Ademin, jeta e ndjek hap pas hapi me të vërtetat gjatë gjithë librit.
Ai ka një diapazon të mprehtë, ku interpreton zhvillimet e kohës nga e kaluara e deri më sot, kohë që ngërthejnë ndjenja të mëdha të realitetit dhe dukurive natyrore brenda shoqërisë bashkëkohore.
Në këtë libër të gjitha vargjet janë në funksion të poezisë moderne/kritike, ku burimi qëndron shumë afër brenda

vargjeve të legjendave të tashmes dhe të kaluarës së kohës tonë.
Në librin "Sytë e gurtë të erës", Adem Zaplluzha me anë të shikimeve realiste të kohës dhe në hapësirën e dhënë brenda saj, portretizon profilet e shumë personazheve me vargje të shkruara.

Përfundim:

Adem Zaplluzha ka një bagazh të madh të vargjeve të shkruara në poezi. Qysh në fëmijëri lindi me këtë talent dhe
shumë herët startoi të hedh mendimet e tija në fjalë të shkruar. Ai vetën tashmë e ka bërë të pavdekshëm duke botuar vetëm në vitin 2012 mbi 37 libra me poezi. Deri më sot, arrin në mbi 85 libra të botuara, gjë që na bën me dije se penda e tij akoma është e artë dhe plotë margaritar.
Suksese edhe më tutje Bacë.

Muhamet Hoxhaj, Gjermani – 27.10.2013

PARATHËNIE

Arsim Halili

Në itinerarin krijues poeti Adem Zaplluzha, pa dyshim se tani më ka një formulë, për të cilën gjë mund të themi se është me një polivalencë ndjenjash krijuese. Ai niset në cakun e duhur, jo për të kërkuar të pagjeturën, sepse tani më e ka të gjetur atë që është enigmë. Me ngulm kërkon ta modifikoj, si të qenë, kur diç është abstrakte në kozmoginin e ideve të tij. Por tani mund të shtrohet edhe pyetja : Kush është në kërkim të enigmës?

Poeti apo dikush tjetër. Sigurisht se poeti Adem Zaplluzha , nuk është më në ankth për asnjë gjë tjetër, poeti në trajektoren e tij krijues riaktualizon dhe modifikon motivet , për të cilat edhe ai vet në këtë kapërcyell të moshës së tij i ka nuancuar me gjuhën poetike aq shume lirika, ku secila veç e veç thotë diçka, porsi tërësi thonë një gjë, se ai shpreh rebelim poetik ku sinjifikatiteti i gjithë asaj që shkruan është gjuha e argumentit, gjegjësisht letrarizimi përballë të përditshmes dhe të përhershmes, të imagjinatës dhe

realitetit, të individuales dhe universales. Nga një kënd në tjetrin, ndjek me kujdes ligjërimin poetik, jo patetik dhe të absorvuar, por gjithnjë në konsistencë me të sotmen dhe të arsyeshmen. Lexuesit i ofron vargun në variacionin e tij shprehimisht të kapshëm me nuanca figurative stilistike, gjithsesi këto lirika tek libri " Ndjekësit e enigmave" i transponon me kulturë shprehëse krijuese.

Rebelimi dhe racionalizmi i vargut

Kur e lexon librin " Ndjekësit e enigmave", në një moment do të ndalesh dhe të pyesësh vetën, po në cilën situatë momentale është poeti. Komunikimi i natyrshëm por edhe divergjent mes hapësirës kohore dhe hapësinore e që me ndjeshmëri e shfaq me diskurs faktik, porse mund të themi paksa emocional, më së miri këtë e ndeshim tek poezia e tij
Fq 5 Ku interkomunikimi është dy vetor në poezinë
" Ti qëndrove stoikisht"
" Unë tani jam i moshuar
Thinjat po rëndohen si shirat
Mbi kokën time
Ti ende ke mbetur lulebora
E paprekur deri në skajshmëri".

Natyrshëm dashuria mbetet prore e freskët, qoftë ndonjëherë edhe në ikje. Poeti shihet se është mjaft dinamik dhe evoluese, ai drejton gishtin kah tjetri, jo për të marrë atë që nuk është e nevojshme, por që në parantezë e lidhë edhe dashurinë edhe marrëdhënien ndër shoqërore dhe kjo natyrisht është edhe dhënie edhe

marrje, ndaj duke qenë peng i fjalës së dhënë. Këtë distribuim e shpërfaq përmes poezive " Ishte kohë e fjalëve"," Fol ".

"Me qindra herë
Deshëm të jemi vetvetja jonë
Dhe askurrë nuk u bëmë hije" …

Poetin Zaplluzha, në ekuilibrin kohor, sikur e tërheq partitura të diagonaleve të cilat shpërfaqen disi me sklerozë të së djeshmes që deshëm ose jo është një barometër identitar të traditës nëpër kohë, dhe droja e poetit është e arsyeshme, sepse ai me ngulm kërkon të jemi vetvetja e jo imtues diçkaje të huaj. Më së mirë poeti këtë
E thotë përmes fjalës poetike tek poezia fq 21 " Ishte dita".Deri sa lexojmë përmbledhjen poetike "Ndjekësit e enigmave ", vërejmë se poeti etablon narracionin e tij poetik, edhe për nga aspekti fabulativ si p.sh tek poezia " Mushkonjat "ose edhe tek poezia " Te kambanorja" . e të ndonjë tjetër, gjithnjë duke qenë atakues me realitetin disproporcional me shpirtin poetik të tij dhe meditimin pozitiv kundruall kërkesës së një jetë më ndryshe në bio-ritmet, jo vetëm në margjinat individuale por universale. Siç edhe cekëm më lart poeti duke qenë I vetëdijshëm se liria qiellore me atë tokësore kanë disonanca, jo vetëm konfigurative, shprehimisht poeti implikon në fjalorin e tij poetik figura stilistike të cilat i metaforizon në kontest metrik të vargut, por edhe artistik e estetik. Ajo çka më bie në sy poeti ndjesinë e tij poetik përdorë variabla

psikologjik, që qartëson rebelimin e tij ideo-emocional, por gjithnjë në kontest të racionalizmit të asaj që për poetin ka ndonjëherë edhe anën diskutabile me realitetin e krijuar.

Në vend të përfundimit:

Nga gjithë ajo që mund të lexohet në përmbledhjen poetike " Ndjekësit e enigmave" shihet se është e ndërtuar në bazë të një parimi të ndërgjegjësimit, për të gjetur të pagjeturën, ose për të profilizuar shikimin ka një e vërtet ndryshe , që deshëm ose jo shpesh herë di të jetë lojale me jetën tonë. Andaj poeti me shpirtin e tij rebelues, është edhe emocional sepse parasë gjithash ai çmon dashurinë ndaj tjetrit , lirinë e të menduarit ndaj tjetrit, pa i cenuar asgjë më shumë dhe më pak se ajo që është e imja, e tij, ose e saj, kjo mbase edhe e racionalizon edhe vargun edhe mendimin e tij në vargun e tij plotë elasticitet artistik.

ATDHEU I PAÇMUAR DHE I KALTËR I ZAPLLUZHËS

Lulzim Logu



Ka qenë befasi e vërtetë takimi im me poezinë e poetit nga Kosova, Adem Zaplluzha!

Kohë më parë, në prag të Manifestimit Tradicional " Ora e Poezisë" që tash katër edicione zhvillohet në Tropojë, e kisha ftuar të merrte pjesë ,së bashku me disa poetë, ndër më të njohurit e Kosovës, pasi kisha lexuar disa poezimbresëlënëse nëse prej tij dhe i surprizuar nga numri imadh i publikimeve të tij letrare.

E prisja me kërshëri, por edhe me detyrimin ndaj veprës së tij letrare, këtë impresion e ndava edhe me miqtë e mi, të cilët më folën me respekt për këtë poet dhe veprimtarinë e tij. Ai nuk mundi të vinte për shkaqe të ndryshme dhe letërkëmbimi im korrekt me të, veçse sa e thelloi nevojën që në një mënyrë apo në një tjetër ta njoh dhe të kontaktoj me autorin e 93 publikimeve poetike në harkun e 70 viteve.

Rasti e solli, që me bujari dhe respekt, autori të më sjellë librin e tij më të ri, ta kem në duar, ta lexoj, ta ndjej natyrshëm ritmin dhe tharmin e poezisë dhe të kontribuoj sadopak në sendërtimin e strukturës së tij solide, e cila mbante një peshë të madhe të mesazhit poetik, social dhe patriotik, harmonizuar në mënyrë adekuate me figuracion tronditës, frymë realiste dhe freski të çuditshme të motiveve dhe trajtave poetike.

Aty është fati historik i atdheut, fëmijëria rebele,shpirti i baladave,koha e arkeologëve, kalërimi në rrugët e ëndrrave,loti i hijes së barit,gjëma e barotit,refrenet e duarve të varfra të lypsarëve ,shijet e harruara të rinisë, humbja e gishtave të butë të dashurisë, nostalgjia e natës së vendlindjes, shpresa e një bime të porsa mbjellë…

Një kaleidoskop ngjyrash, fatesh dhe personazhesh, ku çdo lexues mund ta gjeje një pjesë të vetes, të mendojë, gëzojë dhe zhgënjehet bashkë me poetin, shpesh të bëhet njësh me shpirtin dhe ndjenjat e tij, të shndërrohet në një natë të gjatë përjetimesh të lumtura, por edhe protestash njerëzore, ku fjala e tij është zëdhënësja më e mirë dhe mishërimi perfekt i të qenit të angazhuar me fatet e atdheut dhe fatet personale të ditës që shkoi dhe të asaj që vjen.

A s'është në fund të fundit ky misioni fisnik i poetit të kohës tonë, të evokojë, dashurojë, vuajë, thërrasë dhe përjetojë së bashku me lexuesin e vet, ani pse shpesh, ah' sa shpesh, thirrjet e tyre humbasin pa gjurmë në tymnaja turbulluese të kohës, ku politika e mbrapshtë dhe varfëria mundin shpirtin bujar të poetit dhe ftohin lexuesin e tij në angazhimin e përbashkët për një jetë dinjitoze?!

‘’…as mushkonja nuk paska
Se ku të ngjyejë thimthin e uritur!’’.
Klith poeti në protestën e vet, në përjetimin realist dhe bashkëkohor dhe tonaliteti më i lartë ndjehet në ciklin e parë të librit me titull:”Kalaja që ecën kah e nesërmja’’
Kalaja është qyteti i motmoteve të vrazhdë të luftës dhe i ditëve të trazuara të lirisë, që pashmangshëm shkon vetëm kah shpresa, kah drita e re që ngazëllen zemrat e praruara.
‘’…mëso si ta shuash dhembjen
Kur krahasohet me atë të gurit
Gatuaj bukën e përditshmërisë
Me lotin e hijes së barit…’’
Mbi peshën e moshës, përvojës dhe të qenit bashkëbisedues gjysmëshekullor dhe tejet aktiv me lexuesin e vet, poeti Zaplluzha ja lejon vetes të mbartë dhe përcjellë poetikisht dhe emocionalisht disa të vërteta njerëzore, për të cilat ndonjëherë njeriu i zakonshëm ndihet i luhatur dhe mosbesues, në mënyrë figurative vargjet e tij janë gurët e rëndë të një ure prej dhembje, trishtimi dhe gëzimi çmendurak, që dukshëm e afron këtë poezi nga rilindasit tanë, po aq sa edhe afër Migjenit, fryma e të cilit të duket se shket papritmas në ndonjë varg a rrokje si puhizë që shkund kujtime dhe shpresa:
‘’...Ishte vonë
Shumë vonë kur mësuam
Për vdekjen e perëndive
Asnjë totem nuk kishte mbetur
Në sarkofagun e shakullinës...’’
Heronjtë e zakonshëm, të prekshëm dhe krejt të besueshëm në aktin e tyre për atdheun si Mic Sokoli, të

varfrit me shikime tejshpuese, trenat e verbër të halleve të ditës, piskamat e lutjes nëpër kalldrëmet e gurta ku s'gjenden veç ashte', janë kësisoj paralele sa të rastësishme, por po aq të prekshme dhe të besueshme si dikur.

Kohërat në librin e Adem Zaplluzhës ndërrohen pikërisht përmes sensit të afirmimit të fatit historik të popullit të tij, ndërtuar nga shumëzimi i fateve dhe ndodhive të çdo dite njerëzore, që kapet në perceptimin e thellë të autorit dhe transmetohet në metafora të mrekullueshme, të pahasura më parë diku tek një autor apo vepër tjetër, autenciteti dhe origjinaliteti i tyre përbën vlerën më të madhe të librit, përpos tematikës fine të shkrirë në një rrjedhë kronologjike, që i siguron lexuesit vëmendjen e shtuar dhe ritmin deri në fund të librit:

''…Kapelën e shqyer të erës
E hodha në lumë
Po ashtu edhe këmishën time
E vara në kujtesë
Si një copë të dhembjes së djeshme…''

Gjithçka, si në një shtjellë e erës së bjeshkës sillet kah atdheu, nocioni i atdheut krejt natyrshëm frymon ne motivet epike dhe lirike, mbi atë ndërtohet kuptimi dhe lidhja e tre pjesëve apo cikleve, ai simbolizohet si ndjenjë e ngrohtë, si dhembje e pareshtur, si dashuri e vjetër dhe e re, me të mirat dhe të këqijat e udhëtimit historik prej gjeneze e deri më sot, si një re e kaltër, si një shpresë, si nostalgji e fundit:

''…Pushkën dhe malin i pate në zemër
Sa herë që të ftuan
Nuk prite thirrjen e dytë
Por si një bajloz i bardhë

Dole në bejleg
Ti varri i im
Dhe atdheu im i paçmuar !’’.

Poeti në çdo varg dhe në çdo fjalë rrëmon në kujtesën njerëzore dhe atë kolektive kah angazhimi i prosperitetit të individit dhe të atdheut së bashku , përtej çdo note prej moralisti të mërzitshëm, ai sjell një poezi me peshë të rëndë, që sigurisht ndjehet dhe shijohet jo bash menjëherë sapo e lexon atë, por të mëshon ndjenjave të përziera pas një pauze meditative, kjo dëshmon maturinë dhe
cilësinë e saj, vargjet janë mesazhe, fjalët sikur trokasin me trokthin e kuajve të erës,
era është koha e re e shqiptarëve që rrjedh me shpresë dhe me dritën fatthënëse të shekullit të ri, me emrin e lirisë, pavarësisë dhe dashurisë. Pavarësisht moshës, poeti gëzon dhe lumturohet si një fëmijë i lumtur!

‘’… Ne të gjithë një ditë
Do të vdesim
Por secili mënyrën e vet
Do mbërrijë në shtegun e fundit
Ashtu siç jetoi ...’’

Një libër që meriton radhën që ka, nderon më tej emrin e poetit, të vendit ku ai frymëzohet dhe jeton, por edhe të lexuesit që ka fatin ta ndeshë rrjedhës së jetës dhe të përballet me faqet e tij si me faqet e një stine të bukur përplot ngjyra!

METAFORA E NJË LIBRI QË SHKON DREJT NJË REKORDI

Namik Selmani - Tiranë

Mendime për librin “Mbi flokët e ullukëve” të poetit Adem Zaplluzha nga Kosova

Mbase letërsia që botohet sot dhe mungesa e një strategjie zyrtare po edhe në një formë tjetër e shpërndarjes së librit artisti, politik në trojet shqiptare, ka një “borxh” shumë të madh. Është një “ borxh” sa zyrtar aq dhe moral ndaj lexuesve shqipfolës që ende kanë uri për librin mbarëkombëtar. Nëse nuk ka një garë zyrtare dhe të drejtë për secilin botim që bëhet me përjashtim të një konkursi në kuadrin e grupimeve të vogla shkrimtarësh, nuk ka edhe një numër të saktë për veprat e botuara në shkallë shqiptarizmi. Të gjithë përshtypjet që jepen për zhvillimin e letërsisë bëhen duke iu referuar vetëm disa autorëve dhe ata që nuk kanë mundësi që të qarkullojnë librat e tyre në këtë “xhungël” librore mbeten në hije. Ky përfundim më erdhi në mendje kur po lexoja faqet e

librit më të ri të Adem Zaplluzhës e që edhe vete fytyrë skuqem që nuk kam arritur që t'i lexoj 100 veprat e tij në poezi. Duke llogaritur që poezitë e para i ka botuar më 1957 i bie që të ketë një biografi artistike letrare prej55vitesh
Jam shumë i nderuar që mbaj sot peshën e madhe e të nderuar të bekimit të këtij libri. Autori i tij është Adem Zaplluzha dhe është i 96-ti në radhën e librave të botuar me poezi nga ky autor.

Pas një kohe të shkurtër ku ai të sigurojë paratë e librave të shkruar (Ah, paratë e poetëve!) mi shkon 100. Një numër i lakmuar që ka Brenda vetes përkushtimin e madh ndaj poezisë.
E ka nisur këtë rrugë botimi në vitin 1974 kur ishte 31 vjeç. Pra e kishte kaluar adoleshencën poetike (ku çdo gjë fluturon, hahet thotë populli ynë) e që nga viti 1974 e deri më sot bëhen gati 40 vjet e mesatarisht atij i është dashur të botojë rreth 4 libra me poezi në një vit. Në një vit ai ka botuar 19 libra e ka shkruar 25 të tillë. Ose po të heqësh vetëm 5 librat e parë që janë botuar nga viti 1974 deri më 2000 të gjithë të tjerët janë botuar për 13 vjet . Vetëm në vitin 2013 janë botuar 38 libra të llojeve të ndryshëm.
Në krijimtarinë e tij të këtij libri ashtu si dhe në të gjithë të tjerët është bashkëpunimi mjaft i ngushtë që ai mbaj me Klubin e Shkrimtarëve " Fahri Fazliu" në Kastriot. Kjo komunë është vetëm pak kilometra larg Prishtinës.. Bashkë me lavdinë e merituar të këtij poeti tashmë kaq të njohur në këto treva edhe ata ndjejnë krenarinë që e kanë mes tyre bacë Ademin. Kastrioti është një komunë re,

por ka krijues që kanë krijuar këtë shoqatë me poetë shumë të mirë dhe të motivuar për fjalën e mençur
Nuk dua këtu që të bëj një analizë të hollësishme për të gjithë këto vepra që do të ishte shumë e lakmuar për lexuesit e trojeve shqiptare po edhe libri i tij i cili me një titull shumë intrigues ka ecur në vazhdën e librave të tjerë. Duke nisur që nga titulli kaq metaforik "Mbi flokët e ullukëve" Të gjithë poezitë janë ndarë në tre cikle me një logjikë të njëjtë "Kuajt e bardhë të erës", "Mbi flokët e ullukëve" dhe "Vdekja e zogjve" Në të njëjtën kohë poeti Zaplluzha është edhe social edhe patriot, edhe romantik edhe filozof me mesazhet që ai përcjell
Nuk do të zgjatesha dhe aq shumë me analizën e këtij libri poetik që e bën atë një poet që mund të marrë edhe rekordin "GUINES" që të mos heqë edhe kureshtjen e lexuesve të shumtë të tij sidomos në Kosovë e në Diasporë. Në të gjithë takimet e poetëve të diasporës ai është i pranishëm dhe merr urimet e miqve të tij poetë nga të gjithë vendet e botës. Pa pyetur për moshën e tij që po shkon në kufirin e 71 viteve. Prej shumë vitesh ai e përkëdhel fjalën shqipe, e zbukuron me metaforat e tij të mrekullueshme. Një nga tiparet e poezisë së tij është frymëmarrja e madhe që ajo ka . Në të zë vend malli që është i pranishëm në vëllimet e poetëve të Kosovës po që në librin e tij ai nuk i ngarkuar me nota trishtimi. Në të ka shumë dashuri dhe optimizëm. Ademi nuk i përket atyre poetëve qaramanë që i shohim duke vajtuar për jetën për mungesat e jetës që përherë do jenë në këtë
botë të madhe e të mbushur me aq halle. Jo, ai të merr për dore e të shton optimizmin për të jetuar. Mbase kjo ka lidhje edhe me jetën e tij tërë dhimbje, të cilën ia duhet ta jetonte me forcën e shpirtit të tij të paepur Në

një poezi tjetër ai kërkon që të mos vringëllijnë armët. Edhe pse mosha e shtynë drejt nostalgjisë ai e jeton atë fort . Në llogoren e tij të vargut është një luftëtar shumë i mirë dhe meriton jo vetëm mirënjohjen e shqipfolësve jo edhe të pushtetarëve të të dy shteteve. Mbase nuk është e veçantë që të themi se një promovim i librave të tij të
bëhet dhe në Tiranë për të bërë sa më mirë edhe qarkullimin e vlerave kulturore që krijohen në këto dy pjesë të kombit. Dhe besoj se do bëhet shumë shpejt Poezia e tij është larg folklorizmit, të rëndomtës . Në të njëjtën kohë duhet vlerësuar edhe për kulturën e madhe të rrëfimit.
Në poezitë e tij mund të gjesh në një kohë edhe Sizifin e mitologjisë edhe Gjergj Elez Alinë edhe Drinin edhe lumenjtë e Kosovës edhe borën e bjeshkës aq sa të krijohet përshtypja se je brenda një ylberi varfëror. Ky njeri që disa vite i ka kaluar në Korporatën Energjetike të Kosovës duket se kërkon tani që të ndajë dritën e shpirtit të tij të madh e të bukur e sërish duhet përgëzua, edhe klima krijuese në Klubin e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” që ka njerëz të tillë kaq vitalë Urime, Adem Zaplluzha!
Mos t’u faroftë vargu i fjalëshqipes!

UDHËTIMNËPËR VARGUN KRYENEÇ TË POETITADEM ZAPLLUZHA

Xhevahir Cirongu

Magjia e të shkruari është pakëz si e çuditshme. Ajo nuk është një rastësi, por dhuratë nga vetë Zoti ,e dërguar për te njerëzit e veçantë në shoqërinë njerëzore. Të tillë njerëz, ushtrojnë gjithë qenien e tyre shpirtërore,frymore,mendore dhe fizike duke shkruar mbi fletët e bardha të bllokut të shënimeve. Misioni i tyre, pra i të gjithëve krijuesve të të gjithave fushave të shkencës,është shprehja e mendimit duke e hedhur atë nëpër mjetë fjalës së shkruar. Jo vetëm kaq, por fjalën krijuesit e gdhendin bukur dhe japin frymëmarrje e ngrohtësi për te lexuesi që e transmetojnë te të gjithë kategoritë e tjera të shtresave shoqërore njerëzore. Kjo krijesë e çuditshme me petale e polen lule, gjendet edhe te poetët. Vargjet e shkruara prej tyre në poezi, ngjajnë si gjethet e vjeshtës me kolorin shumëngjyrëshe, dhe brenda tyre thithin polenin e që mbushim liqenin shpirtëror të lexuesit tonë.

Ne takuam personalisht poetin A. Zaplluzha në qytetin e Prishtinës. Ky pot, tashmë është bërë i njohur jo vetëm në Kosovë, por në gjithë trevat shqiptare dhe më gjerë. Poeti Zaplluzha, ka një prodhimtari të bollshme e cilësore në këtë fillim shekulli të ri. E gjithë lënda shkrimore krijuese në botimet e tija, ka rrëfenja të çuditshme përgjatë vargut që përcjell për te lexuesi ynë. Ne intervistuam për këtë qëllim edhe poetin A. Zaplluzha.

Pyetje:
-Cili është qyteti juaj i lindjes?
Përgjigje:
-Kam lindur në qytetin e Prizrenit më 01.02.1943.Aty kam kaluar një pjesë të mirë të jetës sime. Historia e lashtë e këtij qyteti ka ndikuar edhe në formimin tim me ndjenjën e patriotizmit e të atdhedashurisë.
- Çfarë kujtimesh ruan nga qyteti i Prizrenit?
-E ,si të them! Ato janë të shumta, saqë kanë zënë rrënjë thellë në memorien time. Edhe sot në këtë moshë të thyer, kujtimet nga qyteti im i lindjes shpalosen të gjalla para meje. Ato më shfaqen si një ekran televiziv ngado që shkoj e hedh hapin tim. Shkurt, më rinojnë!
- A mund të na thoni më konkretisht?!
-E pse jo! Vendin e parë e zënë lojërat që bënim me bashkëmoshatarët nëpër rrugicat e qytetit, si dhe kur ngjiteshim në bedenat e kalasë. Te gurët e kalasë, sa herë që prekja me duar ata, më shpalosësh historia e popullit tonë që ka luftuar në shekuj për lirinë e mbrojtjen e vatrave tona stërgjyshore nga pushtuesit. Atdheu ynë,Shqipëria është pëllëmbë e histori.
- Me sa dimë juve edhe jeni arsimuar. Ku e keni kryer arsimin?
- Në kushtet e një terrori psikologjik që përdorte sllavi, munda të mbaroj filloren e më pas gjimnazin në Prizren. Më vonë me këmbënguljen time, mbarove edhe Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Kjo ishte edhe ëndrra ime e fëmijërisë: që unë të arsimohesha e të bëhesha dikush në jetë
- A e keni ushtruar profesionin e mësuesit?
- Këtu më zure ngushtë, sepse pak e kam ushtruar profesionin e zemrës time. Kushtet e rrethanat e kohës

nuk ta lejonin këtë mundësi. Në fillim kam punuar mësues në fshatrat Studençan të Therandës. Më pas në Hoçë të qytetit afër Prizrenit.
- …Po më pas ku u punësuat?!
- Ashtu siç u thashë edhe më lartë, largohem nga arsimi dhe punësohem si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës.
- z. Adem! Ju jeni tashmë një poet i njohur në fushën e letrave shqipe, jo vetëm në Kosovë, por edhe në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi, Rumani etj. Kur e keni filluar rrugën tuaj letrare për herë të parë?
- Unë jam frymëzuar nga shumë poetë, por më shumë nga poeti ynë kombëtar Naim Frashëri. Poezinë e parë e kam shkruar në moshën e fëmijërisë. Rrugëtimin letrar e nisa me vjershën për fëmijë e cila u botua në revistën ‘’Pionieri’’në vitin 1957.
-Ç’lidhje ke pasur me grupin letrar që mban emërtimin’’Lulëkuqet e Kosovës’’ ?
- Kjo do mbete një ditë simboli për mua deri në vdekje. Dita më krenare, sepse bashkë me shokët e punës atje në Korporatën Energjetike, themeluam grupin letrar. Aty u botua edhe përmbledhja ‘’Ngjyra e Kohës’’ ku u përfshinë poezi të ndryshme, por edhe të mijat. Kam botuar edhe në gazeta e revista letrare në Prishtinë, Shkup dhe Zagreb.
-Më thatë që keni punuar si përkthyes. Po nga veprat tuaja që janë të shumta me poezi, a janë përkthyer në gjuhë të tjera?
- Po, janë përkthyer në gjuhën Rumune nga i mirënjohuri Baki Ymeri. Është përkthyer libri me titull ‘’Pema e bekuar’’ në vitin 2010 dhe u mirëprit nga lexuesi Rumun. Gjithashtu, po këtë vit në Boras të Suedisë në

antologjinë ‘’Jehona e shekujve’’ të autorit Sokol Demaku janë përfshirë edhe disa poezi të mijat.
- Po prezantime të tjera a keni?
- Kam , por nuk dua të vetë lavdërohem.
- A mund të na thoni disa prej tyre!/?
po më ngacmon kaq shumë me këto pyetje, po u them shkurtimisht: Jam prezantuar në leksikonin e shkrimtarëve shqiptarë 1501-1990, nga Hasan Hasani, si dhe për fëmijë 1872- 1995 nga Odhise K. Grillo. Po kështu në librin me portrete shkrimtarësh nga Demir Behluli në Prishtinë, 2002.
- Ju jeni një poet cilësor dhe sasior. A mund të na thoni sa vëllime keni botuar deri tani që po u bëjmë këtë intervistë?
- Ato janë shumë e shkojnë deri në 96 vëllime të botuara me poezi e skica letrare. Kam në proces punimi për botim edhe katër vëllime me poezi.
- Kush ju financon për botimet letrare?
-Një pjesë të konsiderueshme kam financuar vetë nga kursimet e mia. Kurse tjetrën nga donator e individ të ndryshëm që e duan artin dhe letërsinë. Dua të falënderoj me këtë rast të gjithë ata që më kanë ndihmuar për botimin e librave të mija. Ja ,këto katër vëllimet e reja më ka sponsorizuar z. Xhevdet Krasniqi që punon avokat në qytetin e Prishtinës. Por edhe Departamentin për Kulturë, Rini dhe Sport i Komunës së Prishtinës. Por nuk mund të lë pa përmendur edhe ‘’Market plus’’ dhe drejtorin Tefik Haxhiu, si dashamirës e mik i librit, që më ka mundësuar botimin e mjaft librave me poezi.
…Dhe ne lexuam titujt e librave që ka financuar z. Xhevdet Krasniqi, ky njeri human e dashamir i letërsisë

shqipe. Vëllimet: ‘’Mëkati i hijes’’,’’Rinjohja’’, ‘’Një zog prej uji’’, ‘’Diku në fund të një fillimi’’.

- Përveç faqeve letrare ku ju botoni nëpër gazeta e revista, u kemi lexuar edhe në portalet elektronike. Si e ndjeni veten aty kur ju botoni krijimet tuaja?

-Të them të vërtetën, më japin jetë e frymëzim për të shkruar edhe më shumë. Teknologjia e sotme moderne na ka bërë edhe më të njohur në rrethet letrare nëpër botë. Komentet janë të shumta nga kolegët, si shkrimtarë e poetë nga gjithë kontinentet. Interneti na ka afruar dhe miqësuar me njëri- tjetrin si mjet komunikimi dhe shkëmbim vlerash midis njerëzve, e sidomos mes krijuesve të vjetër apo të rinj qofshin ata të të gjithave fushave të shkencës. Ne si poet e ndjejmë më shumë, pasi jemi qenia më e ndjeshme e shoqërisë!

- Në cilat portale elektronike botoni krijimet tuaja?

-Kudo! Nuk kam dallim mes tyre. Në ‘’Zemra shqiptare’’, Fjala e lirë’’, ‘’KosovariMedia’’, ‘’Gazeta kritika’’, ‘’Dituria. se’’ etj. Zëri i shqiptarëve boton çdo ditë nga një poezi. Kjo më lumturon si krijues.

-Përveç se poet,ju jeni edhe një prind shembullorë .Kur je njohur për herë të parë me bashkëshorten,edhe kjo mësuese, Sulltanën?

-Ju më kërkuat intervistë për poezinë!? Por, ju gazetarët, të gjurmoni deri në skutat e fshehta edhe në intimitet,deri në marrëdhëniet familjare. Nuk po zgjatem: Shkurt jam njohur në vitin 1968 në Prizren, në 500 vjetorin e lindjes të heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti. Sulltana ka punuar 46 vite në arsim. Është vajzë Pejane dhe ka punuar në Krushë të Madhe e në Hoq, në shkollën ‘’Asim Vokshi’’ mbi 30 vite . Sot që të dy burrë e grua jemi pensionist.

-Nga martesa sa fëmijë keni?
-Jemi të lumtur unë si baba, por edhe Sulltana si nënë që lindëm , rritëm dhe edukuam dy fëmijë, pra dy djem. Të dy djemtë janë të arsimuar dhe me profesion. Djali i madh e ka emrin Armend. Është i martuar me dhe ka një fëmijë me emrin Ardian. Jeton në Londër.
Ndërsa djali i dytë, e quajnë Arbri dhe bashkëshorten Sofije. Edhe këta kanë fëmijë: Gentin e Adea, vajza. Jetojnë e punojnë në Otawë të Kanadasë. Aty djali është menaxher kryesor për emigracionin.
-Z. Adem! Qysh në fillim të kësaj interviste, u shprehët se frymëzimet e para për të shkruar ka ndikuar historia e qyteti të lindjes Prizreni. Dua të di unë e lexuesi, se ku janë rrënjët e vargut të poezive tuaja, pra tharmi e tingulli lajtmotiv që përcjell poezia jote !?
-Si të them! E gjithë lënda shkrimore krijuese e imja, jo për mburrje, ka si rrënjë e taban dheun e tokës sonë, Shqipëri. Oksigjeni i vargut është historia e popullit tonë,kurse rrënja e shkronjave thithë gjakun e dëshmorëve që përcjell heroizmin dhe sakrificën e popullit tonë në shekuj për te brezat e sotëm e të nesërm. Frymëzuesja e krijimeve të mija me frymë patriotike, qysh në fëmijëri, ka qenë dhe mbetet dallëndyshja Shtëpia e Rilindjes sonë Kombëtare që ndodhet në qendër të qytetit tim të lindjes. Aty kam marrë vesën e kristaltë të vargut tim poetik.
- Edhe një pyetje tjetër, e të fundit për këtë intervistë: A keni marrë vlerësime letrare për gjithë këtë oazë botimesh që keni botuar,sepse nuk është e lehtë të krijosh e të botosh afro 100 vëllime! Pra, juve keni më shumë botime se sa moshë jete!? Ç’mund të na thuash për këtë?

-Oh, këtu më zure prapë ngushë! Të thash që në fillim që s'dua të vetëmburrem. Le ta thonë të tjerët si të mirën ashtu edhe të keqen. Jam i hapur për të gjithë. Meqenëse ma kërkon një gjë të tillë po ua them juve. Me rastin e 70 vjetorit të lindjes më bëri një ftesë televizori Dukagjini i Pejës . Aty dhashë një intervistë. Kjo është e para intervistë që kam pranuar para medies televizive. Kurse vlerësime të tjera kam marrë nga klube të ndryshme letrare si: Mirënjohje me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë, nga revista ''Albanezul-Shqipëri''-Bukuresht. Vlerësime letrare të cilat janë disa në numër, nga Klubi i Shkrimtarëve ''Fahri Fazliu'' të Kastriotit-Kosovë. Çmimi i Karrierës , nga Klubi i Shkrimtarëve e Artistëve Durrës, e të tjera.

Poeti Adem Zaplluzha na fletë edhe për shokët krijues si: Rexhep Kllokoqi, që është edhe anëtar nderi i klubit të Kastriotit. Por nuk lë pa përmendur dhe Fzali Berisha, mësuesin e matematikës që jep mësim te shkolla ''Pandeli Sotiri''. Ismail Simnica, si dhe kryetarin e Klubit të Shkrimtarëve ''Fahri Fazliu'' të Kastriotit, Bedri Neziri.

Vetë Ademi është edhe nënkryetar i Klubit të Shkrimtarëve në Kastriot, por edhe Anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Në qendër të Prishtinës bëmë edhe nga një foto me poetin e përmasave kombëtare të letrave shqipe z. A Zaplluzha. Një vajzë me emrin Velmine Q. Krasniqi, që u njohëm rastësisht e që vazhdonte arsimin e lartë, na bëri shkrepjet e blicit me aparatin fotografik te shtatorja Zahir Pajaziti (Hero i Popullit) .Poezia e poetit të Zaplluzhës ka vlagun e tokës shqiptare.

Të falënderoj për kohë që ia kushtuat kësaj interviste. Ju uroj shëndet e suksese në krijimtarinë tuaj, që edhe në të ardhmen të na sillni vepra të tjera cilësore letrare.

Prishtinë, Dhjetor 2013.

FJALA E REDAKTORIT

Xhevahir Cirongu

Poet i fjalëve e vargjeve të zjarrta që kanë brenda dashurinë njerëzore
Të shkruash vargun poetik nuk është e lehtë, për më shumë atëherë kur ke të bësh jo thjesht se një poezi do krijosh, apo do ngelesh aty te ai prag guri që s'do vazhdosh rrugëtimin e shkallëve krijuese më tej. Me një intuitë krijuese,duke marrë me vete edhe penën e ngjyer me pjalmin e botës shpirtërore, autori i shumë librave me poezi, siç është i mirënjohuri tashmë i letrave shqipe, dhe që ka depërtuar në gjithë kategoritë e masës së lexuesve;që nga lexuesi akademik gjer më i thjeshti. Pra, ai është poeti Adem Zaplluzha. Ai, në radhë të parë plotëson kuadrin e të qenurit njeri, pra sa intelektual, po aq edhe njerëzor, me thjeshtësinë e fjalës e që lexohet shumë thjeshtë, por në vetvete e gjithë gama e botimeve të këtij autori mban gjithësinë gjeografike në shtrirje, dhe atë filozofike në mesazhet që përcjell për te masa e lexuesve.

Po të vështrosh me kujdes këtë ‘’liqen’’krijimesh të autorit Zaplluzha, sidomos të kohëve të fundit; këtu kemi parasysh krijimet dhe botimet e fillim shekullit të XXI bindesh shumë lehtë,sepse shifra e titujve të botimeve të librave me poezi shkon deri tani në 97 vepra letrare. Muza e krijuese e këtij poeti ka një fillim qysh në moshë të re, por pjekuria krijuese e tij zbriti si një meteor qiellor brenda shpirtit në moshën madhore të pleqërisë; së bashku me bukën e thekur të vargut poetik.

Poezia e AZaplluzhës hapet si ujëvarë e derdhet në shtratin e Lumëbardhit të Prizrenit, por ndalet me vargun e petaltë të trëndafilave shumëngjyrësh, dhe u jep aromën e zambakut të bardhë kur i lexon nëpër vargun e poezive të këtij poeti aty në vëllimet poetike. Shumëkush që ka lexuar poezitë e poetit kosovar, është befasuar, sepse aty gjen forcën e dashurisë njerëzore, të atdhedashurisë, të lirisë, por edhe tragjiken, dhimbjen, etj.

Poeti di ti këndojë shpirtërisht me vargun poetik,lumit, gurit,zogjve,tragjedive njerëzore, yjeve, hënës e qiellit, pemëve, lotit të nënës, gjer te ëndrrave e të shkuarës e të asaj së ardhmes, pra shpresës për të jetuar të lirë e të lumtur. Edhe në këtë vëllim që është i 98 në serinë e botimeve, autori na paraqet me një tufë buqetë poezish të arrira letrare. Mënyra e stili i të shkruarit, te poeti Adem Zaplluzha, na jep tingullin e ëmbël në vargjet e shkruara dhe të ngrohin qenien shpirtërore përgjatë leximit.

Krahasimet, metaforat, e gjithë figurat e tjeraletrare, na jepen të qarta e plot kumbim që tëfrymëzojnë. Vëllimi me titull ’’ Loti i gotës së dehur’’ është me të vërtetë një libër poetik i arrirë artistikisht letrar që i shtohet bibliotekave tona nga autori A. Zaplluzha.

Te poezia ‘’Degët e thyera të pemëve’’ autori ndërthur qartazi faktet e simbolikat letrare. …Dhe më konkretisht:
‘’Sot është e hënë?!
Të martën bie shi në qytetin tim’’.

Ose:**’’Një grua e moshuar i shtinë në rruzare**
Ëndrrat e zambakëve të paçelur,
Edhe në duart e saja
Plot rrudha
I lodhën njerëzit e pemëve’’.

Mendimi i poetit nuk rri brenda vetes, por ecën duke kërkuar shtigjet e fshehta edhe te poetët e tjerë. Ai thur vargun e kujtimit për atë, dhe gufon shpirtërisht se miku i tij poet bëri varg poezie që mbetën në memorien e lexuesit tonë si lapidarë me mbishkrimin e fjalës poezi.
Poeti shkruan për poetin! E kush mund të shkruaj më mirë se poeti për poetin!? E pra, veç poetët për poetin kurrkush s’mund të thotë fjalën e dashurisë dhe të pikëllimit përveç se ata, në të gjallë apo në të vdekur!Poeti kosovar Zaplluzha, duket sebashkë me dashurinë e dhimbjen për poetin Frederik Reshpen, është ulur këmbëkryq mbi pentagramin e vargut. Ai shprehet qartazi se e do poetin edhe kur ai është larguar prej vitesh, por i ringjallur se ka lënë vargjet e pavdekshme të poezisë. A. Zaplluzha e shpreh me këto vargje respektin ndaj kolegut dhe mikut poet, Rreshpeja. Në poezinë ‘’Miku im i mirë’’ shkëputëm këtë strofë ku shkruan:
‘’Miku im i mirë
Kur je i trishtuar,
Ulu në dhimbjen tënde
Dhe recito vargje nga Reshpja’’.

… Por, Adem Zaplluzha, di të presë e të përcjellë edhe vdekjen e dikujt, sa me dhimbje e me trishtim, sepse ajo është pjesë e jetës sonë, një funeral i pa shmangshëm në rrugëtimin e jetës sonë. Vjen një ditë e dashuria hidhërohet kur largohet një i afërm i jonë nga kjo botë. Këtë e shpreh dhe e simbolizon me qarjen e zogjve, me këngën e vajit e të baladave. Dhe më konkretisht, ai shkruan midis të tjerave se:

‘’Kur qajnë zogjtë
Si nëpër balada këndojnë rapsodët,
Me lahuta të verbëta’’.

Po të lundrosh me varkën e mendimit nëpër poezitë e vëllimit më të ri të poetit Adem Zaplluzha ‘’Loti i gotës së dehur’’, do ndjesh aromën e luleve të pranverës në tre kapitujt e librit. Gjerdani i vargjeve poetike të ngërthen gjithë qenien e shpirtit dhe të japin forcë për ta jetuar jetën. Fjalët e poetit janë prush si zjarri dhe lëshojnë xixa ndriçuese përgjatë leximit të tyre. Poeti sfidon moshën, dhe vargu i poezisë e rinon atë. Kjo një dëshmi e vërtetë dhe filozofike, sepse ai na jep faktin më domethënës krijimtarinë e bollshme dhe cilësore me botimet e tija. Kështu, ky poet i palodhur ka sfiduar çdo hamendje se duhesh me patjetër të jesh i ri në moshë që të shkruash poezinë. E gjithë esenca e poetit Adem Zaplluzha është e ndërtuar mbi këtë fakt që para lexuesit vjen me vëllimin më të ri,(nr. 98 libra).

Në poezinë me titull ‘’Pak është vonë’’ ai shprehet në këtë mënyrë duke dhënë forcën e jetës dhe mposhtjen e vdekjes

‘’Pak është vonë
Ndoshta nesër do nisem
Deri te golgota.
Atje ku çdo njeri vdes çdo ditë,
Për një drejtësi
Të padrejtë’’.

Mesazhet e poetit janë kokëforta deri në rrugëtimin e pafund. Në një tjetër poezi me titull ’’Ku po të lëmë kështu?’’ na kujton moshën e pleqërisë, ndoshta personazhi kryesor mund të jetë edhe vetë autori aty. Atij i dhimbset më shumë se vetja atdheu, sepse vendlindja dhe balta do bëhen vatra e përjetshme, kurse poezia me vargun e saj do tingëllojnë fuqishëm te brezat që do e lexojnë. Kështu, edhe A. Zaplluzha nuk i trembet vdekjes, e na jep mesazhin e jetës duke u dashuruar pas asaj. Të punosh për atdheun është sublimi më i madh që i ke bërë vetes. Te Adem Zaplluzha e gjen pikërisht te fjala e shkruar shqipe që lë për Atdheun aty në librat e shkruara e sidomos te poezia. E ku ka më bukur se kështu!? …Dhe citojmë vargjet e poezisë:

‘’Po na përcjellin pleqtë
Me pak lot,
e me shumë pikëllim.
Po të lëmë si qyqen
Atdheu im!

Poezia të rinon e të jep jetë. Ajo është e pavdekshme. Fjala e poetëve dhe e poetit kosovar A. Zaplluzha, ka fjalën e zjarrtë dhe ngroh shpirtin e njerëzve e në veçanti të lexuesit të poezisë. Në Besianë një lexuese e poezive

të autorit, para disa kohësh kur po zbrisnim nga autobusi së bashku autorin në qendër të qytetit u shpreh kështu: ‘’Po të presin lexuesit, i nderuar poet.

POETI QË NA BIND ME KARAKTERISTIKAT E ORIGJINALITETIT

Drita LUSHI

Të shkruash për poezinë e Adem Zaplluzhës, të duket se mban një peshë të rëndë,e mendimin që s'të lë të qetë, se s'do mundesh të thuash dot në fjalë, atë që përçojnë në të vërtetë poezitë e tij.Një "karrierë" poetike nisur qysh herët,e botime të shumta, më bëjnë të mendoj shtatë herë, e të shkruaj një fjalë.

Një penë e konsoliduar shqiptare, me poezi brilante dhe talent të padiskutueshëm,që të merr pa ngutje,dhe me art e finesë,të bën pjesë të fantazive dhe realitetit të tij poetik, me ndërthurje metaforike ndjellëse dhe lakmuese origjinale, dhe mjaft të bukura.

Shpesh, ndalem e rilexoj, për të kuptuar dhe jo vetëm;Lexoj e shijoj njëkohësisht,ato gjetje shprehjesh figurative,që të lënë një çast në heshtje, për atë që syri sheh në vargje, dhe ndërlidhjen e natyrshme të mendimit shpesh abstraksionist e modern të autorit, "gjetjet" poetike të çdo fjale, e të grish kurioziteti njerëzor por dhe poetik, të mësosh mes vargjeve pikërisht atë, që poeti na thotë përtej asaj që shkruan. Poezitë e Tij, janë plotësisht moderne,në stil, mendim, shtrirje, shkruar në varg të lirë, e të ftojnë të ndihesh po e lirë në poezinë e tij, e të ftojnë ta lexosh, rilexosh, ta duash, e të ndihesh brenda saj…

E në **"Stinën asnjanëse"** s'mund të qëndroj asnjanëse.

E lexoj, dhe …



Vendos të bëj një udhëtim të pa bërë kurrë më parë;udhëtoj në "Flokët e mjegullave", në mënyrën më komode, që mund të ketë bërë një poete,ndonjëherë.

Për këtë më ndihmon vargu aq i bukur i Adem Zaplluzhës, përmes të cilit shoh, ndiej dhe prek gjëra, të papara .. e pëshpëris: "Sa me fat jam, sa me fat!"

Ndërsa eci lehtë me sy e mendje përmes vargjeve të Ademit,ato të marrin për dore miqësisht,të fusin në brendi, e duke rrugëtuar me to, sheh dhe lexon përmes tyre, dhe përtej tyre. Janë të paktë poetët, që përmes poezisë së tyre, të zhvillojnë dhe ngacmojnë imagjinatën, që të shohësh si në një film pa zë, tërë atë gjendje të poetit, që vendos të na paraqesë,në një tablo poetike të mrekullueshme.

Përtej,"Stina asnjanëse",në kuptimin metaforik, ne shohim ankthin dhe trishtimin e poetit, "lotin e lisave", "trishtimin e gjetheve", "lisat që nuk flenë", "arnimin e së kaluarës", "drurët që ecin dhe parakalojnë njerëzit", "hënën e vetmuar që i kreh flokët erës", "drurët që jetojnë më shumë se çdo parathënie",etj.

Gjithçka lind, rritet, zhvillohet dhe përjetësohet në "Stinën Asnjanëse" e cila është stinë që i përket plotësisht poetit Adem Zaplluzha, krijuar aq bukur, paralel me katër stinët,që njohim ne. Shpesh, njerëzit e

ndiejnë dhe gjejnë veten në stinë asnjanëse, ku s'mund të jesh njeri, po aq mund edhe të jesh, ku mund të jesh i lumtur, po aq edhe mund të mos jesh, ku mund të ndihesh gëzueshëm, po aq mund të ndihesh i trishtuar, ku mund të dashurosh,por dhe aq mund të ndihesh i braktisur, ku mund te puthësh, po aq s'mund të puthësh, ku ndjen mall, po aq s'mund të ndjesh mall për gjërat jo të bukura. Pra, te gjithë kemi pak,"stinë asnjanëse" në ditët e jetët tona, por Ademi arrin të shkruajë për këto gjendje, sepse ai ka mendjen, fantazinë, shpirtin, vullnetin, palodhshmërinë dhe penën, kurajon dhe guximin poetik, për tu futur në gjendje të qenësishme dhe të paqenësishme,e për të na dhënë një vëllim poetik, që lë gjurmë në syrin dhe mendjen e lexuesit, i cili ia vlen te futet pa hezitim brenda kësaj stine të veçantë.
Poezitë e Ademit, janë piktura fjalësh,tablo jete e fantazie, ku ne shohim të gjitha ngjyrat dhe përtej tyre. Një stil i bukur ku ndërthuret fjala dhe vargu dhe kur përfundon së lexuari poezinë, të duket se ke parë një pikturë nga ato të Van Ghogut.
Nuk ka njeri të mos shohë këtë pamje, pikturuar në këto vargje:

"Sonte paskan vdekur perënditë
As qeni nuk e njeh të zotin e shtëpisë
Një grua e moshuar te plehrat
Disa vjet me radhë
Kërkon unazën e saj të humbur".

"Stina asnjanëse", është prurja e nëntëdhjetenëntë, në poetikën shqiptare, që mban emrin Adem Zaplluzha. Autori ka gati të përfunduar mjaft vëllime të tjerë, çka

tregon për një poet mjaft prodhimtar, të njehsuar së bashku me poezinë; Ose, nëse do të shprehesha ndryshe, do të thosha: **Ademi dhe poezia, jetojnë në të njëjtën ditë,në të njëjtat orë, e në të njëjtën shtëpi.**
Ademi shkruan me varg të lirë, por duke ruajtur ritmin e brendshëm, tërheqjen dhe ankthin poetik të ndezur tek lexuesi, që nga nisja deri në përfundim të poezisë.
Poezitë e Ademit, nuk janë moralizuese në plan të mirëfilltë, çka do ta "vriste" artin poetik, por përmes tyre,lexuesi arrin të nxjerrë, në mënyrë të tërthortë, përfundime të vlefshme për jetën, e çdo gjë që na rrethon, si më poshtë:

"Ka njerëz që nuk e njohin urinë,
Jetojnë me mijëra vjet larg dashurisë,
E ëndrrat e tyre,
I kanë të mbështjellë me makthe.
Kur zgjohen,
Nuk i përngjajnë askujt
Madje, as vetvetes".

Një lidhje pashmangshmërisht e bukur e poetit me gjithçka, me këdo dhe kudo, na bën që të shohim një shtrirje të gjerë poetike dhe njerëzore, futjen e mendimit të poetit ne skutat e jetës, ku mendja njerëzore ndoshta s'mund të imagjinojë, por ai mund te na i sjellë me vargun e tij. Fantazia e tij poetike, vargu i tij, munden të na bëjë të besojmë që ai sheh vërtet: "Atdheun e kafshuar, apo "natën ku bien një nga një perënditë".
Poezitë e tij janë të shkruara çdo ditë tetori, atëherë ku poeti shihte vjeshtën më së miri, sjellë paralelisht me

vjeshtën e moshës, vjeshtën që shqetëson, gëzon ose i bën melankonikë,njerëzit në gjendjet e tyre shpirtërore;
Paçka se të shkruara ditë pas dite,e duken si në një lidhje logjike me njëra- tjetrën, ato munden të kenë identitetin dhe qëllimin e veçantë poetik, përmes të cilit, autori bën ndarjen e poezisë nga poezia.
E konceptuar ne tre cikle, poeti mund të na parcializojë më mirë idetë e tij poetike,dhe ne shohim një film, ku skenari është shkruar nga një dorë, por episodet dhe ngacmimet, janë të ndryshme, çka e bën tërheqës librin, e të lexueshëm, nga fillimi në fund.
Ne ciklin e dytë poetik, poeti është shumë njerëzor, duke dominuar mbi modernen në varg.
Ai përdor fjalën e thjeshtë, kur shkruan për gruan, nënën, Atdheun, për veten, për moshatarët, miqtë etj.
Poezitë e Ademit, herë te fusin ne labirinte gjendjesh, ku mendon pareshtur daljen, dhe kur gjen rrugën, përfundimin ,idenë e poezisë, buzëqesh me vete,e thua: “sa bukur!”
Në poezitë e tij ndërthuren natyrshëm poetika me njerëzoren, e aty ku fantazia simbolike, ngre krye të zotërojnë poetin, befas në vargjet pasuese, shohim Ademin njeri dhe tokësor në vargun e tij.
Natyrisht Adem Zaplluzha, është një poet i veçantë, në vargun dhe poezinë e tij, çka e dallon nga poetet e tjerë kosovarë, të cilët janë më të thjeshte në vargun e tyre, e sjellin vargun në mënyrë të drejtpërdrejtë,por dallon gjithashtu dhe nga tematika, struktura, vargu dhe figuracioni.
Poeti na paraqet vargjet me një alegorizëm elegant, në funksion të idesë së poezisë.

Poeti është interesant edhe në poezitë me rimë, të cilat janë të pakta në këtë vëllim. Ato shquhen për lidhjen logjike, dhe gjetjen e fjala, fjalës pa vështirësi, madje me bukuri:
Ja si shpaloset vargu i rimuar, në poezinë:"Zog Pikëllimi"

"Në qenien time, po ndjehem si i huaj,
As mendja e shëndosh s'vepron.
Letër më s'mund të të shkruaj,
Një mallëngjim i largët më sëmbon".

Poezitë e tij, të bëjnë ti lexosh,të ndalesh e ti rilexosh, ato të ftojnë qysh nga titulli, dhe fjalët vënë në vargje si një gërshet i bukur metaforik, na marrin në thurjen e tyre me mirësi.
Do më pëlqente të ndalesha pak në poezinë:

''DHE JA KU JAM SOT''

Shpirti yt prej një gruaje,
Ai shpirt i madh!
Kalaja që nuk dorëzohet asnjëherë,
Sa fortë qëndron,
Në këmbët e rrënjëve të veta!

Kur mbështetem për rrapin e madh,
Si mali qëndroj në këmbët e mia.
E di se më mbanë gjallë,
Shpirti yt prej një gruaje.
Kur më zë vetmia,
Të thërrasë.

Dhe në prehrin tënd i përkund,
Dhe i vë në gjumë,
Të gjitha trishtimet e mija.

Pa ty do të isha një askush,
Kurse me ty,
Dhe shpirtin tënd lozonjar
U ngrita mbi vetveten.
Dhe ja ku jam sot
Ballëhapur me të vërtetën.

Kaq bukur i këndon ai gruas , sa ëndërron, që çdo burrë, të ishte pak poet që ta shihte dhe vlerësonte kaq bukur shoqen e jetës. E himnizuar njerëzishëm në poezi, për mua si grua, kjo poezi mbetet ndër më të bukurat e vëllimit, duke na sjellë njerëzishëm diçka njerëzore, pa fryrje e fjalë të kërkuara në hojet e imagjinatës, sepse imagjinata më e bukur është realiteti me emrin grua.
Ose në poezinë:"Nëno moj nënë e mirë" shohim poetin aq njerëzor,që i këndon kujtimeve, familjes, babait,duke zgjedhur fjalën ashtu siç bëhet për qenien më te dashur në botë, atë që na jep frymën, e na sjell në jetë.
E duke udhëtuar ne "Stinën asnjanëse",e me hapa njehsuar "Nëpër flokët e mjegullave"- shoh se:

"Ditët kanë mbetur të boshatisura.
Bredhin rrugëve anonime,
Pa emra,
Dhe adresë.
Asnjeri nuk pyet për hallet e tyre"
Asnjë adresë s'do na mbetet në kujtesë.
Çdo gjë në këtë qytet,

Po i përngjan ikjes.
Po largohen
Edhe zogjtë e verbër nga mendja”.

Adem Zaplluzha, i këndon edhe Atdheut në vëllimin e tij poetik “Stina asnjanëse”, por ai, edhe Atdheun në vargje, e vë dhe e sheh nga këndvështrimi i vet poetik,duke i bërë mjaft tërheqëse çka shkruan, e duke mos rënë në përsëritje, çka ndodh shpesh në poetë te tjerë, kur i thurin vargje Atdheut,apo u këndojnë trojeve e plagëve të tij, e nuk i shpëtojnë vargut standard, pa frymë dhe jetë.
Ne fund te fundit, nje Vëllim poetik, i lindur, në një kohë të caktuar, në një periudhe të caktuar, në nje muaj apo epokë te caktuar nuk është gjë tjetër, veçse një skanim shpirtëror i poetëve, të cilin vendosin ta ndajnë me lexuesin. Gjithmonë,nëse do të mësosh për një poet/e duhet të lexosh veprat e tij. Aty, ndërthurur me artin, mësojmë se si ndihet e jeton shpirti i tyre i ndjeshëm, në qerthullin e kësaj bote dhe jete.

Ky Vëllim poetik, natyrisht që do zërë një vend të dukshëm në morinë e botimeve të tjera të këtij autori, që jeton me poezinë çdo çast e çdo ditë.
Gjithashtu,do të zëre një vend të dukshëm në letërsinë shqipe të moderuar, duke shfaqur vlera të vërteta poetike,në të gjitha aspektet, që kërkon ky art; Figuracion, estetike,varg, strukturë, përpos që kemi një poezi origjinale që na bind me karakteristikat e origjinalitetit në mënyrë më bindëse , fillim- fund.

VARGU I POETIT ADEM ZAPLLUZHA SHPËRTHEN EDHE TE HAIKU

Xhevahir CIRONGU

Nuk është një rastësi, që poeti Prishtinas Adem Zaplluzha, ndryshe nga herët e tjera, këtë radhë na paraqitet me një tufë buqetë poezish të haikut. Ai ka derdhur gjithë gurgullimën burimore të shpirtit të tij në këtë vëllim të ri me poezi(Haiku).

Pas shumë veprave të botuara me poezi, këtë radhë ky poet cilësor dhe i ndryshëm nga poetët e tjerë; na paraqitet me një stil disi ndryshe në vargëzim të vargut poetik.

E themi këtë, sepse ai sjell para lexuesit të poezisë një gjini tjetër e cila kjo lloj poezie është pak enjohur te lexuesi ynë. Kjo lloj poezie është shkruar më shumë nga poetët Japonezë, dhe më pas u përhap edhe në vendet e kontinentet e tjera, pra edhe në Shqipëri. Poetët shqiptarë kanë shkruar dhe shkruajnë bukur haikun me fjalën e bukur shqipe. Poezia haiku është varg i çastit,ku poeti e lidh vargun me natyrën që e rrethon, e kështu

shpërthen së bashku me ndjenjën e brendshme të tij. Kam lexuar varg të haikut nga disa autorë të vendit tonë, dhe më kanë befasuar me stilin e mënyrën e të shkruarit. Ata kanë këputur petale vargu nga haiku shpirtëror i tyre, që kur i lexon librat me këtë lloj vargu sa të shkurtër e të ngjeshur me gjetje filozofike; s'ke se si të mos emocionohesh. Aty, te ai varg plot ylbere, shpërthen mendimi e fluturon drejt hapësirës qiellore. Dhe jo vetëm kaq, por është në kërkim të së bukurës fjalë deri në kozmos.

Në këto dy dekada të shekullit XXI,poetë shqiptarë po e thonë fuqishëm fjalën e tyre edhe duke shkruar vargun e poezisë në haik. Ata janë shumë, ne po sjellim vetëm disa emra prej tyre si, Milanov Kallupi, Muharrem Gazioni, Nebi Dragoti etj.

Kësaj armate poetësh të cilët kultivojnë haikun e që shtrihen në gjithë hapësirën shqipfolëse, i shtohet edhe një emër tjetër që këtë radhë na paraqitet me varg haik, dhe ai është poeti nga Kosova Adem Zaplluzha. Vargu që shkruan në haik Ademi,pulson fuqishëm me vendlindjen e tij Prizrenin. Rrënjët e vargut poetik janë ngulur nga veriu deri në skajin më jugor të Shqipërisë, atje te deti Jon. Flladi i luleve pranverore,era e maleve të bjeshkëve shqiptare,valët e bardha të Lumëbardhit të Prizrenit,''puthen'' me kaltërsinë e ''Baba Tomorit'', dhe ''shtrëngojnë duart''

me detin Adriatik e 'vallëzojnë'' së bashku me detin Jonian. Dhe për këtë poeti shkruan kështu:

''Në gjumin e Lumëbardhit,
Ndjeva afshin
E puthjes së Jonit!''

Duhet të theksojmë se poeti nuk lë pa përmendur edhe qytetin e vendlindje së tij. Ashtu, si gjithë poetët e tjerë të cilët kanë shkruar për vendlindjen e tyre të dashur, edhe poeti Adem Zaplluzha nuk e anashkalon atë, por hedh vargje të ëmbla edhe në haik për qytetin e lindjes, sepse ‘’oksigjeni’’ i frymëzimit poetik është aty te vendlindja. Midis të tjerave ne shkëputëm këto vargje diamantesh që poeti ka ditur të përshkruaj aq bukur në tre vargshin e shkruar te haiku i këtij vëllimi të parë në varg haik. Natyrës së bukur që ka qyteti i Prizrenit, nuk i shpëton dot edhe syrit e ndjenjës së poetëve, historianëve apo vizitorëve të ndryshëm kur shkojnë aty në këtë qytet me vlera të shumta historike e atdhetare. Më konkretisht, poeti shprehet me këto vargje:

‘’Qyteti im
Me zambakë të bardhë,
Pranvera në adoleshencë’’.

Poeti bëhet grusht ndaj gjithë dëshirave të jetës. Në këtë rrugëtim të pandalshëm ai trupëzohet si një metal, që kurrë s’jepet ndaj vështirësive, por ecën me vrullin e erës së shpirtit deri te shpirti i gruas, te kjo qenie njerëzore që ripërtërinë shoqërinë e shkrin akujt e së keqes duke mbjellë lumturinë. Burimi shpirtëror i potit na rrëfehet qartazi nëpërmjet vargut edhe të haikut. Prandaj, ai ka zgjedhur të vendosi gurë të bardhë nga shpirti i tij në këtë vëllim edhe titullin ‘’Një grusht dashuri’’ me haik. Vargu që ka në vetvete trio, e që në vargun e tretë na jep forcën dhe kuptimin filozofik, të bën që ta lexosh disa herë poezinë e shkruar nga ky poet; që tashmë ka një

pjekuri klasike në ndërtimin e vargut në gjithë gamën e botimeve me poezi. Ai vjen i freskët edhe me këtë buqetë të haikut në këtë vëllim të parë. Diku, mes poezive të tjera, ai shkruan:

‘’Një lule buzëvarur,
I hapi petalet
Përpiu mjegullat’’.
Apo:
‘’Një grusht dashuri
Në shpirtin e gruas,
I shkrin kallkanët!’’.

E megjithatë, vetë poeti bëhet zog e fluturon. Ai çan mjegullat e kohëve të shkuara e të tashmes, dhe si një meteor ecën i vetëm hapësirës qiellore, me një kusht për të kapur e shkruar vargun poetik. Poezia është jeta e vetë poetit Adem Zaplluzha, që në fund të. fundit u thotë edhe të tjerëve, e në veçanti lexuesit të poezisë, se poezia të mban gjallë edhe kur je larguar nga kjo botë fizikisht. Metaforat e gjetura, krahasimet, figurat e tjera letrare që janë ‘’mbjellë’’ në haikun e shkruar të poetit Adem Zaplluzha, s’ke se si të mos ndihesh i plotfuqishëm e të ecësh i qetë në rrugën e qumështit në hapësirën qiellore. Më konkretisht shkruan:

‘’Një zog në fluturim,
I pyet mjegullat
Për rrugën e qumështit’’.

...Dhe poeti e mbyll vëllimin poetik haiku ‘’Një grusht dashuri’’ me këto vargje dritëjete:

‘’Nëse arrin Të bisedosh
me gjethet,
Shndërrohesh në lule!’’.

Me këto vargje tregohet qartë, se jeta jonë është një gjethe që gjelbëron në stinët tona, por më e rëndësishme është kur arrin të bisedosh me këto gjethe, të cilat janë vitet tona, sepse një ditë ato do thahen, por bashkëbisedimi i shndërron vitet në lule që s’vdesin kurrë,pra kjo lule e ka emrin mirësi!

Autorit i urojmë suksese të tjera në krijimtarinë letrare.

Xhevahir CIRONGU-Poet
Durrës, 25.03.2014

Prof, Dr, Mazllum Baraliu

NJË VEPËR E RRALLË QË PJALMON KURAJO DASHURI DHE HUMANIZËM ADEM ZAPLLUZHA "MENATË VIJNË LEJLEKËT", PËRMBLEDHJE ME POEZI PRISHTINË, 2014

Adem Zaplluzha është njëri nga poetët më të angazhuar dhe më frytdhënës në letërsinë shqipe bashkëkohore të ne dhe gjithandej meridianeve ,ku krijohet dhe kultivohet fjala e bukur poetike Shqiptare. Nëse nuk gaboj,Odhise Grilo,njëri nga shkrimtarët më në zë të letërsisë shqipe të fundshekullit të njëzet – veçanërisht i letërsisë për fëmijë - ishte autor i rreth 110 titujve të veprave të botuara dhe nuk më kujtohet ndonjë autor tjetër i cili kaq më përkushtim,zell,energji të pashterrshme; pasion, dashuri të patundur dhe të pafund, do ti dedikohet poezisë,sikur poeti ynë i mirënjohur,Adem Zaplluzha. Ai deri më tani ka botuar rreth 109 vepra me poezi të zhanreve të ndryshme;për të rritur dhe për fëmijë.

Puna e madhe përkushtuese dhe pasioni i paparë i tij për të shkruar dhe për t'i dhuruar lexuesit të vëmendshëm dhe të dashuruar në letërsi-veçmas në artin magjik të poezisë;fatkeqësisht nuk është vërejtur , studiuar dhe as vlerësuar as në minimumin e nevojshëm dhe të domosdoshëm ,çfarë ky krijues cilësor dhe veteran i poezisë të ne e meriton. Produkcioni i tij letrar i gjertanishëm është i denjë edhe për shoqata,asociacione dhe madje edhe për akademi të tëra, të arteve e të shkencave të ndryshme;gjë që, gjer më tani, nuk na ka rënë të dëgjojmë ,se me të vërtetë ka ndodhur. Këtë barrë dhe këtë punë poeti Zaplluzha e ka bartur,rrjedhimisht e ka bërë pa përkrahje të duhur institucionale;pa hezitim,pa pritesë dhe pa imponim të askujt;thjeshtë për hir të nevojës dhe arsyes madhore për të ofruar,shërbyer dhe kontribuar në ndërtimin dhe latimin - deri në piedestal - të oreolit sublim kombëtar të artit; rrjedhimisht të letërsisë e të kulturës tonë ; në të mirë dhe dobi të qytetarit –lexues dhe ardhmërisë së tij perspektive.

Mirëpo ,shkas parësor dhe arsye për këtë shkrim sot,për poetin Zaplluzha,një sihariq i ri nga poeti ynë,është vepra e tij e radhës e titulluar:" MENATË VIJNË LEJLEKET";vepër kjo e veçantë dhe e rëndësishme nga shumë aspekte,kënde dhe dimensione krijuese.

Në këtë përmbledhje me poezi për të rritur,autori ynë,në mënyrë specifike,por të drejtpërdrejtë, pa ekuivoke të shumta, shpupurisëse dhe indirekte;pa figuracione stilistike të padeshifrueshme,do të shpalosë,duke e vu në dispozicion të lexuesit të vemendshëm, gjithë talentin e tij të pakontestueshëm ,sikurse edhe përvojën e gjatë e të pasur krijuese.

Vepra në trajtim e Zaplluzhës,është një përmbledhje me motive,frymëzime dhe tematika nga më të ndryshme;madje do të thoshim enciklopedike;me dobi, interes dhe kërshëri potenciale për lexuesin tonë. Po të veçonim disa nga motivet,temat dhe frymëzimet,nga të cilat dhe me të cilat preokupohet autori në këtë libër,sigurisht që së pari do të duhej nxjerr në pah:aktin e lindjes;lirinë e atdheun dhe të sakrificës për liri e për atdhe;ëndrrat fëmijërore dhe fëmijërinë;rrjedhimisht dëshirën e poetit për ta portretizuar rikthimin e tij imagjinar dhe metaforik në fëmijërinë e tij të paqenë-fëmijërinë të pa fëmijëri;dashurinë;lëvizjen;angazhimin aktiv dhe përparimin dinamik e progresiv në jetë(si ecje ;si lëvizje e pa ndalur përpara e jo përgjumje,amulli ,monotoni ,indiferencë dhe letargji -drejtë ardhmërisë individuale dhe kolektive –të njerëzve –qytetarëve të tij; në atdheun e lirë e të bashkuar;mërgimin-këtë plagë të shekujve dhe të mileniumeve për shqiptarët;por mbase edhe për të afërmit dhe familjarët e poetit;për vetminë si fenomen mjaftë specifik (dhe i padëshiruar) për poetin- (ani që ai në jetën e përditshme dhe jashtësisnë e sjelljes dhe qëndrimit ,në relacion me rrethin e tij familjar e shoqëror,tregohet dhe mbahet-kurdoherë dhe në vazhdimësi - intrasigjent dhe i “pahetuar” e i paepur),si dhe për vdekjen si një fenomen tjetër relevant,por edhe përmbyllës i ciklit jetësor;për varfërinë,urinë dhe mëkatin e deri të universi si motiv dhe tematikë me porosi universale; me peshe dhe relevancë, për trajtim në poezitë e tij.

Procedimin e tij letrar,poeti në këtë përmbledhje sikur e fillon me një fanitje simbolike e cila përvijohet përmes kënaqësisë që sjell liria e atdheut. Në këtë fanitje

sublime të lirisë ai sikur ndihet i realizuar dhe i kënaqur;pa ndier nevojë për asnjë lloj tjetër përmbushjeje. Në këtë kontekst ai shton:”Nuk dua vdekje më të bukur,/se sa kjo kënaqësi/që shtrihet në krahun e djathtë/të fluturës së atdheut tim…Nuk dua vdekje më të bukur /se sa kjo lindje/që i përket atdheut.(Poezia më lërë të vdes fq. 5).Mobilizimi motivues dhe frymëzues jashtëzakonisht i fuqishëm dhe në moment të caktuara edhe mjaftë shpërthyes,në këtë vepër ka rezultuar më një varg e vistër të figurimeve dhe transfigurimevfe stilistike;diskriptive dhe përmbajtësore; prurje me vlerë këto, të cilat e shtojnë në masë të konsiderueshme procedeun artistik deri në melodramacitet maksimal;fakt ky që ngrit nivelin e interesimit dhe adrenalinës së lexuesit dhe studjuesit të mirëfilltë të veprës letrare,për të absorbuar sa më shumë nga oferta mjaftë e pasur dhe laryshore e materjes poetike,në këtë përmbledhje me poezi. Ja vetëm disa nga shumë metafora mbresëlënëse të këtij libri,që meritojnë një vëmendje të veçantë: “flokët e brymta të shirave(fq.12);qelin duart e lisave;rrënjët e Rrapit të dehidruar;lotët e erës;pikonte trishtimi (fq.13).;huazojnë qështjet e bronzta(fq.15);në katet e sipërme të mendjes (fq.16);shtrydhja e trishtimeve (fq.20);nëpër parathënien e muzgut (fq.23);si rropullitë e shpresave(fq.24.);nazalet e erës (fq24);serenatën e lëngut të mallëngjimit “(fq25);vashat lahen në lotët e hënës(fq.54)etj.

Duke qenë vetë tejet i vyeshëm, i palodhshëm dhe vazhdimisht dinamik e kontribut dhënës në avancimin e kauzës kombëtare dhe shoqërore ;poeti edhe nga të tjerët;pra nga bashkë kombasit e tij me shumë të drejtë, kërkon më shumë punë, mirëkuptim, dashuri, unitet,

harmoni dhe mbi të gjitha përkushtim në ndërtimin e vendit dhe të shtetit të ri;konsolidimin dhe përparimin e atdheut;sepse,sipas poetit tonë, :”përgjumja askujt nuk i bën mirë”(poezia: Dhe ata të tjerët,fq,10).Kjo përgjumje,nuk do ju bëj mirë madje as :”shokëve të luftës”(fq.26.str.3.,vargu 3.)sepse,poeti tërheq vëmendjen e lexuesit dhe vërejtjen e tij se :”të murishtat e shembura/po sillen vërdallë/disa mallkime hijesh të zeza/(poezia:Askush nuk fle sonte/.Poeti me këmbëngultësi kërkon që të mos ketë ngecje,por që të ecet domosdoshmërisht dhe me emulacion e vullnet të pashuar –përpara- deri në ngadhënjim e përparim :”Ne duhet të ecim,bijtë e mi/domosdo duhet të ecim/Përtej ngadhënjimit të fjalës(str. e 3 e poezisë:”për ta mbërri fundin”.,fq.50.,Autori ynë në këtë poezi dhe gjithandej kësaj përmbledhjeje,kërkon që të gjithë bashkë atdhetarët tanë –kudo ku janë, lypset të jenë më vigjilent dhe më përkushtues ndaj kauzës dhe progresit.

Në disa nga poezitë e tij,veçanërisht në ato që kanë të bëjnë me qytetin e tij të lindjes-Prizrenin pitoresk, poeti Zaplluzha,sikur shpreh nostalgjinë e tij për të kaluarën dhe befasinë e pakëndshme për ndryshimet e gjeneratave ,që kanë ndodhur në ndërkohë ,si dhe zvetninë mbretëruese të një “vakumi shoqëror” atje. Duke ndier vakum edhe në zemër,ai sikur shpreh keqardhjen dhe habinë e tij,duke shtuar:”Paskan ikur/ose janë moshuar të njohurit/dhe të panjohurit/e qytetit të zambakëve(fq.16.str.2).Poeti ,përkundër ndiesisë së mirë dhe kënaqësisë që ndien kur e i viziton njerëzit e tij më të afërm dhe më të dashur të jetës në qytetin e tij të lindjes,në të njëjtën kohë ai sikur do të ndiej njëfarë lloj ftohtësie mornicore,sepse siç do të

thotë katërcipërisht edhe ai vetë :”askënd nuk e njoh/Askush nuk më njeh sonte (në këtë qytet M.B.)(fq.17.,strofa e fundit).
Ndaj ,në vjershën :”Vetëm Shatërvani i vjetër(fq16).,autori me nostalgji dhe keqardhje, do të portretizojë tablotë e qytetit të tij ,me “ballkone të zbrazëta” dhe pa njerëzit e njohur për gjallërinë dhe bujarinë e tyre tradicionale mijëravjeçare ,që pritnin dhe përcillnin me mirëdashje maksimale dhe me kënaqësi,të njohur e të panjohur,në shtëpitë e tyre të qytetit muze. Në qytetin e tij të lindjes e të rinisë së hershme-Prizrenin,kanë të bëjnë edhe poezitë:”Kur ishim të vegjël “(fq.71) dhe poezia përplot simbolikë dhe vetëspjegim:”Unë kam harruar kur isha fëmijë”(fq.72). të librit.
Duke u përballur “vetëm me dhembje”,me skamje dhe varfëri;por edhe me robëri e padrejtësi,poeti kishte vuajtur dhe ishte burrëruar para kohe. Duke e pasur një fëmijëri të tillë si shumë e shumë bashkatdhetarë të tij në Kosovë dhe viset tjera etnike autoktone pellazgo-iliro-shqiptare,poeti ynë zëshëm dhe pa keqardhje do të theksoj se :”asnjëherë nuk ishte i vogël apo fëmijë”,që do të thotë mbase se nuk kishte fare ose fare pakë fëmijëri të vërtetë dhe të mirëfilltë (fq.73.).Në këtë frymë autori ,sikur me shpirt të trazuar i drejtohet lexuesit si vijon:”Nuk më besoni por lindja ime /Ishte një trishtim i paharruar/nën rrogozin e vuajtjes/dhembja lëshonte gjëmën e përditshmërisë” (strofa 2 e poezisë :”me plagë të pashëruara”,fq.61.
Duke qenë i mirënjohur nga rrethi i tij shoqëror, si njeri i popullit apo masave të gjëra popullore,poeti këtë do ta dëshmojë edhe si krijues,jo vetëm në këtë

përmbledhje,por pothuajse në gjithë opusin krijues – letrar të krijimtarisë së tij artistike.
Në vjershën :"Të varfëritë e qytetit tim"(fq.33.) p.sh.,(tani poeti mbase fjalën e ka për qytetin e tij –ku jeton e vepron me dekada të tëra-Prishtinën-),po ky i këndon me dhembje të madhe e keqardhje,por edhe me humanizëm të rrallë vegjëlisë së varfër dhe të pa përkujdesje as shoqërore dhe as njerëzore ,në ambientin e tij shoqëror.
Të varfëritë ,për poetin janë:"njerëz të mëdhenj;dinjitoz dhe optimist,por që në dallim prej të tjerëve(të kamurve)këta të fundit dinë të kënaqën edhe më gjëra të imta; me një kafshatë bajate dhe të cilët me pakë bukë e kripë,si në mahi e tejkalojnë maratonën e urisë". Atë ,pra autorin e përmbledhjes e preokupon dhe brengosë tej mase varfëria dhe skamja ekstreme e njerëzve të qytetit dhe të vendit të tij;Kosovës së tij të dashur. Prandaj edhe atyre ua kushton vëmendjen dhe kujdesin e duhur,edhe si poet edhe si njeri human.
Një lloj përkushtimi të tillë grandioz-me një ndiesi sublime - një përkrahje morale dhe humane,njerëzve të kësaj kategorie sociale,mund tua bëjnë vetëm poetët e mëdhenj e të përjetshëm (pra ata që duhet të mbesin përherë në memorien dhe altarin e shenjtë të popullit),bij autentik ,të mirëfilltë e besnik të popullit të vetë.
Duke qenë mirënjohës dhe falënderues për njerëzit që e donë ,respektojnë dhe e rrethojnë,autori i kësaj përmbledhjeje,në poezinë:"Pa titull"(fq 30) dhe "Nuk marr dot frymë pa ty"(fq39),nuk mendon për asgjë dhe as që i frikohet asgjëje tjetër ;madje as "vdekjes së plumbtë",por ai sikur i druan :"zemrës së brishtë,por

padyshim tepër të dashur e më të afërt,që ai ka pranë tij-bashkëshorten e tij".Frika nga humbja e çfarëdoshme eventuale e saj;dashurisë,krenarisë dhe mbështetjes kryesore jetësore të tij,pra e më të afërmes së tij,është e kuptueshme që e shqetëson deri në trazim poetin;ngase me të dhe kryesisht vetëm me të, ndanë të gjitha gjërat më të rëndësishme që ofron dhe imponon jeta e përditshme. Poeti Zaplluzha brengoset shumë dhe preokupohet edhe me gjendjen e rendë të një amnezie; paknaqësie dhe të dëshpërimit (kolektiv) të bashkëqytetarëve të tij dhe këtë gjendje ai e quan:" si një mallkim i hershëm"(shih vjershën me po këtë titull në fq.57 të librit),ndaj i indinjuar autori :"me plagë (ende) të pashëruara" i qorton ata të cilët me pahir përpiqen të ja ia imponojnë këtij modelin : " se si duhet me e dashtë atdheun"(fq.61).Ndaj,më zë të fuqishëm kumbon:"O kush jeni ju të më mësoni/se si duken prangat/dyzet e katër vjet jetova i prangosur/si luani në kafaz/dhe akoma kam mbetur/me plagë të pashëruara…/Dhe ju sot me tregoni/Se si duhet me e dashtë atdheun/…,ndërkohë që unë,më tutje shton poeti,:"/Mbi katër dekada e barta gurin e pikëllimit/dhe gjumin kurrë nuk e pata gjumë/me sy të mbyllur e ëndërroja lirinë".(strofa e fundit e poezisë "me plagë të pashëruara" (fq.61.).

Në poezinë me titull:"Më fal nëna ime",poeti ,duke qenë i pakënaqur deri në zhgënjim me gjendjen e krijuar në ambientin;rrjedhimisht në realitetin objektiv që e rrethon atë edhe në shtetin e tij të lirë e të pavarur,pothuajse në zenit e ngrit zërin e tij të lamentimit dhe për këtë gjendje të rendë,të cilën ai e pasqyron realisht dhe sikur i kërkon falje vendit (nënës)së tij,të cilit i lutët për mirëkuptim,ngase pasi që e ka humbur durimin,tashmë

më shumë iu përngjet “gurëve”,që asnjëherë nuk i ndalin vajet”(str. e fundit e poezisë :”më falë nëna ime” .,fq.82). Fenomeni i emigrimit, tashmë shumë brengosës edhe në përmasa gjithëkombëtare,është ai që e preokupon tej mase poetin tonë; ashtu siç e preokupon dhe e shqetëson pothuajse çdo familje dhe individ, brenda hapësirës etnike Shqiptare. Pikërisht, për këtë arsye ai në disa nga poezitë e tij, më të realizuara artistikisht,këtij problemi i ka kushtuar vëmendje dhe hapësirë të veçantë. Duke e qendërsuar problemin e emigrimit, në poezinë me titull:”Të lutëm më thuaj bir”, poeti me përgjërim iu lutët njerëzve të tij e të popullit të tij,që të mos ikin në mërgim .Lutjet e tij tingëllojnë mjaftë dramatike kur,sikur i drejtohet të birit të tij me këto fjalë:”Të lutëm më thuaj bir/Se nuk do t’i përngjash lejlekut të Mjedës/Nuk do të na lësh vetëm/Si qyqe mali/T’i përqafojmë këto drurë të lagjes/…O si zotin të lutëm/Mos më lërë as mos ik/I trishtuar si lejlekët në mërgim/(fq.74)., … sepse jeta ,në mërgim,sipas poetit, s’është asgjë tjetër ,vetëm se një mashtrim!Meqë siç dihet migrimi i njerëzve tanë,veçanërisht të rinjve dhe të rejave tona,tashmë ka marr përmasa dramatike dhe tragjike,përgjërimi i poetit për mos shpërngulje dhe mos emigrim jashtë vendit ,nuk do të këtë edhe aq efekte .sa do të dëshironte ai dhe ne ,të gjithë së bashku. Pra procesi i emigrimit të bijve tanë,për të cilët poeti thekson se po:”fluturojnë /Si zgalemat e dëshpëruar/(si zogj të trishtuar),të pashpresë e të indinjuar ,si të ishin zogj të pafat të qyqes. Po largohen e po ikin - si gjethe degësh të shkundura- përtej maleve,luginave,deteve,oqeaneve dhe bjeshkëve të pafund të kësaj bote.(vjersha:”Si zgalemat e dëshpëruar”., fq.78).Duke qenë maksimalisht dhe

vazhdimisht i preokupuar,i brengosur dhe i shqetësuar nga kjo gjendje e rëndë,si pasojë e mërgimit,poeti sikur i përgjëron dhe i fton, tashmë të ikurit e shumtë meridianëve të botës së egër të kapitalit e të profitit,që të kthehen në trojet e tyre;në atdheun e tyre,te prindërit e tyre,që vazhdimisht mendojnë për ta dhe sytë i kanë të drejtuar drejtë vend migrimeve të tyre në largësi:"/Sepse kthimi i tyre në atdhe/Do i ringjallë/Edhe gjyshërit e vdekur/"(vj.:"Edhe gjyshërit e vdekur "fq.76.)Më këto fjalë,do të përfundoj poeti ynë shqetësuar dhe indinjuar lidhur me këtë fenomen,që tashmë kaherë është shndërruar, në një plagë dhe vragë gjithëkombëtare që kullon .

Të konsiderueshme janë edhe vargjet ,të cilat i janë kushtuar vetmisë,si një dukuri,gjithnjë e më e shtrirë në kushtet e jetës bashkëkohore, të një demokracie dhe sistemi neoliberal,si gjithandej edhe të ne. Krahas vetmisë,duke e marrë në konsideratë edhe faktorin moshë,autori sikur ndien më shumë peshën e lodhjes dhe të pasigurisë së padurueshme individuale dhe shoqërore:"/Kjo moshë e shtyrë qenka tepër e rendë/Nuk mund të bartët/Zvarritët si mali l lodhur…/frynë në zgërbonjën e shpirtit/…/Përpos hapave të lodhur dhe vetmisë/Askush pranë nesh/Ecim si dy kukëza të drunjta/Pa shpresë…/Qenka shumë rendë/Tepër e rendë kjo peshë e padurueshme /Rendojnë mbi supe ditët/Muajt dhe vitet/Kjo barrë e madhe sa bota/S'durohet dot/Ama as nuk mund ta heqim."/(Si devetë e shkretëtirës".,fq.47. Duke e krahasuar deri në personifikim, gjendjen e tij të vetmisë,moshës dhe çdo gjë që ato sjellin për rrjedhojë,poeti në një masë a një tjetër,sikur e pranon që ndihet paksa i vetmuar dhe i

shfuqizuar,deri në përmasën dhe gjendjen e një lisi të dehidruar ,pranë të cilit,sikur nuk gjendet as nuk sillet askush. Në këtë gjendje kuazianabioze,poeti sikur kërkon mirëkuptimin, mbështetjen dhe dorën e ndihmës,për të dalë nga një:" boshllëk i pafund mjerimi".Duke mos pasur as më të voglën përmasë të përkrahjes dhe as ,siç thotë ai vetë :"ledhatimit" të nevojshëm njerëzor dhe shoqëror-kolektiv,lutet sërish për nxjerrje nga boshllëku i imagjinuar,për të mos mbetur:" si një kallkan i ngrirë dimri".(str. e fundit e poezisë :"Paskam mbetur".në fq.84.,të librit. Pra, e gjithë ajo që u tha më sipër,sikur ngërthen në vetë një shprehje e revoltës së poetit, ndaj gjendjes së krijuar dhe ndjenjës së abandonimit nga të tjerët (të afërmit dhe shteti-shoqëria apo edhe më saktë:shprehje e pakënaqësisë me mungesën e përmbajtjeve,prestacioneve dhe shërbimeve më humane të jetës shoqërore);faktor me ndikim këta të cilët do të duhej të ishin,gjithnjë pranë e pranë me njerëzit-anëtarë legjitim të shoqërisë,veçmas më të moshuarit ,të vetmuarit dhe ata që nuk kanë përkrahje materiale-financiare shoqërore.

Mirëpo,në pamundësi për ta ndryshuar cilësisht gjendjen e krijuar shoqërore; meqë nuk bën ndryshe,poeti i vetëdijshëm për çdo gjë që ndodhë dhe sillet rreth tij,e kupton se kështu duhet vazhduar:"deri në fund të tregimit"(fq.27. vargu i fundit);madje më fuqi maksimale shpirtërore dhe intrasigjëncë të një personaliteti të pathyeshëm gjatë një kalvar të tërë dhe furtunash jetësore,në mënyrë rezolutive dhe të patundur,sikur i drejtohet një autoriteti imagjinar të hyjnizuar,që në asnjë rast;më asnjë mjet dhe mënyrë ,të

mos ia ngacmojë vetminë e poetit(vargu i fundit i strofës së parë të poezisë :”Ti asnjëherë nuk erdhe”.,fq.88).
Kjo në vija të trasha është përmbajtja e librit :”Me natë vijnë lejlekët” e autorit Adem Zaplluzha i cili me një fuqi krijuese të jashtëzakonshme,na ka sjell para nesh një vepër,sa të veçantë, aq edhe të pasur dhe do të thosha me primesa të caktuara enciklopedike,që më thotë mendja se do të pritet mirë nga lexuesi dhe do të jetojë gjatë në memorien tonë kolektive artistike dhe kombëtare.Libri në trajtim,pa dyshim që i ka edhe anët e veta dispozitive, që do të duhej përmirësuar dhe eliminuar. Kjo do të duhej bërë, para se po ky libër të dërgohet për botim. E para çështje që do të duhej përmirësuar është organizimi më adekuat i cikleve dhe poezive brenda tyre. Çështja tjetër ka të bëj me nevojën e përputhjes konkordante të titujve me brumin përmbajtësor të materies poetike, brenda poezive përkatëse. Pra titujt mbase do të duhej të jenë, më domethënës dhe më simbolik;në raport me tërësinë e tekstit poetik përkatës në përmbledhje. Kohezioni poetik,pra tërësishmëria përmbajtësore e materies poetike në një numër të caktuar të poezive,do të duhej ,mbase të ishte më kompakte dhe më konvergjente me porosinë që pretendohet të jepet nga autori. Gabimet semantike dhe ca të tjera teknike,do të duhej eliminuar paraprakisht.Të gjitha këto vërejtje dhe sugjerime,në asnjë masë, vëllimin në asnjë mënyrë, nuk ia zvogëlojnë vlerën dhe rëndësinë e kësaj vepre të autorit Adem Zaplluzha.

KËNGËTIMI POETIK I ADEM ZAPLLUZHËS, PASQYRIMI I BOTËS REALE

Shabaze Vishaj-Grajçevci

Kur flasim për vargun poetic të poetit Adem Zaplluzha, kemi parasysh se kemi të bëjmë me një krijues të mirëfilltë, i cili deri më tani ka botuar 103 vepra. Këngëtimi i tij poetik në veprën letrare"Lëreni zërin tim" është pasqyrim I botës reale, preokupimi I poetit dhe shqetësimi për gjithçka që e rrethon atë shoqërinë dhe popullin në përgjithësi.

Nisur nga titulli i këtij vëllimi "Lëreni zërin tim" shihet qartë se kemi të bëjmë me porosi të veçanta për lexuesin. Motivet dhe temat e trajtuara në këto lirika janë të llojllojshme, e që shumë sish vejnë në pah brengën,mllefin, dashurinë, mallin për gjithë atë që rrethon botën njerëzore. Pra zëri i tij protestues, shfaqet me nota dhembshurie , dhe të ashpra, me qëllim që përmes vargut të ndikoj në mendjet e atyre që me vetëdije hapën plagë të pashlyeshme në jetën njerëzore. Se vërtet Adem Zaplluzha është zë kryengritës në këtë

vëllim poetik dhe është vetë shpirti i popullit flasin edhe vargjet në vijim të poezisë **“Vargu im”:**

‘’Vargu im kryeneç
Sa shumë i përngjan shpirtit të popullit,
Saqë pa të kurrë nuk mund të qëndrojëaq fort në këmbët e veta’’.

Më tej poeti ligjëron për dërrasat e mykura të kujtesës, drerin e pikëlluar e anijet e mbetura në mol. Te poezia : Shirat e një vjeshte vargjet e thurura me mjeshtri dhe të gdhendura me mature flasin qartë për origjinalitetin poetik si në lirikat vijuese:
Sonte po troket vetmia
Po troket si dikur shirat në xhamat e kujtesës.

Ose,kur thotë:

‘’Eja miku im eja ,kjo natë ka zënë e po i. kafshon mollët’’.
Revoltën kundër dukurive negative dhe atyre që shkelin mbi të pafajshmen poeti Adem Zaplluzha e vë në pah me figura stilistike që e ngritin veprën në nivel të lartë ideoartistik.Ja si ligjëron poeti:
Ndoshta vetëm juve/ U takojnë privilegjettë jeni të trishtuar/ nën mëngët e këmishës/ asnjëherë s’pushojnë së kafshuari /erërat e çmendura të jetës/.

(Te poezia Loti) si për shumë poet të tjerë
edhe për Adem Zaplluzhën plaga e
azilkërkuesve është plaga e pashërueshme,
ku ai me mjeshtri poetizon në poezinë:

"Kur
kthehen"/ Miqtë e mi azilkërkues/Përherë
janë të trembur/Netët iu kalojnë nën
ndonjë urë/Ku urinojnë zogjtë e natës/…
Ndërkaq mosha e fëmijërisë poetit i sjell
ngrohtësi dhe nostalgji për të, ku me
lirizëm shprehet:
/Po ikën fëmijëria/ po largohet si hije pa ngjyrë/po këputen degët e mëllagës së kuqe/…

Lirikat e poetit Adem Zaplluzha lexuesin e bëjnë për vete.
Mbresa të veçanta të lënë ato tëdashurisë,veçanërisht te poezia
"Më prit se
unë do të vij, sidomos vargjet:'' **Më prit te**
shelgjishtet/ unë do të vij/ hape kraharorin /
hape zemrën tënde të madhe/ për shpirtin tim
të vogël/''...
Siç shihet e poetit shpërfaqet jo vetëm
shpirti i trazuar, por edhe i gjithë
popullit,ndaj me të drejtë mund të thuhet se
përmes brendisë shpirtërore të poetit
lexuesi e kupton brendinë shpirtërore të popullit Shqiptarë

Ahmet Pllana

POEZI QË KËNDELLIN DHE SHËROJNË SHPIRTIN E LEXUESIT

Poetët shquhen për atë se e krijojnë artin letrar dhe i japin kuptim jetës. Ata dinë të zgjedhin magjinë e fjalës me ngjyrime poetike që kanë ngrohtësi dielli. Vargëzimi i tyre i kristaltë depërton fuqishëm me mesazhet e tij tek lexuesi, duke u bërë joshës dhe ushqyes për shpirtrat e tyre me kulturën e artit poetik. Njëri ndër ta është edhe Adem Zaplluzha, poet nga Prishtina. Ai udhëton nëpër vitet krijuese si një meteor që s'di të ndalet. Si i tillë, ky autor ka ditur t'u dalë hapur kohëve tinëzare për të vazhduar më tej me krijimtarinë poetike.

Poezia apo fjala e shpirtit, poetin Zaplluzha e nxit për të qenë adhurues i jetës me plotë optimizëm, ndonëse shpeshherë në vargjet e tij gjen edhe zhgënjim nga mundësia për ta larguar të keqen dhe për ta ofruar të mirën, duke u bërë kështu kritik i të këqijave që ndodhin në jetë. Poeti Adem Zaplluzha është njëri ndër poetët e frytshëm, ndoshta më i frytshmi prej të gjithëve, sa i

përket numrit të shumtë të librave me poezi. Ai është poet i çastit, por edhe i angazhimeve krijuese për një kohë më të gjatë, duke u bërë i pjekur në poezinë moderne. Poeti Adem Zaplluzha është një poet me një profil krijues të pasur. Ai është poet modern dhe krijues i mirëfilltë, por madje edhe i vëllimshëm, sepse deri më tash ka botuar 105 libra me poezi. Adem Zaplluzha me fillimin e këtij viti, na e dhuroi edhe një libër të ri me poezi, të cilat kanë evoluar nga shpirti i poetit me pezmin dhe ngashërimin poetik të ndërlidhur me qasjen jetësore.
Ky libër me titullin simpatik dhe provokues "Si trenat e verbër", përmban poezi të çiltra dhe joshëse për t'i lexuar, sa që lexuesi vështirë e ka të ndahet pa e lexuar tërë librin deri në fund. Shkurt, libri me poezi i autorit Adem Zaplluzha është shumë poet i këndshëm për ta lexuar, ngase në të has në vargje poetike që kanë muzikalitet poetik, kanë art, përmbajtje dhe mesazh. Libri "Si trenat e verbër" është shkruar brenda një kohe të shkurtër, në muajt janar, shkurt dhe mars të vitit 2014. Thonë se për t'u shkruar një libër i mirë me poezi, duhen disa vite, së pakut dy-tri vite, mirëpo ky mendim nuk qëndron, sepse edhe brenda një kohe të shkurtër mund të shkruhet një libër i mirë, siç është ky libër të cilin tash e kemi në duar. Libri me poezi "Si trenat e verbër" është i ndarë në katër cikle: Poemë për Vaçe Zelën, Zërat e yjeve, Mallëngjime detesh dhe Ky dimër i çmendur. Libri fillon me poemën e jashtëzakonshme të shkruar bukur dhe me frymëzim poetik kushtuar këngëtares sonë të madhe, Vaçe Zelës. Pastaj poeti vazhdon me poezitë tjera, të cilat janë shkruar me përkushtim dhe frymëzim emocional dhe shpirtëror. Era është një simbolikë të cilën poeti e përmend shpesh në poezi, pastaj shiun,

mjegullën, zogjtë, gurët e stralltë të atdheut, etj. Poeti e ndjen dhe ec nëpër kohë, me të kaluarën, me të tashmen dhe të ardhmen. Ja si thotë poeti në një varg: Mes librave të vjetër hapet historia. Në poezitë e librit "Si trenat e verbër" poeti përmend edhe shumë simbolika të tjera, sikurse lisat e vjetër, korbat, dimrat e acartë, etj.

Në poezinë "Ky dimër i acartë", poeti shkruan: "Ky dimër i acartë, Iku nga zgërbonja e ahut, Te Lugu i Gështenjave, Buzëqeshi pranvera." Në këtë poezi poeti shpreh zhgënjimin e një kohe të keqe që iku dhe për kohën e mirë që erdhi, përkatësisht, siç thotë poeti, për pranverën e bukur që erdhi. Në një poezi tjetër poeti shprehet poetikisht dhe në mënyrë modern: /Si patat e egra kthehen stinët,Kojrrilat fluturojnë, Prej dege në tjetrën degë,Një diell ngjashëm me trekëndëshin, Po lind në qiellin tonë./ Vuajtjet e njerëzve nëpër kohë janë preokupim i poetit. Ato vuajtje poeti i paraqet edhe në poezi, madje edhe përmes kujtimeve fëmijërore. Në poezinë "Si trenat e verbër" poeti shkruan: /Ky bredh degëthyer , I kundron largësitë e paepura, Si në fëmijërinë time, Qante një zog, Pandërprerë dëgjoheshin si në kor, Krakëllimat e korbave./ Ndërkaq, në poezinë "Atdheu me mallëngjim" poeti i qaset përjetimit në vorbullën jetësore të quajtur atdhe, ngase mishërimi i tij me të është i pashmangshëm, si një batutë e përjetësisë dhe mallëngjimit, duke e ngritur atë në një piedestal njerëzor. Në poezinë "Ishin stinët e shirave" poeti Zaplluzha shkruan edhe këto vargje: /Brenda saksie si lulja, Po fishken duart e një kohe, Kush trokiti mbrëmë,
Në mendjen e mbyllur të erës./
Poeti shkruan poezi edhe për mallëngjime detesh, për atë se dikush e zhveshi hënën, etj. Ndërsa, në poezinë

“Brenda nesh”, poeti shkruan aq qartë dhe bukur, sa që lexuesin e lë të mendojë e kuptojë se ku insiston poeti ta gjuaj insistimin e tij”: /Brenda nesh, Lindin dhe vdesin fluturat, Herë zgjohen, E herë flenë ëndrrat./ Poeti shkruan për dimrat “e acartë”, “të egër”, “të çmendur”, të cilët kanë lënë vragë në jetën e njerëzve nëpër kohë. Zaplluzha shkruan edhe për ata që rrugëve të qytetit kalojnë hamendshëm apo “shkarazi”, siç thotë poeti. E mira dhe e bukura gjithmonë joshin, andaj e kanë joshur edhe poetin Zaplluzha. Ai në poezinë “Si ta krahasojmë me hënën” shkruan e si të mirën dhe të bukurën e krahason me bukurinë e hënës, duke aluduar në atë kur ndriçon natën e errtë dhe e bën dritë. Zaplluzha beson në atë se poezitë e tij janë pjesë e botës së tij shpirtërore dhe shqetësim për faktin se sa e vështirë ishte ajo kohë. Megjithatë, ai të tashmen dhe sidomos të ardhmen e sheh me shpresa dhe optimizëm.

Poetët shquhen nga të tjerët që shkruajnë e krijojnë, sepse ata dinë të zgjedhin midis atyre magjinë e fjalës së shkurtër, me ngjyrim të ylberta, me ngrohtësi si rreze dielli; me një vargëzim të kristaltë si ujë burimi, që në fund të fundit depërton fuqishëm me mesazhet e tij tek lexuesi duke u bërë profet i shpirtit të tyre. Ai udhëton në kalvarin e viteve krijuese si një meteor që s’di të ndalet, por ecën me hapin e një luani duke rrokur pas vetes poezinë. Si i tillë, ky autor ka ditur t’u dalë hapur kohëve tinëzare që në shumë mënyra kanë dashur t’i ndalojnë fjalën e shpirtit, poezinë. Poeti nuk thyhet aq lehtë para intrigave të pushteteve, të ligësisë që bën kushdo pushtet apo sundues ndaj një pjese të shoqërisë tjetër me gjuhë e zakone ndryshe nga pushteti sundues. Aty në kullën e shpirtit të vet, poeti Adem Zaplluzha rrit filiza pemësh e

lule të shumta që me aromën e tyre e me vlagun e plisit të tokës së vendlindjes, shkruan vargun e poezisë. Tek bisedon me poetin, vetja të duket sikur takohesh me dy botë: njëra botë është e pashpirt që ka mbjellë errësirë me dekada deri aty që edhe fjalën e ndalonte për ta shprehur, dhe tjetra botë të shfaqet si një dritë neoni që përcjell paqe, liri e zhvillim shoqëror demokratik të mbarë shoqërisë njerëzore. Në copëza letre i shkruante poezitë Ademi dhe i ruante diku në raftet e librave , besonte se në një të ardhme do t'i botonte ato, sepse ato ishin pjesë e botës shpirtërore të tij, por edhe brenga që një ditë do u tregonin brezave se sa e vështirë ishte ajo kohë e zymtë me tokë të thatë shpirtërore edhe për krijuesit Kosovarë.

Në të gjitha veprat e këtij autori mbretëron fjala e hapur me rrënjë dashurie e mirësi, por edhe paqëtim. Objekti filozofik si krijues, gërmon nëpër skutat e shpirtit njerëzor, lartëson virtytin, triumfon të mirën ndaj së keqes që shoqëria njerëzore të jetë sa më e pastër në zhvillimin e përparimin e saj. Kështu, autori kapërcen caqet krijuese deri në kufirin e përkthimit të veprës së tij edhe në gjuhën Rumune,nga përkthyesi Baki Ymeri me librin me titullin ''Pema e Bekuar'', që lexuesi Rumun e mirëpriti me dashamirësi. Në lumin e krijimtarisë të autorit Adem Zaplluzha të cilat nuk janë pak, ne zgjodhëm vetëm katër vëllime prej tyre, për të sjellë para lexuesit copëza poezie të shkëputura prej tyre. Nga prurjet e kohëve të fundit të këtyre lumenjve me botimet e botuara, autori ka krijuar liqenin e vet shpirtëror ku kanë mbirë vepra të ndryshme si zambakë të bardhë që japin mesazhe jete. Dhe ja më konkretisht si thotë poeti në poezinë me titull

‘’Kërraba’’:

‘’Një hije flokëbardhë
Mbanë në dorën e djathtë,
Kërrabën e thinjur të shekujve
i mban të gjitha mëkatet njerëzore’’.

Poeti bën dialog me veten, por edhe me të tjerët. Njeriu plaket, por s’duhet të bëjë mëkate. Është një thirrje e brendshme e autori që e mbart fuqishëm nëpërmjet vargut edhe për të tjerët, pra mbarë shoqërisë njerëzore . Dhe vazhdon më tej me poezinë me titull

Asnjë peshk i kaltër

‘’Sa qenkan të thepisura
Brigjet e ikjes….!
Po ashtu edhe ato të ardhjes.
Mbi supet e ditës
Rëndohen mjegullat
Asnjë lehtësim
Pas zbrazjes së shirave’’.

Meraku i poetit shkon deri aty, se mos me anën e fjalës ka bërë mëkat ndaj Lokes së tij që e lindi, i dha nga gjiri i saj sisë, e rriti dhe e edukoi me fjalën e ngrohtë të dashurisë prindërore; sa edhe vetë e kujton me mall kur vetë është prind e me thinja të bardha flokësh mbi kokë. Në poezinë ‘’ Jam i bindur’’ poeti e thotë qartë me vargjet :

‘’vetëm fjala
Ka mundur ta plagosë loken time,
Marrëzisht të pakrehur ‘’
Ose:
‘’Ajo në varfërinë e saj
Asgjë nuk ka pasur,
Përpos fjalës
Dhe flokëve të thinjura të dëborës ‘’.
Apo:
‘’Ky gur i murit të vajit
Askush nuk di,
Se sa vite vajton këtu
E muret qeshin e i përqeshin’’.

(Marrë nga vëllimi ‘**’Si të flasësh me drurët’’**,poezi)
Edhe në librin me titull ‘’Kalorësit e mjegullave’’, poezitë rrjedhin natyrshëm me sentenca origjinale duke përshkruar frymën patriotike e atdhetare të shkrira në vargun letrar, ku estetika, metafora, krahasimi , virtyti , burojnë nga shpirti i autorit të gdhendura në fjalën poetike. Kur lexuesi prek vargun poetik të këtij autori, ndjen vlagun e tokës së vendlindjes, por e brengat që shuhen dalëngadalë gjatë leximit të poezive që kthehen në forcë e burim jete. Këtu qëndron magjia e vargut të këtij poeti, sa poet e atdhetar. Në një poezi thotë konkretisht:

‘’ Ne dinim të pinim ujë guri
I shtrydhë edhe lisat kur kishim uri,
Dhe vrapuam pas kaprojve
Deri sa takoheshim me etjen ‘’.

Ose në poezinë” Zëri im’’:
‘’ Zëri im
Dashuri e lashtë e lisave,
Aq shumë i doje këngët
Sa që ende i kërkon tingujt
Nëpër xhepat e shqyer të luginave ‘’

Ndërsa lexon poezitë diellore me pika shiu në vëllimin e titulluar ‘’Hingëllimat e shiut’’, ndjen klithma patkonjsh për ditën e nesërmen,por shpalosen hapur hartat e atdheut me dhurimin e testamentin nipërve duke e nxjerrë nga ashti i lashtë dardan. Ai përmend kodet tona që nga lashtësia me zjarrin e tingullin e këngës të shkrirë në një trup të vetëm: Dashurinë për Atdheun, për tokën tonë antike. Në njërën poezi , na e përcjell bukur me zë bilbili autori duke derdhur vargje me mesazhe të qarta. Më konkretisht në poezinë
‘’ Toka ime antike’’

‘’Në brendësi të këngëve
Do ta mbështjellim me guaskën e diellit,
Tërë dashurinë për ty
O toka ime antike ‘’.

Por, autori Kosovar Adem Zaplluzha në poezitë e veta, udhëton krenar duke i dhënë tinguj muzikale poezisë të cilat nuk ndalen kurrë, ecin drejt së ardhmes me mesazhin se e nesërmja do jetë më e bukur për shoqërinë tonë shqiptare e më tej. Dhe këtë poeti e kërkon tek fuqia që përcjell fjala, e sidomos fjala e gdhendur poetike. Aty , Ademi ka gjetur vetveten, por ngre edhe progresivitetin e mendimit që duhet të ndërgjegjësohet e gjithë shoqëria

njerëzore., sepse në fund të fundit mendimi i kualifikuar në çdo fushë të shkencës sjell përparim e zhvillim. Ja edhe mesazhi që na jep autori:

‘’Mos është vallë kjo
Dhuratë e Zotit!?
Që rriten sot zambakët
Në majë të shtagës ‘’.

Kur lexon vargun tek poezia me titull’’Koha e gjymtuar’’, të zgjon shumë kujtime dhe i thua vetes pse na ndodh kaq shumë tragjikja?!

‘’ Ai shkëmb
U bënë hije maleve
Zanat këndojnë balada
Gjetheve.

Gurët ecin vertikalisht
Deri te qiejt
Ku zgjohen ninullat’’.
Ose:
‘’Si të flas me drurët’’

‘’Nuk kam më kohë për pendesë,
Çfarë kuptimi ka bukuria
Ne edhe kur flemë’’

Vlerat artistike që kanë vëllimet e autorit Adem Zaplluzha, janë në radhë të parë pjesë e shpirtit të tij,por të gatuar me baltën magjike të vendlindjes, ku pasqyrohet virtyti njerëzor së bashku me dashurinë, me

pemët e gurët që lagen me vesën e shpirtit krijues, me portretizimin e figurave të personazheve nëpërmjet vargut poetik, me fjalën e shkruar që derdhet si mjalti në hojet e botimeve në librat e këtij autori, e që mbeten në memorien e lexuesit tonë. Duke qenë një krijues me prodhimtari e cilësi të lartë. Adem Zaplluzha do të mbijetoj këto dallgë që po donë të na mbysin , e s'na lënë të marrim frymë.

Prof,Dr. Mazllum Baraliu

Preokupimet dhe frymëzimet e poetit Adem Zaplluzha janë të ndryshme dhe të llojllojshme. Ato sillen nga muret e deri te udhëndarjet; nga dhembja e brenga e madhe dhe e vazhdueshme për popullin e tij në varfëri e injorancë e deri te mllefi, dufi dhe kritika kreative dhe inventive, që burojnë si vrushkuj rrekësh pranverore, nga zemra e plasur e tij; nga lufta kundër robërisë e pushtuesve të huaj, të vetmia dhe deri të gëzimi, entuziazmi në liri dhe pastaj përsëri zhgënjimi deri në trishtim e absurd.

Në përmbledhjen me poezi satirike-bajraktarët e vatanit, poeti vënë në pah dhe funksion armët e tij të fuqishme: satirizimin, shpotinë, sarkazmën, ironinë dhe figura e mjete të tjera të sofistikuara, por edhe direkte, në luftë të pamëshirshme ndaj dukurive negative shoqërore dhe individuale, të njeriut të nënqiellit shqiptar, veçmas atij kosovar.

Që në poezinë e parë prirëse, përndryshe edhe tejet domethënëse e simbolike të përmbledhjes ”Dasma e madhe e Moskovit”, Zaplluzha vë në spikamë, sjellje dhe dukuri negative, siç janë:kapadaillëku, serviliteti dhe maskarallëku i personazheve, respektivisht protagonistëve të veprës së tij, të cilët të shumtën simbolizojnë dhe përfaqësojnë në mënyrë më stereotipe, prototipet ekzemplarë, të njeriut tonë sot dhe këtu, si vijon:

‘’Bajraktarët merakosën,
Mu si këndesat e Fatonit
Ndër mejhane na krekosën
Duke i rënë thumbit e patkoit...’’

Poetin tonë e shqetësojnë shumë sjelljet dhe veprimet e disa eksponentëve politikë, të cilët kurdoherë vizion, synim dhe qëllim të fundit e kanë pushtetin politik, fotelet dhe përfitimet që burojnë nga to dhe jo interesin e qytetarit, brengat dhe mënyrat, me të cilat ai ballafaqohet në përditshmërinë e tij të zymtë, si dje si sot; sikur në robëri edhe në "lirinë" aktuale të frymëmarrjes sonë të shenjtë e të pashembullt në historinë e njerëzimit deri më tani.
Poeti vënë në spikamë dhe shpoti sjelljet diletante, injorante dhe tejet hipokrite, të premtuesve politikë të parajsës së premtuar pas proceseve zgjedhore; instrumentalizmi i qytetarëve-zgjedhës, për interesa partikulare dhe më në fund mosrealizimi i paskrupullt i premtimeve të tyre boshe dhe lërja e mëtejme në mjerim popullin...
Poetin e brengosë deri në maksimum sjellja renegate dhe e papërgjegjësi e baballarëve të kombit e të vatanit, veçanërisht, në relacion me tkurrjen e kufijve të atdheut dhe në stigmatizim e sipër me gulç e mllef kulminant , godet me kamxhik të muzave:

''Na i zvogëluat trojet
U bëtë gazi i mëhallës,
Mbeten pa u shitur
Vetëm dimitë e hallës...!''

Poetin tonë të brengosur deri në ekstazë e shqetëson tej mase, nënçmimi deri në abuzim i gjuhës shqipe nga ana e bastarduesve të shumtë, të çdo kundçëshëm e të përditshëm, të cilët sipas autorit të librit përdorin një

gjuhë tallava e të përdalë, siç thotë autori i librit në trajtim.
Duke satirizuar edhe dukuritë dhe rastet e shumta negative të përditshmërisë, poeti proteston kundër sjelljeve të pahijshme, të përdala dhe ekzibicioniste, të disa të rinjve e të rejave tona; madje pa dallim si nga fshati edhe nga qyteti; si të bijtë dhe bijat e farkëtarit, ashtu edhe ato të mësueseve, edukatorëve dhe profesorëve; si kritikët letrarë e shkencor, ashtu edhe analistët politikë edhe ekonomikë etj etj.
I pakënaqur me sjelljet dhe kohët e liga, që ia behën fët e fët, në mesin tonë familjar e shoqëror, duke goditur për vdekje trashëgiminë ekzemplare, madhështore e fisnike dhe tejet pozitive; pastaj krenarinë dhe traditën e ndritshme nacionale, me dhembje e trishtim poeti shpreh dufin e bërë lëmsh në shpirtin e tij artistik, sublim dhe të ndishëm:

‘’Seç na u prish dynjaja
Në këto kohë të liga
Dalin e çmendën vashat
Sikur të ishin shtriga...’’

Dhe në majën aisbergiane të trishtimit, eksponatët e allafrangësisë delirante, shkrimtari ynë i uruar, i quan të përdala dhe laperica, ndërsa artin, muzikën dhe sjelljet e tyre-tallava. Sikleti, zallahia dhe bezdia e kaplojnë katërcipërisht poetin tonë tejet senzitiv e dashamirës të realitetit të shëndoshë, pozitiv dhe perspektiv për njerëzit e tij e të nënqiellit të tij; të protagonistëve të tij; Fanitjën somnambule dhe letargjike, pangopësinë dhe egocentrizmin narcisoidor dhe delirant të protagonistëve te tij përgjithësisht, veçmas gjatë fushatave zgjedhore, të

mundimshme e maratonike të miletit tonë, kur kah do që të lëvizësh e kudo që të shkosh, kryesisht sheh skamje, mjerim dhe varfëri ekstreme të njerëzve të poetit, madje në të gjitha vendbanimet, të cilat me vullnet e përkushtim, por në të njëjtën kohë me zhgënjim të plotë dhe të thellë, zemërthyer e i pakënaqur, njësoj sikur edhe personazhet ekzemplarë-varfanjakë e shpirt mëdhenj të tij e të popullit të tij do të kthehet në vendbanimin e tij, duke gjezdisur e klithur, pikërisht ashtu, sikurse i vetmuari në shkretëtirë:

‘’Kësaj punë si thotë më
Askush marshalla,
Po na shkundën xhepat
Në këtë jetë tallava...!’’

I zhgënjyer deri në mallkim, poeti sërish në librin e tij ekzemplarë, sa shpotitës, humoristik e satirik, aq edhe instruktiv, edukativ e mbresëlënës i vënë në spikamë manipuluesit e vullnetit të qytetarëve tanë dhe premtuesit e rremë politikë apo thënë më mirë, rrëmbyesit e paskrupullt të votave të miletit:

‘’Kush na i mbushi xhepat
Me premtime të thata
Atij i raft zhuga
Mos ju ndaltë lëngata...’

Dhe në fund, duke u preokupuar shumë me temën e mërgimit dhe mërgatës, poeti i lexuesit, rrjedhimisht qytetarit shqiptar, ia jep një porosi sublime dhe vërtetë me vlerë të amshueshëm :

‘’Ndalu bre ti burrë,
Po ta zgjasë vëllazërisht dorën,
Për një kokërr lakër,
Mos e harro Kosovën...!’’

(Mos ia kthe shpinën atdheut fq.22)
Me librin e ri satirikë “Bajraktarët e Vatanit”, poeti Adem Zaplluzha e ka dëshmuar egon e tij krijuese me sukses edhe në një zhanër tjetër krijues, sa të vështirë aq edhe fluid, por gjithsesi me interes të veçantë shoqëror. Preokupimet dhe brengat e autorit transportohen në vargje të mprehta Nondabulkiane, Noliane dhe Koniciane. Autori me këtë vepër e ka dëshmuar afinitetin e tij krijues dhe inventive edhe në humor e satirë, duke dhënë kështu një kontribut të veçantë për letërsinë shqiptare, si dhe një sihariq-dhuratë e këndshme lexuesit shqiptar dhe përgjithësisht.
Ndonjë asimetri shprehëse ose “rrëshqitje në greminë”, në favor të melodramacitetit ekstazor të momenteve shqetësuese të poetit dhe siç do të mund të thoshte ndokush pranisë në masë të ”vulgaritetit”; mungesës së vlerave artistike apo mungesës së elitsisë dhe sublimitetit

artistik, në këtë libër, kurrsesi nuk ia ulë vlerat, përmbajtjen dhe porosinë, po aq sublime dhe me vlerë të pakontestueshme të tij, drejtuar lexuesit tonë të nderuar, sa të etshëm për këso vargje dhe mesazhe, po aq edhe i indinjuar me realitetin e sotëm, të mugët objektiv. Ndonjë sugjerim apo edhe vërejtje, për vargun më konciz e më të disiplinuar, sigurisht që mund të jipet për këtë libër. Mirëpo natyra e satirës e sidomos qëllimi i autorit, që me çdo kusht të arrihet efekti stigmatizues, shpotitës e satirik, madje deri në ironi e sarkazëm, pa mëdyshje se mund të ketë qenë faktor limitues për këtë që u tha më sipër. Sidoqoftë, jam i bindur se ky libër, nga shumë lexues mesatar të nën qiellit shqiptar do të pranohet mirë, do të jetë një lloj eliksiri, që do tu jep atyre më shumë energji, emulacion dhe entuziazëm – më shumë aksion inventiv, veprim kreativ, kritik dhe pjalmonte më shumë kontribut, në eliminimin e të gjitha sjelljeve dhe fenomeneve negative e sociopatologjike, që po na ndodhin në shoqërinë shqiptare, sot dhe tërë ditën. Përndryshe mesazhi artistik, pa semantikë të kuptueshme dhe të drejtpërdrejtë; pa synim, cak e adresë të saktë, nuk mund të iu shërbejë të gjitha shtresave dhe kategorive të lexuesve, përveçse elitave të degazhuara me frymëzime stratosferike. Ndërkaq shkrimi artistik dhe arti përgjithësisht ka për detyrë përtoksimin dhe saktësimin milimetrik të porosive të tij. Përndryshe, përfundimisht arti që nuk kuptohet nga sa më shumë
kategori lexuesish, sigurisht nuk i shërben aktualitetit as ardhmërisë.
Ndaj si i tillë, ai edhe nuk është art i mirëfilltë, por vetëm "art pour art"-izëm...!

NËN UTURIMËN E MJEGULLAVE-POETI ME VIZION MEDITATIV

Nezir Prokshi

Adem Zaplluzha, autori i mbi 95 veprave letrare, kryesisht në poezi, por edhe në prozën poetike – artistike si edhe me disa vëllime me satira të mrekullueshme, tashmë e ka formuar individualitetin e vet letrar, duke hyrë në letërsi si poet i vlerave të mirëfilltaartistike e letrare, ndër më të angazhuarit në këtë fund e fillim shekulli në gjithë gjeografinë shqiptare. Në vëllimin poetik "Për kë po bie moj kambanë" të ndarë në tre cikle që fillon me poezinë "Zogjtë e zier" e për të përfunduar me poezinë e ciklit të tretë " Kanë filluar të lehin netët"autori si çdo brez që vjen në poezi më ndjeshmërinë, vetëdijen, psikologjinë, botëkuptimet në raport me bashkëkohësinë e vet do të sjell edhe traditën dhe historinë. Të gjitha këto veçori do të mishërohen tek gjuha e poezisë dhe fuqia e ritmit që krijojnë, pastaj veçorit e konstruktit origjinal të poetit.

Adem Zaplluzha edhe në librin me poezi që e kemi në dorë " Për kë po bie moj kambanë" vazhdon të mbetet një poet me vizion meditativ i lidhur ngushtë më përmasën sociale, bashkëkohore me të cilën
projekton nervin e tij të shqetësuar qytetar përmes një rebelimi metaforik. Në vargun e tij nuk vërehen mite të zbrazëta etnike dhe etike, marrëdhënie të klasifikuara në role midis temave tabu morale e shoqërore që shpie në orientim të mënjanimit të dinjitetit janë të qëndrueshme ku edhe përthyhet përjetimi dhe përvoja poetike e tij. Një nder armët me të forta të poezisë së Adem Zaplluzhës është dhe mbetet vargu i drejtpërdrejtë i hapur me një intonacion që anon nga neutraliteti me një prirje tashmë të dëshmuar aforistike – sentenciale që vjen prej një përvoje të trajtuar kujdesshëm me karakteristika të poezisë meditative.
Vargu i Ademit nuk është i rënduar me figuracione dhe piruet, por është një varg plot ritëm dhe ligjërim i shëndetshëm intim që ndërtohet nëpërmjet një narracioni poetik i mbështetur në frymën e një post moderne të theksuar. Në këtë rast harmonia e vargut përcillet më një ritëm funksional dhe te drejtpërdrejt: / Miqtë e mi/ Unë jam pranë jush/ Sa herë që doni mund të më prekni/ nga poezia "Zogjtë e zier" Sepse nuk jam i tejdukshëm, por as i përhumbur, i tretur si një flluskë sapuni, thotë poeti.
Po të kundrohet në aspektin tematike poezia e Zaplluzhës shoqërohet me motive e refleksione filozofike për të na shpien deri tek një ekzistencializëm që nuk dëmton gjuhën estetike të poezisë. Libri "Për kë po bie moj kambanë" prodhon edhe një frymë të oponencës kombëtare shumë të nevojshme për

refleksionet poetike këtu e kudo në mjedisin tonë dhe gjithsesi të konkurueshëm me vlerat me të mira në letërsinë tonë. Mjafton të shkëpusim vetëm disa vargje nga poezia "Një nënë dhe një përmendore". Se atdheu ende është plotë dhembje e dëshpërim poeti do të dëshmoj edhe në këto vargje:

''Nuk mund të marr frymë
Kam dhembje shpirti,
Shikimet e topitura
Po shkasin nëpër njomësinë
E tejdukshme të bronzit.

Një nënë me një tufë lule mështekne
Qëndron e mpirë,
S'i lëvizin as qerpikët e erës
Vetëm shpirti i saj i madh
Ka një gjëmë të brendshme''.
...
Dhe për ta përfunduar mund të konstatojmë
Se poezitë e këtij vëllimi janë shkruar në një gjendje ankthi për t'u kapur fortë pas dhe përditshmërisë së saj. Kjo u jep poezive karakter universal sepse siç do të vërehet nga leximi i poezive në përmbajtjen e tyre ka gjendje psikologjike të gjithë anshëm që lidhet me përjetime të fateve të një bashkësie e jo të një fati individual. Kjo më së miri pasqyrohet në poezinë "E mjegullave të brymta" ku "Njeriu me paterica" qenësisht i kafshon konservat të cilat hedhen në dhe "Dhëmbët artificial" mbesin nëpër qoshet e kutive... Kjo i jep poezisë se

A. Zaplluzhës një përmasë tjetër, jo të karakterit të një përballje në sfidën e madhe të luftës për liri, por
B. për një luftë për një bashkim në solidaritet për një barabarësi për jetë më të mirë.

Dhe krejt në fund mendoj se kjo poezi po i largohet suksesshëm hermetizmit "maniak" të një pjese të poezisë që po botohet në Kosovë e pse jo edhe në gjithë gjeografinë shqiptare. Ky vëllim me poezi do të jetë i mirëpritur në aulat e fjalës artistike shqipe në Kosovë e kudo.

SOT KOHA NDRYSHON SHIUN E SJELL VARGU POETIK

Dibram Fylli

Shi bije edhe në qytetet tjera të vendit tim, por shiu në qytetin tim ka një kuptim të veçantë! Pas tij mund të shihej ylberi, fëmijët ylberor, njerëz fytyrëqeshur e shpirtmirë. Pastaj paraqitet piktori me brushën e tij duke i dhënë shpirt edhe gurit edhe drurit, edhe jetës

…Nuk di se çfarë kuptimi kanë gjërat që nuk ekzistojnë
Piktori i japë shpirt gurit…

Duke e lexuar veprën poetike të poetit Adem Zaplluzha, “Shi në qytetin tim”, është e pamundur që të mos mendosh për shumëçka që nuk ke menduar kurrë më parë, vërtetë është një libër jetësor me aq shprehje poetike, të cilat rrallë i hasim nëpër vepra poetike, sidomos në këtë shekull kur poezia moderne ka përfshi mendjet e shumë poetëve.

''Në fund të tregimit,
i harrojmë parathëniet e ngjyrave…''

Duke e analizuar librin poetik të Adem Zaplluzhës "Shi në qytetin tim", hasim në shprehjet bindëse të krijimtarisë artistike të cilat pa mëdyshje tërheqin vëmendjen e studiuesve të letërsisë dhe të kritikëve. Të vargu i poezisë së Zaplluzhës fshihet magjia e shpirtit të njeriut. Ai hap pas hapi kërkon bardhësi, jetë, shpirt...

''Nga bardhësia e zambakëve,
mundohemi ta shtrydhim bardhësinë…''

Libri përmbledh një varg poezish të shkruara me gjuhën e zemrës, me dashuri por dhe me një shqetësim që ideon nga shpirti i autorit, jo vetëm kur ai ulet në tavolinën e punës, për të bërë vargun e tij thuajse magjik, por edhe kur udhëton nëpër qytet i shoqëruar me idetë e tij prej krijuesi të mbi 105 veprave poetike e letrare...

Kur jemi të nevrikosur,
ecim nëpër vetminë e rrugëve… ''

Poeti Adem Zaplluzha paraqitet ashpërsisht në poezitë e tij, sidomos kur gdhend vargjet duke paraqitur një mjegull që edhe sheh çdo gjë edhe nuk sheh asgjë nga asgjëja.
Por së fundmi është Zaplluzha ai që revoltohet në ndërtimin e vargut poetik, duke sjellë para lexuesit revoltën e tij, të adresuar në vendin e duhur, në mes vargjeve, rreshtash e tregimesh në jo më pak se të 104 botimeve të këtij poeti.

''Mjegullat sillen vërdallë
Si vagabondët pa adresë…''

POEZIA SI TESTAMENT GJAKU E LIRIE

Sejdi Berisha, poet, publicist

(Adem Zaplluzha: **“Kur era teshtinë”-** poezi, botoi: Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”Kastriot-2014)

Edhe nëse shkruan e krijon, ndijimi poetik asnjëherë nuk mund të vi i thatë, pa lëng mendjeje, lumturie por edhe dhembjeje, pa ditarin e rrugëtimit jetësor e historik. Kur është kështu, atëherë çdo varg ka mesazhin dhe peshën e mendimit si sublimë e zërit të krijuesit, e zërit poetik. Në këtë aspekt, mund të veçohet edhe mendimi për librin më të ri me poezi, “Kur era teshtinë”, të autorit, Adem Zaplluzha.

Nëse mësojmë e lexojmë për biografinë e këtij poeti, atëherë, në shikim të parë, sikur na krijohet përshtypja se ai “nxiton” për të “radhitur” sa më shumë tituj veprash të tij, dhe kështu, automatikisht zvetënon mendimin për aq shumë libra. Deri me tash, A. Zaplluzha ka botuar 106 tituj, që janë një bagazh interesant krijues me tema nga

më të ndryshmet, të cilat nuk janë gjë tjetër veçse pjesë e jetës së autorit, pjesë pasqyre e periudhave kohore dhe historike, të cilat ndrisin rubikonin dhe pikturën e jetës të sajuar ashtu siç di të këndojë poeti.
Mirëpo, me librin "Kur era teshtin", Adem Zaplluzha,, edhe më shumë e sforcon mendimin poetik, peshën dhe rëndësinë e vargut, i cili, nganjëherë, pothuaj se shndërrohet në dokument, i cili pastaj provokon për të biseduar dhe elaboruar lexuesi me secilin varg me secilën poezi. Thënë shkurt, "Kur era teshtinë" është pasqyrë e rrugëtimit nëpër kohë e periudha, të cilat, tani autorin e bezdisin dhe i sjellin kujtime me peshën e mallit, të dhembjes por edhe të mendimit hidhërak.

Në këtë kontekst, vargjet dhe poezitë e sajuara në tri njësi ciklike: *"Ishte një tjetër lloj bryme", "Kur teshtinë era" dhe "Të kujt janë këto duar"*, janë tërësia, nëse mund të thuhet, e një rebelimi mbase shekullor, i cili shndërrohet në pelegrinazh aq karakteristik dhe me shumë ngjarje, me shumë drithërima, me shumë të arritura dhe të paarritura, të cilat poeti dëshiron t'i vë në një vrap të detyrimit filozofik, por edhe të ndërgjegjësimit, urtisë, të forcimit, kujtimit dhe të shprushjes së rrëfimit historik, në mënyrë që çdo gjë të merr formën njerëzore, duke u ndriçuar përjetësisht, ashtu siç mendon poeti se është më së miri. Kjo, ngase, në ecjen me dritë, me plagë, me vendosmëri, me trimëri por edhe me etjen e shpirtit për lirinë e njeriut dhe të kësaj toke, poeti na ligjëron, sepse, të gjitha këto edhe ai vetë i ka bartur në shpirt e zemër, por edhe secili njeri. Për këtë arsye, ai, që në poezinë e parë tërë këtë ngarkesë mbase edhe shpirtërore, e vë në binarë të rrugëtimit poetik, që e konsideron si rrugë të cilën duhet trasuar e

ndërtuar mirë e sinqertë: *"Sonte duhet të pezullohen mëkatet/Nuk kemi kohë/Të ecim nëpër mjegull/Eja ulu këtu/Kjo sofër ka bukë për çdo kë"*. Pra, poeti, këtë libër na ofron si sofër, në të cilën mund të hasësh, prekësh e të shijosh të gjitha bereqetet dhe të mirat e jetës, por edhe trakullimat e saj, që janë dëshmi e kohërave, janë thesar e qëndresë me nderë e me besë, të njeriut të këtij nënqielli.

Po ashtu, në këtë përmbledhje poezish, sikur insistohet që lexuesit t'i servohet edhe përjetimi poetik, edhe pesha e çdo rrjedhe, të cilën rrjedhë e rëndojnë por edhe figurativisht e stolisin mjegullat nga më të ndryshmet, duke bërë përpjekje që të krijojë pamje e peizazhe nga kohërat ndryshme, që kanë lënë gjurmë për t'i kujtuar e kënduar edhe poeti, dhe kështu për t'i sjellë tek opinioni si madhështi kohërash të përplasur, të zgjuar e të fjetur, të rehatuar e të çmenduar, gjëra që bashkë autorit ia bëjnë me vlerë vargun, gjithnjë duke e begatuar atë me "kalldrëmet" dhe shikimet jo rrallë të zymta për çdo gjë e për gjithçka.

Andaj, vargu i poetit, ndoshta edhe pa vetëdijen e tij, shpeshherë shndërrohet në melankoli, që ai thotë se është e vjetër, por mund të jetë edhe e re, e cila luhatët e pedatet nëpër stinët e vitit, nëpër gjelbërimin dhe ngjyrën lules të vjeshtës. Kjo nuk është gjë tjetër, veçse kallëzim poetik i furtunave që jetën e njeriut e bëjnë lapidar, mbase edhe spirancë për të qëndruar vertikalisht dhe i papërkulur dot.

Autorit, nuk është që i përvidhet dhembja që ka peshën dhe tharmin e moshës, por ai vetë ka atë dallgën për të thënë e treguar se jeta ecën dhe është edhe e pamëshirshme: *"Ishte një tjetër lloj bryme/Pak e bardhë/*

E më shumë e murrme/ Hingëllonte si shiu në binarët e trenit/Ikën udhëtarët e mëngjesit/Askush nuk mbeti/ Në këtë stacion të vetmisë”. Mirëpo, gjithnjë është i kujdesshëm që të këndojë lirshëm për ta “shfryer” mllefin e mendjes e të shpirtit, por edhe për dëshmuar përgjegjësinë e përjetësisë te të gjitha rrjedhave, që ndonjëherë rrinë apo mund të qëndrojnë kacavjerrë në pritjet për zbardhjen e historisë. Për këtë arsye, ai na sjell ndërmend shumë gjëra, të cilat duan koment dhe shqyrtim të drejtë, sepse, në të kundërtën: “*Mbi pergamenën e kujtesës/Pikojnë shirat”*.

Në këtë kontest, autori, jo pa qëllim, na sjellë ndërmend peshën e lashtësisë, duke e begatuar atë me shumë kujtime komentuese në vetë vargëzim, por edhe me qortimin se rrjedhat kohore nuk janë flluska sapuni, që sa mbyllë e çel sytë tretën pa ditur se ku. Përkundrazi. Ato janë përgjegjësi, e cila gjithnjë troket me detyrim tek arsyeja dhe mendja e secilit prej nesh. Diçka të ngjashme, autori sikur thekshëm vë në spikamë tek poezia “Te kroi i Kalasë Ilire”: “*Pak nga pak/Ky qytet/ Nëpër shkallët e trishtimit/Po zbret/ Buzë Lumëbardhit ku dehen myshqet/Fëmijët lozin një lojë arkaike/Te Kroi i Kalasë Ilire/Kanë dalë vashat/I mbushin shtambat/Me ujin e bardhë/Që ngrinë lotin në sy/Çunat si pa sherr gjuajnë me fjalë/ Xhelozinë e erës”*.

Përveç kësaj, nganjëherë, krijuesi di të hy aq thellë në botën e vetë poetike, saqë, ose nuk di të dalë nga ajo, apo edhe e “humb” rrugën, dhe gjatë kësaj ecjeje sjellë edhe frymë të re të këndimit, apo një shkrirje të vetvetes në tërë atë ngarkesën shpirtërore që ka, dhe, po ashtu, edhe në atë etjen aq të madhe që ka për shtruarjen e vargut, për këndimin, krejt sikur duke pasur frikën se një ditë do

të ikën fjalët, do të zvetënohet kujtimi, e atëherë mund të "çmendet" fjala e pathënë. E, të nesërmen mund të takohen eklipset e fjalëve!

Mirëpo, tek ky libër, tek "Kur era teshtinë", hasim dhe bindemi në universin poetik dhe intelektual të poetit, i cili gjatë tërë këndimit është tejet i ndërgjegjshëm që të mos harrojë edhe më të voglin përjetim apo ndijim poetik që ai ka dëshirë të na ofrojë edhe si formulë jete, por edhe si copë leximi pedagogjik për kompletimin e intelektit, për të ditur, për ta kapur dhe për ta komentuar çdo këndim poetik. Në këtë aspekt, sikur na bëhet, se autori krijon, apo dëshiron të ndërtojë obelisk, në të cilin, përmes vargjeve përjetësohet, komentohet dhe lartësohet njeriu, toka, dheu e atdheu. Kjo veçanti, nuk ndodhë vetëm për hir të vetëdijesimit, por edhe për të ngelur përherë zgjuar për atë që është e shenjtë tek secili njeri. Ndoshta, këtij konstatimi i puthitet edhe këndimi poetik i autorit tek poezia "Guri i stralltë qohej peshë": *"Sa herë që ndizeshin mallet/Shndërroheshim/ Në flakadan lirie/E nga gurët e atdheut/ Ndërtonim kala/…Më pastaj/ Sërish ishim po ata burra/Që i rinovonim/ Shpirtrat e shkëmbinjve/Pa i grithur fytyrat/Pa asnjë pikë loti/ I vazhdonim ecjet/Nëpër trupin e një shekulli/I cili çdoherë/I përngjante njerkut shpirtzi"!*

Poeti, duke prekur vetë çdo fjalë, duke peshuar çdo mendim, shpeshherë përballet me vetminë, të cilës di dhe ka forcë t'i përgjigjet, edhe pse nganjëherë, krejt normal, si të gjithë, përmallohet, i dhemb diçka: *"Herë qaj si zogjtë e pikëlluar/E herë/ Fluturoj hapësirave/Deri sa zhbëhen meteorët me bisht/Në zhgjëndrrën e heshtjes"*...

Duke lexuar tutje këtë vepër, vërejmë se krijuesi, i cili e di peshën e jetës dhe të rrugëtimit, shpeshherë përmes

vargjeve i frikohet lashtësisë dhe harresës, duke vënë në spikamë mykun, si simbol të harresës dhe i mosinteresimit, të rrënojave dhe gjurmëve të saj, si dëshmi e peshës së robërisë mbase edhe të shtypjeve jo vetëm fizike. Të gjitha këto, në këtë vepër duken si në pasqyrë, e cila reflekton edhe anën e prapme të saj, respektivisht, të kohërave të shkuara, dhe u druan atyre që do vijnë*:" Muret e mykura/ Me qindra vite s'marrin frymë/Tavani nga lagështia i qullur/ Me formë arkaike/...Këtu/ Në këtë vetmi/Çdo gjë nga heshtja rri e mbërthyer/ Ku vetëm myshqet e murrme/ I zë gjumë i trishtuar"!*

Dhe, poeti, gjatë vargëzimit, sikur shndërrohet edhe në pelegrin, i cili kërkon diçka edhe përtej kohe, përtej, fshehtësive dhe mjegullave, që e kanë shoqëruar njeriun e tij, mbase edhe vetë atë. Andaj, këtë, pothuaj fenomen, e hasim në çdo varg e poezi si zë apo këshillë, krejt njësoj. Andaj, pikërisht për këtë arsye, ky libër ka peshën e vështrimit dhe të analizës jo vetëm të vargut, jo vetëm të këndimit, jo vetëm të thellësive të metaforave dhe të mesazheve si pjesë të rëndomta të poezisë.

Në anën tjetër, autorin e vërejmë se si nëpër vargje, ndoshta kushtuar vetvetes, përbirohet si për birë gjilpëre për të rrëfyer për jetën, e cila asnjëherë nuk i ngjanë drejtëzës, por gjithnjë një vije lakadredh dhe me hije gjembash. Edhe kjo formë këndimit në "Kur era teshtinë", dëshmon për zmadhimin e bebëzave të syrit për të depërtuar në fshehtësitë e shikimit, sepse, pranë njeriut, ka ngjarë e mund të ngjajë që të mbyllen portat që shpijnë drejtë dritës dhe lumturisë. Për këtë arsye, ndoshta edhe ditën *"një flutur e kaltër/I ndizte qirinjtë e natës"...!*

Në këtë formë, pothuaj se frymojnë të gjitha apo shumë poezi në këtë libër, por ka edhe të tilla që begatohen me tharmin e mallit dhe të dhembjes për motet dhe vitet e shkuara mbase edhe të kohës së rinisë, të cilat, patjetër se kanë lënë gjurmë edhe tek autori, Adem Zaplluzha. Ka disa poezi të tjera, të cilat autori i shtron aq fuqishëm që ua dedikon më të dashurve, por që, ato reflektojnë më thellë dhe kanë mesazh e kuptim shumëdimensional, siç është poezia "Je e vetmja shpresë", në të cilën therë malli e dhembja për nënën. Por, ajo që vërshon për dashurinë ndaj nënës si madhështi, vërshon edhe për atdheun, si shenjtëri: *"...Nëno moj/Gjaku dhe fryma e atdheut tim/Ti e mbajte me xhelozi/Sa fortë e shtrëngove/ Në duart e tua të brishta/ Zanafillën e jetës"!* Është një mesazh, i cili, po të analizohej mirë e mirë, nga ai do të dilte një roman ose i çuditshëm, ose, padyshim roman me peshën e historisë.

Por, poetin e ngufasin edhe shumë gjëra e dukuri të tjera, jo vetëm të një kohe të caktuar. Duke pasur parasysh, rëndësinë e dëshmisë historike dhe të respektit ndaj vendlindjes, atdheut, mbase edhe të kombit, poeti në këtë vepër na shpie "telasheve" për të analizuar edhe shumë gjëra, të cilat populli ynë moti i ka si "bashkish" pikërisht edhe nga vetvetja. Këtë këndim karakteristik e hasim tek poezia "Në Atdheun tim": *"...Pakëz më ndryshe është qielli/I atdheut tim/Atje zogjtë kanë tjetër emër/Të vdekurit/ Respektohen më shumë se të gjallët"...!*

Dhe, ndoshta si sublimë e kësaj analize libri, del se autori, Adem Zaplluzha, gjerdanit të 106 veprave të tij, po ia shton edhe një vepër, pra librin "Kur era teshtinë", që kësaj radhe, ndoshta duke e identifikuar më fuqishëm

edhe poezinë si testament gjaku. Prandaj, kujtoj se ky shkrim e ka peshën e vetë kur themi se, autori na bën me dije se i tërë ky bagazh krijimtarie reflekton mëvetësinë e krijuesit, kur ligjëron: "*Në*
ëndrrën time/Zgjohem fillikat vetëm/Kur zgjohem/ Thellësisht e ndjej kafshimin e ëndrrës/Po që se dalë nga ëndrra ime/Do marr me vete/Kronikat e të gjitha netëve/Dhe si një deve karvanësh pafund/ Do kërkoj azil/Në shpirtin e dehur të oazës/Ngase s'dua të zgjohem më/Fillikat vetëm"…?!

Dhe, krejt në fund. Libri "Kur era teshtinë", padyshim se begaton edhe opusin krijues letrar të Adem Zaplluzhës, por edhe vlerat letrare kombëtare.

PËR VEPRËN ,,**DËNESTE BASHKE ME ERËN”** ADEM ZAPLLUZHA

Ma,sc, Izet Shala

(Njëqind libra poetik, dhjetëmijë poezi dhe mbi njëqindmijë vargje, Adem Zaplluzha)

Autori Adem Zaplluzha me vëllimin më të ri poetik,, “Dëneste bashke me erën”, na afron vlerën dhe peshën e vargut që mbartë në brendi mesazhin e së vërtetës dhe mashtrimit duke demantuar ilozionistët, rrahagjoksët e së djeshmes për të sotmen dhe të nesërmen.

Po kush më mire se poeti ndjen realitetin dhe notën e mashtrimit sot, për të dhënë qëndrueshmërinë , faktin e fjalës dhe moralin e saj, deklamojmë vargjet në poezinë ,, Atje në fund të lagjes”, Një copë mjegull bënë një hije, e cila i përngjanë hijes së arrës së egër, ku plakat e lagjes i krehin flokët e thinjura të erës”. Edhe sapo fillojnë sekondat e mbarimi i minutave të fundit poeti nuk ndalet pa trajtuar ngjarjet e ditës qe shkaktojnë ndjenjat e këqija të njerëzve apo edhe të mirat e tyre.

Monstrumi poetiko-portretiv që sot luan tri seritë e ditës me fatin e Kosovës si : Të Foshnjës që kërkon ngrohtësinë e nënës, të rinjve që kërkojnë këshillën dhe dijen universitare dhe të moshuarve që dhanë djersën për të djeshmen , të sotmen dhe të nesërmen, poeti nuk ngurron por vazhdon të jep nga vetja plotësimin e projektit se si do të dukej Kosova sot dhe nesër.

Prandaj, sfida e tij është qe me dhimbje të vogla të operoj fenomenologjinë apo dukurinë e meritokracisë dhe thurjes së odeve për të bëmat ndaj atdheut, dje, që sot kush pos dorës sime duhet të mbaj Flamurin e nacionalizmit.

Shtrohet Pyetja sot mos vallë Kosova dhe shqiptarët kanë nevojë për bijtë e shekullit të ri të Migjenit apo Bijtë e askjut të Rexhep Qosjës?

Kjo, nëse mund të quhet hipoteza qendrore mes analogjisë dhe antagonistes që poeti e sforcon te poezia ,, Mu ata gur mermeri”,,Mbi një pllakë të kuqe mermeri, Lëri shenjat fillestare të erës, Pastaj shikoje Kosovën, përkulu te varret dhe nisu miku im, jeto këtu, nëse do mi shijua, pemët që rriten në syrin e lirisë”. këtu vargjet kumbojnë që njerëzit, qe rrinë përskaj rrugës na kanë përcjellë, duke i folur njeri - tjetrit ne vesh këto vargje shprehin se si edhe tash analfabete lozin me trupin , ndjenjën e njeriut, kurse poeti dhe metafora recensioniste shprehet, Do të vij një kohë, dhe do të ngreh një monument lirie, ne hisen e plotë të gjeografisë kombëtare , vetëm për heronjtë e mi, as kush nuk do të ketë guxim , të shkruaj a flas për ta si unë.

Në të dyja variantet, poeti fuqizon moralin i cili sot, sikur duket është liruar për nga vlera dhe shkon drejt degradimit të shoqërisë shqiptare.

Mendimi poetik divergjent, nuk kalon në sentimentalizëm, as defetizëm dhe as në pesimizmin e poetit, por mesazhi troket ndërgjegjshëm sot te shoqëria që po e ndërtojmë, prandaj kjo porosi sforcohet edhe më tej me veprimet direkte te vargjet që dirigjon keqas, ofron moral tt mykur, gjen vegza të molisura dhe të prishura ne unin e stërkequr Ja si qajmë ne pas vdekjes.,, Ky boshllëk, me fjalamani krye oxhaqeve,nuk njeh fytyrën e vet, ju thash as pushteti nuk është pushtet". Mjaft i kemi share intelektualet , sa ishin gjallë, e sa here vdesin, i nderojmë, po i çmendim me fjalë të mira te varret, Mjaft më, heshtni, u qoftë turp, të gjithë kanë vdekur prej nesh. Këtu edhe poet te tjerë kanë analogjinë e situatave të vargut të Zaplluzhës. Poeti Adem Zaplluzha, shquhet si një nga depërtuesit e thellë të mendimit filozofik të etnosit tonë dhe kjo vërtetohet me vargjet e cituar më lartë, se është e vërtetë kjo filozofi e mbrapsht dëshmohet shumë nëse mundem të shprehem në mënyrë figurative a po përmes alegorisë, te poezia,, Një stuhi nate, me vargjet As ky shall nuk me duhet, kur e ve në
qafë, më duket se atdheut po ia zë frymën, Atdheu s'duron të lidhet, faqe 64.
Humbjen e etikës dhe degradimin e vlerave të mirëfillta. Këtë bindje time e sforcon vargu me metaforën me interesant të libri ,, Dëneste bashkë me erën". Shekuj me radhë lindjet i patëm nën hijet e lisave, edhe vdekjet tona u përngjajnë drurëve, Ecim maleve me një krenari epike, dhe për nga pamja u përngjanim gjyshërve…

E kam të mësuar se poeti apo poetet nuk kanë fund, prandaj edhe poeti Zaplluzha nuk ndalon me këtë vepër,

por vazhdon sikur vazhdon populli rrugëtimin drejt majës për të parë se çfarë fshihet pas asaj.

‘’Sonte dua të luftoj me
çdo kë, nëse lypset edhe me perënditë’’.

Riza Greiçevci

ADEM ZAPLLUZHA:
”**DRURI I PIKËLLUAR”,**POEZI, 2014



Të thellohesh në leximin e veprimtarisë prodhimtare të poetike të njeriut me mbi një gjysmë shekulli me penë në dorë, duke ngarendur gjithandej kopshtit të jetës, vërtet e ke tepër zor që të mos bësh sytë katër, të kthehesh me fytyrë e zemër nga njeriu, fjala e tij, të bëmat, kënaqësitë dhe zallahitë e tij, të kthehesh, herë në kohë fëmijërie, herë-herë në ecejaket e kohës me plot të panjohura, të njohësh e të mësosh se si shkrihet çdo qelizë e poetit në gjirmën e prushimës të artit poetik, kjo do të thotë se ti,o kreshtar dhe dashamirë i poezisë je mrekulluarduke shëtitur me hare nëpër Parnasin plot me bukuri letrare.

Vepra e radhës me poezi “Druri i pikëlluar” i poetit më prodhimtar i këtij brezi, mëton të imponohet si motër siameze

e gjithë atyre veprave të tjera që botoi deri me tash, mirëpo, ja që kjo që kemi para vetes në sy vështrim, për shumëçka qëndron më e avancuar.

Sapo e hap lexuesi librin haset në ciklin e prapë të kësaj vepre, të cilit i prin poezia “Me lërë të qaj sonte”, e cila sikur arrin të bashkojë në një trup të gjitha takimet e poetit me shokun e brezit, të cilit i thotë:

‘’Sonte mund të luftoj me tërë botën
Por jo edhe me zemrën time!’’.

Sepse, zemra e poetit kërcen si ketër në kraharorin e tij, prandaj
prapë i rikujton shokut:

‘’Të kujtohet sa shumë
Ecëm mbrëmë,
Rrugët ishin të gjata
I përngjanin dhembjes sonë
Ti ishe vetëm një lule
Në varfërinë e stinës...’’

Takimi mbi valsin e vargjeve i dy shokëve, gjithsesi është i mallëngjyeshëm, i tujgur me emocione, mirëpo, poeti prapë vargjet poetike janë ato, me të cilat i rrëfehet për gjithçka shokut të tij, e pse, jo, edhe për gjendjen momentale të vetë poetit:

‘’Jam shndërruar në gur varri
Askush nuk më kupton
As të vdekurit nuk më duan
Si të eci nëpër këtë sterrë
Si të qëndroj
Pranë kësaj ofshame!’’.

Ajo që vargjet poetike të kësaj vepre i bën lëngështa,
të buta, të kapshme, interesante, dinamike, me vokacion të ngrehur, është rrëfimi i butë dhe real i poetit, me vargje poetike, jo edhe aq në tepri për biografinë e sendeve, rrethit të jetës, gjërave që përbëjnë spektrin e gjallimit, mirëpo, zoti Ademi depërton si ngjalë në thellësi të meditimeve dhe imagjinatës gjithnjë reale, sa për të gatuar brumin e fëmijërisë, të djalërisë, të burrërisë, kështu për të bërë një biografi të jetës së vet. Jeta është e bukur, e ëmbël,
e çmuar, por, herë-herë, shklasë poetin, kurse ky menjëherë reagon dhe tregon gjendjen e tij, por jo edhe dorëzimin:

''Thashë edhe më parë
Më ikën miqtë
S'ka mbetur më njeri
Në këtë fotografi
Vetëm disa silueta si gur varri
Rrinë ngulur nëpër sinorët e kujtesës''.

Me vargje poeti mishërohet me qiellin, me yjet, me detet, me lumenjtë, me zogjtë, me bjeshkët, shkrepat, por, Toka për poetin është djepi, gjaku, gjuha, identiteti, dheu, prandaj vjershërimi për Tokën vërtet zgjon kureshtje:

''Kjo tokë e mirë
Sa herë që e vura kokën mbi të,
Mi shëroi plagët e hidhura
Edhe në dimrat më të acarta
Pati mirësinë të mi ngrohi damarët
Herë e pata nënë e herë babë.

Asnjëherë nuk ngjau të ofshante
Dhembjet ishin të huaja për të;
Toka ime ngjizur me legjenda
Toka ime,
Djepi i stralltë i gjyshërve të mi!''.

Në shumë prej vargjeve të kësaj vepre dominon përshkrimi
aq i hollë, aq i vëmendshëm, aq dinamik, sa frymëzimi sa vjen e merr gradacion të ngritur. Vërtet janë të bukura, muzikale, por që në vetvete fshehin atë sekretin e poetit për shumë çka e zemrës, vargjet me të cilat poeti përligj metodën diskriptive, por jo aq e thjeshtë, banale, por moderne me mjete e figura të zgjedhura shprehëse dhe me një vokacion të avancuar. Përvoja në lërimin e poezisë e bën të veten, e lartëson poetin, e bën të këndshëm, të dashur dhe më të afrueshëm, siç ndodh në vargjet:

''Më ndihmoni ju lutem
Kam nevojë
Kam shumë nevojë sonte ta ndjej
Aromën e barit të atdheut
Atë aromë
Me të cilën zuri shtat fëmijëria ime!''.

Vargjet e Zaplluzhës nuk ngarendin pas përrallave, legjendave, kornizave imagjinare e të mbufatura me fjalë e shprehje banale, por, nga se poeti di të shkruaj poezi, atëherë ai me vargje poetike depërton në secilën pore të jetës, në secilin cep të vendit të tij, edhe në vendlindje, në Prizrenin magjik, me të cilin rast, shkruan:

‘’Në behar si ujëvarë zbresin zambakët
Gocat dashurojnë pa mend
Lumëbardhi si dhëndër që s’plaket
Çdo stinë është e bukur në Prizren!’’.

Vepra më e re e Zaplluzhës “Druri i pikëlluar”, vërtet ngjitet edhe më lartë drejt kurorës së artit të poezisë, duke dëshmuar pa tjetër se me poezi u morën, merren dhe do të merren brezat edhe pas nesh, shumëdashamirë të saj, por sikur shpesh po harrojmë se të shkruash poezi do të thotë poeti të shkrihet në secilin varg, në secilën rimë, në secilën metaforë, si ai qiri i Naimit, vetëm e vetëm që “të shkelë këmba e saj!”. E unë, poetit Adem Zaplluzha , i uroj shëndet dhe të mos i plaket edhe shumë stinë pena, me të cilën e pasuroi aq shumë letërsinë.

AMËZA E PËRVOJËS POETIKE
(Në vend të recensionit)

Prend Buzhala

Në shënimet bibliografike të poetit Adem Zaplluzha, shënohet se ky vëllim është i 108-ti me radhë! E çka mund të thotë lexuesi i rëndomtë, lexuesi i vlerësimit kritik, përballë një veprimtarie kaq të vëllimshme! Le të mësohemi të lexojmë e vlerësojmë: mund të shkruash një libër poetik e të ketë vlerë, si "Vargjet e lira" të Migjenit. Por ka plot autorë që kanë shkruar vetëm një vëllim peotik, e, megjithatë, nuk kanë bërë emër në letrat shqipe. Ka dhe autorë që kanë shkruar mbi njëqind vëllime (si Rifat Kukaj dhe Odhise Grillo) dhe që të dytë kanë krijuar emrat kulmorë në letërsinë për fëmijë. Ka dhe të tjerë autorë që arrijnë numrin treshifror të vëllimeve të botuara letrare, dhe të mos arrijnë cilësinë që kërkohet.

1.

Megjithatë, Adem Zaplluzha, në krahasim me disa autorë të ngjashëm, ka një fat tjetër krijues. Në radhë të parë, ka përvojën e gjatë krijuese. Nëse rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë, e ka botuar në revistën "Pionieri" të Prishtinës më 1957; nëse librin e parë poetik "Puthje ia botoi "Rilindja" e Prishtinës më 1974, do të kalojnë, mandej, edhe më shumë se njëzet vjet deri te botimi i librit të dytë, diku më 1995 ("Ecjet e viteve të mëdha", poezi, "Jeta e Re", Prishtinë 1995), kur

shprishen rrathët e ndalimeve shtetërore pushtuese serbe mbi botimin e librave shqip. Deri në vitin 2009 ka arritur të botojë 14 tituj veprash, kurse shpërthimet e këtyre botimeve ndodhin prej vitit 2012 e deri këtë vit, më 2014! Për kaq kohë, ai botoi edhe 94 vëllime! Poeti, në këtë moshë të shtyrë krijuese, është i pandalshëm. Po e përjeton renesancën e tij shpërthyese krijuese.

Vëllimi i fundit "Mbi shpirtin e erës pagane" dëshmon disa fakte: jo vetëm sasinë e këtyre botimeve, por edhe amëzat poetike të përvojës së tij të gjatë krijuese, nga njëra anë, si dhe lirizmin e tij karakteristik, refleksiv intim, tematizues dhe metaforizues, nga ana tjetër. Zëri lirik, Uni poetik, e ka parasysh se e tërë bota përreth tij është motivi i tij i jashtëm, kurse tensionet midis të jashtmes e të brendshmes shfaqen në relacionet Unë/Bota, Unë/Jeta, Unë/Ekzistimi...

Dikur Aristoteli i urtë shkruante katarzën, për ndikimin e fjalës artistike në ndjenjat dhe në psikikën e njeriut, një si spastrim i posaçëm të emocioneve që provokon a nxit tragjedia. Edhe fjala artistike e poezisë lirike, përbën një moment tejet të rëndësishëm të identifikimit emocional, që ndikon pozitivisht në këtë drejtim. Së këndejmi, kështu le ta kuptojmë edhe këtë dëshirë të zjarrtët poetit

për të shkruar së më shumë poezi, për ta shquar sa më shumë nevojën e shkrimit si transformim të brendshëm shpirtëror, për ta mbajtur në këmbë duke pasuruar shpirtërisht qenien njerëzore, qoftë edhe si ngushëllim fjalësh të bukura, kundruall situatave të ethshme psiko-sociale. Brengat ekzistenciale, humbjet e shumta në jetë, vetmia moderne, frika e ankthi (“*Kur qante vjeshta/ E ngarkuar me ankthe*”) - janë tema e motove të shpeshta edhe të artit poetik dhe në to e gjen veten edhe lexuesi i kësaj kohe (“*Në shpirtin tim të ngrirë/ Po bie nga pak shi i mykur” këndon poeti tek poezia “Pas një ëndrre fjalësh*”). Të komunikosh me sa më shumë qenie të tilla poetikisht, me artin e thënies së bukur, të ndjesh njësoj si të tjerët, a nuk do të thotë kjo se lexuesi i tillë e njeh vetveten në përvojat,emocionet, observimet e krijuesit? E pra, libri është urë emocionale e shpirtërore me lexuesin vetmitar, bashkëkohor, jo thjesht vetëm për shkak të halleve të përbashkëta, por edhe për nxitjen e së bukurës e të përjetimit estetik të së bukurës në art e në jetë. Prandaj Fjala i bashkon e lidh njerëzit... dhe e arrin efektin e saj spastrues, prej katarze... nuk është e habitshme, prandaj, pse Adem Zaplluzha e thur atuopoetikën dhe poetikën e tillë nëpër vargje. Dhe jo vetëm tek titujt e disa poezive, por edhe në disa tituj veprash poetike,, të botuara më parë, *fjala* qëndron në thjerrëzën e nocionit të kënduar lirik. Madje, cikli ballor i librit mban titullin “*Posa gjej një fjalë*”. Fjala merr barrë të kuintesencës poetike, të vetë-komentimit, të metapoezisë:

''Posa gjej një fjalë
Shaloj trenin e mendimeve,
Dhe dal ngadalë në udhë
Si petalet e trëndafilit
Merr krah vargu i bardhë''.

Poetizimi i fjalës është thelbi i kësaj lirike. Hyrja e kësaj poezie, i ngjet mitit të muzës a grishjes së saj, posi te poetët tanë të traditës (De Rada thërret pëllumbin e Anakreontit, Naimi thërret engjëllin e urtësisë, Fishta zanat mitike shqiptare...), kurse poeti thërret fjalën, kujtesën, muzat... kalin pegasian që e befasonte gjetjet e kësaj aventure poetike të shkrimit të librave ("*Më pret befasia/ Një kalë i bardh/ Vrapon nëpër furtunën e zezë*"). Kryeneçësia e vargut kërkon gjakimin e brendshëm, shpirtëror, por edhe fashitjen, zbutjen, thjesht shkarkimin prej katarze. Fjala ka plasaritjet e saj të brendshme, ajo në poezi shfaqet për të emërtuar fenomene vrastare të jetës, prandaj ekzistojnë edhe "*fjalë plumbash*", por fjala ka edhe thellësitë e saj ("*Dëgjohej nga thellësia e një fjale*"). Ndodh që komunikimi të mos arrijë të vërë dialog me lexuesin e kjo përbën gjendjen më të rëndë të krijuesit *("Humbësit po kalojnë të humbur rrugëve*
Sillen vërdallë... Askush nuk ua vuri veshin/ Fjalëve të mia"). Ndodh që kujtesa e rëndë historike të zgjohet me pezëm, pikërisht për shembjet e identitetit tonë, temë që del e shpeshtë te këto poezi:

''Shoqja ime dhe unë
Pamë në Shqipëri duke vdekur një pemë
Rrënjët e ullirit në kalanë e Krujës''.

Prandaj, edhe ndërtimi i komunikimit me të tjerët, me empatinë e emocioneve, me bashkëndjesinë, përbën vlerën tjetër të këtij arti

‘’Zëri yt si zëri i erës më vjen në ëndërr(...)
Si fjala e harruar rilind
Nga thellësia e tokës (...)
Unë do të të pres diku në vetëdijen time (...)
Bëhem erë te një muzikë
E të presë në zhgjëndrrën time’’.

Zgjimi ndodh në momentet e situatave ekstreme ekzistenciale, kur gjakojmë t’i gjejmë fjalët më të goditura, të depërtojmë në zemrën e qenies njerëzore, për ta spikatur ndjesinë e dashurisë, mendimin pozitiv, transofmimin shpirtëror (“Ashti im/ Do të konvertohet në dashuri”); poeti gjakon, gjithsesi, të depërtoj dhe në thelbin e gjërave, realiteteve, dilemave, çështjeve, dhimbjeve...

2. Shumësia kuptimore/ vlera polisemike e figurës së erës

Në dy librat e fundit shfaqet edhe simbolika e erës, e cila, semantikisht, popullon titujt e disa poezive (si "Mbi shpirtin e erës pagane", "Zërat e shthurura të erës", "Ajo vetë u shndërrua në erë", "Trajta asnjanëse e erës") por u jep ngjyrim stilistik e semantik edhe shumë vargjeve e shumë poezive të tjera. Ajo ka perspektiva të shumta këndimi të raporteve në mes njeriut dhe realitetit, folësit lirik dhe situatave emocionale, metaforizimeve të këtyre situatave dhe shënjimit të botës së ideve:

''Këtu çdo gjë po vdes ngadalë
Si shpirti im i vrarë në erë
(...)
Që ta ngushëlloj trishtimin e erës
Si këmbët e erës po lëkundet dheu
Po dridhen drurët
(...)

Askush nuk i besonte fjalëve të erës

(...)
Dal në rrugë dhe vrapoj me drurët
Vrapoj deri sa e zë etja e erës''.

Era herë është kapricioze, e pathyeshme, e ndryshueshme, e herë me praninë e saj të pastër, amorfe, të padukshme, pa pamje.

''Metaforat kanë hequr dorë
Nga kashelashat
Trajta asnjanëse e erës
Bisedon me boçat e këputura të pishave''.

Madje, përpjekja krijuese këmbëngul ta zë atë në elementin e saj të vërtetë, në bukurinë e shfaqjes së saj, në kuptimet e logjikën e saj të pakapshme. Ajo nuk ka një imazh statik, pikërisht për shkak se elementi i saj është kaotik, shumë drejtimesh, herë erë e mirë e herë e keqe, e shthurur apo përkëdhelëse, me tipare të çrregullta, sado që autori përpiqet ta zë imazhin e saj, së paku një çast ndalimi të saj:

''Mbi shpirtin e erës pagane
Galopuan vetëtimat e ndezura''.

ose, kur dëshiron ta shquajë idenë e situatave labirinte historike:

''Këto trajta të erës
Që duken si sy katrore në pasqyrë
Para njëqind vjetëve
Ishin të rrumbullakëta si rruzaret e gjyshes''.

Era është e lashtë, e virgjër, pagane. nga amorfe pothuajse dhe hyjnore. Së këndejmi, kuptimet saj mund të konkretizohen sipas gjendjeve a situatave intime, po edhe atyre të jashtme, sipas kontekstit të ngjarjeve natyrore, por edhe historike (LESZEK MAŁCZAK), do të thotë, kanë edhe kuptimin e tyre sacrum, edhe kuptimin profanum. A nuk është era ajo që vë në lëvizje forcat e natyrës, madje dhe vetë qenien e njeriut dhe... për të mos thënë se e vë në lëvizje botën hyjnore, autori na e thotë me eufemizëm se kjo është një erë pagane që vë në lëvizje botën. Nga kjo perspektivë këndimi, kundrohet edhe e kaluara jonë, me theqafje e ngritje, me fatkeqësi të shumta e me fuqinë energjike të rezistimit... me kaq shumë trajta e forma ende të padefinuara:

''Në portretin e erës
I shoh asociacionet e lotëve
(...)
Shpirti i kalbur i mesjetës
Sërish zuri të vrapoj si era ''.
(...)

‘’I vështrojë thellësitë e syve të erës
Pas pasqyrës së vjetër
Fshihen tufanet e shekujve’’.

E pra, kjo figurë ngërthen ambivalencën e saj, larushinë e saj kuptimore, situatën kontekstuale. Ajo ka forcë destruktive (stuhi e furtunë që përlan e shkatërron, që sjell edhe vdekje, dhe ka shenjën e saj të mërzisë e të situatës së luhatshme) e shoqëruar shpesh e shpesh nga shiu, si figurë paralele; ka frymë freskuese, që sjell freski mendjeje e lehtësim trupi, kënaqësi përjetimi, shpesh dhe me funksion krijues e shpëtimtar. Edhe te vargjet e Zaplluzhës, kund e kund, ajo shënjon karakterin kalimtar të jetës, përkohshmërinë, boshllëkun, topitjen mendore e shpirtërore, tutje edhe shuarjen, zhdukjen, ndryshueshmërinë, rilindjen e brendshme, po edhe çmendurinë, nganjëherë frymëzimin dhe dhurimin e frymës hyjnore.

Ndodh mu ashtu si personifikimet e saj që ndodhin për “katër erërat” tek versetet e biblike apo tek vargjet homerike (shih “*A Dictionary of Literary Symbols*” nga *Michael Ferber, Second edition, Cambridge University Press, 2007*), ku konfliktet, tensionet, luftërat, përcillen me stuhi, e erëra, kurse engjëj e forca të mbinatyrshme vijnë në këtë botë me krahët e erës. Erërat e forta dhe stuhitë, shpesh simbolizojnë emocionet e vrullshme dhe botën e pasioneve. Së këndejmi, ndonjë varg, a titull poezie, na kujton ndonjë film a vepër me tematikë të ngjashme (për shembull filmin”Fluturoi bashkë me erën”), ashtu sikundër t’i kujton edhe erërat si bashkëpjesëmarrëse në legjendat a mitet antike të

frytnimit, lindjes, plleshmërisë etj, kurse te Zaplluzha marrin karakter arkaizues, një si zgjim i kodeve arketipore të shpirtit etnik.

3. Shkrimi si akt i shenjtë krijimi

Shkrimi përbën aktin e shenjtë të krijimit, mu atëherë kur poeti kërkon që fjalët e shqipes, me anë të alkimisë krijuese, që të gjitha, të
"*shndërrohen në poezi*". Nëse shkrimtarët kanë qenë e janë gjithnjë ata lexuesit idealë e idealistë, të etur për dije e me besim për ta ndryshuar jetën, atëherë hapja e librit përbën një akt të shenjtë. E krijuesit asgjë më shumë nuk kërkojnë se sa që të respektohet ky akt i shenjtë.

“NËPËR GJYMTYRËT E MJEGULLAVE” TË ADEM ZAPLLUZHËS

(esse)

Përparim Hysi

Të fundit po e them që në fillim: kam njohur një Poet të një shkalle të epërme. E kam fjalën për Poetin Adem Zaplluzha. Jo vetëm e kam njohur, por jam befasuar. Kjo befasi imja është shumë domethënëse. Shkruaj dhe vet poezi, po jam i një "lloji" tjetër: unë kurrë nuk heq dorë nga poezia me rimë dhe kjo ndodh për një arsye të fortë: nuk jam i zoti të ligjëroj në poezi me vargje të lira apo të bardha. Sado që jam i një "mizure" tjetër (ata që nuk më njohin mos më marrin për ndonjë poet kushedi?!!!), e çoj gojën vesh më vesh kur lexoj poetë që të çudisin me poezitë që s'kanë rimë. Po si mos qeshja kur lexoja Majakovskin me " Re me pantallona". Në vizionin tim më dukej sikur Poeti e kish kapur renë prej veshësh dhe po ia "vishte" pantallonat me zor. Dhe ashtu si oreksi që vjen duke ngrënë, zura t 'i doja poetë të tillë. Kjo dashuri imja kish filluar që me Migjenin e Qemal

Stafën apo dhe ndonjë poet tjetër, por thashë dikur-dikur se si Janis Ricos zor se do këndonte dikush më bukur. Këtë mendim e pata për "Mëhallat e botës". Mirëpo, dalëngadalë, poezia me rimë sikur po asfiksohej dhe po dilnin poetë që, me të vërtetë,që të vinin në mendime. Në letërsinë botërore kjo kish ndodhur me kohë, por vërshimi i bukur filloi dhe në letërsinë shqiptare. As pretendoj që njihja Martin Camën (ky as njihej në letërsinë tonë të realizmit socialist), por kur ndodhi "hopi" i bukur letrar me Kadarenë,Agollin, Arapin, Shehun e të tjerë, natyrisht zura ta doja edhe këtë lloj poezie: por duhet theksuar që Kadareja dhe Arapi xhëku e "thyen" atë poezinë me rimë.

Njeriu plaket duke nxënë,- thotë populli. Dhe unë lexoja dhe ngazëllehesha dhe me këta poetë që "dolën nga rruga e Zotit". Po si ishe e mundur që mos ngazëllehesh
nga poetë që e rritën cilësisht poezinë e tyre. Tek i lexoja, më dukej se po ua "zhvishja pantallonat reve" të Majakovskit, se kisha parë Moikom Zeqon që i "vishte syze dielli Meduzës së dashuruar"; shihja Dhimitër Pojanakun (theksoj poetin Dhimitër Pojanaku!!!) që i zinte "xhindët prej veshi dhe i bënte të kërcenin polka"; shihja princin e lirikave (mbret i lirikës në vizionin tim është Lasgushi), bohemin e bukur, Frederik Reshpja që më bënte gati të nisesha fluturim dhe t'ia puthja ballin e vuajtur tek këndonte: "... qante dreri në korie dhe lotët bëheshin shi" apo "... po bien ëndrrat e pyjeve një nga një... ose "... mjegulla e hollë ndan dritares sime qan me lot shiu. Poeti tjetër i bukur, Faslli Haliti këndonte për pranverën: " sythi shkrin dëborën në zjarrin e lules... Poezia e Faslliut të bënte për

vete me mesazhet që jepte: "Njerëz" Ruani njerëzit nga njerëzit! Apo dhe më bukur: " Turmat i ngrenë/ populli ngrihet vet!. Epo daullet bien për ata që kanë veshë dhe jo për ata që veshët i kanë zënë me dyllë. Kjo lloj poezie me kaq mesazhe, pak e nga pak, sikur po merrte domenin edhe në letërsinë tonë. P.sh. Petraq Risto "hipën në një karuselë, që për bosht ka një ylber". Fatmir Teziu "ëndrrat i qep në çarçaf" apo"ishte koha që kafenë për qokë e pinte Atdheu". Në një përmbledhje, me pak fjalë, kjo lloj poezie po lëvrohet çdo ditë e më shumë në mbarë letërsinë shqiptare.

* * *

Çdo njeri që njeh sadopak letërsinë apo historinë e letërsisë shqiptare, është i ndërgjegjshëm që letërsia me vargje të lira apo të bardha, pothuajse, tërësisht është lëvruar në Kosovë. Në Kosovë ka një aradhë poetësh që shkruajnë një letërsi të tillë ku mesazhet, shpesh, fshihen mes kodeve të autorëve që i krijonin këto poezi. Që shkruanin një poezi të tillë, kuptohet që ishin të shtrënguar nga kondicioni historik i kohës. Natyrisht, nuk është objekt i kësaj esseje vështrimi dhe analiza e një poezie të tillë, por kjo "esse" modeste ime është për të sjellë para jush një Poet që ka bërë emër me poezi të tilla cilësore. Cilësore nga ana artistike dhe, ca më shumë, me mesazhet që përcjell për lexuesit. E kam fjalën për Poetin Adem Zaplluzha! Nuk pretendoj se e njoh mirëfilli poezinë e tij. Por, në iu futa kësaj pune, e bëra veç nga një befasim. U futa në "Google" dhe, kur lexova, se ç'ka bërë ai gjatë gjithë jetës, jo vetëm që u inspirova, por ndjeva që t'më skuqeshin faqet prej turpit. Pashë që, Adem Zaplluzha, qenka sa unë: 71-vjeç!

71-vjeç dhe ka botuar deri tani 110 (po e shkruaj me shkrim:njëqind e dhjetë) libra. Më gjeni gjëkund të ngjashmin?! Me aq sa kam lexuar dhe di unë: një bum të tillë ka pasur Lope de Vega në Spanjë! Që të bindeni se shifra që citoj nuk është shpikja ime, sa për një "mbrojtje të vogël nga ç'shkruaj", po ju citoj atë që ka shkruar, Profesor Murat Gecaj: "... Adem Zaplluzha më dhuroi 37 (tridhjetë e shtatë libra!!!). Këto shifra janë shumë kokëforte: janë si një fshat që duket,që nuk donë kallauz. Ka dhe diçka tjetër: libri që ka botuar, së fundi, "Nëpër gjymtyrët e mjegullave" është shkruar brenda muajit mars- prill 2014.

* * *

"Nëpër gjymtyrët e mjegullave" është një libër me gati 90 poezi. Të gjitha shkruar me një gjuhë artistike që ta mbushë trupin me mornica. Figurat artistike (dominojnë metaforat deri hiperbolike) mënd hedhin valle. Ato jo vetëm dominojnë gjithë poezitë por të përdorur me dorë mjeshtri (Poeti ka një poezi të kultivuar që zor se tretet nga çdo stomak lexuesish) dhe ajo që duhet theksuar është fakti shumë domethënës: asnjëherë, në asnjë prej poezive, Poeti nuk harron të jap mesazhin. Nuk shkruan "mbill e mos korr", por me një qëllim të caktuar. Unë, për fat të keq, nuk e kam librin e tij, por s'kam si mos ndalem në vargje" ...babai im urrente njerëzit që binin në dy gjunjë/... dhe vdiq "vertikalisht"./ ose, kur flet për masakrat në Kosovë" 7 vetë varrosen në një metër katror" Dhe mund të vazhdoj e mund të vazhdoj me citime pa fund. Unë ju siguroj vetëm për një gjë: në do kini fat e ta lexoni librin e fundit të Poetit Adem Zaplluzha, kini për t'u bindur se keni njohur me një Poet që, në se nuk e ka marrë deri tani dafinën e lavdisë

, kjo ka ndodhur se ende kritika letrare po bën gjumin e saj letargjik. Kritika, në një farë mënyre, për mua është si ai farmacisti i mirë,që korrigjon doktorin në lëshimin e një recete. Pse fle gjumë kritika, ka dhe inflacion vlerash. Ka ardhur koha që një Poet si Adem Zaplluzha të renditet në Fronin e bukur të
Poetëve cilësorë të Shqipes. Jo se ka shkruar kaq shumë, pose ka shkruar dhe shkruan aq bukur. Se poezia e tij ka art. Se poezia e tij ka mesazhe. Se poezia e tij është cilësore.
Hierarkia e vlerave ka nevojë për t'u rishikuar. Të marrë Cezari atë që i takon. E quaj të vonuar, shumë të vonuar që të lihet në "hije" (vetëm me një çmim karriere e një përkthim në rumanishte) një poet i tillë. Ai e ka bërë dhe vazhdon ta bëj aq bukur punën e tij krijuese dhe ka përse ta mbaj kokën lart. Unë (s'jam vetëm unë) pres që Poeti Adem Zaplluzha të marrë atë që meriton.

“ZJARRI I MALLIT TIM”, ZJARRI QË NUK SHUHET ASNJËHERË

Fritz Radovani, Melbourn

U jam mirënjohës për besimin, kështu, thonë të gjithë, ndërsa, unë edhe u kënaqa!

Të gjithë ata që shkruejnë poezi, thonë se vargjet shpërthejnë nga zemra...

Ndërsa, ata, që i lexojnë mundohen me i kapërdij për me ushqye Shpirtin e vet.

Edhe unë kështu veprova! Nuk jam kritik i artit letrar, Ju kërkoj ndjesë për mangësitë!

Vargjet Tua janë një lavë e ngrohtë që të duket sikur shpërthen nga një zemër e ftohtë,

po që merr me vete edhe landë, lisa e gur e zbret tue rroposë cilindo që guxon me pa me thikë në dorë, që mendon me coptue kjoftë edhe një lesker të Atdheut Tand.

Mbi të gjitha mendoj unë, asht poezia Zjarri i Mallit tim:

ZJARRI I MALLIT TIM

Nuk do të ndalemi askund,
E vetmja mënyrë se si të jetojmë vertikalisht
Është lëvizja,
Deri te ëndrra që kurrë nuk e pamë.

Në jemi për çdo ditë
Në rrugëtim e sipër nëpër një trajektore,
Ku asnjëherë nuk na mundon vetmia,
E kemi fshehur mallin tonë nëpër xhepa.

Lisat në mëhallë
Na përngjajnë si asnjëherë më parë,
Me varret e vjetra të gjyshërve,
Që na kanë mbetur peng nga fëmijëria...

Më kuptoni, ky rrugëtim i jonë
Nuk ka filluar sot
As, s'ka të ndalur asnjëherë,
Si fëmijë, i kemi shlyer të gjitha pengesat.

Kudo që të shkojmë, në trastën tonë
Kemi një grusht dhe nga atdheu i largët,
Kur na përvëlon malli i përqafojmë lisat,
Dhe çmallemi si kërthi në prehrin e nënës!
Kur na përvëlon malli i përqafojmë lisat,...
Shumë domethënëse, për atë që jeton!

Në faqe 44,
strofa për Shpirtin e urrejtjes, asht edhe aktuale që po zharitë gjithshka!

Faqe 43,

Frynë një erë nëpër zgavrat
E lisave të shkulur.
Ti as vet nuk di se s'jeton mes njerëzve!

Të duket sikur ndigjon fshikullimën e erës nëpër zgavra, e rreshti i fundit plotëson idenë.
Fq. 36,

Pash më pash po i bie deteve të humbura... Një realitet...që po jetojmë.

Fq. 27.

Poezia Lumi, në dukje ke përshtypjen se e ke lexue dikund...Po, në fakt asht shumë origjinale dhe dishka që lidhet me gjendjen e Autorit, të cilit i shlyhen kujtimet.
A nuk i ngjet kujtdo që asht i zhytun ndër mendime të pafund?!

Në faqe 20,
Poezia: Kush mbërrin i pari në dasmë, paraqet dy element interesant; zogun e fluturën...që njenit do ti takojë gjerdani...
Autori endet në ajër, det, pyje, shkretina e male të mbulueme me borë...Andrron dhe shpesh zgjohet i trembun nga realiteti i Atdheut vet...
Ka raste që lodhet...Bie në njëfarë pesimizmi...Po çohet shpejtë në kambë:

Fq. 77,

MBI **LIBRIN E SHENJTË TË FISHTËS**

Përpara meje
Ecin rrugët pa kurrfarë trajte
Era në dorën e saj të thyer
Si për inati
E mbanë kafkën time të djegur

Përpara meje
Atje te shelgjishtet e pikëlluara
Me tërë dhembjen e ditës
Po qan
Një zog i zi prej argjile
Ku Fishta
Si rruzaret e fatit i rendit këngët

Kur bie shi në këto anë
Çmendurish bymehen lumenjtë
lagjet i harrojnë këpucët
Dhe vrapojnë këmbëzbathur
Vrapojnë deri te kisha
Sepse një i harruar mali
Ia ka nis këngës" Ave Maria"

Këndojnë edhe përrenjtë
Piskamat e trishtuara dëgjohen
Si në kullën e Vraninës
S'pushojnë së kënduar
As shtojzovallet

Thonë se është koha të zbresin yjet
Dhe të këndojnë
Mbi librin e shenjtë të Fishtës

Po atë këngë
Që i këndonte Gjergji i jonë
Kur si një daulle shqyhej Atdheu!

Dhe, libri mbyllet:

***
Të shkosh në Atdhe
Është si të kesh
Një biletë për në Parajsë...

Gjithshkafja....Sigurisht: “No koment”!

Autorit i uroj jetë të gjatë në edukimin e Rinisë Shqiptare, detyra ma e madhe Atdhetare!
Përshëndetje prej zemret me shumë respekt

VJERSHËRIMET E BUZËQESHJEVE TË HUMBURA

Remzi Limani



Kur mendja jonë merr rrugë nëpër udhët me shkronja, na bëhet i pashmangshëm kapërcimi nëpër shtegun e hapur të krijimtarisë letrare të poetit tonë. Adem Zaplluzha. Ky krijues, me një opus të gjerë e të lakmuar në fushën e poezisë moderne, me nostalgji dhe pezëm, nëpërmjet metaforës së qartë poetike na shfleton narracionin figurativ nëpër të cilin kalojnë fatet e njeriut nëpër kohë dhe hapësira të ndryshme. Duke e kërkuar arsyen e humbur, nëpër poezitë e tij, poeti Zaplluzha, deri në kubenë e qiellit ngre zërin e këngës së vrarë, për ta kuptuar dhe hetuar dhembjen e njeriut, i cili sikur mbeti i ndryrë në katrorin e mugëtirës së pafrymë, e një kohej njerkë, kohë e cila na bëhet e shurdhër në të dy guaskat e veshëve të prishur dhe nuk e dëgjojnë dot vajin e këngës ngushëlluese për njeriun dhe buzëqeshjen e tij të humbur. Pra, në librin “Mes telave gjembor”, të ndarë në tri cikle, poeti në mes ëndrrash, me nostalgji i këndon

fëmijërisë së humbur */Shtëpia e jonë kurrë nuk ishte e zbrazët/Më kujtohet kurna mungonin lodrat/Por ajo mbushej me dashuri/.* Pastaj, në dy ciklet tjera na jep një pasqyrim lucid të një shtrese sociale njerëzish me halle…, të nëpërkëmbur dhe të anashkaluar nga syri dhe mendja e shoqërisë në fron. Pra, vjershërimet e veshura me petkun e dhimbjes u kushtohen njerëzve të tulatur nga frika e mendjes së tyre dhe vetmia e pashpirt, të cilëve, pa dëshirën e tyre, gjithandej u loz mendja e shkretë…!

/Ajo i ngërmohej edhe mushkonjave/Që ia bezdisninmendjen e humbur/

Këtu, pra, poeti në fjalë, thotë qartazi, se dhembja e kësaj shtrese shoqërore është dhembja jonë. Ne jemi ata dhe ata janë pasqyrimi ynë. Në këtë kontekst, karshi ndërgjegjes sonë të humbur, poeti vishet me dhembjen e njerëzve të cilët i takojnë vetvetes sonë. Prandaj, me të drejtë dhe me pezëm, poeti ynë derdhë ofshamën e kohës ngufatësh , që nuk na jep frymën e duhur për t`i kapërcyer dhimbjet dhe regëtimat e kohës së zbehur, e cila na është bërë dritë e pakët – ndoshta më e pakët se një llambë vajguri…!

Në këtë përmbledhje fjalësh e ofshamash nëpër kohë, autori i librit “Mes telave gjembor” bën strukturimin e duhur të fjalëve dhe ndërtimin e poezisë e vendos mbi bazat e qëndrueshmërisë faktike siç e përshkruan autori në poezinë e tij */Njëri që i kishte kaluar të tetëdhjetat/Kujtimet i mbantenë dorën e djathtë/Një qeskë najloni e tejdukshme/Mbushur me flokë të thinjura/Mbase donte t`idjeg të gjitha trishtimet/.* Pra, nga dhembja e njerëzve të anashkaluar, poeti nxjerrë në

pah mungesën e ndërgjegjes sonë, humanizmit dhe njerëzillëkun që nuk e kemi karshi të tjerëve. Andaj, kjo lloj poezie, na vjen edhe si vërejtje shoqërore, që më në fund, vishemi me njerëzoren, të kandisemi dhe të veprojmë në përputhje me normat dhe ligjet mbi të drejtat e njeriut.

Si shumë njerëz, të cilët patën fat të ecën qirithi nëpër kohë..., edhe poetin Zaplluzha, koha e veshi me petkun e një moshë të kaluar mbi shtatëdhjetë kalendarë të zhubrosur dhe të harruar nëpër mote. Mirëpo, mosha e tij kalendarike nuk vërehej as në sy e as në

shtrëngim duarsh. Pra, këtë vitalitet fizik e mendorë, këtë "pangopësi"

për të shkruar e shkruar..., Zaplluzha sikur e fiton nga fjalët e gatuara dhe gjumin e shtrirë mbi shtratin e mbushur me shkronja shqipe dhe ëndrra fjalësh... Ai nuk ndalon së shkruari as për një frymë njeriu. Koha e Adem Zaplluzhës vazhdon me rrjedhën e lumit dhe të fjalës shqipe. Kur dita, paksa e lodhur në kocka kërrusej, pahetueshëm hëna kacavirrej në dritaren dhomës së tij. Tani, po ashtu pahetueshëm; dita mbuzej me natën dhe takohen në udhëkryqin e fjalëve ende të pa thëna...

Prof. dr. Eshrefi Ymeri
Tiranë, 29 maj 2014

Në vend të parathënies

I dashur miku im fort i nderuar dhe i respektuar Adem,
Mua më gëzon shpirti dhe më kënaqet zemra për prodhimtarinë e begatë në krijimtarinë tuaj poetike. Ju jeni një gurrë e pashtershme në universin e poezisë shqipe. Unë mendoj se mbarë vendi, që nga nxënësit e shkollës që sapo kanë filluar ta shijon ëmbëlsinë e tingujve tuaj poetikë, e deri te moshat madhore të popullit shqiptar, duhet t'ju jenë mirënjohës në jetë të jetëve për kënaqësinë estetike që u jepni me magjinë e poezisë suaj aq origjinale. Në poezinë tuaj ndihet pulsi i zemrave shqiptare që dashurojnë virtytin dhe përbuzin mëkatin, vesin. Ju jeni një lektor i talentuar, i cili, nga tribuna e artit poetik, i drejtoheni auditorit mbarë shqiptar me gjuhën e një krijuesi të pakrahasueshëm, që të mahnit me magjinë e vargëzimit.

Kam bindjen e patundur se ju, për mbarë trojet tona etnike, përfaqësoni në vetvete oazën mitike të

krijimtarisë poetike. Aq i bindur jam në këtë që po them, saqë edhe në bashkëbisedimin e lirshëm me këdo nga bashkëkombasit tuaj, ju e keni më kollaj të ligjëroni me gjuhën e poezisë sesa me gjuhën e prozës.
Ju uroj nga zemra jetë të gjatë dhe, po ashtu, vazhdimin e pandërprerë të krijimtarisë suaj të begatë.
Me shumë respekt për ju dhe për zonjën Sulltana.
Letra e dytë
I dashur miku im i çmuar,
Ju falënderoj nga zemra për fjalët tuaja prej poeti të magjishëm. Unë kam shprehur për ju atë që meritoni. Madje kam thënë shumë pak për krijimtarinë tuaj që është aq tërheqëse deri në mahnitje. Fjala juaj poetike është një bukuroshe hijerëndë që ecën serbes nëpër mbarë trojet tona etnike. Ajo të rrëmben me elegancën e mjeteve artistike, të cilat ju i qëmtoni me aq sqimë nga të gjitha shtresat e leksikut të shqipes sonë gjëmimtare. Mos u trishtoni, i dashur miku im, nga të gjithë ata që sulmojnë artin tuaj poetik. Madje duhet të jeni krenar kur ju sulmojnë, se, me sulmet e tyre, dashakeqët tuaj zbulojnë tërthorazi
pafuqinë e tyre mjerane për t'u përballur me dallgët kreshtëbardha të detit shpërthimtar mes stuhive tuaja poetike. Ju lutem, miku im i shtrenjtë, të sillni ndër mend një aforizëm të artë të shkrimtarit të madh gjerman Tomas Man, i cili thotë:

"Ne arti na mrekullon kur di të flasë me gjuhën e jetës. Veçse jeta na mrekullon edhe më shumë, kur ajo, pa e kuptuar as vetë, na flet me gjuhën e artit të vërtetë".

Poezia juaj e mrekullon lexuesin se ajo i flet pikërisht me gjuhën e jetës dhe vetë jeta juaj është e mishëruar në gjuhën e artit të vërtetë poetik.

Hyjnia ju ka dhuruar me zemërgjerësi talentin poetik, duke ju hipur majë Pegazit mitologjik. Prandaj, i dashur miku im i çmuar, vazhdojeni misionin hyjnor që ju ka caktuar Fuqia Mbiqiellore , në mënyrë që vëllimet poetike të arrijnë shifrën 200.

PËR NJË "BRENGË", QË MBETET E PASHËRUAR?!

(Libri i 110-të poetik i Adem Zaplluzhës, **"Ajo nuk erdhisonte!…")**

Prof.Murat Gecaj
publicist e studiues-Tiranë

1.

Qëkur u ula të shkruaja këto radhë për librin me poezi *"Ajo nuk erdhi sonte!..."*, që është i 110-ti në radhën e botimeve të autorit Adem Zaplluzha, ndërmend kisha edhe kolegun e mikun tim, pak kohë më parë emigrant në Amerikë dhe tani me banim në Tiranë, poetin "zemërzjarr", P.Hysi, me emrin e shkurtuar, "Papi". Lexuesit e interesuar të disa rrjeteve sociale, por dhe të shtypit të shkruar, kanë vërejtur se ai publikon, rregullisht, poezi të frymëzuara për dashurinë, këtë ndjenjë të bukur mbarënjerëzore. Atë nuk e pengon as mosha që t'i thurë vargje të bukur leshverdhës ose

syzezës, të cilën e kujton nga vitet e rinisë ose që tani e sheh "me zili", kur i kalon pranë.
Çuditërisht, ai Papi, na paska edhe një *"sivëlla"* të tij (dhe që nuk e di a njihen bashkë), pra në qytetin e Prizrenit dhe shumë kilometra larg nga kryeqyteti ynë, me emrin Adem Zaplluzha. Nuk do t'ua publikoj këtu "sekretin" e viteve të jetës së tyre, por miqësisht e them për ata, se kanë një të përbashkët: Të dy, janë *"ashikë të pandreqshëm"!?*
Me kërkesën miqësore të Ademit, megjithëse nuk jam poet, po bëj një shënim të shkurtër për librin e tij më të ri. E kam thënë edhe në një shkrim timin të mëparshëm dhe i përmbahem atij përsëri, se ky koleg e mik është autor shumë prodhimtar, pra konkurron pa u trembur, ndërmjet poetëve e shkrimtarëve të tjerë, për ta marrë titullin "kampion", në këtë drejtim. Ja, ndër të tjera, duke i hedhur një sy listës së librave të botuar me emrin e tij, vetëm në gjysmën e parë të vitit 2014, numri i tyre arrin shifrën 24.

2.
Nuk po zgjatem as ta "lodhi" më tej lexuesin, por gjej rastin ta dëshmoj këtë gjë me 65 poezitë e vëllimit më të ri të A. Zaplluzhës. Janë gjithsejtë tre cikle, të cilët lidhen organikisht me njëri -tjetrin dhe, në tërësi, e pasqyrojnë shpirtin e trazuar e të "dalldisur" të një të moshuari, i marrë "peng" nga femrat "e lazdruara". Autori mbetet tërë kohën në pritje, që ta shohë, të takojë e të çmallet sadopak me njeriun, që ia ka rrëmbyer zemrën dhe, me dëshpërim, për atë thotë: *"Ajo nuk erdhisonte!..."*. Por nuk është vetëm ky varg, që shprehë trishtimin e tij dhe dëshirën e mbetur në letër. Ja, në një

poezi tjetër: *"Asgjë nuk më ka mbetur,/ përpos vetmisë sime.../ Cila grua më mori në qafë,/ asnjë puthje e egër/ nuk ndiejnë buzët e fishkura të erës"("Mos ik sonte!").*
Aq i madh është hapi i dashurisë për poetin, sa askush nuk mund ta ndalë vrapin e tij drejt saj. Prandaj ai merr pjesë në dhimbjen e shkaktuar ndaj njeriut, që dikur ia kishte plagosur zemren:*"Në heshtje të fundosur shiste lule,/ nga fjalët e saj derdhej pikëllimi,/dy sy gështenje,/si dy dritare që s'hapen"("Ajo që shiste lule").*
Vitet ikin dhe nuk kthehen kurrë më. Këtë të vërtetë të jetës ai e di mirë, kur shkruan për "njeriun e mirë", por në pikëllim e pashpresë: *"Kurrë më s'kam me qenë/ pranë teje,/duart e mia të mishta/ s'do të janë më duart, që të ledhatuan…"("Me flokët e shprishur të trëndafilit").*Poetit i del përpara silueta e së dashurës, por tani të gjitha udhët e botës e drejtojnë kah portat e mbyllura. Prandaj, ai shprehë mëdyshjen e vet të trishtë: *"Si i trullosur kaloj sokakëve,/nuk di a jam unë i dehur,/ose rrugët i kanë përpirë/ të gjitha trishtimet e dashurisë..."("Të gjitha udhët e botës").* Si në ëndërr ose paksa në kujtesën e mjegulluar, papritmas, ajo i del përpara: *"Kur çelnin lulet e bardha,/në sytë e tua të gështenjta…"*. Për dashurinë është aq i përbetuar, sa na thotë mesinqeritet: *"Mos më leni sonte të flas,/mund të shkulni çdo gjë nga shpirti im,/por dashurinë nuk ua jap!"*. Atij i del përpara silueta e të dashurës së dikurshme, por tani të gjitha udhët e botës e drejtojnë *"kah portat e mbyllura"* dhe shprehet se: *"Dashuria nuk është pëllumb,/ që sa herë t'i teket,/ të fluturojë në çerdhe të huaj"*. Prandaj ka besim që: *"Do takohemi/ me pranverat tona të humbura"* dhe njeriut të zemrës i

drejtohet me fjalë e shprehje të zgjedhura: *"Engjëllushe e dalë nga dheu", "si hajdut hyra në shpirtin e aromave", "unë t'u marr erë flokëve të tua"* etj.
Sidomos në poezitë e fundit të këtij vëllimi, autori e shton simbolikën e fjalëve dhe të shprehjeve, pasi është brengosur e nuk gjen dot rrugëzgjidhje për dashurinë e perënduar. Për këtë flasin edhe poezitë *"Një grua zgjon dritën e dremitur", "U nis prej një askundësie","Nuk lash njeri pa pyetur"* etj.
…Më fal, i dashur lexues, po sa e sa poezi të tjera të këtij libri të ri të Adem Zaplluzhës mund të përmendnim këtu, për ta dëshmuar këtë mik tonin, *"në dukje, ashik të vonuar dhe të pandreqshëm"!?(* Megjithëse i di dhe i ndjen brengat e moshës së tretë, të cilët e vajtojnë me pikëllim të kaluarën e tyre, ai përpiqet t'ua ringjallë shpresat dhe t'i bëjë të shohin dritë, në fundin e tunelit: *"Nuk janë të përmbytura/ përgjithmonë anijet e shpresës,/përherë në jetë ekziston /një derë e hapur,/ e cila të qet në dritë"*.
Me dashamirësi e respekt, për këtë koleg e mik të mirë, krijues të palodhur e me fryte të shumtë dhe të
ëmbël, e urojmë nga zemra për vëllimin e 110-të poetik,*"Ajonuk erdhi sonte!..."*. Me këtë rast, i dëshirojmë atij: Jetëgjatësi, krijimtari të mëtutjeshme dhe gëzime e lumturi, vetjake e familjare!
Tiranë, qershor 2015

DISA ÇASTE ME POETIN ADEM ZAPLLUZHA

Halil Kajtazi- shkrimtar

Herët kisha menduar të merrem me filistinët e letërsisë, që janë mësuar ta shalojnë "Sikur Hajdar Shosholli atkinë e tij!" me puthadorë të tjerë të konjukturave të çdo regjimi, dhe se si mu qep kjo temë, më duhet ta shfaq mendimin tim. Në fillim si shtesë, ju lutem o shkrimtarë të nderuar të më qortoni, e unë ju kërkoj ndjesë me shkrim: "Qofsha i gabuar për këto vlerësime!". Por, kjo letërsia jonë i ka do halle të mëdha, që askush nuk i jep krah, ose shpesh i jep krah kur i duhet, apo ia jep vervishtën!..

Kësaj radhe po merrem me artin e të qarit në vargje të Adem Zaplluzhës, poetit të Udhëve të Prishtinës, si dhe udhëve të jetës së tij, që nga vendlindja, që me penë e shkrime përpiqet të zë një vend në letërsi. Sepse, tërë jeta e tij, vërtet është përpjekje për t'u shkrirë di "dylli në kaci" për të mirën e poezisë dhe të njerëzimit.

E kisha ftuar Adem Zaplluzhën, sepse më parë kur jemi takuar në Kombinatin "Kosova" të Obiliqit e shikoja si "Qengjin e vogël", e tash bëri emër me vargje të tij, që përherë paraqitet me vepra me vlerë, por pak ka përkrahje, pak ka edhe lexues!

Nuk mund ta them mendimin e gozhduar për një poet, por ka të tillë që kur shkruajnë derdhin edhe lot! Lotët janë një nga armët më vrastare. Thonë se kur përdoren në çastin e duhur, lotët nënkuptohen se provë e humanizmit të një personaliteti të fuqishëm! Por, kur shkrimtari ynë

në këto rrethana bëhet personalitet, apo një troh "faktori" në jetën e artit tonë, kur nga çdo anë sillet e pështillet në cirkun e jetës, ku të njëjtit shkrimtar edhe sot e kësaj dite, luajnë me fatin e të tjerëve, duke ua mohuar qenien dhe përpjekjet që të mbes emër mbi të tjerë, që herët e mbajnë pedigrenë mbi të tjerë!

"FJETËM NJËQIND SHEKUJ" është libri më i ri me prozë poetike i poetit të nderuar Adem Zaplluzha. Ai në fund të kësaj vepre poetike shënon se i ka 109 tituj të botuar, dhe është e besueshme.

E bëjmë një bisedë spontane me Ademin poet, unë e dëgjoj "si një plak pa mjekër", e ai flet: për vete: "Para orës një kurrë nuk fle, pohon Ademi poet. Në orën 6 të mëngjesit zgjohem, e pijë kafenë e mëngjesit dhe ia nisi të krijojë. I pijë dy litra ujë të thartë në ditë. Punën krijuese e nis me një fjali:"Kam një fjalë të cilën mund ta shndërroj në mal, Mali sërish shndërrohet në fjalë…"

Më ankohet se veprat e tij nuk janë marrë në shqyrtim nga zyrtarët dha askush nuk shkruan për vlerat dhe antivlerat në letërsinë tonë, dhe se secili në stilin e vet, është i ngarkuar që të bëj emër vetëm për vete dhe miqtë e vjetër, që herë ,herë ia kanë dhënë vërvishtën letërsisë sonë. Dhe, se gjenerata e krijuesve të ri doli në pah me shumë vragë e me shumë shkrimtarë "çyryk" që mendojë se do të jenë gjithnjë tutelë mbi të vegjlit, duke u mashtruar se "qengji i vogël gjithnjë mbetet qengj i vogël!"

Më kohen filloi të lulëzojë një gjeneratë e tërë krijuesish, që përpiqeshin t'i dhënë frymë e vulë letërsisë së Kosovës, por uroj se muzika bëri më shumë se letërsia… Sepse, në letërsi matet ndryshe: "asnjë shkrimtar nuk e pranon shkrimtarin tjetër mbi vete, asnjë "qengj të

vogël” nuk duan ta shohin mbi identitein e tij dhe ta familjes, duke u krekosur, se vetëm me të lulëzojë arti. Shkrimtarët gjithnjë e më shpesh paraqiten si egocentrik! Egoja s’është e asnjë kohe!
Vetëm pak të ulësh e të dëgjosh poetin, kujtoje si unë në këtë moshë tetëdhjetëvjeçare:
Veprat e sa shkrimtarëve që janë fut në plan programe të shollave fillore dhe të mesme, u kanë krijuar sa vetave “verdhushka” dhe ua mbushin gushën me to! Kush jep lekë, ia ndërron gishtërinjtë kavallit”. Unë për vete pjesën dërmuese të veprave të mia i kam financuar vetë. Kjo udhë e botimit më ka shpëtuar si poet, dhe jam tërësisht i lirë! I fali librat e mia kurdoherë që takohem me njerëz edhe që fare s’i njoh. Nuk qaj kokën, kush i lexon apo edhe kush s’i lexon?” Ndoshta jam skeptik, se ky popull nuk jeton për art. Arti për këtë popull është kafshatë e njomur me pështymë! Folklori popullor i vendlindjes më ka nxitur të shkruaj, por edhe ish-mësuesi im, shumë i nderuar Hazhi Krasniqi. Prindërit e mi e kanë përkrahur shkrimin dhe u jam mirënjohës… Poezia e Rexhep Hoxhës, atëherë ishte hit për mua, ajo e titulluar “Picimuli”. Në klasën IV kisha lexuar librin “Vranina” e Fishtës.
Kur u zgjova nga gjumi prisja që të pija kafenë e mëngjesit, po që s’më dukej jeta si atëherë kur uleshim së bashku me bashkshorten time dhe pinim kafetë në ballkonin e shtëpisë andej nga lindja e diellit. Por, njeriu gjithnjë duhet të jetë i gatshëm t’i përballojë jetës.
Ademi në fund të ballinës së librit “Fjetëm njëqind shekuj”, shkruan:
“Sa herë që provuan të hymë në gjumin e heshtjes, mbetëm si pjesë e saj e pandashme, po ju lutëm, nëse

sërish hymë në gjumin e heshtjes kurrë më nuk do të zgjohemi. Sepse një njeri që fle ai nuk di se kur lind dita dhe kur vdes nata.
Nuk di më për të satën herë deshëm të zgjohemi nga gjumi i maktheve, fjetëm njëqind shekuj, nuk pat kush të na zgjojë. Më duket se akoma jemi duke fjetur…
Lexues të nderuar, e di se nuk i kërkoni vargjet e Adem Zaplluzhës, por ato do të mbesin dhurata për brazat e ardhshëm…
…Si shtesë për Ademin poet, po ua fali edhe një urti: "Kush fle shumë, punën e tij hidhja kllum e në lumë!"…
Në emër tim e përshëndes dhe e falënderoj zotëri Ademin poet, që m'i dhuroj veprat e tij për lexim, të cilat më gëzojnë, e poetit i uroj shëndet e suksese në krijimtarinë e tij. Kjo është një përpjekje e madhe e poetit për brezat e ardhshëm… Mos u dëshpëro, por krijo si gjithnjë vepra, ushtroje mendjen, mprehe penën, se gjithçka në këtë jetë do të kristalizohet, pra edhe krijimtaria letrare.
Bisedën me Ty nuk po e shteroj me kaq.
Kujtoj se me rastin e nxjerrjes së veprës së parë "Puthje" nga "Rilindja", 1974 e pata shkruar një shkrim që është botuar në gazetën e punëtorëve "Kombinati Kosova".
Nëse e ke ruajtur, me dëshirën time, mund t'ia shtosh këtij shkrimi. Kjo është kureshtia ime, sa për të parë, mos vallë të kam hy në hak si poet, o Adem shoqi…
Kujtojmë bisedën tonë të ngrohtë, në dysh: unë dhe ti, poet në qershor të vitit 2014, në shtëpinë time…
Me shpresë se do të takohemi edhe në ndonjë bisedë tjetër më të ngrohtë, po ta dërgoj këtë shkrim, dhe mundësisht sit ë tillë të shkruar me pikëpamjet e mia, përhape në mjete të

reja të informimit. Sepse, gjuhën tonë e duam ta pastër e të bukur…
Qofsh faqebardhë! Vdekje filistinëve!...
Qofshin të nderuar nëpër shekuj të gjithë ata që me grykën e pushkës dhe me penën në dorë, me arsye të shëndoshë, luftojnë për komb e atdhe!

PAK FJALË PËR LIBRIN

Bilall Maliqi - shkrimtar

Në ciklin e parë poetik të librit “Nuk flenë as kuajt e dehur”, me titull “Më mungojnë duart e nënës” para neve na paraqitet një tablo shumë prekëse dhe tejet emocionale e vargjeve të shkruara me aq përkushtim, ndjenjë dhe dashuri të madhe për nënën. Ky cikël është një poemë në vete për nënën me njëzetë pjesë, duke përfshirë rrafshe të ndryshme të përkushtimit të tij, si në momente mallëngjimi duke ia radhitur të gjitha epitetet nënës me një ndjesi të veçantë poetike, dhe s’ka kush më mirë që e kujton nënën me anë të vargjeve përkushtuese, dhembëse se sa poeti i cili e derdh tërë inspirimin e tij dhe lidhet emocionalisht me nënën, me ledhatimin, me kujdesin, me përkëdheljet, me këshillat e saja me të cilat rritet dhe ecën rrugës së drejtë ashtu siç e dëshiron nëna.E poeti Adem Zaplluzha këtë ndjesi e ka shprehur bukur në këtë poemë të realizuar mirë si në prurje të vargjeve interesante, ashtu edhe në ndërtimin e tyre ashtu siç e donë dhe e kërkon një poemë, duke e ruajtur mirë vijën e

baraspeshës artistike të saj.Përveç këtij cikli, libri është i ndarë edhe në dy cikle të tjera / një pemë në kopshtin e vjetër/ dhe /Nuk flenë as kuajt e fjetur/ , në të cilat cikle poeti ka pasqyruar frymëzimet e tij dhe gjetjet motivuese, duke u dhënë figurshmëri poezive prezente në libër.

Poezitë e librit kanë prurje të reja në pendën e poetit, të cilat i ka rregulluar mirë, duke e forcuar mirë vargun, duke ia dhënë forcën shprehëse, motivin dhe gjuhën e kuptueshme për lexuesit në përgjithësi.

Që nga poema për nënën e më tej edhe në poezitë që e kompletojnë këtë libër hasim në një tablo reale dhe në një pasqyrim real të ndodhive nëpër kohë, ku autori edhe në poezitë e tjera shpalos kujtimet e tij në një gamë të gjerë motivuese të poezive të tij.

Poezitë janë të ndërtuara mirë, kanë mesazhin e tyre disa sosh (poema për nënën) është e drejtpërdrejtë, por kemi poezi edhe gjysmë hermetike dhe si të tilla e kompletojnë këtë libër me një vlerë të begatshme artistike

MESAZHET QË I THËRRASIN KOHËS

Rexhep Shahu

Në mendimet e poetit Adem Zaplluzha për me vizatua zogun në mur, zogun e paqes në murin që s'bëzan, që hesht e na ndan, nëpër të cilin kacavirremi për me e kapërcye, por më shumë nuk ia dalim se ia dalim, mesazhet janë pa fund.

Në mos më shumë, në këtë mundim tonin me kapërcye murin, vizatojmë një zog në mur. Një zog që e kemi në dorë dhe duam ta lëshojmë për me njoftua se mbërriti paqja, erdhi paqja, u nënshkrua paqja. Ose një zog që fluturon vetmitar në qiell për qejfin a dertin e vet dhe kur kalon në hisen tonë të qiellit, mbi kokat tona, mbi murin tonë, ne ia vizatojmë hijen e na del në mur një zog te fluturua. Këtë vizatim bën poeti Adem Zaplluzha, sa mundem unë me lexua vizatimet me heshtje, se me zë nuk mundem me i artikulua as për veten time.

Unë që e dua poezinë të tillë, që përcjell mesazhe, mesazhe të mëdha, që i thërrasin kohës, të djeshmes, të sotmes për të ardhmen, nuk rri dot gojëmbyllur para

poezisë së Adem Zaplluzhës. Nuk rri dot pa e lexua me zë të lartë të brendshëm këtë poezi, që në dukje të jep përshtypjen e një mali të ngatërruar me lisa të shumtë e të mëdhenj, të zorshëm për t'i dalë përtej.
Unë e dua këtë poezi që jep e përcjell mesazhe pasi jam kundër poezisë plot lule plastike e aroma të shpikura, kundër poezisë së dashurisë me fjalë e pa dashuri të gjallë, konkrete që të djeg e të bën hi, që të shkul prej këtij planeti e të çon në gji të diellit.
Adem Zaplluzha vë vetën e ne në dilemën më të madhe e të rëndë, me falë.
A mundemi me falë. A kemi çfarë me falë? A na kërkojnë me falë? Pse na kërkojnë me falë? Po kë me falë, thërret me piskamë poeti shqiptar, kë me falë? Kur as nuk na lypin faljen por me arrogancë na dhunojnë në liri pasi na kanë vra, pasi na i kanë rreh varret, pasi na i kanë verbua yjet, ua kanë nxjerrë sytë yjeve tonë.
Poeti e di se falja është hyjnore. Se fal i madhi, i fuqishmi, fal zoti. E di se i dobëti nuk falë se nuk ka fuqi me falë. I dobëti vret, frikacaku vret prej tute e jo prej trimërie. Frikacaku vret se është rritë në frikë e me frikë në vend të huaj dhe gjithmonë ka frikë se e dëbojnë prej vendit të huaj.
Po përsëri thirrja e tij si piskamë i derdhet malit të madh të urrejtjes, kë me falë?!
Përsëri poeti – syri e shpirti ynë – thërret, kë me falë? Se nuk i del askush përpara që t'i kërkojë falje, nuk i ulet askush në gjunjë me i kërkua falje, nuk e ka asnjë fije fisnikërie armiku, asnjë fije dinjiteti që të dijë e mundet me kërkua falje. Ndaj poeti dhe ne, edhe pse dimë e duam të falim, shohim se s'kemi kë falim, s'kemi kë me falë. Sepse duket nga tejkalimi i marrëzisë në krim, edhe

armikut i vjen turp nga vetja e tij, i vjen me vjellë veten e tij, prej ligësisë së tij.
Nga shtatë herë në ditë papagajtë që më rrinë mbi krye më thonë me falë, pohon poeti në vargjet e tij. Por ai thellë e ndjen brenda vetes se papagajtë nuk janë vetëm nga jashtë që i thërrasin por janë edhe brenda shpirtit të poetit.
Poeti e di më mirë se kushdo se nuk jetohet gjithë jeta mbi shalën e kalit të urrejtjes. Poeti e pohon në gjithë vëllimin se dashuria është ajo që do ta bëjë më të mirë këtë botë, do ta shëroje këtë botë.
Është pezull dilema, a do të shërohemi... A do të zbresim nga kuajt e rremë të përrallave tona moderne të trimërisë pa trimëri e të lavdisë pa lavdi. A do ta shohim në dritë të syve vetën tonë. A do t'i përgjigjemi pa hile vetes tonë se kush jemi. A do ta gjejmë veten. Po udhën... A do ta fitojmë luftën ndonjëherë, luftën me veten tonë. Po paqen a do ta fitojmë. A do ta lëmë më luftën imagjinare mes nesh që të mos pikojë gjak paqja jonë.
Adem Zaplluzha është poet i njohur, me mal me libra dhe nuk është e lehtë të flasësh për një libër të tij pa hyrë në malin e tij. Ai është mjaft i angazhuar, dhe duke qenë poet, është i dënuar të jetë zëri i atdheut, është i dënuar të jetë largpamës, misionar, të flasë me zotin në emër të njeriut.
Vizatimi i zogut në mur është piktura a skulptura e paqes që kërkon poeti. Ai donë zogun e paqes e jo korbin e zi të luftës, pasi luftës ia kemi nxjerrë fundin, ia kemi shtrydhë edhe pikën e fundit të lëngut të zi dhe kemi fituar humbjet e mundjet, sosjet, tkurrjet e rrudhjet. Nisëm me e bë luftën por e lamë në mes si gjithmonë, se ne lodhemi dhe mashtrohemi, ne shërbejmë e nuk

shërbehemi për veten, ne e marrim për dele ujkun e veshur me lëkurë dele.
Ndërsa shkruaj këto radhë s'më hiqet nga mendja thirrja e poetit, më me falë...
A e njohim armikun që papagajtë na thonë me e falë, që zëri ynë i brendshëm na thotë me e falë, por mos me e harrua, kurrë mos me harrua pasi harresa na është bërë gur i rëndë varur në qafë në shekuj, shpesh gur turpi, dhe na ka ndjekë si fat i keq e i trishtë, si mësim i pamësuar kurrë prej nesh, i pakuptuar kurrë ose i mësuar sa për një stinë vdekje dhe i harruar në stinë dashurie e dasme.
A e njohim armikun që duhet me e falë. A e njohim armikun brenda vetes tonë. A e njohim veten tonë armik. Që duhet me e falë mbase pa na kërkuar falje, nisë nga mësimi i moçëm, hiqu dreqit, le ta gjeje me zotin. A e njohim armikun që na sundoi 80 vjet, që jetuam në kushte lufte e paqe të trembur me të 80 vjet, pasi u tradhtuam si shqiptarë nga koalicioni serbosllav i komunizmit shqiptar, që e patëm përditë para syve, që për shumë kohë kënduam e vallëzuam vëllazërim-bashkimin e shpikur që na e mësuan idealistët tanë që na udhëhoqën, që u besuam, që u mashtruan vetë e na mashtruan ne.
A e njohim armikun që e patëm 80 vjet në udhën e përditshme, në shkolla, në shitore, nëpër zyra, që e patëm polic, shef, drejtor, që e patëm zyrtar kudo nëpër zyrat e shtetit, që jemi shoqëruar me të, që i jemi drejtuar në spital, në gjendje civile, që kemi pi kafe me të, që kemi kaluar ditë e mote të shumta dashurie e më të shumta urrejtje. Pse duam ta fshehim e të mos e pranojmë se kemi jetuar bashkë me armikun, në një shtet, në një

komunitet, nën dhunë të hapur e të fshehtë, në dashuri të hapur e të fshehtë.
A e njohim armikun para të cilit dridheshim prej frikës kur vinte në oborret tona, në kullat tona, kur na kontrollonte banesën për kokrrën e qejfit të tij, kur na thërriste në stacionin policor për shantazh, për të na bërë hafije kundër njëri – tjetrit, kur na diferenconte e kur ne nuk vdisnim përditë duke thënë jo, nuk të pranoj, nuk të dua.
A e njohim armikun që na kërcënonte me vdekje, që na detyronte me shpifje të iknim nga sytë këmbët e ta lëshonim Kosovën duke lënë familjen në Kosovë e duke u endë djemtë e Kosovës udhëve të Perëndimit. Ne mbase më shumë e zmadhojmë armikun në këngë, ia zmadhojmë trimëritë, bëmat, historitë duke zvogëlua tonat, duke justifikua mos qëndresën tonë, mos rezistencën tonë, frikën tonë, ikjen e dëbimin pa provua me vdekë më parë.
A e njohim armikun komshi me të cilin kemi kalua shumë vite e dekada si komshinj të mirë në marrëdhënie të mira, kur i jemi gjend njëri – tjetrit në hall e në nevojë. Pse i ikim dhe e fshehim sot këtë bashkëjetesë, herë të sforcuar e herë të dëshiruar, herë të dhunshme e herë normale. Duke e fshehë këtë bashkëjetesë nuk bëhemi as më trima, as më patriotë, por shpikim e hiperbolizojmë urrejtje, deformojmë e falsifikojmë historinë e jetën tonë nën pushtimin serb e nën sundimin komunist.
A e kemi shkrua dhe a po e shkruajmë ne shqiptarët këtë armik. A e kemi futë në letërsinë tonë armikun serb. Sepse ai ka ekzistuar në jetën tonë, ka qenë prezent në jetën tonë, kemi luftua, jemi vra, jemi urrye, jemi dashtë, kemi bashkëjetua, i kemi shkua njëri – tjetrit në dasma e

vdekje. Nëse letërsia është historia reale e jetës apo jeta siç është, ne nuk mund ta fshehim personazhin serb në letërsinë tonë, nuk mund ta zhbëjmë personazhin serb, nuk mund ta mohojmë, sepse duke fshi e mohua personazhin serb në letrat tona, ne fshijmë e mohojmë sundimin e pushtimin serb që ka ekzistua 80 vjet kundër shqiptarëve, ne mohojmë e falsifikojmë historinë dhe do të na rëndojnë shumë rëndë akuzat e pasardhësve tanë. Por 80 vjet nuk janë 8 ditë as 8 vjet, por janë gati një shekull pushtim e sundim, janë pothuaj katër breza njerëzorë nën pushtim e sundim serb.

Duke mos e shkrua personazhin serb në letrat tonë ne bëjmë letërsi të falsifikuar, sterile dhe bëhemi bashkëfajtorë në fshehjen e krimeve kundër shqiptarëve.

I njëjtë është edhe problemi i letërsisë për ta shkrua apo jo historinë e komunizmit në Shqipëri. Gjysmë shekulli pushtim e sundim i një pakice antikombëtare kundër kombit shqiptar, sundim i një diktature kundër shqiptarëve. Me fjalë diktatura komuniste në Shqipëri e donte Kosovën, edhe pse ndihmoi Titon ta nënshtronte Kosovën, edhe pse ndihmoi Titon ta bënte Masakrën e Tivarit, edhe pse solli partizanët e Shqipërisë që të nënshtronin partizanët shqiptarë në Kosovë, edhe pse partizanët e komunistët e Shqipërisë të udhëhequr nga misionarët e të dërguarit jugosllavë vranë djemtë më të mirë të Kosovës për llogariti të pushtetit komunist serb, edhe pse diktatori Enver Hoxha për hir të pushtetit të tij “e shiti” apo e tradhtoi Kosovën duke e lënë në dorë të shokut Tito. Udhëheqja komuniste e Shqipërisë e donte Kosovën me kushtin që ajo të ishte nën Jugosllavi, të ishte nën Serbi, por nuk e donte Kosovën të bashkuar me Shqipërinë apo shtet më vete. Sepse instruktazhin

komunizmi në Shqipëri apo diktatura komuniste e Shqipërisë e kishte marrë që në themelim prej serbëve dhe nuk mund t'i devijonte vijës jugosllave, sjelljes jugosllave, qëllimeve të jugosllavëve apo më saktë serbëve që ishin arkitektë të pushtetit komunist në Shqipëri, nismëtarë, diktues, udhëzues e mbikqyrës të Partisë Komuniste të Shqipërisë që nga fillimi e në vijimësi.

Po nuk u shkrua nga letërsia historia e komunizmit në Shqipëri dhe po nuk u shkrua historia e pushtimit serb të Kosovës, shkrimtarët e poetët shqiptarë, njerëzit e letrave do t'i bëjnë dëmin më të madh vendit, do të lejojnë fa falsifikimin që po ndodh përditë duke e paraqitë djallin engjëll, do të lejojnë të ringrihen e të risundojnë diktatorët e pushtuesit, do të rehabilitohen diktatorët e pushtuesit, do të thonë njerëzit se nuk paska qenë aq keq në kohën e diktaturës në Shqipëri, nuk paska qenë aq keq nën sundimin e pushtimin serb në Kosovë

Libri i Adem Zaplluzhës, vizatimi i zogut të paqes në murin që hesht, në murin që na ndan, në murin që e kemi shembë por jo plotësisht brenda nesh, më nxiti e m'i thirri këto fjalë.

Vargu i poetit Zaplluzha brymoset në një tërësi të mrekullueshme poetike.

Nezir Prokshi - poet

(ADEM ZAPLLUZHA: "NËPËR PLASARITJET E MUREVE", POEZI SHOQATA E SHKRIMTARËVE ",“FAHRI FAZLIU”- KASTRIOT, 2014)

Kur e merë në dorë librin me qëllim që ta shqyrtosh, të duket se para vetes ke një pyll të rrëpinjtë që nuk kapërcehet lehtë për të arritur në një pikë ku t'i dëshiron, veçmas kur ke të bësh me një vepër multidimensional, jo vetëm për nga dendësia e përmasave shpirtërore, të vlerave, por edhe për nga shumësia e çështjeve ideo – estetike që trajtohen në një mal temash e kohësh të cilat brumosen në një tersi sa të gjerë të cilat nga vargu në varg, nga strofa në strofë, e pse jo edhe nga libri në libër, që flasin në një hapësirë e kohë e që fillon e lëviz në vetëdije e ndërdije duke bredhur valëve të jetës ku amplituda e dhembjes dhe e harlisjes është e mbetet evidente.

Me të lexuar këtë libër, por jo vetëm këtë, por edhe shumë vargje të poetit Adem Zaplluzha, do të përpushem ta shqyrtoj në mënyrën time, e që mban një titull të thjesht në dukje të parë, por i thellë e poetik kur t'i dalësh veprës në fund.
Kur e hapësh këtë libër të ngjallet një ndjenjë plot e përplot udhë me qindra drejtime të cilat shkojnë, siç thotë poeti "deri në pafundësi, por ti mos u ndal se një ditë do të mbërrish në cakun tënd dhe hapi ynë do të prek "Në shpirtin e mëllagës së bardhë", por edhe një mur i tejdukshëm I vizionit poetic. Atë mur mund ta kapërcej vetëm i guximshmi edhe për sytë e skeptikut edhe për unin e zemrën e ati që i mungon guximi. Tek vëllimi që kemi në dorë "Nëpër plasaritjet e mureve" zemërimi i poetit në përditshmërinë tonë herë, herë fillon e zbutet, por karshi kësaj lind një dhembje për shumë gjera të pambrojtura e të harlisura. Ai kënd ku ndodhen, po ndodhin e do ndodhin edhe më gjera jot ë rëndomta përditë i troket në xhamin e dritares një shi imcak. Ky shi nëpër platformën e kujtesës ngjiten gjallesa parahistorike dhe kacavirren nga lagështia e mureve. Dhe i hap duar, lutet në gjuhën më njerëzore që një natë si kjo mos ndodhtë edhe njëherë se "Zogjtë janë duke vdekur në fluturim/ krahët e vetëtimave/ po thyhen si stapet nëpër kallamishte" Kjo ndodh për arsye se duart poeti i ka të mbuluara me gjethe brenda ujit që ka lëshuar nata me vesë / nën ëndrrat e fshehura të rrapeve/ dhe pa i mëkuar zogjtë shkunden stinët.
Kur na jep vizionin për këto stinë e për këto vise ku poeti identifikohet me të, futet thellë në ato stinë dhe shpërthen me një biografi ku"Njerëzit ecin nëpër zhgjëndrra të thinjura/ Shkelin mbi metaforat e etjes"dhe

gjithçka tani nuk ngjet analeve të thjeshta të cilat e kanë për detyrë të hedhin dritë mbi disa etapa të jetës së stinëve e pse jo edhe të poetit, por me dashje bën një kërcim të madh kohor në një epokë të ravgimeve kohore, të gjurmëve pa dëshmitarë, andaj lind përcaktimi për diç të rëndësishme në jetë / Asnjë korb i zi nate/ Mbrëmë nuk piu ujë te çezmat e mallkimeve/. E kjo është e qartë pasi këtu na paraqitën fytyra mitike të kohës që te poeti zgjojnë asociacione të gjalla, njësoi si te nxënësi i Platonit. Asociacioni poetin nuk e gënjen vetëm mashtrim i përkohshëm që mund të bëhet realitet ose është realitet porse nuk shihen disa gjëra pa u vënë në spikamë. Asociacioni i poetit ndërlidh dhe gërsheton sjelljet jo të ndërsjella të personazheve lirike të heroit pozitiv apo negative. Pas një rropatjeje të këtillë të poetit gjurmohet bukuria që frymon kudo e kurdo. Në ciklin e dytë që poeti Adem Zaplluzha një titull bajagi tërheqës e poetik "Nëpër plasaritjet e mureve" ku janë përfshirë njëzet e dy poezi hapet me poezinë "Të denjë për një gllënjkë fjale" e mbyllet me vargjet e poezisë "Nën lëkurën e erës së brishtë", poeti duke medituar e duke u thelluar katakombeve të jetës, inkuadron me kujdes ritet e kohës pagane si perëndi të një kohe që megjithatë la mbresa duke u manifestuar brez pas brezi pështyma e mbetur në fyt si gllënjka të fjalës dhe dosido i ndjen "mëkatet" si një barrë që nuk mund të kapërdihet.

''Në kohërat e gjyshërve të mi
Zotat ishin të dukshëm
Mund të prekeshin
Sa herë që donin
Ua lyenin buzët me ngjyrën
E portokalltë të dielli''.

Se gjyshërit ishin perëndi në vete dhe që s'kishte njeri mes tyre, se nuk mund të mashtroheshin lehtë me një të qeshur mbase edhe djallëzore se ishin janë e do mbesin burra të fjalës. Se plagët i jep jeta dhe sërish vet jeta i shëron, është thënë qëmoti. E poeti me të drejtë konstaton më elemente të qëlluara metaforike se kush e shëron këtë plagë. Dihet aty ka edhe njerëz të dinitetshëm që mbeten e do të mbesin gjithë kohëve për ta jetuar jetën. Bota poetike e Zaplluzhës di ta rrëmbejë, të na pushtojë me sy të hapur ditë e natë. Kjo botë ka edhe pjesën lartë edhe pjesën poshtë. Në pjesën lartë është e paqena, Sizifi

Kënga dhe syri i kohës së lashtë, ndërsa poshtë është metamorfoza nëntokësore që e ngufatë gjithçka që është e synon të jete e denjë, gjithçka që synon të behet fund i zi, zemër në kulvi. Shirit i filmit për atë që kemi parë është pikëllimi, por edhe hareja, kënga vaji. Por këto botë kanë edhe një, ajo është bota e Yllësisë ku poeti njeriun e kohës së sotme e sheh në një ecje prapa që gjelbëron në hapësirë . E ai që shkëlqen nuk është diell por mendim.

Një jastëk në fund të dhomës, është titulli ë ciklit të tretë që poeti e hap me poezinë "Më pëlqejnë këto pamje groteske", poeti zgjohet përditë i shoqëruar me shishet e zbrazëta të cilat vallëzojnë në tavolinat gjysmë të dehura, sepse edhe koha është e dehur, edhe fryma është e dehur edhe gjithçka që e rrethon duke e dehur në momentet e jo përcaktimit real të njerëzve që vallëzojnë.

Në përfundim mund të konstatojmë se Adem Zaplluzha me këtë vëllim poetik e vërteton edhe njëherë shumë më forte dellin poetik prej një poeti mjaftë më përvojë

jetësore, por në veçanti krijuese që personifikon brezin e poetëve që kanë kapërcyer me sukses kohën hulumtimeve moderne dhe hapërojnë nga një postmodern me dimensione kreative e gjithëpërfshirëse. Këtë e vërteton dendësia e figurave artistike që vërtetë është një orkestrim i bujshëm e i begatshëm. Me një gjuhë poetike të pasur e të kulluar, të plotë që rrjedh si krojet e bjeshkëve më freski e maje qiellore. Veçori tjetër që këtë poet e bën të veçantë është vargu që nuk del me zor por buron si krojet e pastra të Dardanisë, buron natyrshëm, pa droje. Ka një stil të veçantë e të pastër e me një kompozim harmonik. Ky vëllim me të gjitha komponentet karakteristike, me një numër të madh porosish konstruktive edhe gjësë më të imët i ka dhënë kuptim të madh duke e bërë temë të përditshmërisë jetësore.

Edhe pse, si çdo vepër edhe ky vëllim poetik mund të plotësohej edhe më, lexuesi nga kjo vepër del si të kishte dal nga filmi që nuk harrohet lehtë sepse ai film s'është si çdo film, aty gjen përshkrime të thella që janë një kompleks filmash mbresëlënëse ku çdo lexues mund të këtë aktruar edhe vetë në kohë e hapësirë.

POEZI FOSFORESHENTE ME RRËNJË FJALE QË LIND NGA KOCKA E POETIT

Xhevahir CIRONGU- poet

Të shkruash diçka për poetin Kosovar Adem Zaplluzha, në radhë të parë duhet që të kalosh nëpër filtrin e mendimit e të fjalës së shkruar prej tij. Çdo fjalë e rresht që ka shkruar në libra me poezi Ademi, sigurisht ai e ka ‘’matur e peshuar’’ mirë brenda vetes mendimin e fjalës, pastaj e shkruan në letër. Ai gjurmon si skifter mes skutave të fshehta të mendimeve dhe i perin ato brenda shpirtit. Pastaj, si një hekurpunues dredh ujëvarën e shpirtit në letër. Me krijimet e tija, poeti Adem Zaplluzha ka formuar ‘’liqenin’’ e vet me fjalën e bukur shqipe. Unë do ta quaja këtë poet, si një poet i shekullit të ri të 21-të, sepse kush si ai s’ka krijuar e botuar kaq libra me poezi,(ka edhe botime të tjera përveç poezisë). Ai dallohet për varg‘’Naimian’’, ‘’Çajupian’’, ’’Migjenian’’ etj

Pse e quajmë kështu këtë poet?!Po të hedhim një vështrim në gjithë krijimtarinë e tija në konceptin kohë, por e në pozicionet konceptuale të lëvrimit krijues letrar; do vijëzosh trekëndëshin e tre kohëve: 1. Të djeshmen krijuese në kushtet e një regjimi totalitar e skllavërues. 2. Atdhedashuria për vendlindje e gjuhën shqipe. 3. Krijimtari në moshë të re, si dhe moshën e thyer të sotme nga vitet e jetë me rrënjë te liria e Kosovës, po ashtu edhe të fjalës së shkruar shqipe. Poeti bën një përshkrim faktik historik e letrar të të gjithave ngjarjeve të popullit ku ka lindur edhe vetë ai, madje është edhe pjesëmarrës direkt në këtë rrugëtim sa të vështirë e plotë madhështi me çlirimin e Kosovës nga okupatori shekullor Serb. Drithërima e shpirtit të poetit Adem Zaplluzha, lakonte dhe lëngonte për shtypjen mizore që bënte ‘’korbi i zi’’ sllav edhe në fushën krijuese për gjithë shkrimtarët e poetët në Kosovë, e sidomos ndaj atyre me prirje atdhedashuri për fjalën e shkruar shqipe. Poeti ka ditur të kapërcejë me zgjuarsi dhe krijimtari letrare çdo sfidë të kohës makabre. Ai merr guximin e hedh në letër mendimet e tija, nga ku poezia ishte arma e vetme por edhe më e fuqishme që ngrinte peshë ndjenjat e popullit të vet , e që mbillte me vargun e poezisë lulet e lirisë në Kosovën martire. Mbas çlirimit të Kosovës, këto lule u rizgjuan brenda shpirtit të poetit dhe shpërthejnë si yje në qiell të kaltër, sepse ato kishin kohë që qëndronin të ‘’fshehura’’ në qenien e tij, e si rrjedhim udhëtuan me emrin liri drejt vargut poetik e vëllimeve të 116-të.

Poezitë e Ademit janë të thjeshta në dukje për lexuesin dhe për çdo lexues të thjeshtë. Kanë një rrjedhshmëri të pastër kur lexon, por aty do ndjesh një krenari të ligjshme e hyjnore që të ndez zjarre dashurie për njerëzit, atdheun, traditat e popullit shqiptar, fjalën e bukur shqipe, pulson jetën tonë në vargjet e poezisë.

Takon personalisht poetin e befasohesh për fjalën e ëmbël që derdh nga shpirti me një dashamirësi që është tërësisht njerëzore.
E si mund të mos krenohesh për këtë njeri, sa njeri po aq edhe poet!?
Ecën me kohën, ka shkelur mbi kohëra të zymta e të trishtë, por kurrë s'është përkulur para vështirësive. Ai ka thyer çdo gurzi që i ka dalë para, pra, me simbolin e fuqishëm si një mal alpin ngarkuar me borë, por gur zjarri brenda shpirtit të derdhur me aq dashuri në letra fjalën shqipe. Edhe libri i fundit që pret botimin të titulluar ''Fluturojnë zogjtë e verbër'' , na jep plot figura letrare dhe forcën e shprehjes filozofike të vargut poetik. Te poezia me titull ''Ta ndjejmë ekzistencën e fjalës'' aty gjallojnë të fuqishme figurat letrare. Poeti është treguar i kujdesshëm jo vetëm te ky vëllim, por edhe në treguesit e përmbajtjeve të titujve dhe të brendisë që kanë gjithë vëllimet e botuara të mëparshme. Ai asnjëherë se ka përsëritur vetveten në poezitë. Të gjitha janë të ndryshme e dallohen lehtë nga vëllimi në vëllim,por edhe nga poezia te poezia. Ne shkëputëm për ilustrim këto strofa nga poezia ''Ta ndjejmë ekzistencën e fjalës''. Autori e barazvlerëson fjalën e shkruar me peshën e gurit, me dritën e yjeve, me ngrohtësinë e

rrezeve të diellit, por edhe të larë me vesën e mëngjeseve. Fjala është ajo që të ngroh më shumë se zjarri ,- thotë poeti Adem Zaplluzha. Por kur ajo është e gatuar me baltën e vendlindjes. Poezia e poetit Kosovar Adem Zaplluzha ka dritë fosforeshente me rrënjë burimore që del nga kocka e trupit të vetë poetit. E si e tillë ajo duhet vlerësuar nga qarqet akademike e filozofike,historike, letrare e gjuhësore mbarëkombëtare.

‘’ Sa herë që deshën të parët e mi
Nëpër xhepat e erës,
E gjetën vetveten.
Thonë se kur nuk kishin grurë
Në copa rrasash gatuanin dashurinë.

Kështu mësuam nga gjyshërit
Ta ndjejmë ekzistencën e fjalës,
Nuk ishte aq lehtë
Të kapërcehet përtej vetvetes.

(…….)
Nuk na u deshtë shumë kohë
Mësuam shpejt,
Dhe nga ne mësuan të tjerët
Se si ruhet dhe ndizet zjarri’’.

Vet poeti është dashuruar pas letrave. Të shkruash një letër nuk është aq e thjesht sa thuhet. Letra është e bardhë në formën e saj ku mbi atë shkruhet me penë e që derdhet boja që formojnë shkronjën e më pas fjalën. Kur lexohet dëgjojmë tingullin e saj, ëmbëlsinë, dashuri fjale që pasqyron botën e atij që e shkruan.

Po vetë poeti ku është në këtë rast?

Ai është si një margaritar i gjithëgjendur te fjala e vargu i shkruar në letër. A s'është fakti që ky poet me një moshë mbi 70 vite mbi supe, shkruan e krijon mbi tastierën e kompjuterit , që i cili fal energji krijuese për poezinë e dashamirësit e letrave shqipe kaq botime!?

Në poezinë e titulluar ''Të lutem më shkruaj një letër'' ai shprehet qartë dhe me një ekuivalencë të fuqishme letrare. Rryma e të shkruarit, metafora e krahasimet që përdor poeti janë të mbështetura edhe te poetët e tjerë shqiptarë, si te vargu i Naimit, Çajupit, Migjenit etj.

Dhe më konkretisht:

''Më shkruaj një letër
Ku nuk dëgjohet britma e Ot'hellos;
Le të jetë me ngjyrë menekshеje
Po me atë ngjyrë
Që i përngjan dashurisë tënde''.

Poetët nuk i tremben vdekjes. Ata e shohin si një pjesë të vazhdimit të jetës. E pse t'i trembemi vdekjes, -thotë poeti në një poezi?! Të jetosh jetë, duhet që të bësh diçka të dobishme në këtë botë, jo vetëm për veten por e për të tjerët, për gjithë shoqërinë, pra kështu s'ka edhe vdekje, por s'ke edhe frikë nga kjo vdekje që dikur ajo do na trokas në pragun e jetës sonë. Atëherë, pse të kemi frikë nga kjo vdekje?

Ta konkretizojmë me disa rreshta që poeti ka shkruar te ajo poezi ku thotë se,

‘’s’duhet të vdes kurrë!’’ .
‘’Vdekja nuk është vdekje
Po që se ke kohë,
Të rrëfehesh
Përpara pasqyrës se mendjes tënde.
(…….)
Për të mos vdekur askurrë
Mbille pemën tënde,
Të shenjtë mbille
Në rrëfyestoren e shpirtit’’.

Te poezia e poetit Kosovar Adem Zaplluzha gjen vetveten, gjen forcën e mendimit, aty rrjedh e kristaltë fjale e shkruar me petalet e luleve shumëngjyrëshe, tingëllon si valë deti mendimi, vargu merr freskinë e erës së malit e gatuhet me brumin e pjalmit të pemëve, dëgjohen cicërima zogjsh në fluturim, e mbi të gjitha ka dashuri njerëzore me rrënjë te atdheu, te vendlindja,poezi fosforeshente me rrënjë te kocka e vetë poetit. A na lejohet të themi se: Poetët s’kanë vdekje?! Gjykimin bëheni vetë ju lexues nëse kemi të drejtë apo jo për këto fjalë zemre që po themi për poetin Kosovar.

DY FJALË PËR LIBRIN ME POEZI "NJË SHI PREJ BRYME"

Dilaver Goxhaj

Libri i 117-të i poetit Kosovar Adem Zaplluzha, "Një shi prej bryme", ndryshe nga botimet e mëhershme, paraqet një cikël jo të pakët poezish, vëllim që dallohet nga poezitë e tij të mëparshme, për faktin se janë poezi jo me varg të rimuar. Si i tillë, ky botim i tij i radhës ngjan më së shumti me një prozë poetike pasi, po ta vëresh me vëmendje, të gjitha poezitë e këtij vëllimi duket sikur janë vijim i njëra-tjetrës, si një histori e tërë e vuajtjeve të autorit por që personifikon gjithë popullin shqiptar në Kosovë, duke ecur përmes "një ure të ngushtë e të gjatë", sikundër thuhet në njërën prej këtyre poezive. Si i tillë, ky vëllim ngjan si një poemë liriko-epike tregimtare, si një tregim në vargje. Heroi i këtij tregimi në vargje është vetë autori, i cili tregon në mënyrën më lakonike që mund të bëhet, (ka shumë raste që i tregon ato edhe me një e dy vargje), ndjenjat e veta të shkaktuara nga ngjarjet

jetësore të tij, të fisit të tij dhe të fshatit e qytetit ku ai ka jetuar e punuar, jetë, e cila
është tipike për gjithë popullin e vendit të tij, Kosovës. Këto ndjenja Adem Zaplluzha i shpreh në digresione lirike e me një kolorit emocional.
Nisur nga veçoria e këtij vëllimi, pa frikë mund ta krahasojmë me tregimet poetike si "Demoni" i Lermontovit, "Gjermania, përrallë dimri" e Hajnes apo edhe me "Gjauri-n" e Pushkinit, me të vetmin ndryshim se Ademi u ka vënë titull çdo pjesëze, pasi nuk ka pas qëllim që ta trajtonte si poemë tregimtare, kjo i ka dale rastësisht e tillë, ngaqë nuk gjendet në të një subjekt i mirëfilltë, në kuptimin e vërtetë të fjalës; gjejmë më tepër një paraqitje lirike të ndjenjave për copëza të caktuara të jetës së tij, se sa një tregim të vërtetë e të gjatë.
Themi se është në tërësi një tregim lirikë, pasi e pasqyron jetën duke treguar ndjenja të ndryshme të tij si dhe mendimet dhe emocionet e tij, të shkaktuara nga vuajtjet e
gjithë popullit të tij. Kushdo që e lexon qoftë edhe disa nga poezi të shkëputura të këtij vëllimi, përfytyron si vuajtjet e Ademit ashtu edhe ambientin shoqëror të Kosovës të atëhershëm e të tashëm, ambient, i cili i ka shkaktuar këto emocione. Themi se është një tregim lirik në vargje pasi në të ekzistojnë të gjitha tiparet e pasqyrimit artistik të figurshëm të jetës që ka lirika: përgjithësimi, individualizmi, elementi i trillimit, si dhe rëndësia edukative. Të gjitha këto tipare bëjnë që Ademi të na e japi sa më mirë vrullin e ndjenjës dhe të folurit e emocionuar.

Si i tillë, ky vëllim më së shumti është një lirikë politiko-filozofike dhe peizazhi, pa harruar të themi se metafora është tipikja më dalluese e autorit edhe në këtë vëllim.

POEZI ME ZËRIN E ARSYES DHE FUQINË E NDJENJAVE

Sabir Krasniqi-SA-KRA

"Nevoja e artit nuk është të prezantojë se si duken gjërat në aparence, por se çfarë kuptimi mbartin ato në brendësi" Aristoteli

Nga kopshti i mrekullueshëm, tejet kreativ, i poetit Adem Zaplluzha, nga ky burim i pashtershëm krijues, sërish rrodhën vargje përplot koloritet që di t'i gërshetoj aq bukur, me fijet më të ndjeshme estetike, vetëm një shpirt i madh artisti dhe përmes tyre të krijoj valorizim të përsosur ritmor mes zërit të arsyes dhe magjisë së ndjenjave... Po nuk thuhet kot se: "Poetët janë si retë mbi det - thithin ujin e njelmët, për të lëshuar shiun ëmbël".

Te jesh poet nuk është edhe aq e lehtë pasi duhet t'i shohësh dukuritë përreth, dhe botën përgjithësisht, nga disa dimensione! Duhet të veshësh me petkun e atyre

dukurive dhe t'i përjetosh edhe vet! Të përballesh me të mirën e të keqen, me gëzimet e hidhërimet, me lumturinë e pikëllimin, me qetësinë dhe shqetësimet, me dhimbjet, brengat... për të nxjerr nga gjithë këto ndjesi edhe kuptimin filozofik, estetik, psikologjik, retorik, metaforik, porosinë dhe përmbajtjen, përmes zërit tënd të brendshëm, përmes syve të shpirtit; të dish të lundrosh në hapësirën e valëve krijuese, të dish të kapësh ritmin e melodisë së caktuar, të gërmosh në themelet e brendshëm për t'i dhënë dimension universal vargut artistik. Dhe mu këtë ka arritur ta bëj poeti i madh Adem Zaplluzha edhe në këtë libër të radhës, të 119-të, të titulluar, "Në prehrin e pemëve". Kur them poet i madh e them me plotë bindje, pa frikë se mund të bie në subjektivizëm të tepruar, pasi madhështor autorin e bën puna e tij, veprat e tij, jo vetëm nga sasia, fondi i pasur krijues (118-të të botuara deri më sot), por nga përmbajtja dhe vlerat artistike që bartin dhe pasqyrojnë ato, të krijuara në një vazhdimësi më shumë se gjysmëshekullore. Nuk mund të mos e cek në këtë rast edhe thënien e I. Njutnit: „Në rast se unë kam parë më larg se të tjerët, kjo ka ardhur sepse kam qëndruar mbi supet e gjigantëve“, e sup gjigant, poeti Zaplluzha, ka pasur një kokë gjeniale, enciklopedinë e gjallë, filozofin e madh, Sokratin shqiptar, profesorin e ndritur Qazim Berisha.

Poezia, gjegjësisht vepra artistike, është një fryt i një bashkëpunimi të ngushtë mes objektit - veprës që duhet krijuar, dhe subjektit krijues - pra vet artistit, që në fakt, është si një lloj “autoportreti” i ndërgjegjes estetike të krijuesit. Akti thelbësor i këtij bashkëveprimi është përjetimi personal i dukurive përmes shqisave dhe

ndjenjave; perceptimi i fuqishëm emocional i gjithë larmisë së botës shqisore me tingujt, aromat, ngjyrat, lëvizjet, format e saj dhe zbërthimi e riprodhimi estetik i këtyre refleksioneve, dukurive të jashtme fizike të realitetit që na rrethon, përmes botës imagjinare, duke i derdhur e fiksuar ato përmes vargjeve ose figurave artistike.

Si një "autoportret" i ndërgjegjes estetike, çdo poezi, ose vepër tjetër artistike, në fakt, përmban edhe një pjesë të jetës së krijuesit, një pjesë të shpirtit të tij. Edhe në poezitë e Zaplluzhës frymojnë ndjenjat, mendimet e përjetimet, që autori i ka të freskëta nga të gjitha periudhat e jetës dhe të cilave u jep jetë, i materializon artistikisht, i zbukuron estetikisht, përmes vargjeve të derdhur mbi letër.

Gjatë rrugëtimit jetësor, vërejmë përmes poezive të tij, se autori e ka ndjek, e ka ndjerë dhe përjetuar peshën e kohës, peshën e zhvillimeve historike, politike, kulturore e shoqërore të atdheut, që janë treguar shumë të pamëshirshme, shumë të padrejta dhe shumë të egra, pothuajse, në të gjitha sferat e jetës, dhe kjo ka bërë që, në përpëlitje me shpirtit e tij krijues, autori të reflektoj këtë gjendje të brendshme në poezitë e tija dhe të na jep përshtypjen e një poeti të mjerimit dhe dëshpërimit që, në fakt, nuk qëndron pasi marshimi i shpirtit të tij luftarak, por edhe rebelues ndaj dukurive përreth, nuk është mposhtur para asnjë sfide të kohës! Në vargjet e tij spikat edhe historia: burrëria, besa, guximi, trimëria, mençuria etj., si në poezitë: "Po e hidhëron tokën", "Gjyshi im luftëtar i disa luftërave", apo në poezitë: "Nëse ngjan e kundërta", "Herë i përngjajmë njeriut", ku autori futet në brendi të shpirtit dhe, nga aty, reflekton

realitetin e brendshëm psikologjik përmes variacioneve alegorike; ose vargjet kushtuar tragjedisë gjithëkombëtare - eksodit masiv të shqiptarëve të Kosovës në periudhën mars-qershor 1999, në poezitë: "Herë binte shi i mrrolur", "Një hije vdekjeprurëse", që kanë lënë gjurmë, jo vetëm tek poeti, por në histori. Poeti nuk i kursen as dukuritë e shëmtuara shoqërore - ato të shkatërrimit mjedisorë, si në poezinë "Lumin që e njoha njëherë moti", ku atë e brenë dëmtimi i natyrës, por nuk e lënë të qetë as veprimet ekstreme fetare dhe ai ngre zërin në mbrojte të vlerave elementare të lirisë njerëzore - pra vet jetës, në poezinë, "Nuk kam kohë për të humbur", po e anashkaluar për asnjë çastet as botën fëmijërore, për të cilët ai shpreh dashuri të veçantë e që, edhe në realitet, kjo botë fëmijërore është pasqyrë më shkëlqim të veçantë i ndjenjave dhe vlerave më madhështore e më të pastra njerëzore, sa që poeti i quan të vegjlit kardinal, në poezinë, "Të vegjlit janë kardinal". Në vargjet e poetit është e pranishme përherë edhe nostalgjia për vendlindje, për qytetin historik e piktoresk të Prizrenit, për Urën e Gurit, për Lumëbardhin që gjarpëron nën të e që, ai, e bartë me vete kudo, edhe në poezinë "Në qytetin tim", por poeti nuk e harron asnjëherë as elementin thelbësor të qenies njeri, emocionin më dinamik, ndjenjën e thellë, energjinë e fuqishme dhe të pafund që depërton deri në poret më të imta të
qenies sonë, duke na rrëmbyer trupin e shpirtin - nektarin e ëmbël të dashurisë, dhe këtë gjuhë të zemrës ai e shpalos përmes poezive: "T'i preki yjet kah çelin zogj", "Shikimet e tua të largëta".

Po të lexohen me vëmendje poezitë e Zaplluzhës, vëren se brenda tyre gërshetohen element material, substancial, shpirtëror, mendor, kreativ, social e shoqëror, përmes të cilëve mishërohet realiteti aktual me ndjenjat dhe përjetimet emocionale të autorit, dhe i gjithë ky kompleks, kjo shumanshmëri ka një dominant rreth së cilës përmblidhen gjithë përbërësit e saj që dallojnë nga poezitë e tjera - ka botën e thellë imagjinare dhe shumëdimensionale të Zaplluzhës, pra botën e nënndërgjegjshme, që kalon edhe përtej kufijve të së dukshmes, logjikës racionale, për tu stacionuar në pafundësinë e parajsës shpirtërore, aty ku ndjenjat, të lira prej logjikës së kodifikuara, arsyes së kornizave të sipërfaqësores të kufizuar nga perceptimet shqisore ndaj botës objektive, shprehen me gjuhën e pastër engjëllore, aty ku gjendesh përball pasqyrës që reflekton realitetin tënd - dhe t'i sheh, me sytë e shpirtit, përtej kornizave të së dukshmes. Në këtë oazë kristalore, shpirti flet me gjuhën e ndjesive më të çiltra e më të pastra, gjuhë me të cilën në botën e arsyes vështirë mund t'i kapësh përgjigjet... Këtu gjithçka është hyjnore, sepse rrjedh natyrshëm, ashtu siç është dëshira dhe vullneti i vet shpirtit njerëzor - këtij shpirti që i dha bekim dhe frymë vetë Madhështia, prandaj poezitë e Zaplluzhës i shpërfillin rregullat e kornizave të sipërfaqësores nëpër të cilat është mësuar të lëviz mendja jonë me sjellje, norma të kufizuara e të kodifikuara, çofshin ato edhe drejtshkrimore. Nocioni se gjithçka mund të jetë "racionalisht" e shpjegueshme është veçori e "epokës moderne", një epoke të kufizuar vetëm në logjikë dhe arsye! Është absurde t'u kërkosh poetëve t'i shpjegojnë

ndjenjat e tyre, botën imagjinare! Ndjenjat nuk shpjegohen - ato vetëm ndjehen, përjetohen.

Dhe mu ky stil i të shkruarit, pa kodifikime, i lirë në nënndërgjegjen tonë, që edhe është burim i pashterur i motivimit dhe kreativitetit krijues, e bën edhe më të afërt lexuesin me poezitë e autorit Zaplluzha, e bën lexuesin pjesë të poezisë, duke mos e lëne pasiv të kaloj mbi rreshta formalisht, por duke u thelluar në brendi të tyre dhe mishëruar me ta. Lexuesit i duhet të depërtoj përmes vargjeve të pasura me metafora, të endet si një bletë lule më lule, që në fund ta shijoj nektarin e ëmbël të vargut të shkruar, që në të shumtën e rasteve fletë më shumë se një shkrim i tërë proze.

Poeti Zaplluzha, çështjen e shtruar të vargut nuk e shpreh për të krijuar formalisht, por ai ka rimtin e caktuar të rrjedhës, simbolikën e thellë, magjinë e fjalës, fjalorin e tij të pasur, madhështinë e metaforës, metrikën e kohës, intonacionin që di të jetë edhe i ashpër po edhe i butë, ka figurat, koloritetin dhe shkathtësinë për t'iu dhënë kuptim e jetë vargjeve të tij.

Edhe në këtë përmbledhje të tij poetike, por edhe në ato të hershme, poeti Zaplluzha, përpiqet që lexuesit t'i jap diçka më shumë e më përtej mendimit të rëndomtë, ai kalon përtej caqeve të të kuptuarit logjik për ta pasqyruar realitetin e transformuar, që në gjuhën e estetikës quhet art.

Veprën me poezi, "Në prehrin e pemëve", autori e ndanë në tri cikle: cikli i parë - "Kur shiu i zgjatë duart", cikli i dytë - "Mbetëm si tingujt e metaforës" dhe cikli i tretë - "Shoh se si përpëliten eshtrat", brenda të cilëve janë të përmbledhura 69 poezi.

Qëllimisht nuk kam bartur vargje nga poezitë, siç ndodhë zakonisht në parathënie librash, për të komentuar përmbajtjen dhe mesazhet e tyre në mënyrë më të hollësishme, se do më duhej vërtet shumë kohë, pasi në secilin rresht, të poetit të madh Zaplluzha, është e shkrirë një histori! Këtë po ua lë lexuesve të nderuar dhe të etur për fjalën e shkruar që ta lexojnë, shijojnë, përjetojnë dhe interpretojnë secili në mënyrën e vet, pasi secila qenie është një unikat në vete.

Thuhet se jeta është një rrugëtim! Rrugëtim nga një skaj, në tjetrin! Proces i natyrshëm i ligjit universal... Shumëkush këtë rrugëtim e mat me hapa! Shumë të tjerë e peshojnë me kohë - sekonda, orë, ditë, vite të llogaritura në kalendarë... por edhe të tillë që e kalojnë të zhytur në melankoli! Adem Zaplluzha këtë rrugëtim jete është duke e matur e peshuar me GJURMË - gjurmë të trasuar me bardhësinë e shpirtit dhe ngrohtësinë e zemrës, gjurmë të trasuar me fuqinë e mendjes dhe mprehtësinë e penës, gjurmë të trasuara me vlerat më të larta, më të pastra e më të çmuara: artistike, intelektuale, shoqërore e njerëzore - gjurmë që mbesin në kohë përjetësisht.

"Arti është krijuar që të përjetohet e jo të kuptohet. Andaj, çdo herë artet, kur dëshirojnë të jenë të kuptueshëm, çdoherë thonë budallallëqe’’.

***

Zëri i largët i shiut që na "lag" nga afër...

"ZËRI I LARGËT I SHIUT" I ADEM ZAPLLUZHËS
(esse)

Përparim Hysi



Më erdhi me porosi të posaçme , përmjet emailit tim, libri i fundit (më saktë: i posa shkruar i Adem Zaplluzhës). Jo më kot nuk e vura në kllapa: do qe gabim i madh imi sikur të shkruaja: i fundit. Duke qenë se është një "makineri e vërtetë" krijuese, pa menduar se zmadhoj diçka, por jam i sigurt se, ndërkaq, Adem Zaplluzha do ketë filluar të shkruaj një libër tjetër. Nuk besoj se nuk e njeh kush krijimtarinë e tij cilësore, por, sidoqoftë, nuk është pa vend që të vë në dukje një "P Ë R J A S H T I M" për të: është më uniku në gjithë letërsinë mbarë shqiptare dhe zor se ia gjen kund të ngjashmin në botë. Është 71-vjeç dhe deri tani ka shkruar plot 119 (po e shkruaj me shkrim që mos ma merrni për lajthitje: njëqind e nëntëmbëdhjetë) libra. Më shumë vepra se sa jetë. Natyrisht, duhet kritika letrare që ka për objekt të

saj evidentimin e vlerave, duhet ta veçonte Adem Zaplluzhën si Poetin rekordmen për në librat "Geenes", por kritika është duke bërë atë gjumin dimëror që bëjnë arinjtë. Adem Zaplluzha është "makineri" që prodhon poezi cilësore dhe askund nuk ka në këtë" miell prej gruri kuturli", firo apo lëndë për krunde. Ai ka një këndellje të vërtetë, ndërsa shkruan. Duke qenë një nga ata që shkruaj, nuk kam se si mos impresionohem prej tij. Këndellja nga puna krijuese nuk është vetëm "pronë " e Zaplluzhës. Nga kjo këndellje "vuajnë", pothuajse, të gjithë krijuesit. Veçanërisht, poetët. Në poezi, "vuajtja" është më e drejtpërdrejtë e më konkrete. Mos kujtoni se flas me apriori.

Duke hyrë në "xhepat" e kujtesës sime (libri që t'i referohem, më mbeti në Amerikë), po ju sjell si shembull as më pak dhe as më shumë, por, pikërisht, atë që kritika e kohës e quante "Tata i Letrave Shqip". Është fjala për të madhin Atë Gjergj Fishta. Sado me detyra madhore (kreu i kishës katolike me seli në Gjuhadoll), drejtor i gjimnazit françeskan, dhe bash,

Atë Gjergj Fishta, në letërkëmbimin me Atë Dodanin, shkruante (lexuesi të më falë, në këtë ligjëratë të drejtë ka dhe "firo"fjalësh) :- ... në 12-ditë, pra, vetëm për 12-ditë kam shkruar 1200 vargje 11-rrokësh e 7-rrokësh dhe bash me "ariete" të tjera. Dhe tan këto vargje me rimë. Kur po ju shkruaj kështu, kam parasysh Metastisio i cili për 18 ditë i ka shkrua 1500-vargje. Shih pra: kam arrit një rekord në poezi!

E solla këtë këndellje si një ballafaqim, për të thënë as më pak dhe as më shumë që krijimi është edhe përjetim, edhe vuajtje, por edhe gëzim.

* * *

Libri i Adem Zaplluzhës ka titullin simbolik: "Zëri i largët i shiut". E lexova me një frymë dhe pashë që, sado "zë i largët", po sikur po më "lagte" nga afër. Se doje nuk doje, të "lagte" e të bënte "qullë" sa nuk kish zjarr që të të thante. Dhe tek humb përmjet vargjeve (më poshtë, edhe do t'u referohem atyre), tak dhe më vjen ndërmend një shkrim pikant i një krijuesi myzeqar.

Duket më thërret "gjaku", se dhe vet myzeqar jam. Është fjala për mikun tim, shkrimtarin Naun Kule. Naun Kule është nga Libofsha e Fierit dhe, i mërzitur sa nuk ka më

me "defektet" vend e pa vend, të dritave, shkroi asi kohe një fejton të guximshëm: "Fryu era në Vermosh, fiken dritat në Libofshë!". Dhe nuk ishte lehtë asi kohe të atakoje qeverinë (ca më shumë: partinë), por një krijues bëhet zëdhënës i halleve dhe vuajtjeve të zonës ku jeton. Të më fali, Naun Kule, që po e citoj pa i marrë lejen, por, tek shkruaj këtë esse, dua të mbroj veten time. Më shkurt: vërtet që Adem Zaplluzha e ndien "zërin e largët të shiut" në Prishtinë, por këtë zë e ndiejmë nga afër.

Libri "Zëri i largët i shiut" është i ndarë në tri cikle. Tri cikle ku figurat artistike kanë gjetur, më shumë se tek kushdo, një mjedis që të mbushin sa me emocione, aq dhe me asociacione mbresëlënëse. Domenin në gjithë librin e zë metafora. Metafora në poezinë e Zaplluzhës ka fronin e mbretit. Të një mbreti që nuk njeh abdikim. Aq metafora sa gjen tek Zaplluzha, mund të gjesh tek Princi I Lirikës Shqiptare, i pavdekshmi: Frederik Rreshpja. Metafora të tilla që të mbushin emocione dhe mesazhe të bardha gjen dhe tek poetë të tjerë që shkruajnë me vargje të bardha, si tek Fatmir Terziu, tek

Arqile Gjata, tek Lida Laze dhe të tjerë. Por për të qenë më i drejtpërdrejtë me lexuesin, ja tek ju sjell ca syresh: "Nga gjoksi i murrmë i mjegullave të plumbta/ zbresin shira të hidhura/ ose "kopshti i vjetër që ka mbetur i vetmuar/ po i shkund të gjithë stinët/. Më tutje: / aty gjej fëmijë që qajnë me orë të tëra/ për një qese me qumësht. Nuk ke se si mos emocionohesh nga poezitë që kanë firmën Zaplluzha. Për të qenë i sinqertë me auditorin e lexuesit, nuk është në "mizurën" time ky lloj vargu. Unë jam "partizan" i poezisë me rimë. Nuk para m'i "tretë" stomaku im prej lexuesi, këtë lloj vargëzimi, por ndodh si me atë që tregojnë: "Baba, kam zënë një hajdut. Ta mbaj apo ta lëshoj? - Mbaje,- bërtiti i ati. E mbaj unë, po nuk më lëshon ai,- tha i biri. Kështu ndodhi dhe me mua. Nuk më lëshon i madhi Zaplluzha!!! Po si mund të më lëshojë, me të vërtetë? A mund të ndahesh nga ai, kur lexon:" Era përqafon kuaj të verbër/ ose / ndërsa nënat i pjekin bukët e ngrohta/ shiu i dimrit troket ndër male/ Dhe tek kapet që të japë portretin e dhimbshëm të nënës, shkruan: "... nëna fanitet si imazh në djep që, sa vjen e zvogëlohet nga dhimbjet", kurse / babai- burrë krenar/... si një mbret që kurrë nuk abdikon/ bëri qindra luftëra/ po asnjërin për Atdheun e tij dhe, kur iku, tha:- Sot do dalë për gjah dhe do të kthehem, kur të jini në liri”. Dhe kështu mund të vazhdoja të sillja vargje e vargje të mbushur me figura.

* * *

Edhe tek cikli i dytë "Paska rënë një shtrezë e brymtë", autori, e fton lexuesin në meditime. Mesazhi i "fshehur" mes rreshtash të bën jo vetëm kureshtar, por dhe kërkues: të vrasësh mendjen se ku do të dalë autori. Po të lexosh me vëmendje, Zaplluzha sikur ia heq petët

lakrorit dhe "lakrat" dalin sheshit. Lexon: "... Ballkani acar e hileqar ka dymijë vjet/ që na bren eshtrat dhe kujtesën/. /Nata e gjatë sa një ëndërr e keqe/ Oxhaku dënes si një fëmijë. Po si mos emocionohesh nga vargje, si: / zbresin shira e djersitur si kardinalë të dehur/ apo/Fanari në heshtje recitonte një psalme të lashtë/ Ja dhe një tjetër:" dy të moshuar kolliten si trena me avull/. Është në natyrën e gjithë poezisë që kultivohet në Kosovë dhe në trevat jashtë Shqipërisë, që poezia të jetë disi hermetike dhe me mesazhe të "fshehta". E tillë është dhe poezia e Zaplluzhës, por dafinën mbi ballë të tij, e vënë figurat artistike letrare. Është, si të thuash, emëruesi i përbashkët i gjithë cikleve të tij poetike.

Se i tillë është dhe cikli i tretë " Si të flas me ëndrrat e vjeshtës". Edhe këtu ose / bie shi i djersitur/ ose/ në një degë të ftohtë ulliri/ këndojnë turtuj të bardhë/ nëpër krahët e trishtilave/depërtoi një stinë e acartë/. Dhe mund të vazhdoja e vazhdoja, por, për të mos u stërzgjatur, s'kam se si mos citoj një si kredo të tij poetike:

" Aq shumë kam ngrënë poezi/ sa jam fryrë si balonë në diell/lexoj dhe stërlexoj dhe, më duket, sikur nuk kam thënë asgjë: Poetët mbajnë ndonjë fije çmendurie në kokë. Unë do t'i thosha Adem Zaplluzhës: " Vërtet që poetët, ndonjëherë, me vargjet e tyre sikur bëhen jashtë planetarë, por ata janë aq tokësorë dhe njerëzorë, se duan që me vargjet e tyre kjo botë të bëhet dhe më e bukur. I tillë je dhe ti, Poeti Adem Zaplluzha që "zërat e largët të shiut", na bëhesh kaq i afërt, sa na "lag" supet e thatë. Shiu yt, i dashur Adem, simbolikisht është si një shi pranveror që nuk i bën dëm as lulëkuqes, kësaj luleje që është më e brishta në botë.

YJET E NGRIRA TË KUJTESËS“ TË AUTORIT ADEM ZAPLLUZHA

Dedë Preqi

Pas një suksesi evident që arriti autori Zaplluzha me librin e 119-të me radhë, shkrimtari nuk pajtohet me numrin e tyre, duke i dhënë vlerë krijimtarisë së vazhdueshme, i cili e shton vathën e tij edhe me një fryt të ri, me librin me poezi „Yjet e ngrira të kujtesës“.

Është fakt se numri i madh i veprave të Zaplluzhës, janë vlera artistike letrare dhe bëhej fjalë për një autor të rrallë me një krijimtari të tillë, pikërisht lexuesi e ka më lehtë ti njohë dhe më mirë fshehtësitë e aparaturës krijuese të poetit dhe shkrimtarit në fjalë.

Prandaj, kur dëshirojmë të bëjmë vlerësime të natyrës artistike letrare, pa tjetër duhet të marrim për bazë jo vetëm rrethanat, por edhe origjinalitetin dhe gjeturinë e idesë, si dhe thëllimet psikologjike të poetit Zaplluzha. Është thënë njëherë në një prezantim se, shkrimtarët e mesëm e krijojnë artin letrar, ndërsa ata të mëdhenjtë e krijojnë jetën në art.

Gjegjësisht, shkrimtari dhe poeti Adem Zaplluzha, është një krijues i spikatur dhe më i pasuri me ide origjinale dhe të rëndësishme, të cilat munden të u shërbejnë edhe krijuesve të tjerë të poetikës shqipe. Gjithë ajo tërësi veprash të Zaplluzhës, i ngjanë një pylli të dendur dhe të padukshëm idesh, ngjyrash dhe tingujsh. Prandaj, autori ka rrahur motive të ndryshme të jetës edhe në librin e tij të radhës „**Yjet e ngrira të kujtesës**“, përmes të cilit e sodisim lirisht botën tonë dhe botën magjike.Libri me poezi i radhës „**Yjet e ngrira tëkujtesës“**, është një vlerë e imagjinatës krijuese të poetit Zaplluzha, i cili duke përdorur dhe figurëshmërinë e gjuhës dhe të shprehjes, e nxitë përfytyrimin e një prezantimi paralel të dy botëve- të pushtuesit dhe të luftëtarit kundër tij, përmes betejës së flakës dhe asaj të mendjes njerëzore.

Libri ndahet në tri cikle me poezi, cikli i parë fillon me „Aq afër e kemi urinë“, cikli i dytë „ Yjët e ngrira të Kujtesës“ dhe cikli i tretë „Ky qytet i mistershëm“, të cilat autori i rrah me rrëmbim pulsi të brendshëm, e që nuk përjashton aspektin e një vizioni optimist, duke mos u kufizuar në vorbullat e kohës, edhe pse e kaluara ndodhët si një humnerë e qartë dhe nxitë ndjenjën e ankthit e trishton horizontin pa kufij.

Duke analizuar brumin e këtyre poezive, si p.sh, poezinë / I shkelnim sinorët e kafshuar/

‘’Rruga ishte e gjatë,
Në shpirtin e saj barte
Njëqind vjet qençe“ .

Në këto vargje shprehët më se një rrëfim i gjallë, në një pikëpamje shkrihet tërë koha jonë me shekuj, por qençe, sepse na mungonte ajo më e natyrshmja, deri ta gjejmë ndjenjën e lirisë dhe sigurisë njerëzore. Dhe më tutje vargjet tjera në poezinë **:**

/Thashë se ecjet ishin të gjata/
„Thashë se ecjet ishin të gjata
Më të gjata se sa menduan kalorësit“.

Edhe këtu vërehet, po ashtu prirja dhe fati i kombit tonë, që kaloj shtigje të gjata me kalorësit e vet, edhe se ato shtigje ishin më të gjata se që mendohej. Kryesisht autori e ka përfillur këtë lini edhe pse mund të vërehet, apo ndjehet një refleks, i cili e forcon ndjenjën e galerisë së shpirtit, që sinjalizon herëpashershëm për një vizion më të qartë.

Poezia e radhës, /Me ngjyrën e pikëllimit të zezë/

‘’Ajo kohë mos ardhtë më,
Me dhunë na i merrte djemtë në ushtri
Kurse prindërit me duar të kryqëzuara
Pritnin kthimin e arkivoleve të hirta“.

Përmes kësaj poezie shumë prekëse, përcjellët mesazhi i kohës së vrazhdë që mbretërojë në trojet tona, ku

shprehet pasiguria dhe fataliteti i të rinjve dhe i popullit tonë, të cilët me dhunë i shërbyen kohës së okupatorit dhe nuk fitonin më shumë se arkivolet e tyre. Duhet të theksojmë se, autori nuk tenton të thotë diçka më shumë se që thotë realitetin përmes rrëfimit në këto vargje.

Mandej, veçojmë poezinë, /Aq afër e kishim urinë/

‘’Aq afër e kishim urinë
sa që ajo ulërinte si rropullitë e erës“.
Poeti jep mesazhe të qarta dhe tërë akti i këtyre vargjeve përcjell një dozë fatalizmi, në fakt kur imponohet tërë kuptimin i jetës, lëvizjes dhe gjallërisë së saj, atëherë kur i mungon kafshata, ajo e cila është aq afër, që do ta kaplojë një ndjenjë tjetër dhe e pa kuptimtë, që quhet „uri“.

Në ciklin e dytë të librit /Yjet e ngrira të kujtesës/, ku dhe vetë libri titullohet, autori tenton të thotë, jo vetëm atë që duket, por edhe atë që mbetët e ngrirë në kujtesën tonë.

Citat:

‘’Zgjas duart preki gurtë e murrmë të lagjes’’

‘’I preki shelgjishtet e pikëlluara,
sërish nata e gjatë si ajo e Prekazit
deri në mëngjes vajtojnë yjet“.
Nga këto vargje poeti Zaplluzha, qëndron në gjenezën e asaj që gjithë bota e quan dhembje shpirtërore dhe fizike, që e kaluara e jonë këtë e kishte mall qëndrese, deri në agun e lirisë, duke mos harruar dëshmitarët e saj të vuajtjeve dhe të torturave. Autori përmend edhe Prekazin

legjendar, i cili është krenaria e kombit tonë së bashku me heronjtë e saj të pavdekshëm.

Dhe cikli i tretë, /Ky qytet i mistershëm/ autori në rrëfimin e vet përmes poezive bënë një përpjekje dhe shfrytëzon një argument tjetër, i cili trajton botën e shëmtuar njerëzore, sidomos kur ajo bëhet viktimë e të ligave të veta, të cilat rrjedhin nga vetë shoqëria dhe rrethi i saj. Mistere të tilla ka gjithkund në rrethin shoqëror, por dallimet janë të ndryshme, për aq sa janë edhe të rënda për secilën kategori njerëzore.

Të gjitha këto vargje të poetit dhe shkrimtarit Zaplluzha, janë një lëvizje e pakufishme të skemave poetike të cilat janë në përputhje me zërin e vërtetë të tij, të brendshëm. Secili autor e ka stilin e vet, i cili pak dhe shumë ndryshon nga të tjerët, me domosdoshmërinë shoqërore e historike, por të gjitha janë si rrjedhojë e zhvillimit shoqëror, duke i dhënë edhe letërsisë një shkas dhe një impuls më të fuqishëm, po ashtu edhe shkrimtari Zaplluzha me stilin e vet dhe krijimtarinë e vet, i ka dhënë letërsisë dhe poetikës shqiptare një gurrë të frytshme artistike, e cila do ti shërbejë kohës, po ashtu dhe gjeneratave të reja.

VËSHTRIME QË ZGJOJNË KURESHTJE, NGA LIBRI „DRITARET E VERBËTA“ TË AUTORIT ADEM ZAPLLUZHA

Dedë Preqi

Secili njeri ëndërron thesarin e vet, duke dashur ta ketë, i bindur se atij personi do ti printe fati dhe një ditë do ti numëroj monedhat e fituara. Por thesari është i lidhur me diçka tjetër dhe plotësimi i dëshirave është i tëri i pa mundur, sepse jeta ka shumë ura dhe rrugë që duhet të kalohen, do të jetë e pa mundur ti plotësojë të gjitha. Kështu i nisa këta rreshta për thesarin e autorit Zaplluzha, i cili jo vetëm që ka ëndërruar për një thesar të tillë, por ai vetë e ka realizuar në jetën e vet, duke krijuar një thesar të çmueshëm dhe shumë të rëndësishëm, i cili nuk krahasohet me monedha, por as me florinj.

Kështu, thesari i thjeshtë, por shumë i çmuar i autorit Zaplluzha fillon shumë herët, që në ditët e

fëmijërisë së tij, dhe ky thesar ditë përditë fillon të rrjedh sikur lumi, duke i vënë vulën e vet çdo gjëje, dhe njerëzve dhe frymëmarrjes së tyre, bimëve të njoma e të lëngshme, barit dhe tokës së butë pjellore, si dhe ndryshimeve të kohës, kur ajo shpeshherë e ndërronte motin. Sa më shumë që koha kalon dhe pesha e moteve rëndon mbi supat e autorit, aq më shumë thesari i autorit shtohet dhe merr përmbajtje, ngjyrë dhe kuptim , duke u gdhendur së bashku me shpresat e njerëzve, nevojat, apo plogështit e tyre, si dhe me ngjarjet reale që shqetësojnë njerëzit e pafajshëm, të cilët ishin të etur për jetën dhe lirinë e tyre njerëzore.

Thesari i autorit dhe poetit të madh Adem Zaplluzha, nuk është thesar që shndërrohet në të holla, apo mall shkëmbimi, thesari i tij është vetë p o z i a, thesar më i pa krahasueshëm që kurdoherë e ka vlerën e vet të pa tjetërsueshme, që trashëgohet në breza, dhe shkrihet nën peshën e vjetëve, me veçantitë dhe qëndrueshmërinë e saj, duke kaluar nëpër gjitha ndërrimet e moteve, që lëshojnë rrënjë sa më thellë në vetëdije dhe poetikën shqipe. Letërsia shqiptare përbëhet nga një lum i madh, por kur lëshohen edhe rrjedhat tjera, krijohet një oqean vlerash, të cilat janë burime të pashtershme dhe rrjedha të veçanta të frymëzimeve dhe logjikave njerëzore.

Libri me poezi „Dritaret e verbëta“, i autorit Zaplluzha, është i 122-ti, me radhë, dhe ecja e poetit do të thotë nuk përfundon aq lehtë, duke krijuar për çdo ditë nga një „kullë letrare“ , si duket temperamenti krijues i autorit realizohet me sukses në shtigjet e një gjerësie dhe hapësire të tillë, si argument i fuqishëm dhe i frymëzuar i autorit, mbi të cilin mbështetët ky opus i rëndësishëm i

veprave letrare. Ky libër ndahet në tri cikle, të cilat disponojnë një mozaik të brendshëm të logjikës së fuqishme i mendimeve të poetit Zaplluzha, që kanë jo vetëm pikëpamje poetike, por disa poezi kanë edhe pikëpamje filozofike. Autori Zaplluzha, me natyrën e vet krijuese është një vëzhgues i përpiktë i kohës, jo asaj meteorologjike, por edhe i përcjelljes politike, i cili disponon durim të mjaftueshëm për ti thënë gjërat në çastin e duhur, si një karakteristikë e veçantë e poetit, që ka pretendime të rrufeshme krijuese me përshtypje të mira dhe me shkathtësi të pa para, për ta ruajtur dhe për t'ia mbajtur të gjallë krijimtarinë e tij poetike dhe patriotike.

Cikli i parë fillon me ''Makthet e netëve pa gjumë", cikli i dytë me „Dritaret e verbëta" dhe cikli i tretë me ''Tinëzisht rrotullohen zërat e fatit".

Cikli i parë**, M a k th e t e n e t ë v e p a gj u m ë**

''Nga duart e lypsarëve zgjohen trishtimet
Zgjohen me ëndrrat e sëmura
Makthet e netëve të pa gjumë".

Autori Zaplluzha, edhe në veprat tjera me poezi, në mesin e tyre ka episode të ndryshme të shkëputura që rrëfejnë shpesh herë gjendjen e mjerueshme dhe fatin e popullit të vet, pikërisht edhe këtë herë poeti shpreh dhembjen dhe mjerimin e lypsarëve, të cilët mbetën nën mëshirën e kohës, apo të shoqërisë njerëzore. Mandej, poezia nga frika ose mosdija.

‘’Vdisnit vetëm për të ju lavdëruar i huaji
Një pjesë të një gjymtyre,
E varrosët në rërat e huaja
Kurse në atdhe s’patët vend për një kryq“.

Janë këto vargje të ndieshme, të cilat mund të merren si paralajmëruese dhe sinjal për kahen e linjes tonë shoqërore, që jeta i hedh dhe i përcjellë në margjina të ndryshme, dhe sikur nuk është në gjendje që ti mbajë të gjithë penjtë e diskrecionit në duart e veta. Poeti në këtë rast ngre një porosi, sidomos për ata që jetojnë jashtë atdheut, një detaj ku autori ndjekë lirikën e vet sipas rrëfimeve realiste dhe ngjarjeve të vërteta të atyre që përjetojnë jetën diku larg, jashtë rrethit dhe atdheut të vet, duke lënë edhe një pjesë të gjymtyrëve në ato vende.

Marrim dhe vargje të tjera nga poezia, ‘’Ngjanë ecjes së këtyre maleve’’.

‘’Njerëzit dhe drurët e atdheut tim
Janë të ngjizur për këto male
Në shpirtin e secilit zgjohet
Një dashuri e pa parë
Kur i dëgjojnë daullet e kushtrimit“.

Prandaj, edhe në këto vargje lirike të poetit Zaplluzha, ndjehet jehona e tingujve të lirisë, e cila buron nga njerëzit e vendit, që poeti i zëvendëson me drurët e maleve dhe ushqehet nga shpirti i secilit dhe zgjohet në kushtrim për liri me dashuri.

-Cikli i dytë ‘’ D r i t a r e t e V e r b ë t a’’

‘’Nga një libër i vjetër
Trishtueshëm i shkundi
Trishtimet e një jete.
Shkundi edhe vetveten
Nga një përgjumje e përdalë,
Një zog me krih të thyer
Noton mbi sterrën e plumbtë
Dritaret e verbëta
As nuk hapën, as nuk mbyllën
Qetësia po i çmend mushkonjat e verdha“.

Në fakt autori nuk fshehë sekretet e veta poetike, por ato i shpalos para lexuesit, edhe pse ndoshta e quan vetën si një zog me krih të thyer, dhe dritaret e verbëta, as nuk hapën e as nuk mbyllën, prapë se prapë gjen rrugë të tjera, të cilat janë shtigjet e jetës së hidhur dhe të ëmbël, që duhet sprovuar.

I nxjerrim edhe disa vargje nga poezia’’ N u k di a t’i shkruaj një lutje Z o t i t!’’.

‘’Nuk di a t’i shkruaj një lutje zotit
Apo ti urdhëroj
Edhe nëse këtë e bëjë.
Kot do ta kam
Zoti im nuk di shqip,
As unë se njoh gjuhën e tij“.

Kjo është një metaforë e poetit, i cili ka të drejt të bëjë edhe një pyetje të tillë, duke iu drejtuar Hyut të vet, edhe pse nuk e njohin gjuhën e njëri-tjetrit, por më rëndësi është se lutja është një tingull, apo heshtje, që realizohet në gjuhë të ndryshme, por përkthehet në një gjuhë të vetme para Zotit.

Poeti i këndon edhe moshës, sikur në poezinë''**Ah kur isha i ri''.**

''Kur isha i ri
Ah kur isha i ri,
Vetëm një poet rebel
Mund të krahasohet me mua
Unë kurrë nuk e besoja
Se do të plakem një ditë kaq shumë".

Sa e rëndësishme është jeta dhe periudhat e saja, por ajo në çdo kohë i ka përshtypjet e veta, të cilat lejnë vragë të pa shlyera edhe në rini, por edhe në pleqëri. Edhe pse poeti mendon se njeriu plaket shumë shpejt, por kohën nuk mundet askush ta ndal, dhe si e tillë atë, duhet shfrytëzuar për të mirë, pa i humbur meritat e saj.

-Cikli i tretë:'' **T i n ë z i sh t rr o t u ll o h e n z a r e t e f a t i t''**

''**Nëpër kafenetë e mbyllura**
Tinëzisht rrotullohen zaret e fatit,
Ky rulet xhepi
Për çdo natë në lokalet e pista
Kafshon nga një shpirt të lënduar".

Vetë fjala, zaret e fatit e ka kuptimin e lojërave fatale që njerëzit marshojnë edhe pse më shumë humbin se fitojnë. Prandaj, shprehja figurative e poetit është analizë e qartë e rrëfimeve të fateve njerëzore që lozin me jetën dhe fatin e vet, duke e lënë edhe pjesën e fundit të pasurisë së vet në rrotullzën e fatit, e cila është një lojë e pistë dhe e rrezikshme, sidomos për ata që mendojnë përmes kësaj loje të përfitojnë, duke mbet shpesh herë me gishta në gojë.

Po ashtu, edhe në poezinë,

‘’Çdo kush do më njihte se jam shqiptar’’

‘’Po të isha edhe në fund të botës
S’mund të jem asgjë tjetër,
Përpos një imazhi të bardhë
Që i përngjanë
Maleve të Sharrit me qeleshe.
Po të isha edhe në fund të botës
Në mesin e njerëzve më krenarë
Me këtë bardhësi shpirtërore
Çdo kush do më njihte se jam shqiptar“.

Përndryshe, kjo vepër e poetit Zaplluzha, është një lirikë e shfrenuar për një hapësirë të pafund, të prirjes së poetit dhe për efektet letrare, me ç’rast ka mundësi të zgjedh nga më të mirat në disponimin e vet. Në këtë mënyrë, penda e poetit Zaplluzha i ka karakteristikat e veçanta, e cila gjithherë shërbehet me ngjyrën e pa anshme të shprehjes artistike letrare, dhe cila asnjëherë nuk shndërrohet vetëm për qëllime vetiake, për të

kënaqur motive interoverte, por gjithherë në shërbim të kuptimit më të mirë letrar dhe atij njerëzor. Të gjithë ata poet dhe krijues që disponojmë qëllime të tilla, s'ka dyshim se edhe letërsia shqiptare do të mbështetet dhe përqendrohet në këto shtylla të forta, e cila nuk e ka vështirë të shënojë edhe historinë e vet të qëndrueshme dhe të lavdishme.

ADEM ZAPLLUZHA, NJË SHPIRT I LIRË QË NOTON NË MODERNITET

Qazim D.SHEHU-POET
Tiranë, 17 dhjetor 2014

Poeti Adem Zaplluzha përfaqëson në vetvete një krijues të zëshëm ,origjinal,i cili viteve të fundit, ngulshëm, është shfaqur në shtypin letrar kombëtar me arritje të forta të të shprehurit metaforik, duke sjellë një botë sa konkrete ,aq transhendente, në metafizikë të shkëlqyer, përcaktuar nga asociacione shprehëse, polivalenca e të cilëve arrin në skajet e një mendimi, ku largësia na thërret ta vrasim mendjen e na fton të futemi nëpër skutat e nëntekstualë të figurave qenësore. Befasia e figurës është veçori kryesore e këtij poeti të arrirë, befasi që të trondit me veçanësinë e një gjetje të bukur, çka dëshmon imagjinatë poetike të autorit. Për një poet nuk ka rëndësi tematika, as rreshtimi i vargjeve, përkundrazi ,për një poet është e rëndësishme imagjinata e lirë.Jo një imagjinatë e shfrenuar ,po një imagjinatë që nuk i ik dhimbjes njerëzore, kohës; dhe, përmes detajeve, ravijëzon gjithë atë konturitet kohor të mirëpërcaktuar.

Kështu, Adem Zaplluzha na e sjell përherë e më dukshëm kohën, jetën, ambientin, por pa i vizatuar ato me konkretësinë e një realizmi përshkrues, por konvencionalisht. Konvenca është tipar i stilit të këtij autori që merr formë përmes emërtimeve të largëta të metaforës,mpiks e çliron kuptime të shumëfishta;gjë që shpreh një dyndje imazhesh që të trondisin. Autori nuk vizaton pamje reale,po ,përmes ideve dhe gjetjeve të shpirtit, arrin tek to;kjo mënyrë e bën atë një poet modern, shprehësimësisht i tillë;di të kapërceje dhe joshë me vizatimet e tij ideore. Është individi i Kosovës dhe i truallit shqiptar që mbartet përmes frymës dhe dashurisë, përmes dhimbjes, mallit, përmes gjendjeve abstrakte dhe të veshura deri diku me tisin e legjendës historike urbane,aktuale ose të pritshme në një horizont gri, të çelët apo të hapur e të mbyllur. Janë përjetimet e poetit që kërkon të na zbulojë psikikën e këtij individi të kohuar përmes rrapëllimave historike, fatit të vështirë dhe dashurisë për jetën. Poezia e Zaplluzhës si e tillë mbartet edhe tek ky vëllim,duke dëshmuar prerjen vertikale që ai u bën kohërave ,rasteve të saj, duke dëshmuar fuqi kreative dhe zhbiruese në pamje dhe loje ekzistenciale idesh.

Poezia e tij i ik rrëfimit të shtrirë, linear dhe përvijohet përmes kontrapunkteve ,duke harmonizuar një strukturë të thyer ku ngjizen pamjet përmes gjendjeve të tij.Kjo ta kujton Martin Camajn,Frederik Reshpen,Ali Podrimen, poetë të hollë dhe befasues. Them ,ta kujton,sepse shtrati i poezisë moderne ndërtohet mbi shprehjen intelektualiste dhe nervin e fjalës së kulturuar, përvijon gjendje ankthi,thyerje e sintezë të vargut. Në këtë shtrat poeti ndihet mirë, veçues në stil dhe këmbëngulës në

kërkimet e veta. Këto kërkime janë thurima të mallshme të një shpirti njerëzor që kërkon të gjejë kuptimet e atdheut, rinisë, mërgimit, dashurisë, fëmijërisë, të kalojë në një peizazh lëvizës,me konotacione të holla dhe të bukura. Duke u hedhur nga antikiteti në të sotmen autori bën një shkrirje kohërash gjen trillin e tyre dhe pikëtakimet, bën diferencën shpirtërore ,kërkon atë që i dallon dhe krijon paralele historike. Të mbeten në mendje shprehje të tilla të bukura si:Një hënë e re feks nëpër shpirtin e mjegullave;kur mbërrimë në ishullin e mendjes,një zanë mali i lyente thonjtë hënës;me shekuj kaluam prej një ane, në anën tjetër të fjalëve; etj etj. Kulturimi i shprehjes nuk është qëllim, as letrarizëm, kulturimi i shprehjes poetike është veçori e poetëve të hollë. Krijimi i identitetit të njeriut duke kërkuar qenësinë e munguar përmes anktheve ekzistenciale në një sfond të munguar kombëtar dhe të rrafshit individual,vjen në poezinë e tij natyrshëm;sidomos e shprehur kjo në poemthin:”Po të lindja njëqind herë”.Kërkimi i rrënjëve të fisit, të ndërgjegjes që kërkon të natyralizohet, vjen përmes vargjeve të shkathëta dhe kuptimplotë. Dashuria për etninë shprehet këtu me ndërlidhje të forcës kërkuese për jetën. Fjalët poetike shprehin largësinë e viteve në kufijtë e mitit të mbijetesës;është një poemth i dinamikës së shprehjes dhe i forcës së moralit njerëzor që jep portretin kolektiv të një populli të mbijetuar ,që, para se të krijonte zotat paganë ,iu desh të krijojë veten për shkak të fqinjëve të tij gllabërues. Gjithçka nënkuptohet përmes metaforave të qëlluara dhe mjaft origjinale. Simbolika e mjegullave dhe e hardhisë e mbartin mirë kuptimin shumështresor të fatit dhe të jetës. Kjo simbolikë shtrihet në një gjatësi

kohore që ende s`ka mbaruar. Mjegullat,shiu, hardhia, drurët,zogjtë,korbi i Poes, prapë mjegullat, bëhen disa fjalëkyçe poetikë në poezinë e Zaplluzhës që mbartin kuptime tërësore të fatit historik të individit në këto troje ku u luajt fati plot epope dhe dramatik i njeriut shqiptar dhe atij ballkanik. Natyrisht poeti nuk rrëfen, ai shpreh, nuk del hapur të na thotë ato që ne dimë ,po të ngacmojë kujtesën ndiesore të këtij fakti. Kjo është padyshim zotësia e të shprehurit modern të këtij poeti, i cili me vargun e tij arrin të na fusë ndryshe në mendime. Poezia duhet të interferojë dhe jo të referojë,kjo mbetet maksimë e qëlluar e të kuptuarit të poezisë së mirë. Interferenca krijohet mbi bazën e objekteve poetike që shprushiten jo përmes përshkrimit të tyre,po duke u thirrur të shpalosin shenjat përmes fantazisë së poetit;janë disa shenja të cilat zbrazin kuptimet në idetë e thurura. Gjallësia e tyre ,përmes semiotikës e krijon bukur mirë një atmosferë që shpalohet e ngre në mitin e kujtesës nevojën për jetë. Dhe, padyshim, këtu,mund të themi se poeti ndjehet mirë dhe i jep udhë fantazisë së tij në kërkimin e vazhdueshëm drejt shtigjeve të reja të të shprehurit. Siç e kemi shprehur , metafora bëhet një çerdhe strehuese për ide të reja fleksibiliteti i të cilave na josh. Metafora zbulohet përmes një emërtimi emëror,jo foljor në të shumtën e rasteve;krijohet e shpërfaqet në befasinë e gjetjes. Vektori estetik i Zaplluzhës është i thellë,kundrues dhe përgjithësues,ai e lidh horizontalitetin e shprehjes. Zaplluzha është një poet intim filozofik,intimiteti i tij është domethënës,nuk u afrohet çasteve konkretë, po, përgjithësisht ngërthehet në shpalime të gjëra të meditimit përjetues. Ky vektor estetik na jep qasje të gjëra të një shpirti në kërkim, kurrë

të qetësuar, na flet për një poet të përkushtuar të poezisë,një poet që punon e punon dhe arrin që të shkruajë mbi 121 njëqind e njëzetë e një libra poetikë duke i ngjarë Ricosit për nga sasia, po kurrë nuk e zbret nivelin artistik;kjo gëzon çdo dashamirës të poezisë, edhe pse në këtë kohë të pa kohë gjërat mezi vihen re. Megjithatë, gjërat mbeten dhe në derën e shurdhët të kësaj kohe duhet të trokasësh me ngulm. Zaplluzha është një poet ngulmues dhe kërkues, një poet që gjithnjë e më tepër ecën nëpër udhën e vet poetike të trasuar, udhë që është vetëm e tij. Nga ai mund të mësosh, madje shumë, mund të frymëzohesh dhe të të ndalesh me vëmendje,larg çdo egoizmi, sepse nga poetët e mirë gjithnjë mëson. Mëson nga të shprehurit modern, befasia e shprehjes, afërsia e saj me ngacmimet e tua ndiesore. Poet i Prishtinës dhe i Kosovës, Adem Zaplluzha zë një vend të merituar në Letrat tona,ai mbetet një zë i fuqishëm i letërsisë së re shqiptare, krahas Frederik Reshpesh, Martin Camajt, Ali Podrimes, Azem Shkrelit, Fatos Arapit,Xhevahir Spahiut, Din Mehmetit. Kjo ,në pikëpamje të tipologjisë së të shprehurit modern, po kurrë nuk duhet harruar se ai menjëherë ta kujton origjinalitetin e vet. Punon vazhdimisht dhe sjell çdo vit katër pesë libra poetikë,duke dhënë një shembull të këtij Balzaku të poezisë ,se arti kërkon përkushtim ,jo fjalë kafenesh. Në përfundim, ne mund të themi, se poezia e këtij poeti kërkon gjithnjë vëmendje dhe meriton këtë edhe në Forumet letrare të sotme, të cilat shpesh zotërohen nga klanizmi,po kjo nuk ka fort rëndësi; rëndësi ka që poeti duhet të jetë poet. Zaplluzha është një poet i shkëlqyer modern; me fantazi të ndezur, me shpirt të lirë që noton në dallgët e një metafore origjinale.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE 5
JETA DHE VEPRA E POETI TË KOSOVËS ADEM ZAPLLUZHA 10
KËNGËTIMI POETIK I ADEM ZAPLLUZHES, PASQYRIM I BOTËS REALE 13
KONTRIBUTI I DHËNË NË FUSHËN E LETËRSISË POETI YNË ADEM ZAPLLUZHA 19
FJALËT QË DALIN NGA LËVOZHGA SI DO ZOGJ TË SHENJTË 22
NË VEND TË PARATHËNIES 25
VALLJA E VARGJEVE TË LIRA NË TRUALLIN DARDAN .. 27
VËSHTRIM I SHKURTËR RRETH KATËR LIBRAVE ME POEZI 31
ADEM ZAPLLUZHA, “KAMPION” I BOTIMEVE PËR VITIN 2012 39
AFSHI I SHPIRTIT TË ZHURRITUR PËR DASHURI DHE ATDHEDASHURI 44
MBI POETIKËN E ADEM ZAPLLUZHËS 51
LIRIKA KOSMOGONIKE E NJË SHQIPTARI ETSHËM PËR DITURI 58
POET I SIMBOLEVE DHE MENDIMIT TË THELLË 64
KUR I LËMË GJURMËT TONA 68
RINGJALLJA E ROMANTIZMIT DHE OPTIMIZMIT TË POETIT 74
ADEM ZAPLLUZHA MBI FLATRAT E IMAGJINATËS 79
KOHA SHQIPTARE E NJË KRIJUESI KOSOVAR 83
PARATHËNIE 87
PAK SI HYRJE, PAK SI PARATHËNIE 92
SHENJA TË NDRITSHME SHQIPTARE 96
KRIJUESI QË NUK VJETROHET 100
ORIGJINALITETI I NJË POETI MODERN 105

DAULLET E NETËVE KOSOVARE 110
ATY KU FJALËT PËRHERË FRYMOJNË 115
PAK SI PARATHËNIE, PAK SI HYRJE 120
NJË JETË E TËRË DHËNË PAS POEZISË DHE ME POEZINË 130
VËSHTRIM RRETH LIBRIT''KUR DEHEN PERËNDITË''POEZI TË AUTORIT A.ZAPLLUZHA 134
NËN UTURIMËN E MJEGULLAVE – POET ME VIZION MEDITATIV 139
PLAKU ME PENDËN PLOT MARGARITAR 143
ATDHEU I PAÇMUAR DHE I KALTËR I ZAPLLUZHËS 152
METAFORA E NJË LIBRI QË SHKON DREJT NJË REKORDI 157
UDHËTIMNËPËR VARGUN KRYENEÇ TË POETITADEM ZAPLLUZHA 161
FJALA E REDAKTORIT 169
POETI QË NA BIND ME KARAKTERISTIKAT E ORIGJINALITETIT 175
VARGU I POETIT ADEM ZAPLLUZHA SHPËRTHEN EDHE TE HAIKU 183
NJË VEPËR E RRALLË QË PJALMON KURAJO DASHURI DHE HUMANIZËM 188
KËNGËTIMI POETIK I ADEM ZAPLLUZHËS, PASQYRIMI I BOTËS REALE 200
POEZI QË KËNDELLIN DHE SHËROJNË SHPIRTIN E LEXUESIT 203
NËN UTURIMËN E MJEGULLAVEPOETI ME VIZION MEDITATIV 219
SOT KOHA NDRYSHON SHIUN E SJELL VARGU POETIK 223
POEZIA SI TESTAMENT GJAKU E LIRIE 225
PËR VEPRËN „DËNESTE BASHKE ME ERËN" 233
DRURI I PIKËLLUAR 237
AMËZA E PËRVOJËS POETIKE 242

NËPËR GJYMTYRËT E MJEGULLAVE TË ADEM ZAPLLUZHËS 251
“ZJARRI I MALLIT TIM”, ZJARRI QË NUK SHUHET ASNJËHERË 256
VJERSHËRIMET E BUZËQESHJEVE TË HUMBURA 261
PËR NJË “BRENGË”, QË MBETET E PASHËRUAR?! 267
DISA ÇASTE ME POETIN ADEM ZAPLLUZHA 271
PAK FJALË PËR LIBRIN 276
MESAZHET QË I THËRRASIN KOHËS 278
NËPËR PLASARITJET E MUREVE 285
POEZI FOSFORESHENTE ME RRËNJË FJALE QË LIND NGA KOCKA E POETIT 290
DY FJALË PËR LIBRIN ME POEZI “NJË SHI PREJ BRYME” 296
POEZI ME ZËRIN E ARSYES DHE FUQINË E NDJENJAVE 299
"ZËRI I LARGËT I SHIUT" I ADEM ZAPLLUZHËS 306
YJET E NGRIRA TË KUJTESËS TË AUTORIT ADEM ZAPLLUZHA 311
VËSHTRIME QË ZGJOJNË KURESHTJE 317
ADEM ZAPLLUZHA, NJË SHPIRT I LIRË QË NOTON NË MODERNITET 325

ISBN:9789946-36-2
Botuesi :“MEDAUR”

DURRËS